

NANDO ELMO

DITË pas DITJE

Ditar 2005 / 2007



KALUQI

NANDO ELMO

DITË pas DITJE

Ditar 2005/2007



Te kopertina, pjesë nga “Sokrati e Platoni”, sek. XIII, The
Granger Collection, NYC

Botuar privatisht
Rivarolo Canavese në Shënmartir 2017

NOTA INTRODUTTIVA

*Die Ros ist ohn Warum. Sie blühet, weil sie blühet.
Sie achtet nicht ihrer selbst, fragt nicht, ob man sie siehet.
(Trandafila nëng ka pse; lulëzon pse lulëzon
Për vetëhenë e saj ng'i ka kujdhes; e ngë kërkon t'jet e vështruar)
Angelus Silesius*

Πάντα γὰρ τολμητέον / Kem' të guxomi ngajjë (Plato)

*Non senza una musica, dentro, per addolcire la mente...
(Bufalino)*

Non so quale follia (divina, la follia – mania – è sempre tale, dei mani appunto) mi abbia preso nella decisione di raccogliere i miei scritti (italiani e arberischi) come se dovessi salvare qualcosa di prezioso. Ma il daimon così ha decretato – non solo Socrate ne aveva uno, che lo sconsigliava dal fare cose sconsiderate - il mio mi spinge ad osare. E non posso disubbidirgli. Silesio decreta quello che decreta, e chi potrebbe dargli torto? Tutto è senza “Warum”, senza perchè, non solo la Rosa. Siamo d'accordo. Delle quattro cause aristoteliche, dopo la “morte di Dio” ne abbiamo perso almeno due: la efficiente e la finale. Non sappiamo chi ci abbia fatti e dove andiamo. E allora? Bisogna essere matti a pensare di conservare una qualche traccia di noi effimeri.

Mi sto esprimendo in italiano perchè chiunque si trovi tra le mani questa cosa arberisca sappia con che abbia a che fare e soprattutto capisca: che capiscano tutti, soprattutto tra gli arberischi, i puri e i duri – e i pigri.

Dunque. Non so quale follia mi abbia preso e in mano di quale dio (dio sarà morto ma non gli dei) sia caduto, lo ripeto. Ma

posso immaginare che stia raccogliendo questi scritti per lasciare una traccia della lingua di Acquaformosa (o similtale, dirà qualcuno, almeno nelle strutture morfologiche), a chi verrà e per lasciare del materiale di studio ai linguisti del futuro; soprattutto a quelli di Cosenza.

Ho contratto un debito col luogo e la lingua dentro cui sono stato gettato (il Geworfenheit di Heidegger). Lo devo saldare, se non voglio essere un deietto (Verfallen) e non voglio essere nella inautenticità (Uneigentlichkeit).

Il mio lavoro vuol essere testimonianza del passaggio destinale, ma casuale, nella storia, di un tipo che quando, con chissà quale pervicacia, questi scritti di varia umanità componeva, non sapeva a quale fatica si sarebbe sottoposto nel futuro.

Oggi. Improbis labor. Perché non so per quale lettore stia raccogliendo questi lavori (lavori). Per i miei figli? Essi non sanno una parola di arberisco (non dico di albanese per ovvi motivi - e per evitare fraintendimenti) e della parlata di Acquaformosa.

Sì, della parlata di Acquaformosa-Lungro.

*Sì, d'accordo, ci sono tante interferenze, che rendono alle orecchie delicate "barbara", la mia lingua (**langue/parole**). Ma quale lingua oggi è pura? Sentite l'italiano quanto è invasivo e pervaso dall'angloamericano - l'italiano come lingua bastarda. Lingue bastarde, dunque, ovunque ti giri - la globalizzazione e il globish. Soprattutto, se come me, si affrontano argomenti di non facile comprensione. Sono convinto d'essere l'unico arberisco ad aver trattato argomenti di tale portata per oltre duecento pagine.*

Lingua inventata dirà qualcuno. Ma quale poeta non inventa la sua lingua?- anzi uno è poeta proprio perché inventa (poiein) la sua lingua; e deve inventarla se percorre sentieri non battuti da altri (se evita i luoghi comuni). L'ha fatto Dante (si licet), l'ha fatto Pasolini, lo fa oggi Camilleri, per citare i primi che

vengono alla memoria – e come non seguire tali maestri?. E tutti come Solomòs, l'inventore del neoellenico, hanno "comprato" parole. Da chi? Dante dai poeti in volgare del suo tempo, dai siciliani soprattutto (Rosa fresca aulentissima); Solomos dai popolani della sua Grecia; Pasolini dai borgatari e da Sergio Citti; Camilleri non so da chi. Solomos ha "inventato", per il neoellenico, parole come "korfoulemos", "argadini" ecc...di cui, ancora oggi, pochi conoscono il significato – non il mio amico, greco di Tinos, Stefanos Armakolas.

Ma è la lingua stessa che ti presta il modo di rendere arberisco, siciliano, casarsese, romano delle periferie, le parole che ti vengono dall'altrove che abiti. Per quanto mi riguarda, ho comprato e compro dalle opere di papas Manoli Giordano, di papas Gjergji Skirò, di Zef Skiro di Maggio. Chiedo poi la consulenza, per l'acquaformositano, a Giosafatte Capparelli. Ho scritto e scrivo, in ogni caso, per "salvare", ricostruire, la casa, diroccata ormai, che ho abitato – la lingua stessa, come casa avita. Ricostruire con i materiali di oggi la casa di ieri, proprio per dare storicità all'abitare – non si dà nessuna lingua una volta per sempre: se sono "cadute" lingue "forti" come il latino e il greco classici, figuriamoci l'arbëresh.

Quale follia, davvero, mentre le componevo, sicuro che nessuno le avrebbe mai lette, queste pagine di diario. Neanche gli addetti ai lavori (ma ce ne sono?). I quali leggono solo la propria firma e non vanno oltre la composizione di pochi versi. Pare che le lingue minoritarie non debbano andare oltre il poetico/patetico; dimenticando o non sapendo che tutto rientra nella poiesis - la filosofia stessa è un gioco di parola, è una strategia linguistica, una retorica – e se Platone, che detestava i poeti, non fosse stato un poeta egli stesso non avrebbe lasciato alla posterità i suoi capolavori, i Dialoghi, che, a detta di Agamben, così aporetici come si presentano, sono solo dei

proemi, dei prologhi, delle ouvertures di opere da scrivere e mai scritte perchè “le cose serie non si mettono per iscritto”.

Oh già: le cose serie non si scrivono perchè la scrittura, dice il solito Platone (sempre lui, che però fa il contrario di quello che predica, entrando così in quella che oggi chiamiamo “la contraddizione performativa”), ha qualcosa di “terribile” (δεινόν): non sa rispondere a chi volesse porle delle domande. “Et vous parlez comme un livre” - Sganarelle rimprovera il suo Don Juan (Molière).

Terza in una sequenza comunicativa, venendo prima il pensiero che è “rappresentazione”, seconda la lingua che è “espressione” della “rappresentazione” (pensiero), terza la scrittura che è appena un’ombra della lingua parlata, la scrittura è traduzione di traduzione di traduzione – e, si sa, ogni traduzione è un tradimento.

Non ci mette su quest’avviso il “divino” quando componendo il “Simposio” trascrive “un sentito dire (di Apollodoro) da un sentito dire (da Aristodemo)”? Perchè Platone non usa la presa diretta come per gli altri “Dialoghi”, proprio in un dialogo che mette in scena la ricerca della “verità” come Eros che è “mancanza”(Eros è figlio di πένια), che è intermedio tra sapere e ignoranza? Nella nostra mancanza (πένια) di “Verità” non ricorriamo a qualche “espediente” (πóρος è padre di Eros) per barattarne un po’? E tutto questo forse sulla scia di quella interpretazione che dà Socrate nel “Cratilo” di ἀλήθεια (che noi traduciamo improvvidamente con “Veritas” – dimenticando la distanza che separa le due espressioni) come “divina (θεία) erranza (ἄλη)”. Io a questa “divina erranza” tengo fede contro tutte le grammatiche, che, secondo Nietzsche, favoriscono la sopravvivenza di Dio (degli enti metafisici): “Temo che non ci libereremo di Dio perché crediamo ancora nella grammatica...”(Nietzsche: Crepuscolo degli idoli: “La ragione nella filosofia”). Più su, nel primo aforisma della sezione citata,

Nietzsche aveva sottolineato: “Questi signori idolatri del concetto, quando adorano, uccidono, imbalsamano – diventano pericolo mortale per ogni cosa, quando adorano” (ibidem). Al posto di “concetto” mettete “grammatica” (o “concetto di grammatica”), il senso non cambia.

Per quanto mi riguarda mi sono misurato (da linguista? Posso darmi questa qualifica di esperto? o sto invadendo il campo di qualcuno? Dio ne liberi, allora dico: solo da funambolo, da clown della lingua) con l’ “arbrescino” per dimostrare a tutti i pigri che è possibile andare oltre i quattro versi estenuati del poetico di monti tramonti mamma papà patria (la metafisica “Albania, patria degli idolatri), amori, altrettanto sfibrati, in totale entropia, ormai. Con l’arbrescino “mio” ho osato (πάντα τολμᾶν) trattare di ontologia, di fede, di papi, cardinali, vescovi, poltici, ecc., ossia di quanto rimane fuori dagli interessi dei soliti “poeti”, appunto. Ho osato, alla faccia di chi pensa che non si possa, e non si debba, osare e che le lingue abbiano grammatiche prescrittive non eludibili: ma chi lo ha decretato? io seguo solo il daimon, anzi il duende dionisiaco, che è quello che è, padrone non schiavo della grammatica – questo è toccato a me, come una monetina, un talento, uno solo, che non sotterrerò, ma investirò a costo di perderlo.

Vorrei sapere chi abbia fatto altrettanto; e soprattutto chi abbia osato scrivere per il niente, per “Nessuno”.

E, paradossalmente, non sono padrone della lingua – e non vorrei esserlo: sarei padrone di menzogne. Mi sono lasciato andare “com’è gh’è” - dicono a Palermo – in una φαυλή παιδιά/in un gioco poco serio . E questo “com’è gh’è” nasconde un inghippo filosofico che non dirò quale sia (non tutto a tutti, per cortesia – come la lingua che uso: non è per tutti; non lavoro per la piazza - ma quei tre o quattro, ai quali mi rivolgo, abbiano pazienza, se non vogliono entrare nel numero dei più, da pigliare a calc’in culo).

Ho agito da poeta, ripeto, immergendomi in un linguaggio e nuotandovi dentro, in estrema libertà. Il resto è, stavo per dire, “chiacchiera” se non fosse tutto chiacchiera, anche quella del padrone dell’Essere (del famoso “Sein” – ma che sarà mai?) che la chiacchiera (la famosa “Gerede”) vorrebbe evitare. La musica, innanzitutto. E peggio per chi non la sente.

1 të Gushtit 2005

Mund t'jet se ka ligj Schopenhauer, grat jan çoma ndër rrënjët e natyrës së tyre. Më vjen kjò ndërde sidomos kur shoh ndërsjelljen e disave, që, për urtësin që kan, ngë prisje t'ishin çoma.

Çoti e lemë e atyrve që kan t'imitojin burrat e "virtytat" (që jan vese) të burravet. Na prisjim ka grat hollësin, ku se jan më të trasha se burrat, kan më arkancje. Shif gjithë këtë ç'u vun me Forza Italia, që burthojin ngamon muskulet, jo vet fizike po edhe shpirtërorë, si Santanchè. Nanì është një fat i keq se sesa më muskule ke, më pak i zgjidhur je. Vallezorët kan pak muskule, drej ata që natyrisht i sosjin sa të rrëjirjin kurmin. Kan muskule jo të frytur pse atyrve i sherbëton zgjidhja, lehtësia.

Kish ligj Sokrati kur thoj se aktivitetat që ndërrojin kurmin dhe e deformarjin (se si bodybuilding), jan aktivitet servile.

Muskulet shpirtërore e gravet, mbë të cilat foltim sipër, i deformarjin shpirtin...

3 të Gushtit

Sot hapa sënduqin e lalës Mikucit që mbet ngamon i mblitur që kur ai vdiq. Mos njeri pat kurajin t'i ruanej mbrënda njera te fundi, sikur se t'ish njetër varr, ai sënduq. Varr'i kujtimit të tij.

Ka na të vdekurit ngë duan kujtuar, sikur se me të folurit do t'i tandonje gjumin e tyre. Vet njëherë i kisha ngrëjtur kuperqen e kisha gjetur dica piniele e dica ngjire me të cilat zura e pindiksa edhe u.

Lalë Mikuci ish një njeri i çuditur ket famila jonë. Rraxhunier, ju kish kushtuar artës e literaturës. Për artën, akoma kur studhjonej si llogaritar, kish ikur ka Firmoza e kish vatur Romë sa të xënej të pindaksnej e të vizatonej. Rrufiejin më shpi se ish edhe i mir si skulptor. Kish rrënjin e artës, te fundi.

Gjithë veprat e tij u buartin edhë pse shkoj gjithë gjellen e tij ndë Derna të Libies te ku vepronej sesi rraxhunier. Një peritonitë e vrau ç'ish akoma i ri. Ka Afrika u pruar vet një sënduq me librat e tij, me kartat, me pinielet e ngjiret vali.

Këtë herë vajta te fund'i sënduqit e gjeta dica karta. Po kam bes se një njeri më par se u i ka ngar.

Te kartat e tija gjeta këta çë më duken shenime për një rrëfiem, o mund t'jet për një roman.

Jan pak fjeta të zverdhura ka moti. Të thyeshme. Kam t'i ngas me shum kujdhës sa mos t'i shqierr. Këtu e këtë jan dica shënime me ngjostër të kuq. Mund t'jet se i ka ngar im vëlla, ka pak.

E para fjet (po fjetat ng'jan të numeruar) ka kët rrëfiem:

“ ... u ng'e di si do të mbaronj. Një i vështir si ki bir.

Bir. Ësht bir si gjithë të tjert bil tim, ndomos se ng'ë i gjakut tim; kundraz është bir më se tjert pse e shof pa mbroitje. Një si ki bir sesi mund të mbaronj...?

Kur u zu me të vlezërit pse e thërrisjin mullaq – ka e xun ata se ng'është vëllau i tyre?- e iku ka shpia ku ndifej i huaj e vate kush e di ku me petkun ç'i ngit, m'u nda zëmra. U ng'e di pse. E desha më se biltë tim, mund t'jet se pse ng'ish imi ç'ju lidha si i lide njëj qeni më se njerzëvet.

Për disa mot mbet jasht ka shpia. Kur më lën mua e të jëmin pa një lajim, më ra kalosh e tërë jeta. E vrenja ngamon kufirin e

shkretëris, që hapet mbatan kopshtit tënë, i sigurt se do të kisha par një të huaj që do të vin' të më thoj: "E vran. Këto janë mbrolat e tij". Jo se ngë kish fuqin të dil ndan ka gjithë halat, po kish atë maner të fjit haptaz...

Ndose vran profitrat që fjisjin haptaz si ai, sa më mund të kishin vran atë që profit ng'ish? Akoma...

Pra lotët e s'jëmës. Rrij ajo ngamon ket një'angon ture qajtur, si një qene, të birin, e ture më shajtur mua pse ngë kisha dijtur të rrëjirnja biltë tim ka dhuna e tyre.

Ajo ish ngamon me atë diskurs t'ëngjëlit që thoj se ai ishë bir i vençant, sikur se ng'jan gjithë biltë të veçantë; ose kur thoj se ai ishë i biri t'Ynë Zoti, sikur se gjithë ata që u pikstin si ai ka një i panjohur, ng'jan biltë e t'Ynë Zoti. Mund t'jet se drejt pse ish "bir t'Ynë Zoti" e desha më se të tjetër, më se timtë.

Ish i zgjuar më se timtë. Anamesa neve, mua e atij, u kish vendosur një bashkë e hapët e njeri i kish respekt t'jetrit. Sa më t'egër ishin biltë tim aq ai ish i but ket puna. Xënej me lehtësi, përdoronej uprit me meshtërsi e veçante. Biltë tim ishin pak të butë, e herë e herë më kundrastojin ndomos se nga dita lexojin te Libri se prindët duan gjegjur.

Që kur iku shpia ime, si thufet, u errë. E jëma shertonej, e u sa mos t'isha i mundur ka lotët e saj venja nga dita e shurbenja jashtë shpisë.

Kur prirsha ka puna mirrnja udhën më të gjatë e ket nga kodër të shkretërisë ruanja orizontin sa mos të shinja ndo një udhëtar kuj mund t'i pjenja mos kish par gjikun tim bir.

Një ditë kisha mbaruar punën njëhere e u kisha ulur ket një gur sipër çukën e kodris më të lartë.

Pe, te kufiri më llargu, një figurë që ecnej si i deim, si një shumë i lodhët që ng'ja bënë të ngrënj këmbët.

M'u fry zëmra, ngë mund t'ish se ai. I vaita përpara ture burrartur. Kur u përpoqtim ram njeri e jetri për gjunja ture u përqaftuar. Qajtim të dy më lotë të shumta.

“Ndëlem”, më thoj ai.

“Ndëlem”, i thoja u.

Festa kle e madhe. Erdhë e e gjet nga Magdala një grua që dukej fort e lidhur me të e mejtova: “Ka gjetur nusen. Daft Ynë Zot”.

Ja thojin kësaj gruaje si s'jëmës. Luajti gjithë natin e lumtë pse thoj se ai e kishë shëruar.

Shpesh kërkoj të skomollisej ture më rrëfiejtur sesi kish ngrën gjithë petkun, me kë u kish bashkuar, sesi kish mbaruar të vepronej si shkllavë ture ngrën lëndet e dirqëvet.

Ja kish arrën në Egjipt ku kish grisur gjithë të hollat prapa disa mjeshtra që vijin ka Indja.

Nga herë i këputnja diskursin pse mëkatet e tij ngë më ngisjin e atë që kish bën ngë më përkit. Nga një me petkun e tij bën atë që do.

Ngë jam i rreptë me mosnjeri, njof dobësin time e më sosin.

Dobësia i pëlqenej edhe tim biri...etj...etj...

Këtu e para fjetë mbaron e duket se e hëngtin saraqet.

8 të Gushtit.

Sot Alfred Frega erdh e më muar Firmozë e më qelli Çervikat për një përpjekje t'urtrash që din gjithë shorçit mbi vallet, sidomos të Çervikatit.

Ngë kisha klën kurrë Çervikat. Është një katundjel sipër një kodër ka e cila nëng shihet deti. Për ne të shohsh detin është i rëndishëm. Thot një proverb: kush ngë sheh detin ka kufir.

Pikëpamje me detin te fundi i gjën shumë Firmozë, orizonti e së cilës hapet sipër fushin e Sibarit. I njëjti panoram hapet Ungir. Një pikë panoramike shumë të bukur ka Maqi, tek u ulët ket këmbët e njëj lisi, ati ku thon se ulej De Rada, mund të mejtosh sesi Leopardi mbi pakufirin. Sugjestjona të përtenme...

Çervikat buartin gjufin arbëreshe, po kan kujtimin e Valljes ket e cila këndojin kangjele pa kapirtur atë që thon. Ndodhet si ka na, tek u këndojin meshin grekisht e, veç prifrat, o ndonjë si u që pat fatin e mir të studjonej grekishjen, ngë dinë që vjen me thën: kyrie eleison.

Te përpyekja na burthuan një Dvd me Vallën.

Qindrova i çudhitur ture par burra e gra të veshur me stolitë e festës: grat me kostumin zakonshëm, burrat me skolin e khaketin. Mbanja mend se ka na, Firmozë, ngë veshëshin me stolitë elegante, po diljin ka shpia si do ndodhëshin. E, shurbes i rëndishëm, me shumë verë ndë kurmit.

Këta kujtimet tim; u që kam par të prasmen vallje kur kisha dhjet vjeç.

Çervikat kur rrëfienj këta kujtime më thon se për ata vallja është një ndodhje e veçantë ket marrjin pjes më të mirët të katundit, të cilët ngë defen e bëjin valljen me shumë rëndësi. Sesi Çift, kam bes, tek u vallja mbafet pas mezditës.

Firmozë, po që vallja ngë bëfet më, marr informaciona ka Elvir'e Diturit e cila kur ish e re "ngrënej kangjelin", si thufej, ose ndërtovej e drejtonej këndimet e valljes. Elvira më thot se edhë Firmozë ishin më të mirt që hijin ket Vallja e se mos njeri defej. Vejin ture pir likuore kur hijin ndër shpit të cilavet i bëjin nderim – hijtja e valljes ket një shpi ish nderim i madhë.

Kujtimet tim ishin të shkatarruar, më thot Elvira, ka fakti se vallja bëfej ket ditat e karnivallit. Kush mirr pjes ket karnivalli defej e ngë kish radën e valljes, pse vallja, thot Elvira, ish urdhër. Gjithë vejin të lidhur dora dora me një skamandilë sirmje, e pra ishë fjamurari që ng' i lënej mos njeriu t'i çanej urdhërin e

valljes. Kundraz, sa t'ishë vallja më e urdheruar, gjithë shokët lidhëshin, jo vet me skamandilin, po edhe me një trikuzë: ishë vallja trikuzale.

Vallja zënej fill natën, për këtë mund t'jet se atë ç'i mirrjin pjes shkojin për të dejim. Mund t'jet se ture pir bikerine llikuor ndonjëj i vej koca, po ish ligria që bën e thonje e bën e bënje shurbise të jashtzakonëshme. Po vallja ishë ngamon për vetë shumë të holë e çivilë.

Këta fjalët e Elvirës.

Po kur ja rrëfijta Baldakinit, ai u vu e qeshi: "Ngë defshin ket vallja? e sesi mund të zënje vallen e "të ngrënje kangjele" pa katër llitra verë më kurm? Sesi mund të mundënje turpjen të venje për më katund ture kënduar?"

"Pse thufet "të ngrësh kangjel"?"

"Pse vallja zënej kur, ture dal ka shpia ku zënej fill, kryetar'i valles ngrënej shkopin me skamandilin të lidhur ndë çukët si një fjamur e zëj të parin këndim, si për shembull: "e bellu bellu poshta poshta/ rrigullisemi si boshtra".

"Vallja më e bukur ish ajo ket e cila gjëndëshin më të mirtë që dijin e piksjin kangjele, kënga, vjershe me të cilët vallja vandonej o shanej familin te ku kishin hitur.

Ishin më katund dica këngëtar shumë të mir të cilët dijin e kastjojin të cilin e akcilin, edhe jasht ka vallja, për gjithë vitin.

"I ngrëjtin këngin" thufej kur këngëtarët mirrjin mbë sy njeri.

"Një ndër këngat, vaxhdon Baldakini, që banj mend thot: "Dila e Beta dy balestra/ shkrefjin trimat ka finestra/ e i skrefjin një e një/ se Çesarini kish t'ish me ato" për së drejti kjo këngë vin' ka Ungra e përkit tatmadhin tënd. Po shumë e adaktuan edhe Firmozë.

"Ka Firmoza ish kjo këngë: "E Xhuanina llenda llenda/ vete punon me dy pramenda". Njetër të përket drejt t'ij, t'e kish bën Nxhiku i Pirondit. Thot: "Erdh ka Roma edhe Nandini/ sa të vinxhonej Baldakini". Po këtë kënga ishin të bëna ka "suldetët

e marsit”. Pse thërritëshin “suldetët e marsit” ngë di t’e thom, po ishin më të shumë të rinjë që zdropshin ka mëndrat e vijin më katund e “shtijin bënd”, ose zbulojin gjithë veset e të shtrëmburat e të bëgetëvet, ose të pronarvet. E thojn skandale, ose fjalë të liga”.

Prirem ka Elvira e Diturit e më përsëritin se vet “suldetët e marsit” e karnivelët thojn skandale, se Vallja ishë shum e urdheruar.

Shum studhimëtarë analizuan vallen e ture e komparuar me dica pindaksië të moçme, thon se ajò vjen ka lindori, ka Grekia e se ka kifari me vallet e Orfeut.

Mund t’jet.

Dua të përvonj edhë u një interpretim.

Vallja si “ballo tondo” mund t’jet se përfaqëson “kthimin e përjetëshëm të identikut”.

Ngë dua të bënë profesorin, llargu qoftë, po kam besë se kur vallja vë ndë mesët një të huaj (si bëjin Çift) do të thot se do të vër ket rrethi i “kthimit të përjetëshëm të identikut” që do të duket jasht ka aì. “Këthimi i përjetëshëm të identikut” do të bënj identik që do do të duket jashtzakonëshëm. Kush pra do të dalë ka rreth’i valles ka të paguanj për lirìn e tij. E dreq: rreth’i valles do këputur, si do këputur edhë rreth’i “kthimit të përjetëshëm”. Është liri’e Orfeut, është liri’e Krishtit i cili prëmton, taksin, lirinë e botës së rë e të qiellit të rì.

Ket brez’i gravet të Horës së Arbreshëvet është i përfaqësuar Shën Gjergji, i cili me llançin këputin rrethet e spiralevet e dragules, e cila është shenji i uroborit, gjalpri që kafshon bishtin. Dragulea me spiralet e saj është, popani, “kthim’i përjetëshëm”. Shën Gjergji është simboli i çamjes i “kthimit të përjetëshëm”, simboli i lirisë ka gjithë obsesjonat. E ndose është ket brez’i nusevet, vjen me thën se brez’i tyre do këputur, si do këputur vërgjiria e tire sa të lefen qënës të rinjë...

Ndose vremi vallen e Firmozës që mbafej në karnivallë, si ajò e Çervikatit, kam bes se kemi shfaqjen e Apollinit e të Djonisit: aq vallja mban urdherin e Apollinit, aq karnivalli e çanë; vallja mban urdherin e rrethit, karnivalli ngë ka urdhër, ket karnivalli nganjë bën' atë që do.

Ndose pra vallja ka që bën me Orfeun, mund thomi se Orfeu me të vatjen e tij ket rregjëri'e të vdekurvet, sa të kundrastonej atë jashtzakonëshëm që duket mortja e të sillë njetër herë ket kthim'i përjetëshëm Euridiken, gjën pra "karnivallin" e gravet të dejme ç'e vrasjin e e bëjin copa copa...

Po mith'i Orfeut është i dyshimtë e hapin dyshime të mbëdhenj te interpretimi i tij...

14 të Gushtit

Shkova ditë të zeza, i pisëruar, i helmuar ka depresjona, e cila është "jona", e fëmilës sime. E motra e tatmadhit tim thoj me lotët ndër syë:"Na e kemi ket kazati vëndurin tonë, na jemi të pisëruar, jemi të helmuar, pse jemi Helmërat për këtë jemi helmaraqëra".

Ng'është shurbes i lezë të jetoshë Firmozë, sidomos për një intelektual si u, që ngë gjën, pas tetë orë sipër librat o ture shkruajtur, një me të cilin mund të diskutonj mbi rezultatet e studhimevet që është e bënë. Kuj do t' i interesonjë filozofia, ose teologjia, e, pikerisht, teologjia ortodokse, që është e më zë këmbin, si thomi Firmozë, ndër këto dita.

Po kam të thom se erdhtin e më gjetëtin dy të rinjë: Anna Capparelli, që është universitare e vallezore e Massimo Matrangolo një studjues, i universitetit të Bari, shumë i urt. Erdhtin ket llosh'e ulkut, pse më mirrjin për një fort i rreptë. Iu zgjirua buzëqeshja kur pan se jam shumë qesharaq, ndomos depresjona, kundraz drej për këtë.

Erdhtin e më mbituan për nderimin që duan t'i bëjin Dhon Fatuçit. I the se ngë kam si të thom fare gjë pozitiv për atë poet të abortuar, që ngë ka fare lehtësin e atyrve që “ngrëjin kënga”, ose të dhon Oraxit i cili qe vërteta poeti popullor i Firmozës. Ai kish lehtësi, ironi, përdoronej rimat e vjershet me mjeshtri, kurse dhon Fatuçi me osesionin se do j t'ish poet i dijtur ngë kle i mir sa mos t'ja arrënej mos gjikun.

Aq Anna se Massimo, i cili u kujdhës për antologjin e dhon Fatuçit, jan të kënaqur për atë që thom e më japjin “carta bianca” sa të thom atë që dua pse ngë do të fryfet mos njeri.

Nga herë që më përpjeqjin nani Anna e Massimo më dhurojin buzëqeshje të marrveshje. E më e më Anna së cilës i kam abulkacjun për mirsjelljen e saj, ç'i fjet ndër syë. Kundraz, si thoj njëherë një altumundjtote për tim kushiri ka Altumunda: “Vidisi prima a galandaria e pu ad idda”.

15 të Gushtit

Mora sot më qishë antidoron, bukin e bekuar që më parë se t'e hanja e vura ndër hundë sa të më hinej përmbrenda ajo merë, ai adur i shënjtë, si bënja një herë kur isha i vogël. Adur shënjterije që kish kalosh nana ime kur më mirr më dorë pra që kish nxier ka furri bukën. Birsha prapa atij aduri...

Mora edhë folin “E diella” tekun jan shkruar parkalesitë e ditës e Vangjeli e letra e S. Palit që herë e herë është veshtir t'e kapirish pse ka shum fjalë shqipe.

Shën Pali është tash i vështir për kundin e tij, pra ndose kush e përkthen uzarin shum fjalë shqipe, diskursi bëfjet pa domethënë për ne.

Vangjeli është me i lehtë pse duket i shkruajtur ket gjufa jonë. Kam besë se S. Palin e ka përkthier Solani e Vangjelin papas Manoli, i cili i vë më kuidhës së folmes sonë. Sa t'e bënja njera

ndë fundit firmozjot ndrrova dica fjalë të Vangjelit që m'u duktin të vështira t'jen të kapirtura ka pajsanet timtë të sotëm.

Nani teksti bie kështu: "Nd'atë motë Jisuj hyri ket një katund, dhe një grua, që ja thojn Martë e priti më "shpi". E ajo kish një motër që "ja thojn" Marie, e cila "u ul përpara këmbëvet" të Jisujit e gjegjnej fjalin e tij. Po Marta lodhej shumë ture "shurbier" e i vate përpara e i tha: "Zot, "nëng mbjake" fare se ime motër më la "e vetëm të shurbenj"? Thuaji "pra" të më ndifinj".

Ju përgjegj Jisui e i tha: "Martë, Martë, "ty mbjake e trubullofe" për shumë "shurbise", po një "shurbès" i vetëm dufet. Maria zgjodi pjesin e mirë që asaj ngë do t'i nxiret". E si asaj i thoj këto fjalë një grua ka gjindja ngrëjti "vuxhin" e i tha: "I "lumtë" gjiri që të mbajti e sisët që "pive"". E ai ju përgjegj: " Po të "lumtë" më mirë ata që gjegjëjin fjalin e "Tënë Zoti" e dhe e ruajin".

Kush thot se na arbëreshë ngë kemi tash një koinè është i sherbëtuar.

Fjalat që ndrrova, ato ndë mest virgolletat (thonjezit), si duket, jan pakë.

Ndrrova "nuk", që mos një katund arbëresh uzarin.

Tjerat që duken litire jan të veshura arbërisht, vet një purist fanatik mund t'i shtier ktjë.

Thomi se vet kështu, pa fondmentalisme, mund të zëmi të fjasmi arbërisht pa turp ture uzartur fjalat italiane kur na mangon fjala më e moçme, e vet kështu mund të rekuperarmi atò që buartim, po ki është, pra, kujdhesi i shkrimëtarvet...

*** **

Sonde si nga mbrëma vajta edhë një shtitje ka rahj'i Farnitës. Ket kthesi i udhës së re, ket zë e zdropet udh'e farnitavet, është pika panoramike më e bukur. Gjënde nde mest e njëj rrethi te ku

hapen pamje që të lën pa frymë e sheh sa i vikir je. Drejtò sytë ka e menxhëra, ket Pulini zë fill e hipet ka deti. Priru rrethë rrethë ku zënë malet tanë: Shënmërrjemali, Mulla, Mulleta, Piligrini, pjetë me gjelbrin e dushqevet. Pra jeci prapa malevet që na mbllijin pamien e detit të Dhiamantit. Hipu ka çukat e Silës. Vrë një e një katundet arbëreshë, Shën Sofin, Maqin, Shën Mitrin, Vakaricin, Çervikatin, Spixanin. Zdripi posht njera ka det'i Koriljans. Ndose qielli është si sonde, që ka perëndimi është i mbuluar ka re e një sperizë dielli pështon të dhezinj lindorin, e ke vet atë dritë, ndersa gjithë malet jan të bën të kalthër, njeri pas të jetrët, ndër gjithë sfumaturat¹ e kobaltit ka hjea e revet, ke një spektakoll që bën e lose njomësije. Këtë ngjire kobalt i pë ndër kuadret e piktorve si Raffaello, si Leonardo, si Antonello da Messina e ket një vepër e Di Credi që gjëndet ket Galleria Borghese Romë.

Pata sonde njetër herë pamjen e domethënien e valles. Rreth'i malevet që miren për dorje e pra hapen ka deti: e ty ëndrrin se mbatan është liria që të zgjidhin ka gjithë ngatarrimet...

17 të Gushtit.

Mora njetër herë ndër duar fòlet e lalë Mikucit. Ki ç'jam e kopjarinj sot ë shum i shkatarruar ket shkronja.

“...bir'i Tënë Zoti. Kur ngë di kush është i jati sesi mund t'e thërreshë një bir?

Kur e jëma më tha se kish dalur mbarsë qindrova i babartur për ditë e ditë pa dijtur që kish' të bënja. Ish gruaja ime, ndomos se akoma ng'e kisha martuar. M'u kish taksur e për këtë ish drej si kur të kish qënë gruaja ime. U kisha qindruar vet me tri djelme, e kisha bëzonj të njetër gruaje të më ruanej shpin e të më rritnej

¹ (Shqiptart thon “nuansë”, e Altimari e Fortini thon se kjò fjalë është më e bukur e më arbëreshe se jona)

biltë. U kisha drejtuar ka ajò për këshilet e gjirivet. Ish një vajzë e gjirisë sime, që kish qëndruar e varfër ka të dy prindët që kishin pasur kur të dy ishin shumë pjeqë. Gjiritë më kishin porositur: “Mirre me tij, ndreqeni të dy”. Ish e vapkë, pa palë e pa stolì, po ish e ulët e me duart t’arta. Vet se kish, e ka, pak shëndet, po si thufet: “kush është e ngar ka kopica rron një qind vjet”.

Kish por shëndetin e shpirtit: Shih e fjit më ëngjëjit. Shpia e saj ish pjot ëngjëj.

(Këtu një shenim me ngjostër të kuq thot: ”come il premio Nobel Nasch. O come la nostra Natuzza che parla con gli angeli custodi”). E ka shkruajtur im vëlla, pse lala ngë kish si të njihë Nasch. Teksti vazhdon shumë i shkatarruar ka kopicat).

“Kur duall mbars më rrëfajti, e tërë e paqme, se një ëngjëll iu kish afuar e një vrundull erje e ngrohtë i kish hitur mbrënda më gjì.

U kisha qënë i bindur se ëngjëjit mund edhe t’iu kishin burthuar e t’i kishin folur, tradita jonë është pjot njerëz që patin kontakt me ëngjëjt, po ng’isha aq çot sa t’i mirrënja vesh njëj gruaje që të thot se e vu mbarsë një “vrundull erje e ngrohtë”

“Mbeta gjithë natën zgjuar ket der’e kopshtit me qenin që më fjënej ndër këmbë. Kisha zemërim pse ndifsha i qellur dhunë e ka jetr’anë isha pjot njomësi për këtë çomarele që kish qënë e babartur ka i pari që i kish hitur më shpi. Shinja edhe situatën e saj tragjike nd’e kisha lënë. Që do të kish bënur? Do të kish shtunur të birin që kish më sjet? E mos jo, kur t’e kishin par mbarsë që do t’i kishin bër gjiritë, e ligja? E kishin vrarë me gurë si një kurvë?

Ngja një situatë më vënej dridhmat kalosh.

Kur duall yll’i ditës kisha tash caktuar: vajza kish ndënjur me mua.

Kur e pe asò menatje më shpitë e saj i the pa mejtuar: “Kem’ t’ martofemi mbjatu”.

Më ruajti e pabësme: “Si kle se më pate besë”.

Prora sytë më truall, me një shqetësim që më dridh të tërë kurmin: “ E pe edhë u njëngjëll që më tha se ke ligjë”.

Kur hiri të parën herë më shpëtë time, maçja ngarkalesi kurrizin, çfryti fort sikur kish përpjekur një qen e shkaptoj llargu ka shpia e ng’u pruar më”.

18 të Gushtit

Sonde vajta S. Mitër me Alfredo Frega ket një përpjekje me Greqit e Salentit. Një tryesë e madhe me auktoritet që i interesohen ruamjes e traditavet e së gjufës arbëreshe.

I pabesuar. Mosnjeri thot një fjalë arbreshe as edhë për gabim, as edhë për të na kujtojin pse jemi këtë. Nga një bën historinë e ligjës kë do të shpëtonjë ka humbja pakicat, nganjë thot sesa është e vepron për të ndifinj ketà të shkretë që ngë din’ e vën bashk di fjalë arbrisht. Kuj jan e i drejtsofen? Me kë jan e fjasjin? Kur do t’ja japjin shembullin sesi kan të bejin sa të shpëtojin ka humbja arbërishten? Arbërishten ngë din t’e perdorjin pse trëmben mos t’uzarjin fjalë litire, Shqipen ng’e dinë edhë ndose doj t’e njihin s’do t’e uzarjin pse mos njeri do t’i kapirjin. E gjithë dërsijin ture u dhanartur me “le dichiarazioni d’intento”. Fjalë e pra fjalë të cilavet s’do t’i vinjë prapa fare gjë.

Vjet ket Festival’i këngës arbëreshe i venja ture thërritur presentatorit:”Fjit arbëristh, fjit arbëristh”. Kotisht. Kush e di kuj ish’e i drejtsofej paraqitari, mund t’jet të gjithë litinjëvet që ishin fort të interesuar këngës arbëreshe, e cila është e bënë dreq sa të alfabetizonjë vet litinjt.

Ftiga e brumbullit e arbëreshëvet, sa më pak t’atyrve që kan mundësin e ministrojtin të hollat e shtetit, është pa kufir.

22 të Gushtit

Sonde mbajtim përpjekjen sa t'i bëmi nder dhon Fatuçit. I propozova mbjatu atyrve që kish të mbajin konferencat sa të fjisjin arbërisht. Më muartin mbjatu vesh. Foli i pari papas Belushi ka Frasnita. Ket diskurs'i tij, dhon Fatuçi u bë një poet i madhë, një që dij të perdoronej fjalët më një mjeshri të madhe. Gjegjënja këtë fjalë ture u thavmasur më e më. Po zoti Belush është një prift e si i tillë di e gjën të mirin gjithaparau. U që kisha qënë i ftuar sa të bënja avukatin e djallit, u ndiehta me thonjët të prer: sesi mund të thonja gjë kundër dhon Fatuçit pra gjithë të mirat që kish thën Belushi? Sesi mund t'i jinja publikut një kikare kafë të thartë, pra gjithë likuxhit ç'i kishë pergatitur zoti? Ahirna iu drejtova Masimit Matrangolo e i piejta:” Tij që djovase Huysmans i cili thot se vjershet e Virxhilit tringëllisjin si llandje, që të duket, se vjershet e dhon Fatuçit tringëllisjin si llandje? Pse ndose tringëllisjin si llandje, ahirna vjershet e dhon Fatuçit jan si atà të Virxhilit e dhon Fatuçi është poet si Virxhili, ndose tringëllisjin më mir, vjen me thën se dhon Fatuçi është poet më i mir se Virxhili e ahirna dhon Fatuçi meriton jo vet fjalët tona t'ulta po atò t'urta e ndonjëj kritiku të famësh”. I vën ndër ferxhat, Masimi, ç'i pat kujdhës botimit e vjershevet të dhon Fatuçit, thot se jo, se vjershet e dhon Fatuçit nëng tringëllisjin fare.

Ture i vat prapa metodit sokratik, i bënj Masimit njetër piejtje: “Thon se dhon Fatuçi vej ket një e ket njetër ture i piejtur t'i kurregjojin poesit. Nanì ty si thua, se një që nëng ka siguri ket fjalët që perdoron, është o ng'është pronari i poesis së tij? E një që nëng zoteron fjalët që poet është?”

Masimi ngë di si ka të përgjegjet.

“Të ndifinj u. Thuam që forxhar është një që ngë ka fingjilë, ose ngë ka hekur ket forxha e tij. Ose që kusturuar është një që vete

ket njetër e i lipin sesi ka të qepinj një purtele pse ai nëng di i vetëm sesi ka të dal nd'anë?"

Mbaromi bisedimin ture marrë vesh se dhon Fatuçi as nëng shkruajti vjershe që tringllisjin mir, as ng' ish pronar i fjalëvet të tija, as ish zot e noerivet të tija pse vej ture përsëritur "luoghi comuni" e se bënej poesitë me "poetikun", ose ture mejtuar se poeti ka vet të fjasë mbi dallandishet, mbi trandafilet, mbë katundin ç'është me i mir'i botës etj...

Mbaronj pjesin time ture parkalesur sinkun të mos të harronj të vërë ket programi i simbjët që të vinjë një ditë e dedikuar Arbërisë, një ditë ket e cila fjitet vet arbërisht. Marrëveshja është e gjithëve. Publiku duartrokisin.

Kur mbaron konferenca më qasen shumë për të më falenderojin për atë që thash e jan gjithë të kënaqur se foltim arbërisht...

Po ndonjeri shton se dhon Fatuçi ng'ish poet pse "atij poesitë ng'i vijin": "u jam njurand, po e di se ai ndlezot ng'ish poet pse poesitë ng'i vijin, sesi i vijin dhon Oraxit. Dhon Oraxi ish poet i mir, atij i vijin poesitë, i vijin si ka fare gjë, njëmend njëmend...". Ture thën këtë: "atij poesitë ng'i vijin", ki ç'ë e fjet me mua është e thot një të vërë të rëndë mbi natyrin e poesisë e cila ngë do e kirkuar. Ngë mund t'jetë e kirkuar ka poeti, mos ngë ka ajò oreksin t'i paraqitet atij që ajò zgjodhë, ng'ë menirë t'e përpjek mos njeri me oreksin e tij. Konfirmohet kështu edhe ket e diëmja e ket të folurit populor mejtim'i Platonit i cili fjet të "Theja mania", të lënsisë hyjinore e cila vet mund të piksinjë poesinë. Poeti, ndose kle i zgjedur ka Shpirti mund vet të përgatitinjë dheun, kopshtin të ku Ai do të mbiell farin e mirë të inspiracionit – edhe S. Pali duket se fjet si Platoni kur na paraqitin këtë të zgjedhur, ture thën: "kai autos edoken tous men apostolous, tous de prophetas... etj" – "Ai" vetëm bën dica apostul, dica profitra...etj.

Ngë mund t'ish poet dhon Fatuçi pse mos një shpirt e kish zgjedhur si profiti i tij. E ki fat burthofej ket rasti e ket çasti se

dhon Fatuçit poesitë “ng’i vijin”; i vej ai prapa poesisë me një sforc të madhe, kundër lehtësin e dhon Oraxit të cilit ngë difej ka i vinej aiò shkathëtësi me të cilin perdoronej fjalët, të cilat i vëfëshin ket urdhër’i vjershit pa veshtirësi...

I dedikova shumë motë dhon Fatuçit, po diskursi im nëng i përket, e kini kapirtur, dhon Fatuçit, po poesisë pergjithësisht...

17 të Shën Mirtirit.

E pra vjen mesdita. E zënë e të farmakosjin atë cik të ngrënë Menkaci, Bigaci, e Antonella Clerici, që bën vajzën pa ftesë, e të tjetrt, ket televisjona. Ng’është shptim ka televisjona e ka qaqaret e saj që shërbejin vet sa të të tiganisjin trutë, sa të të pakësojin vet si një përdorues që grisin matarece...

Ngë ke ka të pështos pse televisjona, po ç’e bjejtim, ka të rrier e dhezët...gjithë ditin...

Pra vjen mbremja e për mos të shoh të njëjtin Tremonti, që duket i pirë, të njëjtin Giovanardi që duket i thavmasur’i prespit, të njëjtin Rutelli, i cili që kur u martua më qishë duket më papistë se papa, të njëjtin Dalema që bën ngamot të dijturin me buzëqeshjen e dinakut, ruanj ER.

Sa më pak vrenj sesi gjellofet ket Babillonia e Madhja, tekù Ekonomia, sa më të bënej mërakulin e bégaterisë e të lumëtësis së gjithëve, madhësoj numerin e të vafërvet, e mbjon burgjet me njerëzë jasht ka rrethi të njëj gjelle se si do Ynzot.

Kur më varesjin edhe amerikanët me dhunin e tyre vet’e fshefem sa të djovàs një fjetë të Platonit (Moiseu që din’e shkruanej *αττικερώς*) i cili kle më i madhi pse diti të vënej gjithsej bashkë: mithin, metafisikën, skencjen, mysticismin, theologjinë, me musikën e fjalës së tij. Rron gjë te fjala e tij, jasht ka tëtimi e ka qatri’e fjalës skenxore të sosme.

Ose djovasinj një fjet e Aristotelit ket e cila gjënj justifikimet e bekimet e nartyrës sime, që ngë diti të bëfej kurrë një tregëtar i mir i vepravet të tija.

Djovasinj te *Politeia* e Aristotelit: “*to dè zetein patakou to chresmon hekista harmottei tois megalopsýkois kai tois eleuftheriois*” – të kërkosh nga herë fitimin është shumë pak i përshtatshëm të madhështimëvet edhe të lirëvet. E gjetkë: “*...banausous kaloumen kai tas mistharnikas ergasias*” – thomi të trasha (vulgara) veprat të bëna për t’jesh i paguar.

Po ndersa jam e vete me Fedrin kushedi ku, me arrën muzika e *Golden lady* e të vjen dyshimi se gratë jan vet denje të veshjin *Golden lady*, e se kurmi i tyre është vet një makën që grisin dhe shpirti vet avulli i cellulavet... se gjithë bukuria e gravet konsiston ket një parë kallucjet...

Kam të bënj një sforcë të madhë sa mos të bie ket rrethi i Tremonti e Giovanardi e Rutelli, të cilët, po ç’i intereson vet interesi i tyre e të shokëvet putigelë (*banausoi*), marrëjin udhët e retorikës e të sofismevet. E më vjen fjala e të hynorit Platon: “*ho kommotikè pros gymnastikèn... sophistikè pros nomothetikèn... ho opsopoiikè pros iatrikèn.... hretorikè pros dikaiosyne...*” - moda te lloku i gjimnastikës sofistika te lloku i ligjes... ushqimet te lloku i jatrisë ... retorika te lloku i drejtësisë”.

Jan këto fjalë te *Gorgias*, një djalog i shkruajtur dymilë e pesqind vjeç prapa për berluskonin e çivilitetin e tij , tekù ligja, për shembull, kle e shkatarruar ka sofistika...

Ture vrejtur sekujin tënë vjen sospekti se ket natyra ng’është fare një projekt i urtë, se si thon disa skenxjatë materjalistra që jan e diskutojin sonde, ket njetër kanal, pa u vën në akord mbi Darwin. Natyra e ka o ng’e ka një merë? U thom se projektin t’urtë kat e ket njeriu, i cili është natyrë e haptë, hapsirë, pa qendër. Vet kafsha, ç’është e programuar t’jet si është, ka qendër, njeriu ka t’e

stisinjë. Vet njeriu do të ket një projekt, ç’e shtie ket e ardhëmja pa sosur.... po ndose lëmi se atë qendër ka t’e bënë berlusconi ose Tremonti ose Giovanardi ose Rutelli sa t’jemi vet një shtim i ekonomisë, lefteria jonë, hapësira jonë humben...
Pra sheh amerikanët e të bien krahtë: mund t’jen ata ket një projekt i urtë i natyrës?

18 të shën Mirtirit.

Një ngushullim, vet një ngushullim. Një prallë për natën e kësaj jetë. Ose një vetëdije se gjithë është prallë ajo vetëdije për të cilën ke njëëndër, kur të zë një’angëth i math, të vjen të thuash: “jam e ëndrrinj”. Pse vet ki është shpëtimi: të dish sesi tha Ynzot se vet e Vërtetja do të na bënë të lirë. E cila është e Vërtetja? Se ng’ë e Vërtetë, ose, më mir, se e Vërtetja ng’është ket ndodhja jonë. Nietzsche thoj se e vërtetja është një e rreme që ngë ke si t’e konfutarish. Na për së drekti thomi vet pralla, shkruami romane mbi situatës sonë – sesi Platoni sesi Aristoteli sesi Hegeli e të tjetër... Po e keqja është se anamesa vëfet berlusconi me të rremet e tija e pretëndon se t’jen e *Vërtetja* – me sofismet, me retoriken, me publicitetin ket është mjeshtir. E rremja e tij më e madhe është të premtionjë lumturinë gjithëve, të premtionjë rininë e përjetshme me një *lifting*. E ç’është më retorik e më sofistik, më i rremë se një çë do të fshefinjë të dorrokopsurit e motit?
berlusconi rrefien pralla me mbarimin të lumtë, me të cilat zë zëmrin e popullit. Popullismi i tij është televisjona e tij tekur rrefiejin pralla çë populli do shumë e shumë, pse e qëllojin të lumtë ture harruar atë ngusht pjot angëthe ç’është gjella.
“*Divertissement*” e thërrit Pascal, ose “*panem et circenses*” teku volgariteti ngë ka mbarim me *Milan* e bithë e sisë. Populli do “*divertissement*”, ose shpëtimin ka trëmbja e mortjes, e të së ardhëmjes. Për këtë përciellë gjithësej.

E rremja më e madhe e berluskonit është se bënë se populli të besonjë se ket bota mund të ket një lumtëri teku gjithë hanë e pinë, si ai. Se është ket mundësia e njeriut t'ja arrënjë ket “*kainoûs de ouranoûs kai gen kainèn*” (2 Pet.3,13) – Bush e gjithë Amerikanët, që jan pelaxhane e mejtojin kështu – po ec e ja rrëfijë gjithë dënuarvet te vdeqja pa ftes që mbjojin filaqit e Merkës.

Optimismi i tij e të Bush-it është një e rreme e madhe: të mejtosh se mund ket një udhëtim të historisë ndaj të miravet (projekti i urtë i historisë) ket kjo jetë. “*Le magnifique sorti e progressive*” – është mëkatë rrënjësor. I cili lefet ka eksigjenca e njeriut perëndor, ose të civilitetit perëndor, të ndifen si mera, si fundimi, si mbarimi i projektit t' urtë që fshefet mbrënda natyrës.

Njeriu ka një anë – si mer'e natyrës - e Perëndimi ka jetra, si mer'e historisë, jan sot mëkatët më të mëdhenjë: erresia e enkratisë që vjen ka promptimi i djallit (i cili është rregji i botës): “*eritis sicut dei*”.

Ndërkaq na jemi ket situata tragjike e gjelles tek sperimentomi se natyra ngë ka një ”projekt t'urtë” – ngë dimi ndose ka një projekt t'urtë. E këtë kish' t'e dijin më e më të kristertë të cilët kish' të dijin se ket *Apokalypsi* është shkruajtur:”*Idou kainà panta poiò*”- “do të bënë gjithsej të ri”. E ndose Një do të bënë gjithsej për së ri, vjen me thën se atë që bëri kle një gabim i madh. Ket lloke të ndrishme kle thën – si kujtuam sipër - se bota është rregjèria e Djallit (vrë: I^a Letër Joh, 519: *Kai ho kosmos holos en toi poniroi keitai*), e kle thën edhë se Ynzot bëri të llavur gjithë skenxjen e njeriut: *ouchi emóranen o theòs ten sophian tou kosmou toutou?* (Kor.1,20) – *sophinë* e Amerikanëvet, urtësin e berluskonit – ndose fjalët e tija mund t'jen të përqeshura ka i pari komik, ka ligj S.Pali.

Nani tekù mund të kemi sprënxë ndose sprënxa është e tilla dreq pse mund t'jet e tradhirtur, mund t'jet një dështim?

U ngushullofem me Platonin i cili m'e këndon (*aidein*) e më magjepsin (*epaidein*), ture më shkukur ka kjò botë së cilës ngë di e i thom “ë”, “ëh”, “po”.

Qindron vet vetëdijta se ngë kemi ku të rrëbehemi e për këtë, po që jemi të mallkuar, kemi vet sa t'i lidhemi responsabilitetit personal që na thot: *neminem laede*, me atò të tria soke që daljin ka *Synkatavas*in të Krishrit e *Compton* e Dalai-t Lama, e ç'jan: *Contingency, Irony and Solidarity* – që'sht titulli i njëj libri – për m'e djovasur - i Rorty. Të cilat duken virtyte të Sokratit i cili këputnej me ironin bazën e të dijturisë së t'urtëvet e nëng mbaronej diskutet e tij – i lënej të hapët. E ngë harronej solidaritetin kur kujtonej se të huajt e të nëmurit jan të ruajtur ka Zeusi. Si Krishti i cili këputnej kryelartësin e priftravet e sinangogës – t'urtët e qerojit tij – e praktikonej dashurin (solidaritetin) me litinjët, me kusaret e me putërat e hinej pa trëmbje ket shpi'e të gjithëve.

Sod Pera, ture përsëritur Popper, thot se Platoni është armiku i shoqerisë së lirë. Ng'ë kështù. Ai, hyjnori, desh vet të na mësonëj se pa ligjet (“perëndeshe”, “hyjneshe”, i thoj Sokrati i cili i rispektoj edhe kundër vetëhesë së e tij) ngë ke ka të vesh, ngë mund të propozosh asnjë “merë e urtë (e bujare)”, ngë ke si të stisish një vetëhë e ngë ke si t'i gjegjesh asaj ligje themelore: *neminem laede*. Pera i trëmbet *Politeia*-s së Platonit pse ket ajo shoku i tij ngë mund kish bënë ligje *ad personam*.

21 të shën Mirtirit.

Pra ndose t'e thon *Alkibiades*, ose *Alexander* mund kesh gjithë mjeshtrit më të mirë e kësaj jet se ng'është mesim që mund të mbanjë. Vete sesì cinxulla prapa nga erje: si miku imë Dante Vicchio ose si sinku ka Ungra për të cilët i dështuami jam u që ngë dita e mora gjithë ndodhjet për të bëgatsha, sidomos mbi kryet e të tjervet, e ture utilizuar të hollat e shtetit.

Thon skolla. E mësimet e saj.

Thon gjithë se ka t'jet skolla të mësonjë udhën e dreqtë. E thot edhe Moratti. Po pse Alexanderi ng'iu gjegjë atij mjeshtri të math ç'ish Aristoteli (i cili shkruajti edhe dy *Ethik* e dijë që ka të mësohet më skollë, më se Moratti)? e pse Alkibiadhesi ngë xu fare gjë ka Sokrati më të cilin edhe fjëj? Do me thën se kur lefe berluskon vet berluskon mund të jesh. E këtë vjen fjala e të hyjnorit Platon i cili thoj te *Politeia* se par se të lefemi na zgjedhmi gjellen që do të gjellomi e i nënshtrofemi njëj fati që ngë mund t'jet i ndrruar...

Kjo prallë më bën të bindur nga dita e më shumë.

Kështu Ruini, i verdhi Ruini – i verdhë si Torquemada: po që ka vesin të vërë hundin ket shurbiset e të tjeret, sesi mund t'e bëmi të bindur të bënëj “i fattacci suoi”? Edhë këtu burthofet kryelartësi'e Perëndimit i cili xu të praktikonjë *tolleranxjen*: fjalë që vjen me thën jo: “eni se ju duami si jini”, po: “eni pse do të kemi paçenxë me ju: *do t'ju presmi pse më parë o më vonë do të bëheni si na – pse na jemi më të mirtë e Ynzot është me ne*”.

Sa na tollerartin, neve “bixantinëra”, litinjët?

Sod duket se ndonjë ka na do të ngrënjë kryet, pse do t'ish ortodoks, pse i duket se ortodoksia është më e mirë se uniatizmi.

Ahirna paçenxa, toleranxja e tire, e më e më dashuria e t'Ynzoti, ven' e bekofen.

E kështu, për shembull, peshkopi i Ungaris nxërraret e thërret anatemat e tij, pa asedhë tolleranxje e Perëndimit, e pa – mkatë i math – dashurin e t'Ynzoti, që ng'është fare tollerant, as fare gjë ndër mejtimet e njeriut...

23 të shën Mirtirit

Qisha e Ungaris ka autarin që ruan ka dhesperi, ka Perëndimi. Kur peshkopi thot meshin ruan ndaj Romës e i prier krafët Lindjes.

Qisha e Ungaris, kisha e Dhesperit, kisha e Perëndimit.

Çë bëzonjë ka të këndonjë *Fòs ilarón...* ajò dritë s'do t'e ngas kurrë ndër ballë as edhë ket agimi...

Perëndimi është mbarim, është fund, është sosje.

Sesi mund të shpresomi një rilindje? Jo për të pirsëritmi një histori që vate, po për të presmi dhuratat e Shpirti që frin nga mot...

Perëndimi proklamoj vdeqëjen e Perëndisë me zërin e farmakosur e Nietzsche që shtoj një mejtim pakë i gjegjur: “Perëndinë e vrau njeriu më i shemëtuar” (vrë Zarathustra).

Zoti Matrangolo shpesh më pyanej: “Sa jan atà ndër peshkopkrat o ndër kardinelët o ndë teolograt që besojin Perëndinë? Fshehen prapa Krishtit zot”. “*Totus mundus fit arianus*”, shtonej pra pa ngushullim.

E mejtova gjetkë atë që thot teologu i vatikanit mons. Dalmazio: “Teologjia me kategoritë logjike të saj është skolla e ateizmit”.

Pascal preferonej të fjitë me “kategoritë” të Shkrimit të Shëjtë: Perëndia i Abramit, i Isakut, i Jakobit, përpara të cilit ngë vlejnin kategoritë as të Aristotelit (Perëndi si *causa causarum*) as të Tumazit (*Summum Ens, summum Bonum*).

Përpara Perëndisë së Abramit vlen vet besa, e cila ka difektin mos t'jet e mbrojtur ka mos një kategori llogjike.

Aqë sa llogjika të vë ket sigurimet, kaq besa të vë ket një hapësirë pa kufirë, ket një shkretëri: “Lë shpin tënde e jec ket një dhe që do të të tregoj...”.

Aq logjika të stisinë një botë e sigurte, aq besa të vë mbi ujërat që hapen ndër abiset pa fund... Pafundimi është “fundi” i besësë...

Nani, si na mësoj skenxja, që na ndrojt trutë, sesi mund kemi besë?

Na, po edhë teolograt, që jan skenxëtarë, po edhë peshkopkrat, edhë kardinelët, edë papa, që jan gjithë teogra, që jan gjithë profesorë, ose gjithë skenxjatra, sesi mund ken besë? ket një prallë? Pse Shkrimi i Shëjtë është një prallë. E mirë vet për fëmijë.

E kush është i vendosur të bëfjet fëmijë po çë u bë skenxjat?
Ai Pascal kish të kish ndo mijë probleme të mëdha pse, megjithëse ish një skenxëtarë i math, vaxhdonej të kish besë ndër prallezit. Kish t'ish një fëmijë çë doj të rritej. Pascal kish t'ish një skizofrenik, pa ç'e dij.
Sesì na, ka jetr'anë, çë vremi kishin e Ungris shum litire shum perëndore, ket dhesperi i saj...

24 të shën Mirtirit

“Ou me gar tois echtrois sou to mysterion eipo” – “ngë do t'i kallxonjë misterin armiqëvet tënd”:

- e para pse është një misterë - me çëdo fjalë do t'e thomi do t'e tradhomi;

- e dyta pse një mister mund të komunikofet vet zëmër e dëlirë me zëmër e dëlirë. Pa fjalë pse fjalët e përkthejin mbjatu ket një llogjism'i njeriut, e prandaj e kufinojin te pralla e njëj lloku e njëj moti e njëj ideologjieje – po çë fjalat jan histori ose llokë, motë, ideologji...

- e treta pse edhë ndose mund t'e thonja me fjalë, armiqët tënd do të qeshjin pse do të kishin mbjatu gjë për më e masur, me llogjikën ose me matematken...

- e katërta, pse “meden balite tous margaritas ymon emprosthen ton hoiron” /”mos i shtini margaritat tuaja ndër hundë dirqvet”. Vreni me kë fjisni, jo githësej gjithëve. Ngë jan gjithë të gatshëm të gjegjëjin ngagjë, sidomos misteret shpirtërorë.

Po na fjasmi, fjasmi shum, pse kemi shtypjen se fjala nget gjithsej, se prapa fjalës është realiteti, e se fjala zbulon realitetin. Na kemi bes se me fjalin, me logjiken, me dy, tri kallime syllogjismi, kemi e vërtetjen. Kemi stypjen se çë do fjala mund arrënjë, vërteta eksiston; e se çë do fjala ngë arrën nëng eksiston. Për këtë fjasmi, sa të zbulomi nga mister.

Sot na duket, për se sa foltim, për se sa libra mbjuam me fjalë e me formula matematikje, se ngë eksiston më një mister e se gjitheseja është te dispozicjona jonë. Kështu dimi se ornitoringu është ornitoringu, dreqë se si e deklaruar me skencjen; se arvuri është vet një arvur dreqë se si na e deklaroi botanika, se një njeri është skicofrenik pse kështu e deklaroi psikjatria. Ng'eksiston më një mister. Për këtë fjasmi e fjasmi shumë, për këtë kallëxomi misterin e Krishtit – ose të njeriut – pse ngë kemi më një urdhër mos të fjasmi.

Krishti – ose njeriu – është drejt atë çë na thot historia, është drejt atë çë na thot psikologjia, filologjia, eksegjesi, ermeneutika, teologjia, kristologjia (gjithë ndërtime subjektive të njeriut, çë për “*consensus doctorum*” bëfen objektive).

Ngë kemi më një mister mbi të cilin vlen urdhëri të rrimi qet, të mbami një heshtim të thavmasur... sot vet çotrat thavmasen...

Po, edhe ket udh'e Perëndimit, kle një filosof çë tha se e vërtetja (a/letheja) ket momenti çë burthofet, është e fshehet, ket momenti ç'është e jipet nigohet... teologjia (apofatik) ortodokse na mëson se Perëndia është gjithëparu e mos gjikun.... vjen me thën se ndose Përëndinë duami t'e shofmi ket ndonjë fjalë, o një mejtëm, o ket një gjë si do t'e duash – edhe të shëjtë -, Perëndia ng'ë këtëje, pse Perëndia ng'ë fjalë, ng'ë mejtëm, ng'ë gjë – edhe të shëjtë -, ndomos se është gjithëparu.

Edhë këtë të folë është të folur. Një filosof modernë Wittgenstein la thënë:” Mbi shurbiset mbi të cilat ngë kemi si të fjasmi është më mir të qetemi”. Po shtoj se shurbiset, mbi të cilat ngë kemi si të fjasmi, jan më të rënda se atò mbi të cilat na fjandasin se mund të thomi gjithë atë çë duami..

25 të shën Mirtirit

Jo se, sesi thon disà, realiteti është dukje, ose ëndërr. Realiteti është realiteti. Problemi i math është se mbi realitetin na stismi *kosmos*-in tënë. Me interpretimin tënë, na stismi botën, na stismi *kosmos*-in. E kur Nietzsche thot se ng'eksistojin fakte po vet interpretime, do të thot drejt se na mund të njohmi vet interpretimet tanë – realiteti këtë jashta na qindron i panjohur.

Na njohmi vet interpretimet tanë. Edhë kur fjet skencja – “che è impianto metaforico non dissimile da quello che presiede la costruzione del mito” (Galimberti) - realiteti qindron i panjohur. Edhë skencja është një ndërtim njerëzor, aq sa realiteti është një ndërtimi i Perëndisë – e vet Perëndia mund t'e njoh – njeri i math e tha. E aq realiteti është realë, aq ndërtimet tanë jan pa realitet. Kur edhë indianet fjasjin të *samsara* jan e i referiren jo realitetit këtë jasht po gjithëve ndërtimevet e mendjes sonë.

Kështu kur Krisht thot: “i vasilia i emi ouk esti ek tou kosmou toutou”, do të thot se rregjëria e tij ng'është e atij “kosmos” që njeriu stisi, ndërtoj, me veset e tij, parë më parë me vullnetin e fuqisë, me filopsikinë, me enkratinë, e, më e më, me “*concupiscentia sciendi*” (ç'është vullnet zoterimi), e cila, sipas Sestov, është mëkatja rrënjësore.

Krishti, si dimi, ngë “la” kët jetë. Ngë kle as një stilitë, as banoj ket një shpellë. Ket shkretëria mbet vet dyzetë ditë, pra u pruar ndë mest njerëzvet, - drejt si ai murgu ket prralla taoistë “Dhjet demra” . Hanej e pinij me mëkatëruamet. Mund t'jet se hinej ket kandinat ose ket bari e bridh me kartazit me ta. Drejt si bëjin këta priftra të rinjë ka Firmoza, pa moralisme të rremë. Kur kish të parkalesnej ngë hinej ket një klishë, po venej llargu ka gjithë, përposhë njëj ulliri – qoftë ngamon i bekuar vet për ket.

Krishti, por, ng'i dha kurrë vesh, ng'i dha kurrë besim kosmos-it, radhit, që politika, ose vullneti i zoterimit, të motit tij, i kishë ndërtuar njeriut me dhunin e saj... Ai proponoj një transvlere i

gjithë vlerjet i themeluar jo ket vullnet'i zoterisë, po ket kenosis, ket stynkatavasis, ket dobësia, ket dorrokopsia e filopsikisë, e enkratisë ...

Kur gjegjinjë Romë “Christus vincit Christus regnat, Cristus imperat” ose ka na Kostantinianin “Iesous Hristos nika” ... më vjen itericja... – u do të kisha preferuar: “*Christus amat, Christut servit, Christus Christus secedit a potentia. Ut homo vivat*”.

Ruini, kundraz, Ruini i verdhë, duket se kundraston këtë botë, të hëngurit, të pirët, të bredhurit me kartazët, po pra i lëmon likurin e qimen berluskonit, bekon moralitetin e tij e çë do është borgezë. Klen fashistra shumë priftra, edhe “murgjë” franceskanra (“murgë” Firmozë vjen me thënë fatkeqë - poveraccio). E shumë ngë patëtin turp t’ishin emëruar “Cavaliere” ose “Grand’ufficiale della Repubblica”. Po sot të bëjin shënjtë jo pse u hyjnove, ose ngave “theosin” (ose sesì propozonej Kaparelli ynë, ture përsëritur Pitagorin: “*omojosis toi theòì*”) po vet pse kleve një moralist sesì ata të “*Comunione e liberazione*” për të cilët përsëritmi pyejtjen: “Me kë u kunguan e ka ku u shpëtuan” po çë jan gjithë “in carriera”, ture perqafuar gjithë dinakerit e gjithë dhunin çë një karrierë siell.

Po këtë i siguroj shën “eskrivà de balanguer –i”. Sesì i sigurojin Messori e Mondadori.

Po kështù vete jeta. E kosmos-i me bukuritë e tija. E na çë jemi dështime, ose “*ektromata*” (si thot S. Pali) rrimi e ruami të thavmasur pse na tradhëton, jo vet fjala e berluskonit, po edhe fjala e Krishtit: “Dual e thërriti gjithë murgjit, të verbërit, koçet...”

U ngë ndifem fare i ftuar. Rri këtë jasht ka darsëma, i ultë ket shkallaret e dersë e ruanjë i tavmasur si vete bota çë stisi civilitetin e Perëndimit, çë zdorrokopsi nga gjë e thom: kur do të mbaronjë?

26 të shën Mirtirit

Pra thon se e zë me mons. Fortino – i cili ë mik i dashur e të cilit mund t’i kujtoja : “Amicus Plato....”; po jo, i shtonj “sed magis amicus amicus”.

Po më dhëmbet se ai vete ture përsëritur “i luoghi comuni” të Ratzinger e të Pera kundër relativismit.

Relativismi? E sesi mund t’jet ndryshe për një të krishter?

E një i krishter që thuhet bizantin (ndose kjo fjalë ka një domethënie ket interpretimi i botës)?

Na dimi – na e mësuan Etrat tanë ka Lindja – se që do bën njeriu, që do mejton, nga fjalë që thot, nga koncept që piksin, nga religjon që pratikon, nga sistemet politikë që ndërton, ngë ka si mos t’jet te historia, i themeluar ket një qerò e një llokë. Se nga metafysikë delë ka një *Weltanschauung* ose një filosofi të gjelles – do me thënë ka një pikpamje subjektive e shtringuar ka një strukturë trashendentale që bën e na duken mejtimet tanë objektive.

Na mësoj pra Marks – ndose trëmbemi t’afromi Etrat e klishës ortodokse, ose teologjin e Atyre që kundrastuan filosofinë skollastike e pretendimet e saj – mësoj Marks se nga filosofi – e na shtomi nga teologji – është ideologji që delë ka një situatë sociale. – Po, ju parkales, vreni ndryshimim ç’është midis “*Aletheja*” grekishte e “*Veritas*” litishte se si e përskruan Heidegger te libri “*Parmenides*” e se si *Veritas* hinë ket domethënia e “*Imperium-it*”. Vullnet fuqije që ish tipik e “*Imperium*”-it që stisi Klishin...

Nani ndose klisha e Ruinit u borgesua njera sa vete “a braccetto” me të mirët e kësaj jetje, teologja e e vërtetja e tij daljin ka kjo shoqerì.

Ndose situata ë kjo, me ndihmin e Etravet tanë Jan Krisostomi, Vasili i Qesares, etj..., na vendosemi ket relativismi pse dimi se na pështon ka djalli e ka “*tutte le sue pompe*” - sesi premtuam të

bëjim ket pagëzimi. Na çë praktikomi relativismen – ose më mirë nihilismen (ç’është filosofi e Koheletit – o jo?) – dimi se “vet Ai rron, me gjithë energjit e tija jo të krijuara” përpara së cilëvevet çë do bën, çë do mejton njeriu, është fare gjë.

Vet me zëmren, vet me urtësin e zëmrës, mund t’i afrohemi I “pjotishtit i tjetër”, i Cili është po ket llargësit e Tija çë ngë mund arrëhen ne logjismet sesi ata të “*Sommum Ens*”, “*Causa causarum*”, “*Sommum Bonum*” et tjerat të ndrequra ka filosofia, po ulet – “*synkatavasis*” - njera ket mbrëndjet e njeriut, te ku vet do kërkuar, te ku vet do përpjekur.

E ngë do thënë – “ou mi gar tis ehthris su to mystirion ipo” – pse nga fjalë ngë mund t’e rrëmbenj te domethënia e saj.

E dij shën Pali i cili shkurajti, për gjithë Ruinërat e gjithë Fortinot: “*Ek merous gjinokomen ek merous profitevomen, otan to telion elthi tote to ek merous katargithisete*” – “*njofmi vet pjesësisht, e pjesësisht mund fjasmi, kur do të vinjë i përsosuri ahirna çë do është pjesë do t’jet i shkatarruar*”. I përsosuri ngë “ka të vinjë”, e kemi përpara pjesësë sonë ngamon për të bënë “pjesë”, ose relativë, të thënin tënë

E dij shumë më mirë ai jetri Siçiljan “*sine glossa*” çë quhej Gorgias ka Lentini. I cili kish dreqë mejtuar kur tha për Qënëjen: “Ndose Qënëja është na ngë kemi fjalët t’e rrëfiemi, pse një shurbes jan fjalët e njetër është Qënëja”.

Për kush ka familjaritet me filosofin’ e sosme – ose me Heidegger, ose me Derrida, ose me Rorty e të tjerët – di sa i gjet kësaj teologia apofatikë e Etravet tanë. Ajo teologji çë ng’i fidhofet “*ratio*”-s, po vete drejt drejt ket zëmra “noetik”, ket urtësia e zëmrës, përpara e së cilës logjika e *ratio*-s ngë ka vëlim...

Na çë jem’e shkomi orin e nëndë, jem’e presmi të zjofemi ka ëndrri i ligë i Perëndimit... sa të ruami njetër herë Lindjen ka e cila na vjen relativismi i Etravet tanë (ortodoksra?)...

Mbrëmanet

Jan e bëjin një veprim të mirë këtë ka Makji. Ose këtë “ortodoksra”. Mund t’jet se me ftigin e tyre ndonjë sot mund të thot: “Po e di që vjen me thën t’jesh “bizantinë” (sa mos të thomi: “ortodoksë” – fjalë e mallkuar...) ...”

Ket kënéta e Arberisë mund t’jet se gjë ë e tundet.

Mund t’jet se Shpirti është e frynë.

Mbi një numer i vogël, një i vogël popul, një gjindje e shprishur që është e shkon shkretërin e Perëndimit...

Po pse mua që rri ket praku i shumë dierve, pa hitur mbrënda ket shpité, pse më interesojin këtë shurbise?

Gjaku ng’ë ujë.

E rrëfijta kët fakt të ndrishme herë.

Kur, shumë vjetë prapa, gjegja një Pjemontez, sherbëtor i njëj bankje (jo prandaj një prift o një klllogjër) që din’e këndonej grekisht (pa klën grek) gjithë troparet, e dijë kush ishin Krisostomi Niseni Damasheni etëtj... m’erdh si një zemërim i math: pse ai ëh e u jo?

Kur një herë Veneti përpoqa Cacciari e i kërkova pse citonej ket librat e tij Etrat e klisë Lindore e m’u përgjegjë: “Chi, se no”?, thash njetër herë me zemërim: pse ai ëh e u jo? Pse eseun më t’urtë mbi ikonat e shkruajti ai litë e jo një ndër tanshit? Pse te klisat tona ng’u folë kurrë të akcilëve të mëdhenjë? Pse u buartim (?) prapa aristotelismit – nose kurrë- e skolastikës – kujit edhe Jakini ka Fiore i trëmbej? Pse edhe Grottaferratë ngë gjegja kurrë një të më fjitë të mejtimit të këtyrve?

Ahirna zura edhe u të djovasnja gjithë libret që munda mbi besën e Etravet Lindorë. Kështu nani kur vete te banka mund rri pa turp përpara nëpunësit që këndon grekisht – si ngë gjegja kurrë ndonjë Ungër ose Firmozë – gjithë troparet përpara klientevet të thavmasur. Nga herë që vete te banka nani mikun

tim e falenderonj grekisht e citomi ndonjë Atë të... “ortodoksisë”, me kënaqësi reciprokë.

28 të Shën Mirtirit

M’ë arrun sot disa rrëvista, edhe arbëreshe, me buletin e llogaris rrjedëse (tringllisin mir kjo fjalë shqipe) e më një kartë që më kërcënon: “O paguan o ngë të dërgomi më rivisten”. Po kush ju e lipi kurrë rëvisten tuaj? U ngë kam mot të bier prapa çotitë tuaja. U lodha me Skanderbekun, u lodha me traditat tona që mos njeri ndjekë më, u lodha më “les trouvailles”, me rrënimet e historisë. E pra, em t’ë thomi për së drejti, veç dy o tri, mos njeri di e shkruan – e të dish të shkruash ngë vjen me thën të dish të vësh dy virgolla o një konxhuntivë të lloku i drejtë . Kur hapinj ndo një rivistë të tanshit më bien krafët – si mund vemi akoma prapë çotivet.

Shkomëni rrunganxjen – e ndose ngë m’ë shkoni bën guallu – kur dua të djovasinj gjë arbëristh që “ne vale la pena” e shkruanj vetë. Edhë pse – i kini vën rë, e kini notatur – u shkruanj se të komentarinj, sa t’i bënë më të qartë, më të kulluar, mejtimet e të mbëdhenjëvet: që ka kifari me këtë Skanderbeku ose Jurendina ose Kollogrea, ose tri Kostantinërat (vë ndë mesët edhe të madhin ka Ungra).

E pra e pra, mund t’jet se mosnjeri u adunar se ku do është oft’e söldevet, që qelbet drejë si koprea e të ligut; se ku do jan politikandrat, të cilëvet ng’i intereson fare gjë i Arberisë (si atij Cerchio që është gjithaparë parastemë si Ynzot), u ikinj si dhëlpër përpara qenëvet. Me sielljin astëmën me rrahallin që më nxier frymin me qelbësin e tyre.

Për këtë, ndose i kini rishikim shëndetjes sime, mos më dërgoni më rivista e mos më ftoni më te koncertet të muzikës popullore. Edhë për muzikën kur dua i këndonj vet këngat, pata një të

kaluartë të shënuashëm te kor'i Grottaferrata-s e këndova për Rai-n. Pse nani kam të vete të gjegjinjë sanremin që më shkatarronë kujtimet? U këndonja pjotë verë perposh dritësore së nuses sime.

12 të shën Ndreut

Pata kifari këto dita që shkuan për një problemë gjuhsorë. Më telefonartin se doj' të dijin që vjen me thënë "Vatra".

Mbjatu m'erdhë ket kujtimi i grekishtjes: "Bathron Dikes", ose "thron'i Drejtësis". "Bathron" (ose Reuklinianisht: "Vathron") thuhet edë "Bathra" (ose "Vathra"). Domethënia aq njerës fjalë sa jetrës është edhé: "Themel", "Mbështetje", "Shkallarë" etëtj. E Vatra ng'është një shkallarë te nieveli i kujit dhezmi zjarrin? *Βάθρον οίκίας*, prandaj.

Ndose shomi vatrën sesi "themel" i shpisë i ramë më të.

Për së dreqti vatra është qendr'i shpisë. Është lloku, vendi, te ku mbahej dhezët zjarri. Zjarr'i kujtimit të orazëvet e shpisë. Zjarr'i shënjtë të perëndivët ("Lares, Penates") që Enea qelli me të, kur iku ka Troja e muar udhët e mërgjimit. Vendi të vdekurvet që na japjin themelimin e natyres sonë.

"Vatra" qëndr'e shpisë, te ku djegë një zjarrë i mbajtur çelët ka një e "huaj", ardhur ka jashti: Mëma jonë (gjithë Jurendina, mëmat tona), ardhur kush e di ka cila botë e huaj t'ish e bënë Zonjë e shpisë së etravet tanë. Jan dreqë mëmat tona që na bëjin të dyshme natyresh, e na bëjin gjithë mullaqra.

Pra që thë këtë, u ngë di ndose "vatra" hin ndër ato fjalë grekishte që na lanë atà etrat tanë që vijin ka Morea. Te libri i Rupprecht Rohr mbë gjuhën e Firmozës nëng figuron. Ndose njeri di gjë më të dreqët mbi domethënien e "Vatrës" 'e të më sakërdhirinj.

Mund t'jet se ata t'urtët ka Chieri, që më kujtuan se thom shpesh "herdhari", do t'e dinë më se gjithë, po që patin fatin e mirë t'i

jipëjin kët ëmër shoqatës së tyre. Mund të shpresonj ka atà një ndihmë?

Po xura se edhe në Romanië i thon “Vatra” vatrës, drejt si na, me të njejtin domethënie.

13 të shën Ndreut

“Atjè kam edhè u Zonjën mëmë”. Atdheu është vendi të ku fjen nën dhè etrat tanë. Vet njerëzit kan atdhè, pse vet njerëzit varrëzojin të vdekurit.

G.B. Vico thot se “Humanitas” vjen ka “Humando” ose “të varrësoshë”. Varrimi është karakteristika më e vetme, më tipike, e njersisë. E të vdekurit jan “koprea” që bën e lulëzojin më të mirat. Kish ligjë Sokrati: Plutoni, rregj’i nëndheut, rregj’i gjithë shurbisevet të fshehura, është më i bëgati, më i qosmi, e pse ka nëndheu i botës vjen ari, e pse ka nëndheu i vetëhesë sonë (i pavetëdishmi) na vjen gjithë të dijturit (sesi kujtimë, si thoj Platoni). E të pavetëdishmin na e bën të vdekurit për të cilën jemi atë që jemi: eonia i mnimi...

Po na sot harruam të vdekurit, jemi shumë të shtun jashta ka vetëhea jonë sa t’jemi ankora “Humani”, atà që varrësojin. Mund t’jet se të vdekurit do t’i shtimi te hapësirat ilësore, pse këtu mbi dhe ngë kemi më llok te ku mund t’i varrësomi – edhe pse vdeqjen ngë duami t’e shomi më. Ahirna mund t’jet se ngë do të kemi më atdhè, pse ngë do të kemi më lloke të bekuar ka eshtrat e prindëvet e të miqëvet...

Kush e di. Mund t’jet se ahirna do të vremi larta ka qielli e mund t’jet se ahirna do të bëhemi më shpirtërorë...

Mund t’jet se poesia e Zefit Skirò di Maxho do vrejtur kështù, sesi një varrësim me të cilin është e shënjtëron, njetër herë, vendet e tij...

14 të shën Ndreut

Shwarzenegger – më i ziu – e vrau Tookie. Shwarzenegger, Terminator, ai çë di e bën më të fuqishmin vet ket filmet, iu trëmb, si gjithë Amerika, njëj të ziu e e vrau. Ket vepron boja vjen me thën se është një shoqeri nevrotike pjot trëmbësi. Amerikanët më të qosmët, burthofen si më të vafërt, trëmben se bierjin “amerikan way of life”, ç’i duket menira e bekuar ka Ynë Zotë. Neve “amerikan way” na duket, për atà amerikanë çë njofmi, një gjelle e bjerrë pjot dhunë, pjot skicofreni... Shpesh këtë amerikanë çë njofmi jan “siçiljane të karit”, si atà ç’i mbajin bishtin berluskonit, e trëmben nga motë se varfërohen...jan pjot trëmbësi se të hollat çë kam ng’i sosjin kurrë...

Tookie më filaqì gjetë vetëhenë e tij aq sa e kishin sinjaluar për çmimin Nobel. Kush e di ndose Shwarzenegger me gjithë muskulet e tij do t’ë gjënjë ndonjëherë fixhen e tij njerzore.

16 të Shën Ndreut

Sot përpoqa tek bari mikun tim nëpunës bankar çë vepron te Agjensia Unucredit të Favria-s. Sa u pam zum fill me troparet tanë të këndojim: “I Parthenos simeron...”. Pra, sa t’i burthonej miqëvet piemontezra sa i urtë është ndër shurbiset ortodokse e se sa mir di grekishtjen, shtoj: “En Iordani vaptizomenu su, Kyrie,...”.

Kur ja arrum te “qe to pnevma en idi peristeràs...”, qindrova i thavmasur: Shpirt’i Shënjët u materjalizua se si pëllumb. Vjen m’ë thën se njeriu ng’ë lloku privilegjat te ku mund burthofet Perëndia. Edhë Krishti mund t’u kish mishëruar ket një pëllumb, ose ket një shtjerr...

Kujtonjë se Shën Gustini thoj, ngë banj mendë ku, seYnzot krion ëngjëlit, pëllumbat, çë dirgon sesi mesaxheret e tij e prà i shkatarron. Për së drejti, ku vate pra pëllumba ç’u façua te Jordani? Po ngë bënej kështù edhè Zeusi, çë burthofej si dem, si shqiponjë, si arë, si gjalpër. E pse Shpirt’i Shëjtë zgjod pëllumbin?

Sa mos t’jem eretik e sosinj këtù, pa mos t’ju ftonj mos të më vini prapa: jam i rrëzikshem....

4 të Marsit 2006

Vjenë Lina, grua siçiliane ka Gela, me të cilen shkëbenj librat e Camilleri – një herë i bjenj u, njetër ajo – e më siell të sprasmin e shkrimtarit siçilian : Pensione Eva.

Lina më vren me një buzëqeshje pjot me djallëri: “I ke bënë edhè ti të ligat çë rrufifen Camilleri ket ki libër?”

“E pse jo? Ndër atà mote ish i detyrueshëm të frekuentonje disà lloke. Ngë kishim ndryshe manerë të afrojim një grua...”

“E i bëre edhè ty të liga për së vogëli, sesi Nenë?”

“Pse ti jo? Ng’e kishim gjithë një tavullat, ose një “tettomorto” tekù vejim e bridhjin jatrua e të sëmur? Po isha shum i vogël ahirna sa të bëja shurbise të liga. Pra vajta njize te kulegji i priftravet e zura të bëfsha shënjtë e xura ç’është mëkatja. Kur dolla ka kulegji isha shum i dijtur sa të bënja shurbise të liga. Xura dashurin. E ahirna ngë di ndose bënja shurbise të liga edhè kur venja ket ato shpì me atò gra, pse mejtonja fjalin e S.Gustinit:”*ama et fac quod vis*”.

Jo vetim. Ligja urdhëron mos të deshirosh gruajen e të tjervet. E ato ishin gra të mosnjeriu, për kët mund t’i deshironja pa mëkatë”.

“E si kle e para herë?”

“E ti çë do t’e bësh? Ng’jan shurbise çë kallëzofen, edhè pse u i desha nga mon atò gra, ngë qyejta kurrë. U atò gra i donja mir,

binja në dashuri. Isha një “cottarolo” si thon litinjët. Për kët kam zili të thomë si kle e para herë”

“Po kle e para herë me një grua asoje? E ju namurarte?”

“Ëh, po, zonjë”.

E me kryet ulët zë fill e rrufienj.

Kisha bën ka një ditë o dy tetëmbëdhjet vjeç. Vinja ka Roma e u qëndrova Salern sa të falnja lalën e cien që banojin ket ai qytet. Cia kish mbajtur mend se bënja tetëmbëdhjet vjeç. E më kish përgatitur disa llikuzhi për darkën. Ishim akoma më tryes kur im kushrir më ruajti më një buzëqeshje pjot ironi ture më ftuar: “Ea se dalmi, se t’i jap u llikuzhit. Ea se vem’e jami një shtitje, se je mafe si një rrikiz”.

Dualltim gjatë detit. Një erë e fortë e e ngritë shkundënej degat e palmavet, suvalat e detit kapërcejin mbatan muralunëvet. Ish akoma bisht’i dimërit që qatrarnej fillim e paraverës edhë ket ai qytet detarë.

“Di që të thom? Ea se vemi të shpia e disa shokazve time. Pra shoh se ti ecin ngruq e shkryq e jo vet për erin o për verin, kam besë se ke bëzonj të marrësh një jatri që di u”.

Lamë gjatëdetin e hitim ket një anë e qytetit pak e dritësuar. Rrethuan për dy tri rrugete që nata bënej akoma më të shkreta sesa ishin. Hitim ket një purtun fort i errët. Bënej dritë vet një llumin i dhezët përpara njëj ikonë të Shën Mërisë se Pompeit. Isha shumë babëllabà për mos të pandefnja ku ish e më qellnej im kusëhrrir. Hiptim një shkallë akoma më e errët se purtuni. Cilat shokazë e tim kusëhrriri mund të banojin ket ai llok?

U hap një derë e më në fund na erru drita. Një djalosh na bashkoj te një sallot teku rrethë një tryesje ishin ulët tri kopile. U ngrejtin të tria të na faljin, ture e puthur, tim kusëhrrir. Dukej se ishim të pritur pse njera ndër kopilet tha ture qeshur: “Ki është it kusëhrrir? Ësht ki që bëri vitrat?”

“O, tratomënie mir” ju përgjegj im kusëhrrir.

Na ftuan t’ulëshim me ’to rrethë tryesis.

Njera ndër të tria u façua ket një derë e dha një vuxhe: “Donna Mari venite a verè chi è venuto a trovarci”

“U sacce, u sacce: è l’amuri mio T***, mo veng, mo veng e vi puort’u caffè. Faccitile accumuladà”.

Ngë shkoj shum mot e u paraqit një pjakë e majme e zgjiruar si një bute, me dy sy çë vejin nga një për kundin e tij. Ecënej sa mënxith mbi di këmbë të fryta si patuçe: “U figlië mie bellë” vej ture thën ndërsa i qasej tim kusëhriri me spazin ket kish vën disa kikare kafe.

Pra çë mbështeti spazin ket tryesa m’u qasë: “Chistu è u giovatto bellu. E mo virimm che avimm’a fa’. Carmeli ci pensate vui?”.

Ndërsa të tjerët pijin kafeun Karmelina u ngrë e erdhë e m’u vu prapa krafvet. Më përqafoj e më qasi faqen ket faqja ime ture më vën dorin mbrënda ket këmisha. Ndersa më lëmonej muskulet e gjirit më thoj ket veshi ture pëshpëritur: “Do të shosh se ki djalë është një ter? Do të vish me mua? Vemi ket kamarja ime? I lëmi këtë se jan e më varesjin me qaçaret e tyre?”

Im kusëhrir më benej shenj me kryet të venja me Karmelinen.

Kur ndelgova ku më kish sjelur im kushërir, një dridhim më zu kurmin. U bëra i turpëshem, e u nguqa i tërë.

Ket kamarj’e saj Karmelina zu fill të më puthnej gjithaparuar. U u kisha bën si dru. Shinja çë do bënej Karmelina me surprizë, pabes se një grua mund të më deshironëj nd’atë maner. Karmelina thoj se më donej. Isha në pamundësinë të ngrënja një dorë e ket kish’ t’isha si do natyra, isha mungar...

“Ç’është era e ligë çë të bën mungar? O ngë të pëlqenj?”.

Karmelina bënej kund se u kish fryjtur. Po u rrinja me sytë më truall...

Ngë di të thom si vate pra.

Mb’udhë im kushërir më ruanej i pabesëm: “Pse bën mungarin? Mos më thuaj se ngë bëre fare gjë me Karmelinen. Shi se

Karmelina është gruaja më e mirë që mund gjësh Salern....”. Venja me kryet ulët me një dridhëm kalosh. Kisha te kurmi e te duart aromin e Karmelinës. Një zëmërim i math më shkundënej gjithë kurmin e m’anagasnej hapet. U vura e burrrarta përposhë shiut e zura e thërrita si i marrë....

Shkova gjithë natën me syt të hapët, me Karmelinin që vaxhdonej e më kërkonej me buzën e saj gjithë kurmin. Te një moment ndiejta syt të lagët, helmëzat më shkundjin gjithë kurmin. Ahirna do të kisha pasur Karmelinin prrëzë sa t’i kthenja gjithë puthjet që më kish dhënë. Doj’ t’ju kisha vën për gjunazë sa t’e dhulonja si një perëndeshe.

Mbeta gjithë ditën pastaj më një ngatërrim të madh ture shëtitor te gjatëdeti. Moti u kish hapur e një diell i ngrohtë më mbajti mend se kish ardhur paravera.

Im kushërir më qeshnej: “Po ç’efekt të bëri Karmelina? Ngë të xhuvarti fare? Oë, duke i çotjasur...”.

Ng’e ndienja tim kushërir, fjit, fjit mund t’jet se më jip disa këshile, mund t’jet se më ngushllonej ture thën se e para hërë je kështu i ngordhur sa ng’je i mir të bësh fare gjë.

Mua më vijin në nxë disa vjershe të shëjtë te ku deklarofet se dashuria e mortja ven bashkë, ose se dashuria është e fort si mortja, se dashuria... dashuria... dot’e kisha pasur me mua Karmelinen sa t’e mbanja prrëzë për ngamon.

U kishim ngjatur sipër muret të gjatëdetit e ngrohëshim si dy xhapi: “Thuam t’ e vërtetjen. Ti sonde do të priresh ka Karmelina. Mos u llavë, të qellinj papani. Po të rakomandonj, bë mos të më shajin se kam një kushërir pa herdhe....”.

Ng’iu përgjegja, ndiejta një lot që më lagënej syun, kët herë me kënaqësi.

Kët herë Karmelina mbet e paqme. Me shumë njomësi i shkararta gjithë kurmin me buzën, i lëmonja krafet të hollë, i puthnja syt. Karmelina kët herë kish lëshuar hjetat e lesh'i zi i zdripej gjatë krafëvet. Me ato hjeta të lëshuara çera i dukej më e vogël si ajò e njëj vaizje...

“Të dua mir, mbam me tij, mbam me tij, të dua të dua...”

Akoma sot kujtonj Karmelinen me mallëngjim. Mund t’jet se ket gjithë grat që pata vajta ture kërkuar Karmelinin...dridhmin që më kish vën më kurm...atë humbje tek vërteta dashuria e mortja përpiqen...

“Ahirna ngë bëre shurbise të liga” më thot Lina, “po mund t’jet se për këtë ju burra jini ngamon ka njetër anë kur dashuroni...”

’E t’jet si t’jet. U ng’ jam fare te logjika “huius saeculi”. U thom si Tertuliani: “*Non pudet quia pudendum est*”. E kush më njeh di se u qella ngamon sesi më frymëson për mbrënda “*intelletto d’amore*”. Me gjithë pasonjet ë mira e të liga. Gjithsej e i bukur e i shënjtë....

Xura më ka atò gra se ka prifrat. Qofshin të bekuara atò gra.

28 të Shën Ndreut 2005

U zdrypa Firmozë për kapdhanin sa të shokëronja mëmin, e cila, ndomos se ka katërzet e trembdhjet vjeç gjellon e vetme ket shpi’ e prindëvet tim. Ja arrënj mbrëmanet përposh shì e mjergull, që më thonë: njota ja arrure më shpit tënde. Kish tridhjet vitra që ngë shkoja Firmozë pushimet e natallëvet. Kisha harruar tëtimin e Firmozës e lagësin e klimit të saj. Kisha harruar se moti mbllin më Shën Mitër e hapin, kur hapin, më prill (po “prilli të kërrusin si këmilli”). Kisha harruar sesi frin levantina e sesi nxin qielli ka Sybari e sesi mbjidhen retë pjot shi

e borë mbi Silës. Pjot borë është Pulini. Te një moment sakirdhirem mbi situatën e motit ture vrejtur ka terraci i shpisë. Më thot se do të shkonjë ditat përpara vatrës, teku një kucar i math na defton ka tëtimi.

Më dispëlqen se më klishë ngë këndojin më “I Parthenos simeron...” çë kish një herë merë pushimes.

Mëma pjek mishë derri me hellin. Arom’i mishit të pjekur është arom’i Firmozës më dimër. E mua çë jam vegjetarjan më vjen varesi për këta të pjekur.

“U bëre litë. Vet litinjët kan veset tondë. Ku u pa se ngë piqet mish ket shpia ime, e mish derri më dimër?”

Mëma ka frigoriferin pjot mish ç’i sualltin për arvaxhet. Njeri ka t’e harë. E ai njeri jam u. Për gjithë javin çë do të shkonj Firmozë, do të ha mish. Edhë dy herë ditin.

Pra mejtonj se Solovev tha se Antikrishti do t’jet vegjetarjan e ngushullofem: Krishti edhë haj mish po mish shtjerri...

29 të Shën Ndreut

Erdh e më muar Alfredi Frega me “la gloriosa cinquecento”, çë ka dyzet vjeç. U mbjak me ne, po si na ngë ka astëmin, hipet ket ngjitj’e Honit pa veshtirësi. Motori i këndonë si kur t’ish i ri. Alfredi më qellin Fermë teku ë e mbafet një konferencë mbi librin e Damësit “Mediterraneo e Migrazioni”. Konferenca mbafet ket një sallon i madh e fort i ngrit. Gjithë konferenxieret jan të mbullukuar ket kapotet e, kush e ka, mban shapkën ndë kocët. Sidomos një grua litire (e njëmos kush?) ç’është asesor’i i pakicavet. Më duket një situatë “da terzo mondo”. U si i hollë, si civilë, nxier kapot e shapkë, edhë pse jam i mësuar se kur jan zonja ket një sallë ke të nxiersh aq shapken sa kapotin. Pa shapkë e pa kapot ndënja ket ajo sallë i vdekur tëtimi ture mejtuar se pse kan akoma këto situata ket katundet tanë. Me gjithë të hollat çë grisen si Ungër pa fitim pse nëng pajiset me

ngrohjen një sallon teku mund të gjegjen konferencat pa çë të akullofen trutë? Sesi mund të mbash ket të timi për dy, tre orë një publik çë ndiejti abulkacjunin të vi' të të gjegjënej?

E m'u akulluan trutë kur u ngrëjta e u qasa ket triesa e konferenxiervet sa të thonja edhe u dy fjalë. Tëtimi më babarti edhë gluhin çë ngë gjënej udhin e saj. Babarta katër fjalë e u prora t'ulsha pse isha i vdekur tëtimi.

Sa shurbise do të kisha thënë, më e më mbi historinë, tek e cila ulmi pamundësin sonë t'jemi sot atë çë jemi. Priremi prap nga herë ture rrotulluar ket vatra të njëjtin hi e pra ngë dim'e thomi një fjalë, ngë dim'e shkruami një vargë arbërisht për të përshkruami atë çë jemi.

Mundësi'e të vdekurvet? Të cilët kan zili mos t'i harromi? Mundësi'e të vdekurvet çë kan zili t'jemi si jemi ket moti ynë? Nietzsche thoj se për të jetomi mirë, kem' të harromi. E Plotini thoj se shpirti më i mir është ai çë di e harron.

Sosmi me historinë çë na magjepsin. Zakonat jan zakona të mira vet ndose din'e përsëriten.

The ndryshe shurbise ket ajo sallë e ngritë.

Pra me Alfredin u pruartim Firmozë. Një mjergull e madhe na mbarrarti udhin. U pa'të nxirnja kriet ka dritarja të ruanja mos të diljim jasht ka udha. "Terzo mondo" veja ture thërritur: "Pa një vijë mesore, pa një vijë anësore".

Pra Alfredhi, po çë "la cinquecento" ngë ka fanel të mirë të presjin mjergulin, pat "l'infelice idea" të prirej prap sa të mir maknin më të madhe. Ket mjergula jan manovra çë ngë bëhen kurrë. Na u drodhë zëmra kur pam se njetër makën ish'e na vinej kundër. Si do qe, j'arrum Ungri e Alfredhi muar jetrën makin. Ndërsa u pruartim Ungir mjergulla u spavë e patëtim si të mbjdhëshim Firmozë pa probleme. Po më për së drejti: më gjithë tëtimim e lagësinë çë mora me kriet jasht ka dritarja, më zun dhëmballët.

Ekutikà Firmoza: aromë mish derri të pjekur, dëmbje dhëmbësh, rromacë, tëtimë, lagësi, qiell'i vrëjtur për muaje e muaje.

30 të shën Ndreut

Sot duket se do të bier borë. Zdripen fieta borje lehtë lehtë. Mejtonjë kur isha djalë kur na bllijin më shpi metra borë, mos ngë vinej Anxelmi të na hapnej derin, ngë kishim ka të diljim. Ka qaramidet zdyshin kanarikulit. Ahirna vëjim pagjidhet sa të zëjim ndo një zog. Pasaret cimbisjin këtu e këtje, po rrijin llargu ka ullir'i pagjidhjes.

Më telefonarin Alfredhi: “Vem’e i gjëmi atà ka Maqi?”

Atà ka Maqi, jan vet një: Jozif Kosentino. I cili na pret me harë. Maqë nëng bie borë. Përkundrazë hapet qielli e burthon një diell të sëmurë.

Vëfem mbjatu me miqësi në përballë të Kosentinit: ka një bibliotek të qosme me librat e etravet tanë lindorë. Ki është një arbëresh' i tërë. Na rrëfien guerrin ç'ë e i bën peshkopi ka Ungra e se si gjindja e Maqit është me të. Sesi kur ndodhet i vjen një prift ortodoksë t'i thot meshin – përkundrazë kur na qellin ka bari të pimi gjë gruaja çë na shërben më merr për një prift – jam i tër i veshur i zi –e thot: “Erdhë për meshin tonë?”. Kosentini thot i kënaqur: “E sheh se si na duan?”.

Kosentini më mbjon më libra teologjije ortodokse, e bën e njoh Maksimos Lavriotes, e Romanidhes historian.

Mund t'jet se këtu, ket ki katund çë më mban mendë Çiftin, pse ka një pik panoramikë çë hapet mbi detit, është e tundet gjë. Mund t'jet se ket katundi i Radhanit do të zërë njetër histori për arbëreshët.

Po kush jan sot arbëreshët? Shkruajin e fjasjin litisht, parkalesjin litisht, nderojin Padre Pio, bëhen Papaboys e i ven prapa *Comunione e liberazione* e votojin berluskonin, ëndrra e ankthi i Italisë.

Kosentini fjet, fjet, fjet, si gjithë ata që ngë kan dëgjonjësra.
Vuxhë te shkretëria... Te shkretëria e Arbërisë.

31 të shën Ndreut

Sot as hëngra as piva. Më dhëmben dhëmballët e më duall një aftë ket çunjet. Jan dhëmbje të cilavet ng'jam i mësuar. Rruzaja ç'është vajza që baton më shpi t'i jap ndihje mëmës e fjë natin me të, më kësilon të spërlanj dëmbët me uthull e kripë. Sot ë dit pushimi. Ngë jan jatronjë. Farmacia ë e mbllitur, ndose dua të rri mir kam t'i vete prapa kësilëvet të Rruzares. Mejtonj se mëmalasht'e saj din'e bënej mbjastre me qepë e me mëllagë për nga një dhëmbje. Gjithë të sëmurtë vejin ka cjë Rruzaja. Kam bes se kjò Rruzare e vogël ka marrë ka e jëm'e tatmadhit të saj. I besofem, po që ngë kam më gjë, jatrisë së saj. Uthulla e kripa më ekçitojin ndutu më shum dhëmbjen. Rrusaria prapa syzet të saj miope qeshin. Ruan këtë liti ç'i ka bes vet jatrisë litire. "Mua më skuan mbjatu dhëmbët me uthull e kripë, ng'e ke besë?"

Mund t'jet se shërimi është një akund besje. E na që ng'i kemi besë faregjëje kemi sëmundjen më të madhe.

1 i Janarit 2006

I gëzuar vit'i ri, gjithë atyrve që ngë kan dhëmbje dhëmbësh. Po e gjënjë një që do të më shëronjë mbjatu. Është zonja Xhuzepinë Laurito ka Ferma, e shoqja e Fran Damis avukat e i prasm i historjan i Ungris për konferencin e të cilit mora jetrën mbrëma ketë sëmundje. Me zonjin Xhuzepine shkova një vit, që ngë kam si të harronj, ket skolla e mesme e Firmozës ndonjë tridhjetë vitra prapë. Ishim të rinjë ahirna. Po duket se vitrat ngë shkuan. Xhuxepina është e bukur si ahirna. Tridhjetë vitra që ngë shihemi. Xhuxepina ngë më njohu mbjatu kur u përpoqim ket

konferenc'e të shoqit. Duket se u mbjaka shumë. Po kur më më njuhë ka të njëtin përzëmësi të së shkuames.

Nani çë më ka më shpì do të më mbjonjë me llikuzhì. Më ofron kanole e ndrishe ëmbëlsira. Pranonj vet një rakì me të cilin shpresonj të qëllonj një çikë dhëmbjen e dhëmballëvet.

Xhuzepina më kësilon një injeksjon me antibjotik. Më duket keqë të pranonj ket jatrì e thom se jo, ture e siguruar se nani rri më mirë.

“Vinj u neser e të bënj injeksjonin ndose je akoma i sëmur. Kjo injeksjon bën mrakulli për dhëmbët”.

Sytë e saj çë qeshjin ngamon bëjin të ndienj gjithë barrin e vitravet çë kam kaloshë.

Ë njetër dhunë e këtij kthimi Firmozë: kush e di kush më muar sysh.

3 të Janarit

Kthimi Romë më shëronë ka gjithë dhëmbjet e Firmozës e t' Arbërisë.

Tha një i urtë se e njëjta mjeshtëri njerzore është dhëmbja. E mund t'jet se u prirem Firmozë sa të praktikonj këtë mjeshtëri çë më del më mirë se gjithë të tjerat.

Si do t'jetë, ajër'i Romës më vë fuqi kalosh e vete ture ecur për disa ore për udhët e saj me time shoqe. Zdripemi ket staciona e S. Pjetrit e vemi më këmbë njera ka Staciona Termini. Ishë rruga çë përshkonja në Ndon Sassone, ture biseduar mbi “i massimi sistemi”. Nani ç'ài ng'ë më, kam pak entuziazmë të vete ture shtitur Romë.

Bënj një pushim si ngamon te libraria Feltrinelli, te Piazza Argentina. Hapinj disa libra, i prier fjetat me një gjest automatik

si kur se jam'e përkëdhelinj atë faqe gruaje çë më vren e paqme ka kopertina. Pra sytë më ven mbi një libër mbi logos-in. Ka sesi epigrafë “*En archè en o logos*”. E mbllinjë mbjatu. Nëng dua të di asedhë kush është auktori. Sigurisht është një racionalist çë do të dimonstronjë sesi *logos*-i i racionalismit është i njëjti me *logos*-in ç’ish “*en archè*”, me *logos*-in ç’ish “*pros tòn theòn*” e me *logo*-sin ç’ish “*theòs*” (“*kai theòs en ho logos*”).

Kjò rrunganxe e racionalismit për të cilin *logos*-i i tij është ai i Perëndisë, më vë “*di cattivo umore*”. Dy *logos*-et ngë mund t’jen i njëjti.

E para: *logos*-i i njeriut është një mjet *i vullnetit të fuqisë*. E Perëndia, sa më pak se si kem t’e njohmi na të krishter, ngë ka një *vullnet fuqije*. *Agape* e Tij ka lën nga një vullnet, pse një mos ng’ë *Agape*. E cila është “*gratis*”, pa shkak e pa kufi. Vullneti është ngamon i lig pse ka shkak e ka kufi.

E dyta: *logos*-i i njeriut ndan (*ratio - diaballein*) kurse ai i Perëndisë mban nga gjë bashkë: Ditin e natin, të miri e të ligun, dheun e qiellin, shiun e etjen, dimrin e verin, gjellen e mortjen. Ket Perëndia gjithëseja është një (*symballein*).

E treta: *logos*-i njerzorë ose “*dianoia*” ose “*ratio*” ose te fundi skenzja, ose *episteme*, sipas Shën Palin është lënsi perpara t’Ynë Zoti. Ahirna, sesi mund *logos*-i ç’ish “*pros ton Theon*” t’jet *logos*-i njeriut ose vëçversa? Frimëmadhja e katolikëvet me teologjin e S.Tumasit është një “*hybris*” çë ngë ka rrëpar. Pra ndose Krishterja ka fund ket “*lënsi’e kriqes*” sesi mund t’jet se *logos*-i njeriut mund t’jet ai ç’ish “*pros tòn Theòn*”? *Logos*-i njeriut do të ndanjë (*diaballein*), do të ndalonjë, nga një lënsi. Nani ndose Krishti, *logos*-i ç’ish “*pros ton Theon*”, iu dha i tërë lënsisë se *kriqes* sesi mund t’jet *logos*-i i njeriut, sesi mund t’jet *logos*-i i “*ratio*”? kët e thot “*ratio*”, *logos*-i njeriut kundër *logos*-in e njeriut e kundër frimëmadhen e tij.

“*Ratio*” është *logos*-i i litinjëvet, *logos*-i S. Tumasit, *logos*-i klisë katolike. Klisha ortodokse pat ngamon, e i vate prapa,

“logos-it të zëmëris” (“*Le coeur a ses raisons, que la raison ne connaît point*” – Pascal, *Pensée* 277), çë grekisht, te grekishtja e etravet tanë lindor, quhet “*nous*” çë ng’ëshet as *logos*-i Aristotelit as *ratio* e S. Tumasit ose S. Gustinit.

5 të Janarit

U propa më shpi Rivarolo Canavese. Dentisti ngë m’jep pushimë. Nëng ja arrënj të të qendërohem ket fare gjë. Kam kryet vakand. Ja arrënj vetim të djovasinjë ndonjë libër. Ket njeri i njëj auktori çë prirem e djovasinj shumë herë e me të cilin kam një bashkëtingëllim shpirtëror, djovasinj ket fjet çë ngë kam dëshirë të përkthenj arbërisht. Kush ka vesh të gjegjin ‘e të gjegjinj:’*Ricche di significati emozionali sono le parole che pronunciamo nella nostra lingua che, prima di significare, è qualcosa che si dice, che si ascolta e che si intende, perché si vive in quel mondo di cui quella lingua è lingua. La carica emozionale che riveste le parole della lingua madre non è mai traducibile in un’altra, per cui al limite possiamo parlare più lingue, senza giungere al fondo della comunicazione, perché non viviamo il mondo che nelle altre lingue si esprime. Questo dovrebbe insegnarci che la parola non è lo strumento di un’altra potenza quale il pensiero o l’anima, ma l’eccedere della nostra esistenza nel linguaggio, il trasfigurarsi del nostro corpo che nel gesto verbale tradisce il modo in cui ha percepito il suo mondo*”. (U. Galimberti: *Idee: il catalogo è questo*. – Feltrinelli 1999 – pag. 37).

I kushtonj këto fjalë atyrve çë bëjin “import-export” gluhsore ka Shqipëria ture bën “affari” me financiametët krahinor, shtetëror e evropian, sidomos atyrve çë jan antropologra të mirë: Ku bbona salute. Ng’ dua të bënj ëmra, po veprojin te Unikali.

17 të Janarit 2006

Ndose kisha pasur si, u kisha vën përgjunjaz përpara atij kuadri të Gauguin “*Bonjour monsieur Gauguin*”, ose përpara atij t’jetrit me dy gra Tahitiane, ose të gjithë të tjervet, e të gjithë atyrve të Van Gog-ut ç’ishin të vargarisur te museumi i Brescia ket një ekspozicionë të jashtzakoshme që mbjedh vepra që ngë kisha akoma parë as Romë as Paris as Martigny as Lugano.

Ndose kisha pasur u kisha vën përgjunjaz ture shtun lot njomësije, te lloku t’i veja prapa shoqëruesis (si thonë shqiptarët), guidës, që vej ture i mbjuar me çotì kriet e skollelëvet me të cilët isha bashkë. Ish vajzë e bukur e cila shihej se kish xënë më kujtës fjalët e tjervet e i përsëritnej pa ditur ç’ish e thonej. E për bukurinë e rinisë së saj mbeta qetu për disa motë, sa mos t’e babarnja e mos t’e mortifikarnja. Pra kur bëri të prasmen gjuhgatësi, të prasmen pirdhuçkari, si thomi na, ng’ja bëra më e zur’e mejtova vuxhëllartë.

S’mund tratofet artja me mentalitetin të “*adaequatio*”, pse artja ngë një sistem të shenjes, që rrinë te lloku i shurbisevet këtjeshashta. Artja, ndërkaqë, ng’ë një sistem. Të sajat jam simbole që ngë ven me ligjen e “*adaequatio*” ose të “*orthotes*”, të cilat ven bashkë me parimin e identitetit, jo të kontradiktës, e të “*tertium non datur*”. Këta parime ket simbolet nëng vlejtin. Për kundraz simboli i mban bashkë, pse te simboli një shurbes është njetër. Simboli ngë ka kifari me *logos*-in e “*adaequatio*”.

Jeta këtjeshashta është vet një griepësh, një ganxhë, teku artisti vargarisin shapkën e tij; një karriqe ku artisti prënë shpirtin e tij: pse artisti ngë di që do e vepron për fare gjë.

Kur Van Gog pindaksin qiparriset, ose ullinjët, ose vreshtat, ng’ë e pindaksin qiparrise, ose ullinjë, ose vreshta; ng’ë e pindaksin postierin ose jatruan ose xuavin; këtë jan shenje të rremë te ku pathënmja e noeris së tij gjën një manerë (të rreme)

të burthofet, te një moment... e na lë neve që kontemplarmi ket një hapësirë e madhe pa fjalë. Çë do fjalë (fjala ndanë) do të tradhëtonjë domethënëjen, atë mister që kemi përpara.

E kështu nëng mund të thomi - si ë e thotë shoqëruesja, guida - se Van Gog ket ki kuadhër ë e riprodhon, ë e kopjon Millet: njetër herë ket Millet Van Gog gjet njetër ganxhë, një shkallandrun më i përshtatshëm të ku mund vargarisinjë sensibilitetin e tij.

Kështu kur Van Gog “kopjarin” Millet është e bën të njëjtën shurbes sesi kur “kopjarin” qiparriset, ose ullinjët ose postierin.

Vet realizmi mund, naivisht, të mejtonjë se artisti ka të kopjonjë, ose ka të përfaqësonjë shurbiset këtjè-jashta. Sesà të vdekur e sesà shurbise të vdekura la realizmi, sidomos realizmi socialist, te udha e tij. Edhë Guttuso një herë tha se realizmi socialist ish një keqkuptim i artës.

Te simboli këtò gra të Gauguin bëfen Shën Mëri më se Shën Mëria, e quadret e tij jan si gjithë quadret, përfaqësime të shenjtë. Për këtë ket ekspositat kish të vëjin disà kushine për me vën përgjunjaz, pa mos njeri ndër këtë t’urtë që ven ture bën fjalë matulla matulla. Kuadret kur jan të frymëzuar ka “Shpirti” duan vet qetësi e konteplacionë.

1 i Fjavarit

Nesër është festa e Ipapantisë. Për këtë rast zot’i klisë së madhe në Rivarolo ftoj një prift ortodoks romen sa të celebronej dhesperin. Klisa u mbjua me romene – njera, kam t’e thomë, më e bukur se jetra - e të shërofet zëmra me kaq bëlicë pse është rallë të përpkësh një Pjemontese e bukur. Bëjin gjithë “le badanti”. E për këtë, me ato, ishin edhë gjirit e të sëmurvet e Rivarolos. Klisa ishë pjot gjind si ket një fest’e madhe.

Ngë pata vështirësi t’i binja mb’udhë me veshin parkalesivet romenisht të priftit ose të korit (një tenor, një kontralt e një bas

ç’i mbanej ison-in me një thellsi e rallë te koret tanë). Kështu pata si t’i venja prap me grekishtjen tonë.

Me këndimet lindore, me livandin që prifti shprishi me thimjatirin pjot çinxhinele, zëmra vate ka desh, e sytë m’u mbjuan pjot lot. Ng’jam një që mallëngjefet lehtësisht, as jam si thonë litinjët “un bacia pile”, po pak herë pisërofem sesi kur ket ndonjë klishë gjegjinj këndime si do Ynë Zot , në ortho/doksi, ose te menira e dreçët (ortho) të lavderoshë (doksia) t’Ynë Zot . Gjë më helq kush e di ku, për këtë nëng frekuentonj klishat litire po edhë tonat ket këndofet më litisht se grekisht.

E me këtë grekisht, që na ngau, me fat të mirë, kush e di pse, kem të bëmi kundet na arbëreshë. Ngë më pilqen fare se përktëmi meshin arbërisht.

Këtu jam i pajtuar më *Orakolet të Kaldevet* të cilët thon se shenjti do t’jet i shprejtur me fjalë sa më të huaja që mund t’jet. E jam i pajtuar edhë me Vattimo i cili thot se për të shejtin ngë do të përdoren fjalët që përdoren nga dita për nevoesat të njeriut: *pasan tin viotikin apothometha merimnan..*

E me grekishtjen na arbëreshë kem të bëmi kundet pse e kemi thellë më zëmër dreç si kemi më zëmër arbërishtjen.

Për sa më intereson u kam më zëmër më grekishtjen se arbëristjen. Fare gjë më nget sa këndimet grekisht e nga herë që ket mesha hijin këndimet litisht di se kam të dalë ka klisha.

Kur sosi dhesperi ket klisha e madhe e Rivarolos klem gjithë të mirosur ndë ballë ka prifti romen. Një merë e hollë përfumi lindor u shprish ket klisha. Na ç’u bëme litinjë këta tradhita i buartim: thom Ungir e Firmozë, gjetkë ng’e di.

E me këtë grekishtje që jem’e vëmi ndë tavullat, ose që jem’e vëmi nëndhë, me grekishtjen që harruam, na arbëreshë kem’ të bëmi kundet.

Ndër historjanet tanë është njeri që di të më thot pse thomi meshin greke e jo arbërisht, se si romenisht e thon këtë romene?

Kur pas dhesperit u hiptim ket oratori sa të hajim një copë paneton e të pijim një pik spumant, pse famulltari, si thon shqiptarët, i S. Giacomo doj t'i bënej festë romenëvet , ju qasa priftit të huaj e i këndova *Fos ilaron*. I thash: vet kështu mund të mbllinj ditën time.

3 të Fjavarit

Jam e djovasinj romanin e Carmine Abate, i cili thufet shkrimtar arbëresh ndomos se shkruan italianisht. Më xë një varesi e madhe, pse përsëritin të njëjtin “*fabula*”, “*fabulin*” e kthimit. Vet se kët herë vet’e zgavalarin Skanderbekun të një maner’e dëtiruar sa të bënëjë historinë arbreshe, sa gjithë “*fabula*” e Abate-t bëfet e pabesueme.

Ngë ja arrënj të këputinj pabesimin, sidomos kur bën e fjasjin *similarbreshinisht* personagjet e tij. Italisht thufet se shkrimtari përdoron “il birignao similarbreshino”. Do të kisha shtun ktjë librin kur ja arrura ket fjeta e zetë, po më ndifi dashuri’e atdheut, e vajta përpara njera te fundi te ku gjeta pikërisht “il lieto fine”.

U ngë duronj ëmbëlsirat, vuanj djabetin. Kam të rufem ka cukarit edhë sidomos kur ë i shprishur ket fjetat e libravet.

Po ng’ë ki problemi ynë, këtë le t’e shofjin kritikata ialianë.

Problemi ynë është vet pse një çë ngë shkruajti kurrë një varg arbërisht shkon për një shkrimtar arbëresh. Na për t’e thomi i tilli e parkalesmi të shkruanj një roman arbërisht. Ndelgomi se kështu ngë ka si të verë ture gjetur çmime letrarë, as ture gjetur kush ka fuqin t’e djovasinjë arbërisht.

Po “qui si parrà la sua nobilitate” e do të na nxier ka sospekti se Arbëria për të është vet një motiv më shum të mbjedhë “lettori, purchè siano”. E për këtë shkrimtarit tanë “arbëresh” i kemi gjithë konsideratin çë mundmi: libri është një produkt industrial e si i tillë do promovirtur.

Po për shpirtin e prigatorvet tanë arbëreshë e' t'jet vet një shkrimtare italian.

4 të Fjavarit

Me arrënë me tamtamin e miqëvet që djovasjin edhë “la carta igienica” ki librush’ i Ornela Vorpsi: “Il paese dove non si muore mai”.

Ornela është skrimtare shqiptare që shkruan italianisht. Njetër problem: që shkrimtare është Ornela? Ng’ë problem që na intereson, pse ng’jemi e e djovasmi pse është shqiptare.

Librush’i saj kapërcen me dy këmbët problemin, pse Ornela është e shkruan jo një “fabula” shqipëtare po është e deskrivirin një situatë njerzore existenciale më par se një rrëfim shqiptar.

Si do që t’jet, me ashpërsirat e saj shërohem ka ëmbëlsirat e Abate

Ngë dua këtë të thom fare gjë mbi Vorpsin shkrimtare, m’intereson vetim ikja e saj ka mëmat, ciet (ka tezët si thon shqiptarët) e gjithë ata që të pengojin sa të rritesh, sa të gjelloshë ndë mest rrëzikvet.

Kam ngamon ndër kujtimet litrarë ikjen e Tolstojit: kish katër zetë vieç kur iku ka e shoqja... e ka ciet...

14 të Fjavarit

Mora sot te libraria “Claudiana”, që është shpia botues së Valdesëvet, librin e Giovanni Rota: Giuseppe Gangale, Filosofia e protestantesimo.

E diovasa ndër pak orë pse ka pak fjeta, 176.

Auktori është një kirkues e univetsitetit të Torino-s. Si ngamon, kan t’jen litiñjët t’e din më të gjatë se na.

Gangale? Kush ish ki arbëresh?

Një i çuditshëm personaxh që kish një më të çuditur pikpamje mbi gjufin arbreshe. Kështu e shkon “vulgata” arbëreshe.

Kursë ture diovasur librin e Rota-s, kujit ng’i intereson arbëresheria, vjen jasht një filosof e një intelektual i madh i lidhur me më të mbëdenjët filosofat e sekujit që shkoj: me Gobetti, me Croce, me Gentile me Tilgher, Banfi etëtj... Antifashistë si ngë din t’jen shumë arbëseshë sot.

Megjithatë ng’i jap marrëveshje teorisë së tij me “la cultura della crisi”.

“La crisi”përballë kë?

Ng’eksiston një njeri sot që ng’është “laudator temporis acti”. Ngë një sot, një kohë, që ng’është “in crisi”.

Krishtëria kle “in crisi” sa u le. Ngë kle kurrë një krishtëri e dëlirë e pastër. Si filozofia, e cila u le mbjatu “in crisi”: Platonit ja këndoj mbjatu Gorgia-s. Sokratit dhe shkrimtarëvet të kohës së tij ja këndoj mbjatu Aristofani.

Ng’eksiston një mot te ku shurbiset ishin të tëra, të njëjta. Si u le mejtimi u le dyshimi, u le sospekti, u le kriza.

Sa mos të ven te kriza, ata që i trëmben rrëzikut (po Sokrati thojë: “*Kalòs kyndinos*”) pikstin rregullat, pikstin ortodoksinë, pikstin ligjen, logjismet, arsyen, Bunker-et të na shpëtojin ka armiqtet e atyrve që i trëmben honevet, që i trëmben rrëzikut. Po fare gjë i mbajti këtej ka honet e qënies. Arsya lindi iracionalismin, ortodoksia erezinë, rregullat deshirin e lirisë, qiviliteti durimin e qivilitetit...

E sotmja është nga herë moti i krizis...

Po na që jemi erë, na që jemi puhë që përshkon anamesa ullinjëvet e Zefit posht ka Hora e Arbëreshëvet, sesi mund të rrjiremi. Ku mund të kumbismi pamundësinë tonë? Mos nëng përseksmi një manerë të lëshofemi, do t’jemi ngamon të trëmbur ka kriza.

14 të Fjavarit

Vete ket kjo Torin e bënë e bukur ka olimpiadet. Ki qytet te ku banova ngamon me veshtirësi, ki qytet ngamon i vrëjtur, i hinjët më truall e i hinjët në qiell, nani, çë kur mbaroj t'jet vet qytet'i maknavet; çë kur hiti te kriza e Fiat e Piemontezët i burthuan botës se ngë din'e bëjin vet makna; ki qytet ë e më burthofet ket gjithë bukuri'e tij.

Vete ture shëtitur ket via Roma, dielli i magjepsin pulleset. Via Roma ë pjetë të huajë, pjetë merikane. Nxuartin ka udhët gjithë maknat, haptin shum zona këmbësore, e kan më në fund kënaqësin t'ecinj më këmbë ket ki qytet çë do të prirët t'jet i njerëzvet.

Përpjek dy famile shqiptare. Katër të rritur me dy djelme. Grat jan fortë të bukura. I ndalonj : Jini shqiptarë? Un jam arbëresh.

Jemi gjithë të gëzuar për përpjekjen.

Ture folur xë se jan çam. Thon se folmja ime është ka Çameria. Ng'e kisha gjegjur kurrë kët fjalë. Ngë di ç'është Çameria. Më thon se është prrëzë greqisë.

Edhë e shoqja e Servetit, zonja Athina Papa, ç'është greke, më tha, kundër fjalët e të shoqit, se fjas si arbërorët, ose si atà shqiptarë (?) çë banojin në Greqi.

“Ty je shqiptar. Ng'është Çameri pa Shqiperi”- ngushton Serveti. Servetin ngë kam si t'e kundrastonj pse t'historisë së Shqipërisë u di pak, përkundraz: ngë di fare gjë. Kush e di çë short arbreshi jam pa këtë urtësi.

U ng'e di e ngë dua t'e di, ç'është kjo natyrë çë më vjen për jashta e bën e shkruanj arbërisht. Dua të rri ket padituria ime. Ngë dua të mbjonj kryet me osesjonat e të tjervet.

22 të Fjavarit

Jemi nga mbrëma përpara televizionës me tim kushërir Ndreun. Na thavmasjin e na magjepsjin këta çë shkasjin ket akulli me patinat.

Nga mbrëma i njëjti vajtim i Ndreut: “Sa di e bën litiri. Pse na arbëreshë ngë dim’e bëmi fare gjë? Pse na intereson vet barku e kushalli?”.

23 të Fjavarit

Karolina Kostner vate e ra ture luajtur ket akulli. Mua më pëlqejin këto të ratura (cadute), këto këmbaz ç’i shtron fati edhe më t’urtëvet. Kush ka kifari me gjellen mund ket gjithë dijturin e jetës se ngë ka si pështonjë ka rasti, i cili ng’ë i vendosur një herë për gjithmonë, po pikset herë për herë pa ditur si e pse. U bekonjë fatin çë na bën këmbëzin, e bën e bimi më truall. Vet kështu mund të xëmi ultësin – “l’umiltà” e cila, sesi thot Ornela Vorpsi, “manca nel lessico albanese”. U jam i sigurtë se ultësia mangon edhe te leksiku arbëresh.

24 të Fjavarit

Sonde është mbrëmje e “gala-s” së madhe te stadjumi i akullit. Jemi njetër herë të magjepsur përpara televizionës. Sonde mosnjeri vete e bie. Vet kur jan regulla një mund të bier. Regullat jan kundër natyrës e dij Kalliokle (vre Gorgias të Platonit). E kish ligjë S. Pali kur tha se Ligjëja është për mëkatjen. Ket ngë jan regulla ngë bie mosnjeri.

Gjithë atletet vallësore bëjin vallen e tyre ture u qellur ket i qellin muzika e teku i qellin frymëzimi çë ngë njeh regula po vet zëmrin...

Karolina Kostner është hyjnore. Qellet me një hjë të jashtzakoshme. Ndose ëngjëlit ekzistojnë jan si ajò. Po ku vete gjithë kjo bukuri?

E psë gjithë kjò bukuri?

Koheleti im përgjegjet: Gjithë këtë Ynë Zot t'è dha sa të durosh gjithë dhëmbjet e jetës. Vesh nga dita një stoli e bardhë e paftë leshi yt arome të çmuar.

26 të Fjavarit

Muzika. Muzkat e Ungris. Mos është një familiaritet anamesa “muzika” e “muzkat” e Ungris? Van e tanduan “Muzakejin”. E pse jo? ndose vëmi gjithsej përposh Muzat. Muzat ishin (jan) orazit e burimevet. “Ka Muzkat” Ungir është lloku i burimevet, llok pjot kanalle, i qosmë ujërash. Ndërkaq ka “Muzkat” mund t’jet se vjen me thënë “*ka lloku i Muzavet*” e Muzakeja vjen me thënë – ndose mund të imitomi Sokratin - “*Mousikôn oikìa*”, shpia e Muzavet.

Çë do të thon t’urtët?

5 të Marsit 2006

Si nga herë, mos bëmi zbalin (gabimin) të ngatarromi “realitetin” me litersin. Nga kujtim është litersi. Është litersi nga gjë çë shkon anamesa (ανάμεισα – grekisht) fjalavet, anamesa mendimevet. E ng’ë faregjë verteta se “*To autò Einai kai noein*”, se qënia e mejtimi jan e njëjta. Meitimi ka ligjen e tijë, e e qënia ka ligjen e saj, e ligja e logjikës ng’ë ligja e realitetit – ose më mirë ng’eksiston mosnjë *orthotes*...

Këtë m'e thot Ravidasi (ëmrim si mjeshtër i yoga-s), nga herë çë më bën të bindur të ulem me sytë të bllitur përqindruar ket fryma, e bën e harrofem kush jam e ku. Jeta këtjë jashta është te fundi pikerisht atë ç'është, jo atë çë thom u se është. "Il niente – shkruajti një njëherë – è l'universo senza di me". Kur ng'jan u arvuri qindron arvur jo dru për m'e prer, jo hu për më dhulluar, jo gobaçe për m'e djegur. E kështu kaciqi çë ngë ndrrofet në mish për me pjekur... Kur shkon ket mejtimi gjithë qënia ndrron domethënien e saj e bëfet "jetë për mua", për kët, ture mejturar se "*to autò esti einai kai noein*" (është gjithë një qënia e mejtimi, do me thënë: ture i dhën qënies ligjet e mejtimit, ç'është mejtim'i njeriut e jo mejtimi e sos) jem'e bëmi gjithë guajet çë jem'e bëmi. Ndërkaq prof. Honsell e Oddifredi – çë jan të dijtur - qeshjin mbi mejtimet e të tjervet çë ng'e mejtojin si atà....

10 të Marsit

Jam e jap një shtitje, si nga javë, Torin, çë nani u lirua ka gjithë merikanët e olimpiadet e është vakand gjindësh si ngamot. Piazza S.Carlo pa makna e pa gjindë është pa të rrufier ket bukuri' e saj çë të paqëson me veprat e njeriut. Gjegjet ka një dritësore një pjanofort. Fryn një puih e ëmbël çë lajmëron paraveren ç'është po t'ja arrënjë. Më pëlqen të ecinj pa mejtme, ture u përqindruar ket hapet, ket t'ecurit (provoni, provoni të bëni njetër kaq, vreni cili hon ju hapet). Më pirpjek një i zi e më jep një të shtim me krahun: "Fratello, compra libro, è di più grande scrittore negro". Mua çë shkova e shkonjë gjithë ditat time ndë mes të libravet më vjen të viell.

"Pse, i thom, kin't'imitoni veset e të bardhëvet? na jemi më të malkuarit, më të sëmurt, pse do të bëfeni të mallkuar e të sëmurt si na...?"

Paqja e shpirtit vete a fafuttiri e kujtonj se njeri (një kërkues) te staciona e Bari-t ë e shqetësofet: Kush e di ç'ë e bën Ravidasi.

Ë e bën Helmin, atë firmozjot që dirgon t'e marrjin ndë bithët, me gjithë çotit e tire, arbëreshë e litirë.

12 të Marsit

Është e fryn akoma sot puhia. Ka dritësorja vrenj gjithë malet që rreth rreth bllijin gjithë sheshin e Rivarolo. Jan Prealpet pjot borë. Simbjet ra shumë borë e e vrenj me zili pse, ndomos se gjithë, ngë pata si të venja të skiarnja. Të shkas me skitë është njetër rast të mejtonjë bashk me Ravidasin. Për Ravidasin të mejtosh vjen me thën t'jesh pa mejtime, pa kujtime pa fare gjë që të skon ka mendja; të pirpjekësh atë fare gjë që është themelimi i gjithësejës. E kështu, ture vatë ndë mest dushqevet e të Bruson o të Champoluc prrëzë këndimit t' ujit të lumit që zë fill e madhësufet me të losurit e borës e të akulit të Monte Rosa, vëfe më paqë me gjithësejin ture qën shurbes ndë mes të shurbisevet pa rufjanerit e mejtimit që do njeriun si zot të botës....

Ravidasi sot ë regj'i ditës, më qellin ku do, ndomos se ng'i jap vesh kur më këshillon të lë të shkruanj: "Ngë sheh sesa koprë je prodhon? Leja profesurvet kët vesndier...që do t'e dish ty?....

*** **

Datë historikë sot. Lucia Annunziata tarandaksi Berlusconin. Për fat të mir gjëndet, nga kaq ndër kaq, njeri që di e i mban ball të i dirguarit e t'YnZoti. Nani 'e të ven si duan zgjedhjet politike, kemi kënaqësinë se ndodhen herë e herë gjindë me herdhët të zdredhura. E kënaqësia është më e madhe pse herdhët i pat një grua. E sesì mund t'ish ndryshe?

Na gëzon fakti se rrunganxjes i bëri pishë kalosh një grua: është dhuna më e madhe që mund t'i ndodhet mammasantissima-vet.

13 të Marsit

“Non riprendeva, anzi lodava ed amava, che gli scrittori ragionassero molto di se medesimi: perchè diceva che in questo, sono quasi sempre e quasi tutti eloquenti, e hanno per l’ordinario lo stile buono e convenevole, eziandio contro il consueto o del tempo, o della nazione, o proprio loro. E ciò non essere maraviglia; poichè quelli che scrivono delle cose proprie, hanno l’animo fortemente preso e occupato dalla materia; non mancano mai né di pensieri né di affetti nati da essa materia e nell’animo loro stesso, non trasportati di altri luoghi, né bevuti da altre fonti, né comuni né triti, e con facilità si astengono dagli ornamenti frivoli in se....”

Ki është zoti Leopardi:”*Detti memorabili di Filippo Ottonieri*” cap. VI.

Kush më akuzon se kur shkruanj ruanj vet ksizin time, kan këtë një përgjegje e hollë e e fortë. Leopardi ë një mbronjës i mirë pse ai për gjithë veprat e tij fjau vet mbi “*le mal de vivre*” i tiji. Ka jetr’anë që njëf më mirë se gjellen tënde? Ngë ke manerë më të drejtë sa të njohësh njeriun se të rrish tue mejtuar rrethë ksizës tënde. Dreq si thoj Sokrati: “Mos ngë njof vetëhenë time sesi mund njof tjerat shurbise?”

Po të njohësh vetëhenë tënde do mot e ngë ke si të bësh skencjatin...

14 të Marsit

Bëra, këtë dita që shkuan një ritrat (ose portret, si thon shqiptarët – po pse kish t’ishë më korrekt (?) “portret” se “ritrat”? Kush e matin dreqësin ose pastersinë e këtirve dy fjalëve? “*Consensus professorum*? E kush i njeh?). Ja bëra Irenës.

Amemorja. Doj' t'i bënjë kësaj gruaje ka Kalabria, një nderim për miqësinë e dashurinë që na lidhin. Kur ja ofrova e rifjutarti me ndëlesën se ajo te shpita e saj ngë vargarisin ritretira, pse tha se sielljini keq. Vet të vdekurvet kanë t'i vargarisen ritretirat.

Ng'u bëra i bindur ka kjo ndëlesëje, e kur sot klem të vetëm i lapa një tjetër motiv për rifjutin e saj. M'u përgjegjë: "Ti më pindakse xhakarune, ti më nxore gjithë mbrolat, gjithë të veshurat, kalosh...Jiti është një vizatim obshenë"

"Po të vizatova vet syvonin, o, më drejtë, vet sytë..."

Irene më ruan me sy të ligë: "Pse, që të duken sytë....?"

Këtë vizatim, që nani më nget e më helmon edhe mua për bukurin' e tij e rifjutuar, e fshefa. Atë sy ata sy, mund t'jet se thon më sesa u mund kapirinj.

16 të Marsit

Dy filosofra Emanuele Severino (ai kundër të cilit ë e mbjaket Oddifredi) e Giulio Giorello, prëmë te transmisiona "L'Infedele" deklaruan se kanë probleme me mortjen. Giorello tha : mi fa schifo. Severino ish i sqetësuar e ish po të bënej shenje "scaramantici". E se si kle? Dy filosofra ç' i thon ëh anankes te logjika, ng'i thon ëh mortjes e cila është si thot Anasimandri "katà to kreon ...didonai ...diken ...katà ten tou kronou taxin / me anankazi... t'i japsh... drejtësi... sipàs radhën e motit". Cila është drejtësia më e vërtet se mortja. Kush i thot ëh logjikes ç'është e themeluar mbi lidhjet e anankes ngë mund t'i thot mortjes se i bën "schifo", sikur të thoj – sesi tha një herë një skrimtar i math – më bën "schifo" se dy për dy bëjin katër.

Çë filosofra jan këtë? O një është filosofi që banon rrenjërit e qiellëvet tek gjithësej është përposh ligjes e ananke (cilës edhe Perëndia "semel jussit semper parei" si thot Seneca), te ku ng'është trëmbje e ng'është "schifo", përsihjefje, drydhim; e një tjetër është njeriu që trëmbet e drydhet e përsihjefet ndomos se praktikon

filosofin? Ng'është ahirna kundër logjikes ai filosof ç'i përsihjefet vdekjes?

Vjen me thën ahirna se ng'ë raport anamesa filosofisë dhe gjelles. Nganjera vete për faktet e saj e filosofrat ngë kan çë të na thon e logjika ngë ka si t'i aplikofet gjelles.

E ngë kan ligjë as Severino as Epikuri kur thon se kur është gjella ng'ë vdekja e kur është vdekja ng'ë gjella. Është ndosekurrë vërteta se na vdesmi vet kur gjellomi e se kur vdesmi mbaromi të vdesmi: na vdesmi nga moment e gjella e vdekja jan gjithë një, kur vdesmi mbaron aq gjella sa mortja. Me gjellen principium-i identiteti vete e merrë ndë llunjët pse kush mund të thot se ngë vdesmi ndërsa gjellomi?

“Mais à celui qui prend pour guide la raison, qui sola ratione ducitur, à celui-là il est strictement interdit de pleurer et de maudire: il doit se contenter de comprendre, “intelligere” (“non ridere, non lugere, neque detestari, sed intelligere” – Spinoza – parentezë imja) – L. Sestov: Athènes et Jerusalem).

Ahirna, pupani, çë filosofra jan Severino e Giorello?

Pse ng'i dirgomi t'e marrjin ndë bithët këta farrabularë me skolin, me këmishin të mbërthier, me shtekun e me syvonat të verdha...?

19 të Marsit

Vej me putërat e me të mëkatëruamit. Hanej e pinej. Thon disà se ishë edhë elegant, një fjakë, një i hollë, pse veshënej atë stoli pa të qepura sipër të cilës vun ngusthin atà ç'e kriqësuan. Këtë kem't'e përsëritmi njera t'e varesja, një mos nëng delgomi pse rregjëri'e tijë ng'ish *“tou kosmou toutou”* – tekun *“kosmos”* vjen me thën pastërtia e borgesëvet, edukata e mir e tyrve, *“le bon ton”* -. Ahirna ngë dimi çë ka kifari Aì me atë çë predikon aì i verdhi i Ruini-t....

20 të Marsit

La shkruar një shkrimtar i famshëm kur isha i rì e venja pjot u ndër udhët të Romës: “Thoni ngamon jo, gjithëve. Vet kështu mund t’ju trëmben e mund t’ju qellëjin abullkacjun”.

*** **

Kërkomi të mbafe mi barbarë, lëmi profesorët që na duan të lobotomizuar, sidomos atà profesor tedeskra, të cilët, si thoj papas Matrangolo, shkatarrojin gjithësej. Mbami gjëndjen tonë paftës. Eni t’jemi si jemi. Mos i japmi kund profesorvet që duan të na mësojin sesi kem’ t’jemi.

Detyri. Ngamon detyri. Përpara kujt? Perëndia vdiqë. E ngë do t’jet kurrë një gjykim i gjithëshëm. Jemi gjithë pas ftes ... ndose ftesin njeri, ai njeri....

*** **

“Ç’është kjo dashuri që më ofron e për të cilin do mejitimet e gjellen time? U kan t’im shoqë, kam t’im bilë që më marrjin të tërë. Dashuria jote më trëmbin. Është barr shumë i math, shumë i rëndë. Shpëtomë. Mos më premëtò çmime as mos më kërcënò ndëshkime. Ng’e dua as edhe gratis dashurinë tënde. U ngë dua fare gjë, dua t’jem e tërë e vapke, e nëmur. Ndose më do mir, rrimë llargu...”. Kështu parkalesnej Ririna...

21 të Marsit

“Ndose më njifnje par se të lefsha, ndose nëmëronje gjithë cellulat e mia, ndose njifnje gjithë eshtrat tim, dhja ket barku i mëmës; e njifnje të mirat e të ligat time, pse bër’e u leva? Çë lojë doj’ të loznje ndose imi ish një lojë tash i lozur, që doj të privonje ndose ish tash i ditur sesi kish të mbaronej joku? E ndose ti dinje se si jam pse ngë më deshe sesi jam po më tregove

nj'udhë që ngë kisha pasur kurrë t'e praktikonja?". Kështu rrekonej ket dhëmbjet e tij ai miku im që iku ka bota ture mallkuar. Kështu dha më të mirin parkalesi.

*** **

E para ditë e paraverës: e ku sini futi. Më vjen ndër duar ki libër i mallkuar: "Le ali al pensiero" të Franca D'Agostini. Nje libër logjikje. Si bën logjika t'i vërë pendat mendimit, noerisë, ndose e lidhin ndër ferxhat e parimevet të saj: *principium* i jokondraktimit, *principium* i identitetit e të *tertium non datur*, e pra e anances? Me logjiken mejtimi rrethon anamesa tautologjivet ket të cilat vet mund të jipet e "vërtetja". $2 \times 2 = 4$ është një e vërtet pse është një tautologji: kur thua 2×2 je thua te njetër maner 4 dhe viceversa. Se si mund të fjeturonjë mendimi me logjiken? Vet ndose libraret ka ferxhat e saj mendimi mund të fjeturon: sesi ket artja te ku vlen vet "*Theia mania*", ose *lënsia hyinore*, ose absurdi. Absurdi e lënsia mund t'i vën pendat mejtimit. Lënsia, ajò "*theja mania*" që sipas Platonin i kish sjelur gjithë të mirat Greqisë, ndërsà fare dijturia, fare drejtësi'e mendimit, fare urtësia... (vre: *Phaidros*, 244b).

22 të Marsit

Pse shkruanj arbërisht? Sa të fshefem. Aq sa të tjerët që shkruajin lirisht duan të burthofen. E jan litinjë këta që vëfen në dukje. Fshefja është virtut hyjnore: vet Perëndia fshefet. E natyra që është hyjnore: *Physis kriptesthai filei*. "*Lathe biosas*"...

22 të Marsit – mbrëmanet vonë / “around midnight”

Kjo ishë hera rreth së cilës më telefononej papas Matrangelo e bëjim bisedime të gjetë thelogjije ose mbi të ndrishme argomente. Një herë më tha:” Bëmë Perëndinë një ruas, një spiun, ka vër’e qiçit”. Ng’i piejta ahirna që do të thoj. Ka të ndrishme bisedime më vjen nxë se mund t’jet se mëkatet seksuale ngë doj t’i gjegjënej. Mund t’jet se ish’e i riferirej S. Borromeut ç’ishë i oseksjonatur ka mëkatja e mishit e përgjonej atë që bejin më shtrat njerzit e kohës së tij.

Sonde mbarova të djovasnja librin e Alfonso de’ Liguori mbi të njëjtit argument. Ngë mundin mos të mejtonjë se aq njeri se jetri shënjët litì u ngostin (ture bën mëkatjen e grykës) me pemet e “*drurit e të njohurit së mirës e së kekjes*” (sesì skruan papa Gjergji Skjirò).

Me të njohuri, ture u bën sklavet e logjikes van e ndajtin (*diaballo*) mekatjen seksual ndër një rastësi e pasosur. Vet “*druri e të njohurit*” mund të jap një mundësi të tillë. E “*të njohurit*” ë mëkat’i parë, ai që ndan (*dialli/ ai që ndan/* nga “*diaballo*”, greqisht) atë që ket “*drur’i gjelles*” – pemet e të cilit mund të hafen - është gjithë një (*symballo*). Sa të ndytur kish t’ishin këta të dy litinjë sa të shihjin gjithë kët ndyturi gjithaparur? Ndose të njohurit është i pari mëkat, gjithë atë që vjen ka dijturia është, akoma më, mëkat.

Për atà dy shëjtra jemi gjithë te gryka e pisës, sosin vet sa të ruash krahun e njëj gruaje e pisa të hapet. E kush do të më pështonj mua ka pisa, mua që vura xhakarune grat kur vijin e pozarjin për një kuadër? Si bënë këta litinjë të ndotjin gjithësej - atë gjithësej që Perëndis kur e piksi iu dukë se ish e mirë shumë: “*kai eiden ho theos ta panta, hosa epoiese, kai idou kalà lian...*” - “*ahierna Perëndia pa se ghjithkjish te jeta ishin të mira shumë*” (te gjufa e papa Gjergjit Skjirò).

Vet një mentalitet e sëmurë dhe e ndohët mund të mejtonjë se vrejtim'i njëj kurmi gruaje mund të të qellinjë ndë pisët. Për këtë jini gjithë tash ndë pisët ju çë vreni *letterine-t* ose "*Il grande fratello*" – ndelgon Zef di Maxho?. E berluskoni është rregj'i pisës, me "*tanti saluti*" Ruinit...

Të fala litinjëvet, na shpresomi ket Perëndia e gjallë dhe të gjelles, e cila është si është... Perëndi çë bën ngagjë gratis, për dashuri e ngë do faregjë prapa, e sidomos ngë fryfjet e ndose fryfjet ka shumë ironi e shumë urtësi mos t'i gjas shënjëtravet litinjë...

23 të Marsit.

Donja të prirsha të djovasnja njetër herë atë çë shkruajta. Për të ndreqnja ndonjë gabim, sa të precizonja ndonjë noeri. Po ç'është kjo vullnet përsosurije? Përsosuria të një i qënës i cili për përcaktim është i papërsosur? Vetim profesorët jan të përsosur - e na osesjonin e përsosuris ja lëmi atyrve edhë pse jemi të bindur se përsosuria është vet e Perëndis e se vullnet'i përsosurisë dhe i delirsisë dhe i pastërtis është blasfemë.

29 të Marsit 2006

"Qe afes imin ta ofilimata imon, os qe imis afiemen tis ofiletas imon".

Ahirna Ati Ynë do të bënëj pikerissht si do të bëmi na. E ndose na ndëlemi disa shurbise çë njera sot na u duktin mëkate për të cilët dënuan vëllezërit tanë, ndose na këtë i ndëlemi edhë Ati Ynë do t'i ndëlenjë.

Ndose njera djë dënuam omoseksualet e sot adhjasmi se këtë ngë kan t'jen më të paraqitur si të mëkatëruam, edhë Ati Ynë s'do t'i konsideronjë më të mëkatëruam.

Vet për ligjen jemi të paraqitur si të mëkatëruam: ndose na nxiermi ligjen edhe Ati Ynë do të bënjë njetëraq. Nani ndose njerzit (disà njerëzë) nxuartin ligjen që dënon divorcën pse klisja vazhdon e bën atë që Ati Ynë ngë do të bënjë më pse kle i detyruar ka ndëlesa jonë mos t'e bënjë më?

*** **

“Pacs”: ngë kan fuqi tash ndër manastiret?
Klllogjërët ngë jetojin si “Pacs”: burra me burra, gra me gra? Ahirna që ven ture gjetur gjithë këtë të krishterë të “*Comunione e liberazione*”, e gjithë priftrat, njëmos se mundësin të thonë ngamon të prasmin fjalë? Këtë që skandallizofen nga herë ngë jan të denjë të skandallizimit e Atit Tonë? Aq bëjin, aq do të meritojin. E ndose skandallizofen për ne, sesì pretendojin mos të skandallizofemi na për 'ta?

*** **

“Del Dio che emoziona non mi sento di parlare seduto su una sedia. Quindi mentre parlerò di questo Dio starò seduto per terra (...).
Le ragioni di sedere per terra: Il contatto con i popoli del sedere (verbo) per terra che sono la grande maggioranza dell'umanità (...) ... le sedie non sono che una penisola del continente umano (...)
“...riuscii a prendere sedere su poco più di un decimetro quadrato di legno (...)
“... la felicità era la sensazione sto toccando il fondo comune della condizione umana non sono più nel preservativo di plexiglas della mia condizione di

signorino”...(...) – (Luigi Lombardi Vallauri: *Nera Luce, Saggio su cattolicesimo e apofatismo - Le lettere*)”.

Aq sa t’ë dierë bota e historia (pse do t’i bënj kundet me historinë – sa më pak arbëreshe) që bën Ravidasi, ose ai Nandin’i Helmëravet, ose Nando Elmo, zgjidhni edhë ju këtë libra pa vat’ prapa romanevet similarbreshine.

Kush e di? Gjë mund t’jet se do t’ë xëni, edhë si arbëreshë.

U rri me bithët për trualli, karriqet ja lë pëshkopvet e profesurvet.

Ture mbetur me bithët për trolli, xura shumë shurbise.

E para: mos t’i trëmbem profesurvet, as peshkopvet (“*fuge episcopos*” – si thot S. Jan Kasiani): më posht se më truall ngë kan si të më shtien. Jam ka ngamon i shtitur (Geworfenheit) më troll: që kur u leva e edhë më par se të lefsha – Perëndia e diti ka ngamon se do t’isha një dë/shtim.

Ture u ulur më truall marr shurbiset sesi vijin, sesi ndodhen, sesi i dirgon Zoti, as ulem te karriqja të gjikonj të tjerët. Kur e bënj, e bënj sa t’ulinj arkancjen e ndonjeriu...

*** **

Kur Lombardi Vallauri ulet ket karriqja e profesurit e do të gjikonjë Perëndin me gjikimet njerëzorë, ngë gjëndet më: ngë gjëndet ai e ngë gjën Perëndinë.

Ai thot, sesi Wittgenstein, se mbi shurbiset mbi të cilat ngë kemi si të fjasmi është më mir të rrimi qetu. Nani u ng’ë di pse Vallauri nëng bllin atë të skret’ë griqë. E bën si priftrat, e bënet prift edhë ai.

Mbi këtyre shurbise aq kur pohon, sa kur mohon, je bën të njëjtin diskurs pa domethënie.

Pse ahirma këtë profesurë kan të burthojin sa t'urtë janë?
Ngë kish qën më mir se Vallauri të kish ndënjur qet, i
ulur me bithët më truall? Sesì mundin njeriu, ose
Vallauri, të vendosinjë ndose Perëndia është i lidhur ka
necesiteti o jò; ndose Perëndia mund të ket akte
vullneti o jo, etëtje....? Ng'është Perëndia që ngë mund
t'jet këtë e atë, që ngë mund të bënë këtë e atë; është
arsya që mund bënë diskutet që ng'jan të saj...

*** **

Severino, i cili i trëmbet mortjes e thot: “E të rrier sa
më llargu mundin”, mban se faregjë mund të vdes, se
gjithësej është i përjetëshëm pse “qënia është e ngë ka si
mos t'jet”; se fare gjë ndërron pse për të ndërrohet ka të
shkonjë ka mosqënia ket qënia e mosqënia ng'është; e se
mosnjë perëndi mund të na pëstonj ka mortja pse jemi
të përjetëshëm për ligjen e fatin e qënies e lidhur me
necesitetin e tyre. Ku vemi kur vdesmi Severino ngë di
t'e thot. Ai di vet se jemi të përjetëshëm pse kështu i
siguron arsya... e kur arsya siguron mund t'jesh i sigurt
se ë e thot “E Virtetjen”.

30 të Marsit.

Thon se bënë një konfusion, një ngatërrim “terribile”.
E si do t'e bësh, biri im?
Pse edhe të tjerët që bënë njera nani? Ngë ngatarruan
qiellin me dheun, mejtimet me “realitetin”? E ëndrrat (e
më e më ëndrrat e arsyes) ng'i pruartin në angëthe “*el
sueño de la razon produce monstruos*” / *ëndërr'i
arsyes prodhon morra?*

*** **

*“All’interno dell’università (shkronja e vogël është imja), che sembrava (?) decisamente condannata a essere solo un docile ufficio in cui amministrare gli spiriti, destinato a fabbricare gente senz’anima, senza nessuna voglia di averne una, sbocciano (?) germogli negativi che realizzano certe improbabili probabilità. Questo fa nascere in noi la speranza che l’università (si sipër) possa salvarsi dal proprio burocratico destino e purificarsi, scomparendo. Studenti e professori (?), in tutti i paesi sviluppati, scoprono (?) improvvisamente l’inganno di una cultura pietrificata (...). Gli intellettuali vengono finalmente riconosciuti come mercanti dello spirito manipolato, repressori della curiosità e del senso critico giovanile (?), e capiscono che il loro ultimo compito è denunciare la mistificazione per cui sono ingaggiati; in questa autonegazione trovano l’ultimo barlume di orgoglio e indipendenza” (Fernando Savater: *Degli dei e del mondo*. Pag. 95. Frassinelli 2001).*

Gjithë pikat pyejtje janë timët – *va da sè*.

Ngë dua të vëfem këtu numer’i të rinjëvet (*germogli*) pse ngë më lë mosha, po sa ka që vete ture thënë këto shurbise? Kush ngë mund të shoh këtu universitet atë irkocervë të Unikalit? Për rrjestin citaciona komentaret e vetëm.

*** **

Doni njetër?

“La scienza ricopre efficacemente l’ambito del razionale, così che qualsiasi critica le verrà dall’oscuro mondo dell’irrazionale; la scienza come l’altra Divinità, è una totalità che si spiega da sé e la cui negazione è follia. Il nuovo insipiente che bestemmi in cuor suo (vet më zëmër mund të mallkomi) la scienza, non troverà nessun Anselmo pronto a scagliarsi lancia in resta contro di lui, perché la sua negazione sarà considerata inintelligibile e si obietterà che ciò che dice manca perfino di quel poco di senso necessario a essere confutato (ib. pag. 122)”.

Kështu Nando Elmo është ai njeri ridikoll me të cilin ngë biermi mot. Na mësoni te universiteti e jemi t’urtë “kat’eksokén!” e fare gjë mund të kundragonjë teoritë tona pse kemi ka ana jonë skenzjen e cila me arsyen e saj na shpëton ka gjithë gabimet.

*** **

Doni njetër?

“Meno si pensa, meglio si parla: una volta che abbiamo imparato a camminare, da bambini, continuiamo a farlo per tutta la vita in modo meccanico, senza bisogno di pensarci sopra, ma se ci ostiamo a osservarci i piedi per captare il meccanismo dei nostri passi, finiamo per inciampare e cadere. Secondo Wittgenstein, il metafisico è questo maldestro camminatore che continua a guardarsi i piedi mentre cammina e finisce per inciampare, non sapendo che disinteressarsi del movimento dei piedi è il modo migliore per non cadere. (ib. pag. 123)”.

Te lloku e t'ecurit vër folmjen e sheh se je ket e njëjta situatë. Bën gabime vet ndose do të fjash ture mejtuar sesì je fjet. “*Parla come t’ha fatto mammata*” vet kështu ngë bën kurrë gabime.

E kështu ngë mund t’jesh arbëresh ture mejtuar sesì ke t’e jesh. Ji atë çë je e je arbëresh? Kështu Carmine Abate kur sforcaret t’jet arbëresh e vete ture kërkuar arbëreshërinë, ahirna bired, ahirna pengofet e vet’e gramiset ai me gjithë arbërinë e tij.

*** **

Vajt’e tandova Savater; çë ka t’jet shoku i Zapaterit – e mund të kisha tanduar njetër qind si ai – pse ndose i thom u këtò shurbise shkojin për simbatikeri për “*buddanate*” e atii t’i çudhitur’i Nandinit: mos ngë ke martiri mos njeri të ka bes mbi fjalës.

U ndërkaq vete për udhën time – ç’është - e përsëritinj – udhë shkretërije: ngë kam asnjë merë çë përndjek, së cilës i vete prapa. U vete ka vete për “*vocatio*”, për “*innermost flowering*”, pa merë pa kufi, gratis, gjithësisht gratis, falas. Kështu bëra me kuadret: i dhurova, i rigallarta: cilin çmim kish’t’i kishe dhën, kur mbrënda fshefe vetëhenë tënde, mishtë tënd, dashurin tënde, dështimin tënd e tëtj... ?

1 i Prillit 2006

Shkova sot Torin ka via S. Giulia 2, teku ket një mansardë e madhe përposh një vetrat e gjerë, kishë atelierin prof. Teonesto De Abate. I cili ng’ish vet profesor ket Fakulteti i Arkitekturës së Torinit, po edhë

piktor i famshëm, ç’i jip mësimë gratis gjithë atyrve që kishin oreksin e forcën të hipëshin më këmbë njera ka ai, ket kat’ i gjashtë.

Kish katërzetë vjeç e nga dita ai plakuç hipënej gjashtë hapësira shkallësh pa çfrytur, sesi një djalosh, sesi ng’ish i mir të bënej ndo një i ri, që gjimëtonej të vazhdonej të hipej prana të parat lodhësi.

Atjë mbjidëshin disa personaxhë të Torinit i mir, sesi Profesor Fusari, kryejatrua i CTO, ç’ish piktore diletant po shumë i shkathët. Atjë vijin kolecionistra të rëndë, të njëjtin artistat të rinjë. Atjë vin’e pozarnej Elsa D’Agostino ç’ish modela e Akadhemjes Albertina e të tjera gra – Elsa do të kish pozatur gratis (thonej se kisha talent) shumë herë për mua.

Ket De Abate më qelli të parën herë Luigi Le Voci ka Kastrofila.

Le Voci ish nxënës i De Abate ket Fakultet’i Arkitekturës, po ng’i interesonej shumë Arkitektura, i interesonej më piktura.

U kishim njohur Kastrofil me Le Voci.

Kisha marr qirajë një kamare ket shpi’e së jëmës ket i prasmë vit të liceut. Si ngamon, kur ng’isha prapa libravet e skollës shkonja motin ture vizatuar. Le Voci më ruanej me kureshtje. Ahirna bënej vet vizatime gjeometrike për skollin teknike që frekuentonej.

“Dua të vizatonjë edhe u si ti. Thuam si kam të bënj”.

“E që kam të të mësonj. Mua ngë më mësoj mosnjeri”.

“Çë mundinjë të të mësonj, atë që ngë xura?”

Ditën pas ish tash me llapsin ndër duar ture kopjatur disa punëtor ç’ishin e ndreqjin udhin përpara shpisë së tij.

“Si të duken?”

Qindrova i befasuar ka lehtësia me të cilën kish realizuar hapësirin ket kish vendosur vizatimet e puntorvet kështu fortë stilizuar po njetëraq të vërtetë (ndose kjo fjalë vjen me thën gjë te artja). Me katër viza kish shprehur ffigën e tyre. E më e më më ngau shpejtësia me të cilën kish vepruar. Karakteristike që ka akoma sot.

“E sheh se ngë kam fare gjë të të mësonj? Je i mësuar pa ditur”.

I rrufiejta mithin e Athenës që lefet e tërë e veshur me armët ka kryet e t’jatit; kështu artisti lefet tash i mësuar, skolla mund vet t’i mësonjë sekretet e teknikës që përkaşjin përdorimin e materjalvet... Mba mend edhe Giotto i cili din’e vizatonej dhent më mir se Cimabue kur akoma vej e kullotnej kafshin, pa ditur ç’ish skolla. Kush ja kish mësuar artin Giotto-t? Cimabue do t’i ket mësuar vet si vëfen ngjiret mbi muret. Po e Leonardo? Ja mësoj mjeshtri i tij sesi kish të pindaksnej ëngëlin e pakzimit? E ata artistra të shpellëvet prehistorike cilin akademje kan frekuentuar për të vizatojin ata kuel e ata që e gjithë kafshin e tyre me anatomin te lloku i saj?

Çë ahjirna zum e vizatuam bashk e bëjim garë kush ish më i mir të vizatonej pa ruajtur fjetin.

U ahirna vizatonja vet ritretra të nusevet o atyreve që do të bëfshin nuse e për të cilat kisha rar në dashuri, pa se atò t’e dijin....

Një ditë Le Voci më tha: “Dua të bënj skulptorin”

“E këtù, miku imë ngë kam si të ndifinj. Ngë kam asnjë pajë për kët artë. Po ti vëru si u vure me vizatimet. Ndë ke pajë ajò do të burthofet pa veshtirsi, sesi u burthua ket im vëllà që di e dhullon drurin pa skollë”.

Mbrëmanet vate te udh'e madhe e kalloj një ndër ata gur që vëfen si parakarre ket buz'e udhës.

Ditën pastaj guri u kish ndrruar ket një fixhë gruaje... sot si skulptor, pa skollë, bëri shumë bronzë e është shumë i njohur ket fonderit e Torinit...

Kur pra u përpoqim Torin ai si nxënës t'Universitetit, u si profesor te skolla e mesme e kishim të dy nevojë të njëj lloku te ku mund përdorim ngjiret vali pa i bën dëmë mosnjeriu, ai më propozoj të vej' të gjëjim profesorin e tij që kish një ateljer teku mund të vëjim kavaletet tanë. Më tha se dhe atjè mund të piriqjim personaxhe të vler' e të rëndë – e ashtë kle.

Atjè njofa Altieri i cili do të kish klen tregtari i kuadrevet tim për disà mot. Altieri kish eskuziven e vepravet të Marino Marini, të Guttuso, të Donini, Omiccioli, e të tjerë artistra të famëshë...

Po Le Voci erdhë ket ateljer'i De Abate vet për pakë ditë. Sa i sostin të xëj si bashkofen ngjiret vali e cilët është mir të perdorosh bashk me tjeret e cilët jo...

Kur e pirpoqa pas ndonjë muaj me albumet e tij përposh krafut që vej ture vizatuar pamjet e Torinit, i piejta pse ng'u kish par më ka De Abate.

“De Abate është i rrezikshëm. Ka një personalitet të fort e vete e mbaron se e imitonë. U kam të vizatonj i lirë, si më thot mbrënda...”

Çë ahirna Le Voci vinej ket De Abate jo për të pindaksnej po vet sa të diskutonej me tjeret artistra ngamon polemikisht.

Gazetat zun'e foltin për artin e tij. Kuadret e tij u bën të shtrënjët e zu e hapi ateljer Paris Milan e Romë. Akoma sot që rriti fëmilin bën cingarin: një muaj ketù, një muaj këtjè.

Gjithë gazetarët që shkruajtën mbë Le Voci, nënvizuan shpirtin e tij cingari.

Edhë për këtë kam një merit u.

Një herë ç'erdhë e më gjet Romë i dhurova romanin e Kerouak "*On the Road*" që kish qënë sapò i botuar në Itali.

Ai roman i çeli leteralisht kryet. Zu fillë e udhëtoj më këmbë për gjithë Europin.

Të parin udhëtim e bëri në Spanjë.

Më desh një suverë leshi të kuqe për tëtimitim e mbrëmanes – do të kish fjetur shumë herë përposh yllëvet: ish'e nisej pa të holla, do të kish shitur vizatimet që do të kish realizuar ndër qytetet që do të kish ngar ket udhëtimi. Ka rrufiemja e tij, shumë gjindë do t'e kishin pra ftuar më shpì, kur e njëfjin si artisti i mir ç'ish.

U pruar ka Spanja pa suveren time, që ka bjerr o ka shitur kush e di ku, e me albume pjet vizatime që më babartin sytë.

E më zu një zili e fortë për shpirtin e lirë të tij, që më mban akoma sot...

Akoma sot kur mundin niset më këmbë ture e shpresuar në autostopin.

Kështu, vjet – ish më gusht – kur erdhë e më gjet Firmozë e kish të prirej Kastrolilë, po që ngë shkoj postalli, ngë kle maner t'e bënja të bindur të më prit se venja e lipnja huaj një makën sa t'e qellnja u më shpi. U nis më këmbë, ndomos se ish vonë. Udhës i vate mir me autostopin pse pra një orë më thërriti me telefonin të më thonej se ja kish arrur Kastrolilë.

Udhëtimi më këmbë i mësojë edhë të kutëndofej me pak shurbise.

Mamau i kish përgatitur shumë shurbise të mira, po kur u vum më tryes desh vet një rrozele e një kutunjuall e ngjepsi vet një aj djathi.

Kur mundin fjë më truallë.

Po ngë kle ngamon kështu i përkorë.

Kur kishim shtatëmbëdhjet tetëmbëdhjet vjeç, kish një oreks të madh e ish ngamon i vdekur uri. Kur vejim te çinematografi kish të përgatitnej një panin të madh pse ngë duronej shumë pa ngrën.

Ahirna çinemi ish i hapët çë menatet njëra natin vonë.

Një film e shihjim katër, pes herë. Hijim ç'ish drita e dilëjim ç'ish nata e thellë.

4 të Prillit.

Sot shkova Torin te libraria Feltrinelli, ajo më e vogël se ajo jetra tëkù Carmine Abate vat'e paraqiti librin e tij, të prasmin. Hira te kjo librari sa të mirrnja frymë pse kisha bën tash shumë kilometre më këmbë – kur vete Torin ng'ë zakon imi të marr autobusin, ecinj ngamon më këmbë, sesi bën Romë. Te libraria i dhë një shikim pakujdheshëm gjithë libravet çë botofen ket bota e tërë ture madhësuar qaqaren botësore – e “*vanitas vanitatum*”. Kam të thomë se ngamon më zën kryet gjithë këta libra e më vjen një marrmendje e madhe e nakatosja, e zdingu. Po ture dhën një rrotullim mbë taket dal mbjatu jasht:”Sesà shurbise ngë më nevojën”.

Ndryshe, për kundraz, kur hinj te libraria “Claudiana”, ajo e Valdesravet. Libra e auktorve të rëndë. I ruanjë me mallingjim, pse adunarem se jan shumë shurbiset çë nëng di e librat çë nëng djovasa: “Sesa shurbise do të

më nevojën, jo të bëgatëm dijturije, po sa të shërohem ka sëmundja e dijturisë”.

Një herë gruaja çë vepron te libreria e cë më gjën edhë gjetke librat çë më nevojën, më tha: “Ma signor Elmo, perché è sempre così triste?”.

Ju përgjegja: “Perché non ho il più il tempo per legger quello che dovrei e non ho il denaro per acquistare quello che mi manca. Così la scoperta di quanto non so mi fa star male”.

Zonja më ruan me kënaqësi e kam të shtonj: “Non per quello che intende lei. Solo per guarire dalla volontà di sapere, solo per guarire da quello che credo di sapere. Per arrivare al “*mauvais pas*” completamente nudo di sapere...”

5 të Prillit

Rivarolo u mbjua pjot lule. Kopshtat e saj jan pjot forsicje, pjot manjolje, pjot gërshi, pjot manushaqe ndër guxhurubet e shpivet, pjot kokonare gliçinesh. Ndifet tash arom’i ëmbël gaxhivet e të ipokështënjavet (kështënjat ngunga, thomi na), e të vidhevet, ndomos se ng’ë akoma mot’i tyre. Natin një drapër hënie thot se qasen pashkët. Simbjet do të vete Firmozë të shkonj pashkët. Ka tridjet vjeç çë ngë gjegjin më “*I zoi en tapho*”, ose të marr aromin e dhafnis e së Shtunës së madhe kur zoti e shprishin më klishe ture kënduar “*Anasta o theos, krinon tin gjin*”. Dua të vete të këndonj më klishe “*Kristos anesti*” dhe “*O angjelos evoa*”... Ndienj tash aromin e kuleçevet... E mamau më urdheroj misht e kaciqit.... Gjithë shurbise çë arsya më nxuar ka kryet po zakonat jan zakonat...

6 të Prillit.

Lombardi Vallauri vete te shkreteria me një trast pjot me qepët e Egjiptit; vete në shkreteri sesi ven turistrat sot ture qellur prapa gjithë komtet e shpis. Hipet ndër brinjat shkëmbore me gjithë veglat ç'i pirgatitin teknika moderne. Kur një ka këto vegla është sikur të perdoronej ashensorin.

Lombardi Vallauri i mohon vetëhesë së tij kënaqësin të vdes uri (“thuaji këtire gurve të bëhen buk!”), ose të gramiset, ose të dështonjë ndërmarrjen.

Lombardi Vallauri është një profesor, një “*philosophus cathedrarius*”, ngë ka si të bired, di si është i ndar qielli, di e përdoron busullin. Kur j'arrën te “*le mauvais pas*” di se fare gjë i lig mund t'i ndodhet. Ka “*la méthode*”. Na çë xum filosofin e greqëravet ngë mund biremi, ket mos një honë mund gramisemi... na e siguroj Sokrati...

Po ture qellur trastin, ture qellur, si marroc, të tërë shpin prapa, pritet jasht ka rasti se mund t'i bien ka qielli shkurtëza ose manna. Kështu ture fjetur i fashquar ket thes'i alpinëravet do të ndafet ka rasti t'jet i bekuar ka siren' e natës.

*** **

Kujtonj se Luigi Le Voci, pra ç'u laurear arkitektë, ngë desh të bënej atë profesion çë mund t'i siguronej një gjelle pa shqetësime. Desh të bënej artistin ture sfiduar gjellen. Njëherë djovasa te ditar'i tij: “Chissà se oggi mangerò?”.

Veprat e tij sot vlejnin shumë po është ngamon ket pasiguria se një ekspositë mund t'i ver keqë.

Po ai është cingar e litì. E si cingar e litì dit'e u shitë ngamon mirë.

Një here erdhë ket ateljer'i De Abate me disà vizatime. Prof. Fusari ja vlersoj shumë. Le Voci pa u mbjakur i tha: "Invece di farmi i complimenti perchè non stacca un assegno e me li compra?"

Prof. Fusari ç'ish zot bujarisht pa u cilisur: "È uno zingaro il nostro Le Voci. Passi nel mio studio, prendo tutto".

Përpara paturpjes e Le Voci, De Abate më shanej pse ngë bënja njetër aq. E më shtinej të përgatitnja një ekspozim. U i përgjegjësja se dojtë qindronja për ngamon një diletant. E i tilli qindrova "sediovo". Te domethënia se ngë dua të zoteronj fare gjë, as si artistrat çë zoterojin një teknik, as si filosofrat çë zoterojin gjithësjin, as si impreditarët çë zoterojin puntorët ose markatet. Një diletant edhe të gjelles te domethënia se i marr vet ëndet çë mundinj. Kështu ket artja përdoronjë vet të papriturin. Ng'jam i mir të përgatitnj ose të taksem me fare gjë...

Mos njeri mund të vër një besim, as mund të projektonj mbi mua...

Është e veshtirë liria, e di se është edhe e rëndë....

7 të Prillit.

Prëmë, pastaj disà vitra, pè popani filmin e Roger Vadim "Le repos du guerrier" me një Brigitte Bardot, te rol'i Geneviève, fort e rè. Një film çë kur duall më kish shumë ngar ket "*pars destruens*", e më shumë romani, ka i cili kish qën i frymëzuar.

I vretur sot, me urtësin e pastaj, filmi ngë duket fare gjë i rëndë. E më e më më shtypin ai Robert Hossein, te

rol'i Renaud Sarti, që ket klisha pa qiellëz e S. Galgano, ture u vën përgjunaz përpara Bardot-lis i thot: “Ng’e mundinjt më. Liria është e rëndë...martomë”.

Vadim-i, kam bes, vendosin skenin ket klisha pa qiellëz sa personaxhi të kontaktonj mbjatu qiellin. Atë qiell që na rri sipër jo sa të na shpëtonjë, po sa të na shtypinjë më truall. Vadim-i do se t’jet mbjatu i bekuar ai kthim te gjella normale, borgeze, të Renaud Sarti, që kish ngar vetëvrasjen, i mundur ka “*le mal de vivre*”.

Te romani skena ngë zhvillofjet ket një klishtë po “*sur le bord du lit*” tekun Renaud i drejton këtë fjalë Geneviève-s:”*Je ne veux pas faire ce qui je veux, passe-moi les menottes (...) Je ne veux pas de la liberté, de la liberté de rien. Il n’y a rien à être libre.(...) l’homme est une fausse couche de singe, je suis un fausse couche d’homme. Mais j’en ai marre de la vie de fausse couche, je veux être rien qu’un homme, je veux dire Bonjour Comment allez-vous Très bien merci et vous, je veux aller moi aussi dans la grande Machine à Laver, aide-moi, toi qui sais cela. Aide moi à vivre*”.

Deshiret e Renaud jan atà të filisteut borgez, të lartësimit të konformizmit...

Liria është e rënd? Martomë? Sa të vete edhë u te “*la grande Machine à laver*”? sa t’i thom edhë u ëh, po, “*a la Grande Machine*”? “*On ne escape pas a la grande machine*” (Deleuze)

Ngë kujtonja më këtë parkalesi e dishperuar, o, më mir, me fortë shpres se martesja do të zgjidhinjë problemet e vetmisë së njerëzvet. Më drejët, të zgjidhinjë pajetësuemësin e gjelles. Kur kisha vrejtur filmin ndryshe herë, si duket, isha i interesuar për të ndryshme shurbise, për të xheshurat e Bardot, mund t’jet, jo për këtë përfundin që nani më zdingon.

Renuad Sarti është një ndër njerëzit e shpellës së Platonit. Renaud do shumë ferxhat. E sa më atò e shtringojin, sa më atò e pengonjin, sa më i do. Ai, kam besë, do ferxhat e logjikës, të moralitetit, të shtetit, të klishës, të gramatikës, të skollës e të tjera. Sa më ferxha kan (“*passe-moi les menottes*”) sa më mir Renaud rri. Ai ngë do një moralitet që del ka liri’e shpirti tij, ka responsabiliteti tij, po do një moralë abstrakt, sesì ajò e Kant, që ka t’e vër ndër ferxhat e arsyesë pse vet ferxhat e saj jan të mira.

Renaud ng’është një pronar i së shtunës. Ai do një e shtunë t’e shërbenjë si një shkllavë. Si gjithë të kthyerit i vëfet përgjunjaz pronarit “*pereinde ac cadaver*”. E martesja e gruaja përkthefen ket “*le repos du guerriere*”: “*Toi tu es le repos du guerrier lâche, de l’embusqué; Notre-Dame des Déserteurs, aie pitié de moi. Je veux dormir-mourir, et pour ça une femme c’est le meilleur système.*”

Renaud do t’i kish pëlqier shumë Ruinit.

E ki ish Vadim-i? Kjo Bardot-la? Bardotëla, që ket skenat e “lirisë” Vadin xheshin xhakarune e kur Renaud i lipin t’e martonjë e veshin edhë me një skamandilë, një panë, që i fashqon edhë xerkun?... e tërë e veshur si një misilmane, me çadorin, Bardot-la.

U vura e qesha fort. Zgjova time shoqe: “*Ma che cazzata è mai questo film? Questo Renaud Sarti passa da un suicidio all’altro*”.

Mëkat, pse muzika, sidomos dy copat të jazz-it, është shumë e bukur. Kam të thom se ai ish mot’i esistenxjalizmit... e Christiane Rochefort na mëson një e mjerë “*insostenibile leggerezza dell’essere*” që Kundera kish të na burthonej me ndryshe mejtime... e

Valerio Zurlini, te filmi “*La prima notte di quiete*” me të ndryshme fuqi e stilë të shëndosht...

Më vjen nxë i jat’i Ndonit Sassone kur na thoj: “Kështënjat ka zjarri kin’ t’i nxirrni me duart tuaja”... ndryshe se: “Martomë...”

Ku vete zëmërim’i Dostojevskijt të “*Mejtime ka nëndheu*” kundër “*la Machine*”, ajo e Enverit Hoxha për shembull...

10 të Prillit.

Ndose veni Kastrofilë e kërkoni për Luigi Le Voci mosnjeri di kush është. Si m’u ndodhë mua kur ja piejta njëj kornixari te ku kisha qellur disà kuadre timëshit. Ai mejtoj disà motë pra më piejti: “Chi Le Voci? il maestro?”. Kastrofilë mosnjeri di kush është Luigi Le Voci, po gjithë dinë kush është “il maestro”.

Vërteta, Le Voci veproj sa të kriarnej personaxhin “il maestro”. Me gjithë çuditjet e tij ket kjò merë sigurisht ja mbaroj. Kam të thomë se sesi artist e meriton t’jet i thërritur “maestro”, po kripa e çuditjevet do të lërë për ardhmjen shenjë më të thellë.

Nani do fati se edhë mua dy o tre vetë më therresjin “maestro”.

Njeri pse ka një kuadër timëshit për të cilin i ofruan një çmim fort i shtrënjët – një pagë “di magistrato” si thot ai.

Jetri pse më pa se vëfsha kocaposta ture bën yoga e qindroj i thavmasur.

Si do t’jet kur Le Voci erdhë e më gjetë Firmozë vjet, ndërsa jipjim një shtitje njera ka bregu, një dha një vuxhë: “Maestro!”. U pruartim të di. E u si i babartur,

pse dinja se ndër të dy “il maestro” ishë vetë një, pa t’i thonja: “Ë e më kërkon mua”...

Pat’i spjegonja “al mestros” se ai që më kërkonej ish një mësues imi i yoga-s.

“A!” – bëri ai me kënaqësi: tron’i tij ish i shpëtuar.

Gjegjënja ka qielli falen që ndërrojim me Ndon Sassonin: “A, thes muti”.

Me “il maestro” këtë komplimente ngë kisha si t’i ndërrojja. Është shumë serjozë “il maestro”.

13 të Prillit – e ënjtja e madhe.

Ja arrura Firmozë ka Roma me tri orë vonë. “Janë e pjekjin mish shtjerri”, thot im vëlla. Ajëri i njomëthë i paraverës është pjot aromë mishi të pjekur. “Jo, thomë u. Është jav’e madhe ngë kan të kamarojin”. Ku se kur himi më shpi jemi të sulur ka arom’i mishit që është e piqet më vatër. Është drejt arom’i mishit tanë që është e mbjon gjitoninë. Nga herë që mbjidhemi më shpi mëma na pergatitën mish sikur se i mbjidhemi kush e di ka cila shkretëri, pjotë u. E ngë ndifin se mëma di se u ngë ha mishë për të pështonj ka ki fat i ligë: tradhita; u bë ngamon kështu, e kur hapet tryesa mos ngë pergatitën mish që do t’i ofroshë mënorvet. Kështu, po që jam pronar’i shtunës, kamaronjë për mos të zë ngusht mëmin.

“Pra ju jini gjithë pa klishë, ka ju vjen se kur vini më shpi ju çelet ki diskurs se kamaromi?”

Nga kthim zëfemi me mëmin. Nga herë i njëti diskurs. Na ndrruam zakonat: të ngrënit, të veshurit, folmjen, mejtimet, gjikimet, menirin e llogjismëvet.

Mëma tandofet, ng’ ja bën të mejtonjë se rriti fëmilë pa Krisht, pa klishë, pa zakonat e katundit. Çë mostra rriti?

“Mostra na? E ti pse bën e kamaromi?”

14 të Prillit – e prëmëtja e madhe.

Somenat të parin mejtin që patë mëma që se kem të bëmi kulaçin e paskëvet. E më ruan mua: “Profesù, shi’ se u ng’e mundinj. Ke të gjeshish brumit”.

Ndersa gjeshinj brumët, më ruan Rruzarja, vajza që ndihin mëmin që kur ng’e mundin më, as me këmbët as me sytë.

Ka trimbëdhjet vjeç Rruzarja, po qellet si një e madhe, pjotë urtësi ndër shurbiset e shpisë. Ka gallbë, është sperte. Tundet e qetme ndërsa vë më radhë çurrugat, nxonjat. Fjet pak e shumë bënë.

Ndërsa jam’e gjeshinj brumët më ruan ngamon më e çuditur: “Sesi je e gjeshin atà brumë? Ngë ke t’e shqiersh. Ti e shqier. Ke t’e gjeshish me forcë po me butësi”. Rruzarja me kësistrin e ndan dysh brumin. Një copë m’e lë mua e jetrin zë fill e e gjeshin ajò. Ture më ruajtur me buzqeshje më jep, pa shtuar një fjalë, një mësim mbë të gjeshurit e brumit. Bëmi kulaçin e lëmi për dy o tri orë brumit sa të vinjë. Kur brumit ë t’ardhur mir, Rruzarja i ngrën hjiropanen me të cilin e mbulojë sa të rrijë ngroft e më burthon kulaçin që u fry e mbjoj të tërë spazin.

Furri elektrik ë i gatitur ka herë, ja arru 250 gradhe.

Rruzarja thot: “Ngë kem’ t’ja shkomi venë, Zonja Mari?”.

Mëma i thot se ëh e te një moment vea është e gatitur. Këtë herë më nget mua sesi piktur të ndërhyj.

“Si jam e vete, Rruzà”.

“Mir”, më buzëqeshin Rruzarja.

Kur pra kuçina mbjofet me aromin e kulaçit i pienj Rruzaress:

“Si thua Rruzà? Thua se kamaromi me kët adur?”.

Rruzarja më ruan e çuditur, ngë di që vjen me thën “kamaromi”:

“Po një që arbreshe je, po që ngë di që vjen me thën “kamaromi”?”.

Rruzarja ngë di jo vet domethënien e “kamaromi”, po ngë di që ngjir ka qielli. Aiò thot se është “azzurro”. E u i pienj që ngjir ka bart e ajò thot se është “verde”. Kur i thom se qielli është i kalthër e se bart është të gjelbir, e se llimunet janë të verdhë, ulin kryet e babartur. Më thot edhe se më skoll ka një profesor që i mëson shqipën.

“E arbrishtjen? Mos njeri ju mëson arbrishtjen?”

“Po që di u murga? U “sinjora-t” (ose mjeshtlat, ose profesoresat) i kam gjithë litire ka Kosenxa”.

Ndërsa jem’e fjasmi u e Rruzarja na e arrën tatmadh’i saj i cili ë e i siell gjizin mamaut. Më falen me të njëjtat fjalë: “Kur erdhe? sa ditë do të rrihë?”.

I thom se erdha vet për katër dita, se pra do të prirem më theristi e do të rri, si vjet, njera më vjesht.

Kur gjegjin “theristi” e “vjesht” Gabilleti më ruan me tavmasi: “I mban angora mend këtë fjalë të moçme? Po ka vete e i zë fill? Këtë janë shurbise pjeqësh, sa mënxitë i banj mend u, që jam shumë më pjak se ty”.

Ahirna i prirem Rruzares e i pienj që është theristiu, o feristiu si thomi Firmozë. Rruzarja ulin kryet e turpshme.

“Nji ahirma që të mësojin më skollë?”

“T’ë thë, u “sinjorat” i kam gjithë ka Kosenza”.

*** **

Sonde vajt’e gjegja dhesperin Ungër. Me këndimet e korit kam vat’ disa herë ndë “parrajs”.

G.B. Rennis është e vepron drejt mir ture kërkuar hollësi të këndimet që herë e herë më kujtojin disa këndime rusjanë që gjegjinj Romë kur shkonjë ka Borgo Pio të “Russia ecumenica”, ku vet’e bjenj librat e teologjisë ortodokse.

Pak ortodokse për kundraz jan këndimet litinjë që kori këndon te procesiona me varrin e Krishtit.

Pra që kënduan “I zoì en tafo” është veshtir të gjegjish “Sono stati i miei peccati”. Litire, shumë litire kjo traditë.

Firmozë ku ja arrura që procesiona ngë kish akoma dalë ka klisja “Sono stati i miei peccati” kle eliminuar. Këndojin vet “Aggios o theos”. Më në fund. Ish hera. Antropoqendrismi i “Sono stati i miei peccati”, te ku mëkati i njeriut detyron Perëndin, është për së dreqti një mëkat i math. Ket perspektiva ortodokse është gratuiteti i dashurisë së Perëndisë, që ng’ë i detyruar ka fare gjë, që bën *synkatavasis* përpara së cilës “*kai angelon stratiè ekseptitonto*” e të cilin “*doksazuse*”.

Qendrim’i amartologjisë së klisjës litire qendron edhe sakramentet pa të cilët gjithë katekizm’ i klisjës katolike ngë mund të na dënonj ka e përjetshmja ndë pisët. S. Gustini mejtonej se edhe pakzimi ngë mund të na prier ka paftesja origjinale....

15 të Prillit – e shtuna e madhe.

O jam’ e bier erënië o këta dhafin që shprishi sot zoti më qishë ture kënduar “*Anasta o theos*”, ngë ka asnjë aromë.

Ë e bieret nga gjë..., po ngë mund të vete prapa këtire mejtimeve, edhe pse ket omelia zoti i ri i Firmozës thotë se Krishti u zdripë te pisa jo vet sa të spëtonej Adhamin e Etrat tanë, po edhe sa të qellënej ket pisa dashurin e tij, aq sa edhe ket ai llokë të ku gjimëton paraqënia e Perëndisë, do t’jet për ngamon dashuri’ e Tyn Zoti...

Kì më sosin. Firmozë jan e hijin pak e pak mejtime ortodokse...

Kush e di? Mund t’jet se jem’e mbaromi edhe me “*Azione Cattolica*”, me “*Le figlie di Maria*”, me “*Comunione e liberazione*” e me “*Democrazia Cristiana*”. Kush e di, kush e di?

16 të Prillit – Pashkët.

Sot vajt'e gjegja meshin Ungër. G. B. Rennis bën'e vajta njetër herë ndë parrajsit me këndimet e korit. Po kisha dashur ngamon Kristosanestin të shpejtë, kundraz Rennis ben'e ekzekutuan spesh shum të ngadalshëm. La se kor'i t'e këndonej vet ket mbarim'i meshës alla ungirnotëza: të shpejtë të shpejtë; pjot harè...

Peshkopi ish i rrethuar ka disà prifra të huaj – më thon romenë – të cilët, ndifet, se ng'i kam zakon grekut...

Prifra të huaj, prifra pa skollë... duket se Yn Zotë duall te qaca e ftoj gjithë ata ç'u ndohtin po çë arbëreshët jan të zën, kush me gruajen, kush me profesjonin, kush me karrjeren, kush me arbrishtjen, kush me litishtjen, kush me universitetin, kush me rivistat, kush me konferencat, kush me ekumenismen, kush me pelegrinaxhet, kush me "i giovani", kush me "i vecchi"... *vanitas vanitatum*... mos njeri vetëm me llavdin e tyn Zoti...

19 të Prillit.

Sot Romë vajt'e pe te Kuirinali ekspositën e veprave e Antonello da Massina. Njifnja vet tri vepra e këtij piktori ndër më të mbëdhenjët: Ritretat e Palazzo Madama Torin, të museumit Mandralisca Cefalù, e Virgjirin e Palazzo Abatelli Palerm. Këtù jan vepra të famshme të mbjedhura ka gjithë bota. I njihja vet riprodhimet e librave etë historisë së artës. Nani ç'i shoh për së vërteta më vjen si një mungim, për të rimirrem kam të shkonjë anagast ka një kuadër e njetër pa të qindronj shum për para njerit o jetrijt.

Ng'e duronj për shum motë gjithë bukurinë e tyre.

Bukuri së cilës ng'jemi më të mësuar.

Ngë kisha akoma pasur një efekt të tillë, asedhë përpara kuadrevet e Rembrand, i cili më la pa fjalë, e ng'jan Michelangelo ose Raffaello që mbajinë.

Më të mbëdhënjët për mua janë këta të dy. Pra kam kapërcenjtë te Van Gog, Gauguin, Matissë: vet eksposimet e tyre më ngan si këta...

E Basquiat, që të bëri Basquiat? Si frynë shpirti?....

26 të Prillit.

Mejtonja sot mbë atë frazë të Descartes të “*Discours sur la méthode*”, te ku thot se ke të zgjedhëshë vet një udhë e s'ke t'e lësh kurr. Njize o vonë do t'ja mbarosh gjikun. Po problemi është se kur zgjodhe një udhë di tash ku do të ve' të mbaroshë: njize o vonë do të mbarosh drejtë ku kish të mbaronje. Udhëtimi yt, po ç'e zgjodhe, ngë të vlonë asnjë surprizë: te ipotesa është tash gjithë atë që do të gjëshë.

Na vemi pa dijtur ku jem'e vemi pse muartim udhin – nd'është një udhe, ose më mirë vet një udhëtim – që na u ndodh: e para ç'u ndodh ka na qelltin këmbët. E jemi nga dita – mirë o keqë - të thavmasur...

Pra dimi se ng'jemi na që qellemi, dimi se jemi të qellur. E sesi thot një psalm: Im Zot është batù im, fare gjë ngë mund të më gjimëtonj, edhë helmet, edhë malkimet, pashpresa, nata më e thellë..

27 të Prillit.

Këta shkrintarë ng'jan të taksur me vërtetjen. Kujit i intereson literatura, kujit i intereson suksesti, kujit i intereson urtësi'e historisë që skruan, kujit sistemi, mbrënda të cilit janë të vërteta frazat e tij, etëjtj...

Nd'ishin të taksur me vërtetjen kish vet të balbëzojin, gjithë bëllabra kish t'ishin, pse vërtetia ngë jipet. Ajo, ndose burthofet, burthofet vet me metafora, çë, pikerisht, na qellëjin ngamon ku ajo ng'është.

“*Ça manque a l'être*”, thot Lacan prapa një ushtrë filosofrash, kurrë të gjegjur – par më pari Gorxha ka Lentini...

Nani ngë mundmi asedhë të balbëzomi pse edhe balbëzimi ynë është një “*manque*”, një mungim..një mungari... të balbëzimit....

Sa të balbëzoshë ke vet t'jesh i taksur, i angaxhuar (*engagé*), ose impenjartur (angaxhuar për angaxhuar më mir për ne “impenjartur”) me vërtetjen. E cila, e tha Heidegger, është “*a/letheia*”, ose gjë çë vjen ka “*lethe*”, çë burthofet ka fshefja. Për së drejti, vërtetja është metafora e fshefjes: drita është metafora e errësisë... e kush do të thot fshefjen, kushë do të thot errësin, kush do t'i jap domethënie “*lethe-s*” të *a/letheia-s*, çë mund të bënë ndrishe se të balbëzonjë?

Edhë te Tabor-i të ku u burthua “drita”, u burthua edhë një mjergull e madhe çë fashqoj ata të kujvet i burthofej: *idou nephele* (Mat. 17,5)...

29 të Prillit.

“U ngë dua të mallkonj”, më thot, “po konsidero se Mëria ishe e taksur më Zefin. Ahirna kur një grua taksej me një burr ish sikur se t'e kish martuar, ish si kur se t'ish e shoqja. Drejt sa, ndose burri doj t'e lënej, kish t'i shkruanej një kart ripudimi drejt sikur se t'e kish martuar. E ndose gruaja ngë doj të martofej më – shurbes i pamundur – ish e konsideruar një leqe, një adulter, një kurvë, me gjithë pasojat e rastit.

Kur ëngjëli iu paraqit me kërkeset e tij, Mëria ng'i tha: shi' se ng'jam e lirë, shi' se jam gruaja e njëj tjetri, shi' se kush të dirgon ngë ka si të deshironjë gruajen e njëj tjetri, etëj...

Sa Ligjë ngë respektuan aq njera sa jetri?

Mëria u la t'e fashqonej hjea e të papriturisë, hjea e njëj ndjenje ç'e dorrokopsi, ndienjë te ku Ligja e Zefi ngë kishin llok. Ndjenje "dashurije": *ama et fac quod vis?.....*"

Ndose Mëria do të kish pasur pregjikimin e Ligjes ngë do të kishim pasur Shpëtuesin, e Shpëtuesi ngë do të kish shpëtuar "*gynaika en moiheja kateilemmenen*"...

*** **

Udha çë më siell më shpì u mbjua me kokonare gliçinësh.

Gliçini më kujton nga herë kur i ri hipështa ka dhon Fernandi Manes, i cili kle mësuesi i gjithë atyrve, midhis Ungaris e Firmozës, çë ngë kishin si të frekuentojin liceun jasht katundit.

Ahirna ng'ish si sot çë jan skollë gjithaparuar.

Ahirna ndose doje të studjonje kish veje llargu: Kosenz, ose Napul, ose Salern. E këtë mund t'e bënej vet kush kish prindë të bëget. Të tjert vejin ka dhon Fernandi e pra vejin e bëjin esamet Kastrofilë.

Me mejtimin e lirë, dhon Fernandi kish pasur të shkatarruar gjellen pse ngë kish dashur kurrë t'i afrofej fashismit. E kundrastonej ture shajtur gjithë ata ç'i mirrëjin pjesë atij "karnivali të madhë", ç'ish fashizmi, ture i vatë prapa njëj "kalavau"...

Te cinematograf'i Dopollavorit t'Ungaris ndërsa tjert i trokëllisjin duart diskursevet të Duçit, ai bënej pordha...

Ka ai xura shum shurbise e më e më lirin intelektuale.

Ahirna kish rarë në dashuri për Xhilden, një nxënëse çë kish të kish një zetë e pes vjeç. Kish zën vonë të studjonej e bënej ahirna akoma skollin e mesme. E ndërsa na, më të rinjë se ajo, fjisjim të Platonit ose të Kant. ajo jip e mirr akoma me "*rosa, rosae*".

Ish fort e bukur Xhilda; e ishim gjithë të rarë në dashuri për të, e vejim ahirna ka dhon Fernandi më se të përpjikkim Xhilden, se të gjëgjim mësimet mbi Kant.

Një ditë zu e xhiroj një poezi te ku fjitej t'ërës që tundënej kokonaret e gliçinit, që mbjonej me aromin e tij gjithë gjitonin. Po poesia kish një sekret: ish një akrostik ket përsëritej ëmër'i Xhildes për pes o gjasht strofa të shtruara me endekasilabe të përsosur.

Kur u zbulua sekreti, Xhilda u ndie e qellur dhunë: dhon Fernandi mund t'ish i jati. Po profesori e nxuar ka ferxhat: “Ki ng'është shurbes yti. Ngë të përket. Këtò jan shurbise timet, që më përkasjin vetim mua e ti ngë ke të mbjakesh... Ti je metafora e atij që kish të kish qën e ngë që; e atij që do të jet ngamon...pamundësi' e deshirit pamundësi' e gjelles...”

30 të Prillit.

U rua ket pasiqiri.

Lëmoj musteqet.

Shkurtoj me gërshtërt mjekrën.

Shpjeksi lesht të kuqë ç'i hapej rrushkull si një rrëshyel mbë kryet.

E shprishi me profum, dreq si i thot Koheleti.

I dha një ndreqje stolisë së bardhë.

“Jam Matallena ime, jam e bënj gjithë këtë per varrimin tim”.

“*Que es muy lindo que un entierro?*” Citoj, pra, ka kush e di ku....

1 të Majit 2006

Festa e puntorëvet. E sesi mund mos të kujtonj të parin puntorë i Cili, pra që bëri gjithësejin, tha:”*poiesomen anthropon kat'eikona hemeteran kai kath'homoiosin*” (Gn. 1,26. *Evdomikonta*).

Ndodet një do të pënxonj te ku jemi “ikona e gjasja” e Perëndis, tek mund të gjënjë aq njerin sa tjetrin njëmos se ket hapësira (apertura, “das Offene”) e Tij që ngë ka kufi?

Ndodet një kërkon të përcaktonjë njeriun tek mund e qendronj? Ngë gjën të njëjten veshtirësi që gjën kur do të përcaktonjë Perëndin? Ngë përcaktomi njeriun ngamon ket shurbise që ngë jan esencjalisht njeriun? Njeriu kur do të përcaktofet, ngë ka të gjëndet gjekë (ëmëri, mbiëmëri, familja, feja, farja, profesjona etëtj.... - të cilat jan gjithë shurbise të jashtme)?

Njeriu është hapësirë (“*das Offene*”) dreqë si Perëndia. E kur Nietzsche thot se njeriu është “kafshë jo e stabilizuar”, ngë e thot kët fat (ngë dimi ndodet i mirë o i ligë) të njeriut?

Disa filosofra thon se, për këtë, njeriut i gjymëton qëna; po pse ndodet qëna është hapësirë që ngë ka kufi e për këtë ngë ka si mund t’jet e përcaktuar, e kuptuar (“*captare, capere*”), e mejtuar? Njeriu ka qënie të hapur dreq si Qëna; e po që ngë ka si t’jet i përcaktuar, thomi se ngë ka qënë e se qënë ka t’e bënë.

U vë se “i mejtuar” do me thën “i vën te mendja” e se mendja ka kifari me “tekë shurbiset “mënojin”, “kan mejtim” (pushim), sa të marrëjin kufinjet e fjalës e cila, po, ka kufinje, ka retat e logjizmit për të kuptonjë (*capere, captare*)...

Po fjala, që ka kufi pse “vë të një formë”, është ndryshe ka Qëna e, për sa do të thot, ngë ka si të thot atë “*res extra*” (Qëna) që ngë ka kufire.

Pa/stabiliteti i Qënës që ngë ka një llok te ku të vendoset, pa/stabiliteti i njeriut, mashkaret e të cilit - me të cilat e thomi, dhe që jan ngamon të ndryshme ka atë që njeriu është - mashkaret e të cilit jan ngamon “Jetri”, me të cilin e thomi (metafora, metonimie, synedoka etëtj...), pa/stabiliteti i Qënës bën, i vetim, ikonin e gjasjen e Perëndis.

Njera sot Perëndia u tha me disa metonimië: *Summun bonum, summum ens* etëtj...

E moralistikisht u tha se për t'jemi ikona e gjasja e Perëndis kem t'jemi të mirë sesi Ajo e se kem'të jemi të persosur sesi Ajo. Nani Ajo, Perëndia, është e persosur pa qën e persosur.

Nd'ish e persosur kish të kish kufinje pse vet shurbiset e persosur kan kufinje, kan formë e formë të persosur. Po ndose Perëndia ose Qëna kan kufinje kem' të mejtomi se gjë më i madhë se Perëndia, ose Qëna, mban aq njerën sa tjetrën, gjë “*epekeina tes ousias*”.

Përsëritmi: Qëna, Perëndia e Njeriu jan hapësira (“*das Offene*”), për kët mosnjë filosofi, ontologji, teologji, anthropologji mbaroj të përcaktonej aq njerat sa jetrën.

Dështimi i gjithë tentativet të definojin Qënë, Perëndi e Njeri na vën ket lajmi se kujtimi (*memoria, meno, mënoja*) është shumë i “formuar” (te domethënia informatike) është shumë i formalizur (ngamon te domethënia informatike), shumë i vën posht ligjen e principium-vet e logjikës, sa të ket kifari me Hapësirat....

Ka hapësira, ka jostabiliteti, ka posibiliteti se mund të dalë çë do do, i paprituri, lefen gjithë trëmbësit frikat drëtë dridhmat e njeriut.

Sokrati ish i shqetësuar se të mbëdhenjët i kishin dhën shurbisevet ëmre lëvizje. Socrati, ndomos se thoj: “*Kalos kindinos*” – “*ë i bukur rrëziku*” -, i shqetësuar ka levrimi (“*hos ionton apanton aei kai hreonton ... all'houtoi autoi te osper eis tina dinen empesontes kykontes kai hemas efelkomenoi proseballousin*” – Pl. *Kratylos*, 439c) mejtonej se ish bukur për njeriun të gjënej e të kontemplannej shurbise të qëndrueshme në vetëhenë e tyre e shpiksi metafysiken e moralen e, pas atyrve, *epistemen* dhe, bilën e saj, *skencjen*. *Metaphysika*, *moralja*, *episteme*, *skenzja*, jan “mjetet” me të cilët njeriu mban mbë kujdhës frikën e hapësirës e posibilitetit e të papriturit, e pasigurin e tij.

Po çë jan “mjete”, e mjete të shpiksur ka njeriu, *metaphysika*, *moralja*, *episteme* e *skencja*, ngë kan asnjë themelin ket Qëna,

ose ket Perëndia. Ligja e moralja, që ka ajò lefet, jan ekuivoku, keqkuptimi më i mathë teku njeriu do të themelonjë qelljen e tij sikur t'ishin të urdheruar ka Perëndia.

Nga gjë që shpiksin njeriu është një “*ut si*”, një “*sikur se*”, një “*als ob*”, një “*comme si*”.

Tentacionja e madhe e gjithë atyrve që urdhërojin, të fashistravet pikerisht, ose të katolikëve, ose gjithë tiranëve, si Hoxha, është të mejtojin, e të urdherojin t'jet i mejturar, se këtë “*sikur se*” kan themelim o ket natyra o ket Qëna o ket Perëndia. Shkojin, si thot U. Eco, ka “*sikur*” ket “*se*” e ka “*se*”, ket “*prandaj*”, ka “*ut*”, ket “*si*”, ka “*si*” ket “*ergo*”.

Fati – i mirë o i keqë ngë di, po u dolla ka gjithë këta “*empasses*”- është se jemi të lirë e ndose një shlaveri logjike eksiston është gjithë krijim i njeriut i cili vet me këta “*come se*”, “*ut si*”, “*als ob*” “*comme si*”, “*sikur se*”, mund të perdoronjë Qënien, mund të thot gjë mbë Perëndin e mbë Njeriun. Hala e madhe është kur këta *ëndre* dhe “*sikur se*”, bëfen ankthe ture printënduar realitetin që asnjë arsye mund t'i jap: “*el sueño de la rason produce monstruos*” (*sueño*, vete pa thën, si “*ëndër*”, jo si “*gjum*”).

Qëna e Perëndia fjasjin pa fjalë. Fjala është e tërë e njeriut, edhè ndose është njeri që thotë se ng'është njeriu që fjet po fjala që fjetë njeriun.

Si do t'jet, fjala është metafor, metonimi, perspektivë, parçjalitet. Abstraktejonë ndërsa Qëna e Perëndia jan realiteta më e themeluar pa qën e themeluar.

3 të Majit 2006.

Ket librushi im “*Lo specchio l'enigma*” kisha shkruajtur ne 1997 “*sarebbe auspicabile porre l'accento su ciò-che-ci-divide e su questo fondare i modelli nuovi di pensiero e di vita*” (fjeta 56).

Nanì djovasinj të njëjtën mejtim kët librushi i Enzo Bianchi “*La Differenza cristiana*”- Einaudi 2006.

Ngë dua të thom se Enzo Bianchi djovasi librushin tim, papas Matrangolo ja kish dirguar kur kle i botuar. Probabilisht të dy varemi ka ki mejtim i U. Eco: “Non è fallacia ontologica tenere sottomano una ipotesi sull’”identico” per approdare a uno studio unificato del “diverso”. È fallacia ontologica saccheggiare il magazzino del “diverso” per scoprirvi sempre, subito, con certezza assoluta, l’”Identico”.(U. Eco: *La Struttura Assente*, 1983, pag.379).

Për së drejti E. Bianchi, ç’është një “*dei fighetti dello Spirito*” i sosmë, çë vete e vjen ka “*i fighetti della televisione*” si Fazio e Lerner; E. Bianchi çë stisi një manastir ç’është një Hotel “a cento stelle”, ka dy kalime gjuhësore ç’jan një program dhe e thon të gjatë mbë mentalitetin perëndore: “*Ascoltiamo lo straniero, smetterà di essere estraneo*”. Pse “*lo straniero*” ka të mbaronjë t’jet i tillë? Pse E. Bianchi, dhe borgezrat si ai, ka të rier “*tranquillo*”..., mund t’e vëni ngusht.

E pra si bën një i huaj mos t’jet më i huaj, ndose jemi gjithë natyrisht të huajë?

E pse i juaji ngë ka të na çanjë më boqet? Për “*la tranquillità nostra*”.

Nëng pranohet i huaji si një çë çanë boqet, jo si një çë vë në diskutim paqen tonë. Këtù problemi është sesi mund bëmi sa i huaji mos t’jet një problemë.

Na perëndimorë u kostituum si jatronjë e botës e xum të risolvirmi gjithë problemet e gjetim jatrinë për gjithë problemet. Një ndër jatrinë çë bën mërakulli e gjet iluminizmi i Voltaire: “*la tollerance*”. Çë vjen më rrar si: kini paçenxë, kini durim, më par o më vonë i huaji do të bëfet si na, i perëndor, i krishter, katolik, pse na kemi civilitetin çë do t’e bënj të bindur se më mir se na ng’ë mosnjeri. Neve na puthi historia, sesi na puthi Perëndia.

Jetri kalim thot:”*sei diverso quindi ti accetto*”. Ngë thot u shpresonj të bëfem si ti, ose, më mir, shpresonj se ti do të qindrosht si je për gjithmon: lekurkuqë lekurkuqë, misilman misilman, aztek aztek, iranian iranian, pa demokraci pa demokraci. U jam aq i verbër, sa ngë të shoh si lekurkuq, jam aq pa dituri sa ngë di ç’është demokracia etëjtj....

Të dua mir, ndose mund t’jet, pse je i huaj e ng’je si u, pse sesi jam u më siell zdingun...

4 të Majit 2006.

Shkruan Maximos Lavriotis, theolog ortodoks i *Megistis Lavra*: (përkëthenj si mundinj) “Biblia e njëtë ë e bën me fjalë e mejtime të krijuer. Nga mejtim çë mund t’jet i shpiksur ka trutë e njeriut është i krijuer. Trutë e njeriut mund funcjonojin vet ndër kufinjjet e motit dhhe e hapësirës; ngë mund të konceptonjë mosnjë realite e pakrijuer e asedhë mund t’e kuptonjë. Po çë mosnjë fjalë ose konsept i krijuer mund të përmbanjë kurrë realitetin hyjnor, është i papështuashem se nga martiri e krijuer çë eksiston, sesi Biblia o çë do ndryshe shurbes te ku burthofet Zbulimi hyjnor (sesi ikonat të shënjëte) do të trazmitonjë shum pak, fundisht pak, realitetin hyjnor i njëjtë, atë realitet çë Perëndia zbulon ket i drekti Zbulim i tij njerëzvet. T’i kesh besë konceptevet të krijuar e shprehjes së krijuar për të shprehish o të kuptosh realitetin joekrijuer e Perëndisë është një gabim metodologjik i trash, pse ng’eksiston mosnjë “*analogia entis*” e mosnjë “*analogia fidei*” as ndonjë realitet midhis të krijuerit e jotëkrijuerit; fare gjë çë mund të riprodhirinj relitetin hyjnor ket realiteti ynë i krijuar” - (Maximos Lavriotis: *Zbulimi i Perëndisë* – Peterhouse – Cambridge).

Këta i jep vërtetim diskursit çë bëm sipër ket e para e majit.

6 të Majit. 2006

Ngasja më e madhe e këtyrve krishtere sesi “i fighetti dello spirito” si E. Bianchi, çë vete e bën “*lo spiritoso*” te televizjona ka Fazio e Gad Lerner, është pelagjanismi: “*i fighetti dello spirito*”, ndërsa burthofen kokukur, jan e bëjin një “*ut si*”, një “*sikur se*” të sigurtë se mos një relativismë mban mejtimet e tyre. Kundraz relativizmi është djalli për ata. Ata kan vërtetjen, më e vërtetë se e Vërtetja. E din se vet ata mund shpëtojin jetën. Ndërkaq shpikstin disa idola si “*il dialogo*”, “*l’ecumenismo*”, “*la tolleranza*”, “*propaganda fide*”, e tëjtj... Bejin kongrese ket duartrokasen vetem, me serjoze o.d.g. teku fjasjin “*gli esperti*”... Gjithësej për paqjen e gjithësejs. Këta jan “*costruttori di pace*”... Ndërsa harrojin se “*têi gar mataiôteti he ktîsis hypetáge*” (Ro. 8,20) e se vet Perëndia mund të bënj “*nea ktîsis*”. Për së dreqti kle shkruajtur: “*kainoùs de ouranoùs kai gên kainèn katà to epángelma autoù prosdokómen*” (2 Ptr. 3,13); “*éstai gar ho ouranòs kainòs kai he gê kainé*” (Is. 65,17); “*idou kainà poiò pánta*” (Ap.21,5).

E një ndër më të mbëdhenjët filiosofra e kohës sonë la thënë: “*Nur noch ein Got kann uns retten*” – vet një Perëndi mund të na shpëtonjë.

Nani vete mbaron se këta “*fighetti dello spirito*” mbajin llokun e “*katehon*”-it (“*tò gar mystérion éde energeítai tês anomías, monon ho katéhon árti héos ek mésou génetai*” - 2 Tess. 2,7), atij çë mban kët jet sa mos të sdorrokopset, sa mos të vinjë e madhja apostasi, po ture bën kët pengojin ardhëmjen e Perëndisë, e parusin e tij.

Kur i shoh te televizjona këta “*fighetti dello spirito*” thërres: *Maranathà....*

10 të Majit 2006.

“E din gjithë se gruajen time e rrëmbeva. Ahirna mund të më kishin prer edhe kocin. Ng’ë si sot që jan gjithë lleka. Graja ime ish e butë e butë. Vrenej ngamon më truall. E kur i fjisnje bëfej e tërë e kuqe. Ng’e ke gjufin të përgjegjesh kur të përshëndetjin? Dukej e egër, po kish sy shumë t’ëmbël për t’ish e egër edhe përmbrenda. Si kle kle, më zu një orekës i math, kish’t’i puthënja atë buzë e hollë si një pjasje e e bardhë sikur se këtë gjaku ng’i shkonej, e kisht’i ngishnja atë likur ç’i fashqonej sa mënxitë kurmin e hollë si një kallmë. E krafet, kisha një shtipje e çudhitur, se do t’ja kisha çare ture e shtringuar më se sa sosnej. Ndërkaqë hipej si një burrë te shkalla kur mbjidh ullinjët e ngrënej vallunet pjotë rrushë sikur se iu kish piksur më kurm fuqia e dhjet burrave. Ndër të vjelat kur me kazjunin t’e ndifnja të ngrënej vallunet për t’ja ngrakonej gadhiurit, një ndër punëtorët më tha shi ka ket të vesh, ng’ë viskot për dhëmbët tëndë e pra do të të mbitinjë cunjet. Ë bilë patruni, ti je vet një furiz.

Shkonja vet mbrëmanet e mia, ture e marr vet ket mendja ime, e lënja ujërat timë të vejin si ujë muzkje ture përsëritur i llavë ëmërin e saj. I puthnja kokazit e bithës...

Një ditë ç’u përpoqëtim ajo sipër gërshisë u poshta, uli syt mbë mua e pa thën një fjalë duroj shikimin timë pa , si dukej, trëmbësi. I the se i dukëshin shalët, ngë ke turpë se u rri këtu përposh? Ng’u përgjegjë, e vaxhdoj të mbjidë pemet pa u babartur e ture zgjiruar shalët për të arrënej një degë më e lart. U babarta u që rrinj’e ruaja ndose ja arrënej njeri e sidomos i jati o e jëma o i vëllaj ç’ish më i egri se gjithë më familë. E zura e përcolla vakand me griken e thatë për gjithë shqetësimin që vënej më kurm atà mish të bardhë që shikonja. Shi’ se u ngë tundem ka këtu e kur të zdripesh ka gërshia do të të marr. Ti je më vë më kurm një oreks të math.

Ngë përgjegje, as u tund ka dega tek u kish hapur shalët të rrinej n'ekuilibër.

Ngë ke gjufë të përgjegjesh, shi' se u vazhdonj e të ruanjë e kur do të zdripesh u të vë duart kalosh.

Duart e saj vazhdojin e mbjidjin gërshi. Nga çik lënej të bijin disa veshë. U kisha bën i tër lucë e ngë do kisha ditur të thoja cilët uj më lagnej.

Më shpëtoj ka situata delar'i ç'ish e shkonej me mëndrin.

Guanjù, ng'u adunarte se kjo ë e pjekur?

Kur pa delarin vu vestin anamesa shalvet e zu fill të zdripej ka gërshia.

Thuaja një fjalë këtij xhuvinoti, qeshi çobani.

Ajo u anangas me panaren pjot gërshi e turë u burrartur j'arru ket kazini ket ish e përgatitjin të ngrënit e të korravet: qepë, ullinjë, ruvdata, përsutë...

Aso ditje ngë hëngra, ndifsha i ngosur.

Shi' se ti e merr ndë bithët e vdes, më përqeshnej gruaja e delmjerit. Ki trimë do të bëfet nga dita më i likësht e do t'e marr ndë llunjët.

Përqeshja e gjithëve me bëri më rrëziktar. Kish t'ish imja, kish t'i burthonja gjithëve sa vlena, dreq me një grua çë ngë kish si t'ish imja.

J'arru gushti.

Përposh shkandrisë më e madhe. Kur gjithë fjëjin mezdite.

Ish ditë pjot cincërta. Ahirna ishin cincërta pa kufi. Nani çë dorrokopstim gjithë dherat se kish të stisjim shpì u llarguan ka katundi cincërrat e dallandishet. Vera është ngamon e qetme, ngë llarisin fare gjë. E ti e di ç'është një kacamite? U bët gjithë gjeometre e nga një desh të stisnej shpit e tija sa të mbjonej me të holla bankat. Kini nga një tri makna e për tri makna hëngëtit gjithë petkun. E di. Edhë u bëra ket gabim të madh, edhë u i vura kët halë ket goj'e katundit. Po u kisha një pretekst. U kisha

lerë ket nje katoq te ku mbjidhëshim si kafsha e fjëjim një sipër tjetrit.

Ahirna ishin hardhla mbë muretet, arvuret pjot cincërra.

E sa të gjegjenej cincërrat ajo çomë kish vatë ndër dherat. Dielli i poqi kocin dhe e zu një marrmendje e madhe. E gjeta ndë mest kallamevet e fiqur. M'u duk e vdekur. E mora ngrah e ja qella s'jëmës.

Nga, nga ec mirr ujë të ngrit. Lag një cinxullë e sillme.

Ndërsa venja ture gjetur cincullë e ujë frisku e jëma e kish ngjatur më shtrat e i kish nxierr vestin kalosh. Ish e tërë e lagët djersësh. Për shkandrën e për ethen dridhej e tërë. E për sëmundjen nanë e jëma m'e ftonej për likur vet me mbrolat intime. E desha ndutu më shumë keshtu e sëmur e e vdekur si ish.

U ngorda i tërë. Zura e dirsita edhë u. Më zu edhë mua një marrmendje, ndërsa lagënja tirqit.

Je me jep atë cincull, çë je pret sa të vdesë?

E jëma zu fillë e i shkoj cinezullin ndër ballë, ndër shalë.

Një e sëmurë ng'ë më një grua, as një virgjir çë ngë do par. Si një jatrua mund t'i kish vën duart kalosh pa trumbulsi?

Ndërsa e ruanja pata zilë për sëmundjen e saj. Do t'e kisha pasur ngamon të sëmurë... kështu e papërgjegjëshme...

Mund t'jet se një deshër i tillë ng'ë fare i mir. Mund t'jete se edhë u kish t'isha i sëmurë. Po kle ahirna ç' u taksa me vetëhenë time: ka t'jet imia...

12 të Majit 2006.

Nevon se t'jemi illuministra si do Kant. I cili thot se ngë kem t'i vemi prapa mosnjeriu. Kem t'i japmi kund vet arsysë, vet logjikës. Mos njeri na thot pse kem t'i vemi prapa Kant-it ndose ai thot se ngë kem' t'i vemi prapa mos njeriu. E ka ku arsya

muar mundësinë që ka, të bën një gjithë të bindur mbë fuqin e saj...?

Vdiq Perëndia, po pa Perëndi ngë kemi si të rrimi e bëm perëndi arsyen. Do të vdes edhe arsya drej pse është Perëndi...

Ishë “*Organon*” arsya, u ndrrua në një “*eskaton*”.

Po cila është arsya që gjykon arsyen dhe e vendosin si i njëjti mjet të predhikonjë e vërtetjen dhe e prodhuktëvet e saj?

Thon “*adaequatio*”, “*orthotes*”.

E kush gjykon se lidhja e propozixjonës, racjonalisht “e vërteta”, ka për së drejti “*adaequatio*” më shurbiset këtë jashta?

Dukja.

Po dukja nevon një feje, një bindje, një besim. E ket feja, bindja, besimi, mos njeri mund të na siguronjë se ng’jem’e ëndërmi.

“...filosofrat vërtetojin se njohjat kan t’jen të fituara ture u nisur ka ato të paranjohura të dhëna e të caktuara, ket vërtetja e të cilavet thomi se i kemi besë: një bindje e tillë rrëjirnjër ket pitagorikrat sa ng’ish i dimostruar, ket peripatetikrat sa ngë mund t’ist i dimonstruar e ket platonikrat aq njerat sa t’ jetrat (Giordano Bruno: *De Umbris – modus 16*).

Gjithë aparua façon feja, besa, bindja.

Kush thot se edhe skencja është një fë, një bes, një bindje, ngë ka padrejtësi...

Shkomi ngamon ka një Perëndi tek njetër, të cilës i celebrimi ceremonitë, me bindje e serjositet shpesh tragjike. Vreni ceremonitë e Ekonomis....(edhë ajo e Perëndisë).

18 të Majit 2006.

Më ruanej i vrëjtur ture çfritur kamnua ka hundët, pra që nduknej gjat gjat ka sigareti.

Ju që dini. Ju e shtut si lëng pjënsi. Ng’u lodhët për fare gjë. Gratë ju i sielljin më shtrat prindrat. Gruaja sot u bë shërbesi më

i lirë, i pa çmim i botës. Ka do prire gjën një çë të pret me shalët e hapta. Na kish t'e dirsijim...

Si do kle. Kle përposh njetër shkandri gushti ç' e pe se veij njetër herë ndër kallamet. Kisha besë se do j'arrenej mënevët çë nxijin me korronxezë.

Leji të rrin korronxezët. Mos kam të vinjë njetër herë të të marr kur do të të vilakosinjë vapa? Ea hir, ea rri më hjë...

Sikur t'e kisha tëhelqur me kush e di cilin mjalët, la udhën e korronxezvet e u drejtua ka kaliva e delarit. Më ruanej si e magjepsur. E dyta herë çë më mbanej syt kalosh. Po i uli mbjatu. E një dridhëm i skundi kurmin.

Je njetër herë pjot djers. E di se ndose bier uj mund të të zërë gjë? Nxuar mbjatu mbrolat kalosh e qindroj vet me zlipin: e ty bëm si mëma. Lagim me uj frishku.

Qindrova i palivizur si një shtatull. Ruanja i pabesim shfaqjen çë më paraqitjej përpara. Kur e kisha par të parën here ndër duart e s'jëmës i turpëshim llargonja syt, ng'i kisha vën shumë kurmit të saj. I ruanja nani këmbët me gjisht të vegjil e të kërrust si marroca sipër një fill bari. Shalët rrubullaqe rrëjirëjin një mes çë hapej si një spazë me mushkulet e barkut të sheshët. Këtjè çera ime mund të birej. Trungu ish i vogël në faqen e mbetjet të kurmit. Dy sisë të vogla... ngë më pilqien kurrë grat me shumë sisë...

Do se kam të shpjeksin leshët? Një fill vuxhje më zgjoj ka magjepsja çë më kish marr.

Ngjatu ket lliterj'e delarit se të luginjë.

Kisha marr një hjiropane ka shkallandrini e e kisha lagur ket ujët e karroqes.

Ti do ruajtur më parë.

Çë ke të ruash? Bë nga, do se ka t'j'arrënj njeri?

Do t'e bëmi një lozje? Vëru ket kakava se të luginj me pompin.

Shi çë ke të bësh, e anagasu...

Përgjunjaz sipër kurmin e saj zura e e lajta si kish bën e jëma.

Pra zura e i lëpijta barkun.

Dukej si një shtjerrë i gatuam t'ish i thertur.

La t'i hapnja shalët. E më zu nj'oreks i math, sesi do të zër njëj ulku kur ndien erin e gjakut.

Ishë e ngrohtë e e lagët. Cili është ki mërakull që të bën e dishëron të spavesh...

Shkuma e birrës u kish e tërë e spavur. Ngrëjti qelqin e e piu gjithë me një frymë. Teri buzin me shpinë të dorës.

Na thomi thomi, po që thomi? Vet fantazme. Vet tringëlle fjalësh. Ti thua po po me kryet. Po sesi mund të dish atë që ngjepsa u? E ndomos se e mbajta me mua, ngë ngjepsa më me atë grua atë që ngjepsa ahirna. Kle nëma ime ajò e para herë. I këcenja nga mbrëma ture kërkuar paspresisht atë vëlim mortje... bën e më bëri vet shumë fëmil po jam akoma fatkeqsisht i gjallë e i zgjuar... edhë ajo mund t'jet se kërkonej atë dejmje të parës herë, pse ngë më thoj kurrë se jo, kundraz ish ajò që shpesh më tëhilq e pra hapej me nj'orekës të madh. Pra për gjithë ditën më vrenej e egër e me urrejtje...

U bëm të hinjët, u trishtuam ture kërkuar të përsëritjim... kë?

E na mbajti, na lidhi, na pengojë dimri i pakënaqësisë sonë

19 të Majit 2006

Im bir i shtu një sy i pakujdesshëm këtire fjetave. Thot: ket prralla jote ë gjë që nëng priret. Im bir ë skencjat e përdoron matematken e do se gjithësej ka t'jet si nj'ekuacion, ose si një sillogjizm. I thome se kur një rrëfien zë, lë, harron, përsëritin. E se shurbiset kan t'j'arrëjin ngamon ket një merë, është një pregjikim racjonalisht e perëndorë. Këtù diskursi bëfet i vështir e i gjat e sot ngë kam fuqi të vete përpara. Ndë mest gjithësej ngë kam një "Invalsi" (i piksin gjithë litiri sa t'i jap rraxhë truvet e sa të madhësonj "*vanitas vanitatum*", vakandin e vakandëvet,

fumatin e fumatës, ose ftigin e brumbullit, ç'është jetri ëmër e Sisifit) kujit kam t'i jap kund. Më shpit time kundet ngë priren kurrë. Për kundraz, ngë bami kunde. E për sa më nget mua ng'jam fare logjik, ngë kam dinakëri: ng'jam miku i djallit...

24 të Majit 2006.

Kisha harruar të të thoja sesi e rrëmbeva.
E nani? i thoja u pra ç'ju mbraza mbrënda, nani si bëmi?
Shtiri sallaçin derës.
Pra muar hiropanen. Teri gjakun ç'i ndotenej shalët.
Za vëre ket dritësorja si një fjamur të fitimit tënd. E mos u llavë.
Ea se mirremi njetër herë.
E zu një muzike e hollë e fortë, e ashpër e e ëmbël.
Priru, thërrisnja, kam të të puthinjë kokazit e bithës.
Njeriu i ka turpë kurmit, u ja bekova të tërë gruajes simë për kët mund të të rrëfinj atë çë dua. Po rrëfinj edhe pse kan të ndelgonj pse kle gjithë një mashtrim. E ndose Perëndia ngë na nganonej... po qoft i bekuar e doksa qoft e tërë e tija...
Kur pra u xu ku ishim të fëshefur e çë vin me thën ajo hjiropane e ndotët me gjak i jati zu e thërriti: Veni ju ka zoti o kam t'ju e siellë këtù...

Çeli njetër sigaret. Ruanej llargu mbatan limtin e gërshivet.
Pse rrufiemi. Jemi piçuçra e përdhuçëra. Ngë dimi e bëfemi të bindur se gjithësej shkon. Ngë jemi të bindur se gënjemja është pse na jemi si kikklikiu i natyrës e lozja e perëndivet. Rrëfiemi se të bëfemi të bindur se shurbiset i bëmi na...

29 të Majit 2006

Thon gazetatat se Papa në Aushwitz ture kujtuar tmerimet e nazifashizmit iu drejtua Parëndis e i pyejti: “Perëndi, pse heshte?”

Kjò pyejte i gjetë asaj tjetrie që thot : “Ku ishe?”.

Aq njera sa jetra duan të shpëtojin responsabilitetin e njeriut...

Po Perëndia ish te sëmundja i brëndësmvet, të ur'i tyre, ish te lager-i, ish ket furret, ish te kamnoj që dilë ka çimineret, ish ket gjithë dhëmbja e njeriut i shënderruar ket një gjë pa çmim.

E ng'ë vërtet se Perëndia heshti. Perëndia ngë fjet me fjalët e njeriut, fjet si zerë i ndërgegjes i gjithëve. Po pak jan atà të disponueshëm t'e gjegjëjin të babartur si jan ka zhurm'e botës, ka zhurm'e pregjikimevet të kulturës, të historisë. E të dhunës së njeriut.

Perëndia foli dhe e gjegjëtin njerëz si Bonhoeffer, si gjithë ata që pra vdiqtin sa të lirojin të tërë Europin ka nazifashizmi...

Ngë gjegji folmjen e qetme e Perëndis Pio XII, ng'e gjegji Klisha. Atij e Asaj do t'i kish drejtuar pyejtjen Papa Venditi XVI.

Klisha për “*oikonomin*” e saj, misteret e së cilës na ngë kemi si t'i ndëlgomi, ngë fjet kurrë: ngë foli për “*desaparesidos*” të Argentinës o të Ciles, për kundraz vate e i shtringoj dorën gjithë ditaktorevet të botës.

Kur Klisha i lipën ndëles botës për mëkatët e saj ja arrën ngamon shumë vonë, shumë vonë.

Ngë mund të shkrakomi përgjegjësitë tona sipër Perëndisë. E Cila na la të lirë të qellemi si duami... e na jemi shumë të zënë ka çështjet tona sa të shqetësofemi se njerëzit jan e vdesjin uri, o se jan e vdesjin për lirin, o se jan e vuajën për sëmundje që i dhuruam na me civilitetin e me demokracinë tanë...

Sot jan “*Médecins sans frontières*” ose “*Emergency*” ose tjetër ONG që gjegjin zërin pa tringël e Perëndisë...

7 të Vjeshtit. 2006

Akoma sot kam gjegjur: “Sa na rikriarte asò ditje që fole arbërisht”. E kan ligjë: i kthenja gjithëve nderin të fjasjin sesi dinë, pa turp.

Thon se pata kuraxh: një profesor që ngë ka turp të fjasë sesi e bëri e jëma, sesi e bëri historia, sesi e bëri ndodhja. Nanì është edhe e vërtetë se gjithë ngë kapirtin gjithë fjalët time, po gjithë deshtin pra të dijin sesi thufet arbërisht “azzurro”, sesi “verde” e tëtj...

Ditin pas, gjithë më pirsëritjin: Allora, qielli është i kalthër? Mëma më tha se “kalthër” është si e thoj ajò kur ishë e re”. Kam besë se kushdo gjegjin se qielli është i kalthër s’do t’ë harronjë më...

Ndose mund të xëmi gjë ka kjo eksperjenze, mir se na erdhë. Ndë xëft gjë Dhimitri e të tjetër mir se na erdhëtin asò mbrëmje Firmozë.

Dua të thom se e marrja pozicjónë ime ngë do t’jet më racjonalle se ajò e të tjetret, është, kam bese, irracjonalle si gjithë të tjerat, po kam besë vet se do t’jet më e përshtatshme të lironj gjindjen ka turpja.

Sa herë e tham se litiri na bëri për sekujë të turpshëm të folmjes sonë.

Sesi na mbjoj pjotë turp pse thomi meshin grekisht e se bëmi kryqë te manera jonë. Nanì pekopi i Ungri është e na mbjon eparkin me priftra romenë: mir se na vijin, po pse ngë urdhëron priftra djakonet që tash kemi?

Murgu (i mjeri) Zefi ynë Di Maxho i cili përktheu arbërisht meshin ka grekishtja, kush do t’ë përdoronjë, romenet? Vërteta se te Hora e Arbëreshëvet kan më krypë ndër tru se na, e ng’i premtuan peshkopit ka Ungra t’i vënej përposh urtësisë së tij, po na bëfemi nga dita më të vapkëth, e ahirna?

Ngë dua të pirsëritinj nga herë të njëjtat fjalë. Dimonstrova ket një mbrëma që mund bëmi.

10 të Vjeshtit 2006.

Hapinj ndodhurisht librin e Giovanni Reale “*Valori dimenticati dell’Occidente*” e djovasinj ket treguesi “*Studiare Platone con Heidegger*” (e pse jo *Heidegger con Platone* - sarebbe più opporuno, no?) .

Sesa herë djovasa Heidegger e sesa herë djovasa Platonin me e pa Heidegger. Po, i marr nani ket rasti, qindronj i mbambarrartur: “Sesi Heidegger djovasin Platonin?”

Kam pak kujtim. Po ki ng’është një fat i lig, pse, nga herë që pirsëritinj të djovas një libër, e gjënjë ngamon të ri e më duket se jam e xë shurbise të rea, te një menirë e re, shurbise që besonja se dinja tash.

Kujtimi ngë më ndifin, sidomos ndose një libër e djovasa një herë e më duket se e kapirta. Ngë sosin të kapirish, po ke edhë të xësh gjë e për të xësh e njëta është të pirsëritish, të pirsëritish për të mbash mend...

Kur kleve vet një herë ket një qitet është sikur ngë kleve kurrë...

Po këta të harruar është edhë mejti me të cilin ngë prëfe mos gjikun. Si thot Plotini, shpirti që harron është më i miri pse bëfet i lirë ka gjithë pasjonat – ndër të cilat kem’ të vëmi edhë pasjonin e lokut i sigurt, të mejtimit që nëng zdorrokopsin mosnjëherë, e të kthimit të përjetshëm të identikut...

E pra harrimi është jetra manerë e kujtimit – si thot i kurrë shum i dashuri Borges – pse vet kush një herë xu, dijt, mund harronjë. Një herë dinja – si Borges – “el arduo latino”, e grekishtjen; e dimonstron fakti se jam e i harronjë... pse bënj një lodhje të madhe, një sforcim, kur djovasinj Platonin e ng’i bie mbjatu mb’udhë. Akoma djovasinj me lehtësi grekisht Vangjelin e S. Palin, po tjetër?

14 të Vjeshtit. 2006

Më zë një varesi e madhe. Mund t'jet se mbaroj mot'i arbërishtjes. Mund t'jet se mbaroj mot'i i gjithësejs për mua. Ke t'jesh i ri sa të të shkonjë ndër rrëmat lëngu që të shtie të piksish gjë; sa të përsëritish atë ftigë brumbulli ç'është gjella. E cila ndose të paraqitet si kthim i përjetshëm të identikut, të varésin; ndose të paraqitet si kthim i përjetshëm të ndryshmit, të lodhin. Ke të jesh i ri, fort i ri sa të duroshë gjellen kështu si është – pa domethënie... – absurdi si thot Camus e sesi përsëritëtin gjithë eksistecjalistrat... Ose udhëtimi ket shkretëria... Abrami, që eci ngamon për sesa rroj - kish Zotin për delar e ngë mund t'i gjymtonej fare gjë... Na? Na që kemi si delar?

Giuseppe Rensi, veprin e të cilit përsërita të djovasnja ndër këto ditë, e thot haptaz haptaz: Realiteti është irracjonal, racjionali është joreal, jasht ka gjithë hegelismet të cilët, ket totalitarizmi i idelogjisë së tyre, përcieljin gjithë kaosin që hapet rrethë noerit tona...na jemi të mir të krijomi vet ishulla rregullariteti e harromi gjithë honet e detit që i rrethon...

15 të Vjeshtit 2006.

Detyr'i arsyes është ai t'i vër rë arsyes e të njof mir limtrat e saj. Illuminizmi më i mir është ai që di e dritëson merat e arsyes: sesi modernitetin, historismin, merat e të mira e skencjes, “njëjin”, idhentitetin, përparimin, entusjasmin etëjtj... Ahirna jemi të dritësuar kur do të xëmi se ecmi mbi ujit e se ngë kemi një botë ku mund prëmi udhëtimin tënë... Po ajo dritë që na dritëson ka se nga herë që do të rrëmbemi atë që na duket pjot dritë pështon më tutjë...

Ket poesia, e artja në përgjithësi, ajò dritë na burthor kët fat (ngë di ndose i mir o i keq), na dritëson jostabilitetin e gjithësejs, po na magjepsin me dritin mbrënda së cilës gjithësej është e dritësuar. Kjø dritë është Jetri që na mban vet sa të shkomi si buzëqeshja e gjithëseis. Kjø dritë façofet ket çëdo vepër edhe ndër ato të dhon Fatuçit, vet se ket atò ai poet tradhtoj dritin... u sforçar të thoj shurbiset, jo të pathënëmin e tyre... te fundi dhon Fatuçi lë fjalët e tija pa drite, ose, ture e thën litisht: “ha messo un sasso in bocca al significante”, për mjet të cilit fjalët e tija nëng bëjin shenjë atij mbatani që fjalët e poesis kan të hapjin... të Jetrit ç’i paraqitet vet syvet e shpirtit, vet besës se “shurbiset ng’jan si duken, si burthofen”.

16 të Vjeshtit 2006.

Papa Vindhiti e ka me arsyen, e ka me gjithë racjonalistat ç’jan e e shtien njetër herë ket shkretëria e besës, ket e cila shurbiset që besofen ngë gjëjin një “*adaequatio*” për t’jen të dukshme. Pra që Klisha u perqafua e vate dora dora për sekujë me arsyen, e ng’iu dukë e vërtetë të bënej të dukshme (*credo ut intelligam, intelligo ut credam*) shurbiset e fesë, aq sa mejtoj se mund t’i imponohej gjithë botës, pse mosnjë që përdoron arsyen ngë ka si mos të perqafonjë besin katolike, pse kjo ka ka ana e saj arsyen, sot që arsya është e dimostron se fea katolike është një fë si gjithë të tjerat, e rrufiomet e saj, për arsyen, jan rrufime si gjithë të tjetër rrufieme, sot Papa, e klisha katolike me të, e zë me arsyen e thot se arsya ka limtra mbatan të cilvet ngë mund të ver.

Shoh Papa Vindhitin që thërret me Lord Henry e Wilde-t: “*How dreadful! I can stand brute force, but brute reason is quite unbearable. There is something unfair about its use. It is hitting below the intellect*”.

Papa Vindhiti, e me të klisha katolike, harroj kaun e “*intelletto d’amore*” e vete ture gjetur akoma britë e arsyes, asaj grekishte

këtë herë, pa ditur se pakzim'i Aristotelit kle një fat i keq për benë. Harroj se shën Virgori Palamas denuncjarnej “*kakodoksìn elenike*” drejt me Barlaamin i cili dojt t'i mësonëj kallogjërvet e malit Athos sësi kish të bëfshin dhishipujë e Aristotelit. E për së drejti “grekrat” (“*romaioi*”) e Kostantinopolit mallkojin elenismën kurse litinjët e perëndimit madhësojin Aristotelin e e shënterogjin me Tumazin.

Sot papa Vendhiti lëpin lakosat e arsyes...

U ëndërrinjt një klisëhë e katakombavet ket nëmërofet një “numër i vogël”, pa arsye... pa “*tibicines*” (“*kur parkalesin fshehu*”) që fryjin borit ture kënduar për udhët e për sheshet “Noi vogliam Dio...” - sësi bënë Ungir ture bashkuar peshkopin te katedrali ket dita e njëzetepes vjeçarit e episkopatit të tij. Nga një shijimet e tij...

Pa arsye, pse “Vangjeli” ngë xëfet ka njeri. “Vangjeli” si thot Pali është vet “*di'apokalypseos*” (Gal. 1,11), pse ng'është mësim njeriu, ng'është llogjismò, ng'është fjalë (as të Bibljës, as të Vangjelit - që jan kryjime njeriu – vrë S. Krysostomin) që mund rrëfienjt përpyekjen e Perëndisë e cila vjen nga mon ka të lartat, gratis, pa sforçet e njeriut t'e kërkonjë (“iu burthova atyrve që ngë më kërkogjin” – për ket ngë mund të këndomi: “Noi vogliam Dio...”). Na ngë mund dishiromi fare gjë mos ngë vjen ka e larta drita që na bënë hyinorë.

Më dispëlqen për Mons. Fortino e për katekizmin e tij, po ng'ë libër, ng'ë vepër njerzore që mund zër vendin e “*Χάρις*” e Tënë Zoti e cila është si era që ngë dimi ka vjen e ngë dimi ku vete... e kujit i nget.

Ture mejtuar se Perëndia ish shurbes i llogjismit të njeriut (*Credo ut intelligam, intelligo ut credam*), njeriu pat si të deklaronejt “*vdeqjen e Perëndis*”. E si jo?

Arsya mund të deklaronejt vdeqjen e gjithë produktimevet të saj. Që dogjë, që piksin llogjismi i njeriut ka kifari shpejt o vonë me faregjën.

Po çë ndodhet: ng'ë fare i vërtet se, si thot Hölderlin, “vdiqtin hyjnitë e lasht e akoma ng’u len të rrinjtë”.

Hyjnitë ngë vdiqtin kurrë, ndërruan vet ëmër: është bëzonjë të thomi sesi ja thon? Sosin vet të dimi për kë një është i disposuer të sakrifikonjë gjellen e tij e njota Perëndia.

Litinjët (klisja litire) çë përkthen “*Fjalën e Perëndisë*”, “*Logos-in e Perëndisë*”, ket noerit e llogjismet e njeriut, ket llogjismet, ket kategorit, ket syllogjismet e arsyes, gjëndet sot te nevoja të piksinjë njetër Perëndi, çë më do t’i adaktofet atyrve – po ngamon llogjisme njeriu jan...

Perëndia sesi na thot shin Pali është një përvojë, një eksperjencë çë të zdorrokopsin (“*eksaisfnes*”, i papriturisht, si thot Platoni, ose Plotini) ket udha e Damaskut. Përvoj dhe eksperjencë çë nëng pergatitin mos një kërkim intelektualë, mos një abilitet filosofike, mos një mësim teologjije.

Me filosofinë e me teologjinë jemi ngamon ket vendi “*tou kosmou toutou*”, pse ki kosmos është i bën me gurtë e arsyes... e cila është mjet njerëzor...

Kur vete Rromë e përpjek atà priftra të veshur me klergyman, elegantra, me lëkurin e fytyres të lëmuar, kapirin se jan jo të ngar ka shënjëtëria po jan bilë të urtësis njerzore, profesorë, teogra e filosofra, jo të ngar ka hareja, ka “*Χάρις*” e hirisë së hjesë së Tënë Zoti.

Këtà kur i lipin bukin e hirisë së Tënë Zoti t’japjin gurin e arsyes. Këtà priftrat e Sinagogës së re, ruazit e të shtunës, më se martirië të lirisë së Tynë Zoti jan ndanjësit e morales borgeze, borgeze e vogël e vogël... me gjithë trëmbjet e turpjet e saj. Sa më të sjelljin shpatën e Krishtit, sielljin mirsin, kujdheset e idologjisë së borgezisë e të djabatës... edhë këtù te mesi i Aristotelit, as me Krishtin as me djallin. E të vjen ngulli të viellësh (“*mello se emesai ek tou stomatos mou*” – Ap. 3,17)...

18 të Vjeshtit 2006.

Kush tha se njeriu mbaron me filosofinë strukturaliste? Njeriu nënq mbaron sesi ngë mbaron Perëndia. Kush vren ka një llargësi ka e tilla shifen strukturat që mbajin realitetin, nëmos se njeriu? E sesi mund mbaronjë ose sesi mund humbet ki njeri i tillë gjykon se njeriu është i reduktuar një nënjëthë tekù përpikjen vijat e strukturavet që pikësin? Ai njeri që gjykon është një pikëpamje që është njeri par se t'jet pikëpamje e par se t'jet nënjëthë vijash strukturve. Ndose njeriu humbet ket "totaliteti" të "*l'esprit humain*", kush është që mejton ket "*esprit*"? Me më urtësi (Kantjane) Wittgstein thot se na projektomi mbi realitetin struktura jo të nevojshme, për të tëra subjektive e kur i vremi, vremi vet strukturat, jo realitetin. Anamesa lojet gjuhësore e realitetin ng'është mosnjë necesitat: mundësia e "ananke"-s mbarojë, u buar, u humbë.

Çë na qindron? Vet besa. Besa ket marrjet tona irracionaliste me të cila racionalisht gjykomi jetën. Besa që na lidhin me resposabilitetin me të cilin i përgjegjemi të Tjetrit.

20 të Vjeshtit 2006.

Filosofrat me skolë, xhakët, këmishë. Ngë shef një vet me një suvere, një T-shirt (veç, mund t'jet, Deleuze). Skolë xhakët këmishë, elegante si atë të Derrida, Vattimo, Eco, Foucault, Levi-Strauss, etëjt... Urdhër, struktura, arsyë. Edhë kur predikojin "*La struttura assente*", "*Nichilismo ed emancipazione*", "*La Ragione errabonda*", "*La ragione distruttiva*"...

Jan profesorëra, nevojnin një "Divizë" (një uniformë). "Divizë" është afër "divus"... bilë dialli, i cili prëmëtoj: "*Ndose hani ka arvur'i dijturisë do t'jini si Hyjni*". E kush është sot më "divus" se këtë me "divisin" e dijturisë?

Ketà, që thufen të gjithë ateistra, pse adhurarjin atë hyjni që është arsya-urdheri-struktura-sistem-ananke, për të cilin hyjni janë të gatëshëm të sakrifikojnë (të bëjnë “sacer”) ngagjë, sidomos lirin e tyre?

22 të Vjeshtit 2006.

Ndër kartat e lal Mikucit gjënj kë të shenim: “Dua të dimonstronjë se gjithë parabolat e Vangjelit janë pervoje që bëri Jisuj më par se të vej të shkretëria; e se figurin e re të Perëndisë e muar ka Zefi, i cili si atë putativ u qell me ‘të si një që të nganjë mundësi, një atë që përdoron vet afërërsin miqësore përpara gjithë gabimet e të birit.

“Ka Zefi Jisuj muar mjeshterin të afërsonjë të Jetrin pa dashur faregjë prap; mjeshterin të bësh ngagjë gratis.

“Zefi pra do të vdes i vrarë ka hunjë të judinjëvet pse i kish dhënë ndifme një të huaji – kam bes se ture përdoruar shkëmbimim të motëvet do të vendosin ket episodë të moti ynë: Zefi do të jet i vrarë ka judinjët pse i ndifin një palestinezi (vë parabolin e të samaritanit të mir).

“Zefi ose Sepa (si thomi Firmozë) ka lëshuar gjithë ferxhat e tradhitës, ferxhat e Ligjës. Është një pronar i të shtunës, kur sheh se njeriu është ndër nevojët. Për ket Sepa ng’i bënej dëm mos njeriu e thonej për vetëhenë e tij: “Jam pa krye”. Ket gjir’i tij nëng banonej mosndonjë mejtim me të cilin mund të vënej ndër ferxhat gjellen, botën, qënë...

“Thoj se mjeshtret e tij ishin lilet e kopshtit e zogjtë e qiellit, të cilët marrjin diellin e shiun, dimrin e verën, si do ndodhen, pa gjykim, pa një mejtin vlerje. E xënej ka maça, e cila haj kur kish u, pij kur kish etë, fjënej kur i vin’ gjumë e hinej e dilë ka shpia pa urdhër pronari, e vej ture shkaptuar nga herë që përpisë ëngjëlit e Mëris. (Ki karakter i Zefit do mir i precisuar pse ka ai derivarin gjithë karakteri i Jisuit)

“Mund t’jet se ka Zefi Jisuj ka xën si kish të qellej me adulterin (Jani: 8,1 e tëtj...)

“Mund t’jet se midis Mëris e Zefit ka klën një raport i komplikuar: aq ish pjot “senx të mir” Mëria, aq ka klën “pa senx” Zefi...

“Njetër aspekt që do vën përpara është raporti jo i thjellët, po shumë i komplikuar, midhis Jisuit e Janit, të cilët janë bredhjin raportin e komplikuar ç’është e pikset anamesa Ligjes (e dhunës së Ligjes) e lirisë së Jisuit. Për shembull: kur Jisuj vete përpara Janit sa t’jet i pakzuar e i vëfët për gjunjaz, Jisuj është e i qellin dhunë të kushiririt si ruas’i Ligjes, kështu kur Jani thot “Njota qengj’i Perëndis” është e trajton Jisujin me të njëjtin ironi pse, si priftrat sot, ka besë se jashtë ka Ligja ng’është shpëtim. Te fundi, Jisuj e Jani ngë kanë fare marrëveshje rreth Ligjes. Jisuj dënon dhunin e Ligjes, aqë sa Jani është një sherbëtor i rrept i asaj. Mund t’jet se patëtin shumë bisedime kur frekuentarjin ndonjë monastir të Esenëravet: nganjë, pra, ka marrë udhën e tij... Mos ngë kështu ngë kemi si të spjegarmi zënmjet e Palit e të apostujvet “*yperlián*”, e ndërmjet të krishtervet izraelitra e të krishterët xhentilë...

“Ngë di akoma sesi kam vendosinj këtë episod ndërsa Zefi është akoma i gjall.

“Zefi është një eretik te ambjent’i tij e për ndienjet eretike e tij ka një raport jo të lehtë me Mërin e cila si gjithë mëmat është shumë “conservatrice”.

“Mund t’jet se Zefi është një idhjet, si ai i Dostoevskijt”

“Po mund t’jet edhe se do të ndërronj gjithë rrefimin ture e bën jo një ditarë të Zefi po të Jisuit – një ditar të Jisuit e shkruajti tash një Francizë, Barreau: “*Les memoires de Jesus*”...

“Te fundi, sesi Variboba shkruajti “*Gjellja e shënë Mëris*” u do të skruanj “*Gjellja e Zefit*”.

25 të Vjeshtit 2006.

Mons. Milingo. Jesuiti qeshin, shan Milingo. Jesuiti ka vërtetjen e sa më të përdorinj dashurin si Krishti, përpara adulteris, gjykon. Jesuitit ng' i intereson Njeriu, i Tjeteri “më mishë e eshtra”, i intereson vet një entitet metafysik që sot ja thon Klisja e djë ja thojn Synagoga – e vete pa thën se është më mir të vdes një i vetem se të skandalizofet Synagoga. Jesuiti është ngamon “Inkujzitori i math” (djovasni Dostoevskij).

Neve, vete pa thën, na pëlqen Milingo, pse do t' i nxier ka grika e ulkut të Mundësis, të Njësisë, të Totalitetit, shtjerrin që babaret për jomundësin e tij...

*** **

Papa e bën kështu të glatë me arsyen, po arsya është metafora e Mundësisë, e të Vullnetit të Mundësisë. Ng' është më gjë mbatan arsyes - e Nietzsche këtë e zbuloj një herë për ngamon. Është arsya që piksin atà të thën pa arsye, që piksjin të lënë - e hapin ata hapësira pa masje të sëmundjes shpirtërorë, sesì eretikrat, për të na shpëtonjë ka ata të cilët dhezjin kaminet.

Papa (e jo vet ki) u bë ruesi i të shtunës e ngë do të dier ndrishe. Njeriu me mundësi bëfet ngamon rues i të shtunës...

27 të Vjeshtit 2006.

Te “Otto e mezzo” diskutojin Mons. Barragan, Prof. Marino, e jini Stefano Rodotà mbë euthanasin.

Ngë di si mund kapiren një që zë ka Perëndia e t'jetërt që jan ateistra, po, sikur duket, Ferrara, “ateo devoto”, ka bëzonjë të ndihmjes së klisjës për politiken e pronarit të tij: pa fjaljen e klisjës gjithë aparur duket se ngë mund bëmi fare gjë.

Mons. Barragan thot se pronar' i gjelles së njeriut është Perëndia. Ngë dimi si. Thomi se Perëndia i dhuroj gjellen njeriut. Nani, ture mejtuar si mejton një njeri, kur një dhuron gjë, për ket vetëm, ng'ë më pronar'i shurbesit që dhuron. E kush merr dhuratën mund bënë të dhuratës atë që do (veç të ket një respekt, ndë dafët, të dhuratës që pat, po ki është njetër diskurs). Kush dhuron, bier gjithë drejtësit mbë dhuratën, as mund të pretendonjë gjë. Hin pra, ket nganjë rast, drejtësia e "usucapione": ndose gjatë gjithë një gjelle përdorova gjellen, bëfem pronar'i saj. Sidomos kur kjo gjelle bëfët e rëndë e paduruashme. Sesi mund t'jet pra e mirë një dhuratë që ndërroft ket nj' angëth i math?

Kur Jobi gjëndet ket ferxhat e dhëmbjes e teolograt duan t'e ngushullojin me diskurset e tyre t'urtë, teku Perëndia burthofet i njëjti pronar'i gjelles, i math'i vuar i thot "miqëvet" të tij: "Ju sa të mbronjëni Perëndin thoni të rreme".

Sesi teolograt mund të thon të rreme, sidomos atà të Vatikanit? Teolograt shajin Jobin, sesi shajin njeriun që do të përdoronej eutanasin: njeriu ka të vuanj pse ng'ë ai pronar'i gjelles.

Po kur Perëndia burthofet i jep ligjë Jobit të vuar e jo teologravet: "Sherbëtori im Jobi thot të drejten". E cila është e drejta? Se Perëndia është "Dhunë"... - Ngë m'e k'ënda të citonjë vjershet e Jobit – djovasni ket libër te ku dimonstroft se "Urtësia" e moçme është ngamon më e madhe se nga një filosofi ose teologji e sotsme.

Pra teologu Barragan fjet mbi "*ars moriendi*".

Ndelgofet se është e bën një provë retorikje, e Ferrara e Ritanna Armeni mallëngofen: "kur do të vish njetër herë të na fashë të "*ars moriendi*?"

Ka klën një shkrimtar që sperimentoj një "*ars moriendi*". Ja thojn Tiziano Terzani. I cili kur kapirti se jatronjtë mund të shërojin – kur e gëxarjin – kurmin e jo shpirtin – pse të mësojin vullnetin e gjelles së përjetshme ç'është kundër shëndetin e

shpirtit – u tërhoq ka gjithë spitelët e vate të prit “*sorella morte*” ket një kalive ndër malet e Orsigna si një shëjtë lindor.

As Barragan, as “*l’ateo devoto*” Ferrara, as e çuditura Ritanna Armeni, cituan Tiziano Terzani, i cili ng’u bë vet pronar’i gjelles së tij, po edhe të vdekjes së tij me të tijin “*fuga dal mondo*” të spitelëvet, të jatronjëvet e të teologvet.

Terzani fjet të eksperjencjes së tij të vetme. Mons. Barragan fjet të eksperjencjes librare të tjervet, e ngë mund të dish ç’është “*ars moriendi*” ndersa mortjen ng’e ke prrëzë.

Bota, gjella, qëna, jan bota, gjella, qëna e nganjëj e nganjë i bën si do e ng’është njëni çë mban. Eksperjencet jan aq sa jan njerëzit. Njëjsia është kakodoksi metafisike, njëmër, çë Klisha do të bënej mirë të lënej prapa sekujvet e njëjsis e imponuar me mundësin e “*il braccio secolare*” të Shtetit. Sot, ndose do Ynë Zot, banomi një plurivers tekù ran gjithë rrëfiemet të mbëdhenjë e qindroj vet resposabiliteti të veçantit “*të rritur*” (“kur isha i vogël mejtonja si i vogël, sot ç’u rrita mejtonjë si i rritur”- Pali). Terzani mejtoj – pa dijtur ndose ish ai i vetëm pronar’i gjelles ose Perëndia - si “i rritur” e ng’i la resposabilitetin e tij Barragan-it i cili i fjet njerzëvet çë akoma ng’u rritëtin – ose mejton ai se ng’u rritëtin e kan bëzonjë të fjalës së tij të dritësuar...

30 të Vjeshtit 2006.

Kujtonj si vdiq Anton Sasoni, i cili si racionalist ç’ish kish besë vet ket skenzja e besonej se vet skenzja mund t’ish pronarja e gjelles së tij. Ngë dyshoj kurrë se skenzja doj t’e kish nxierr ka ferxhat e sëmundjes, leucemia. Ng’iu lëshoj më dorë ndodjes, ngë praktikoj lënësin (*Gelassenheit/ Abgeschlossenheit*) ngë j’arrù asedhë njëj liriye absolute (*moksha*) si Terzani, çë kam besë se j’arrù “*samadhi*”-t.

Sasoni ish fort i lidhur kësaj gjellje, e fort i kish besë skencjes e iku i shqier ka shumë lakosa (*fata volentem ducunt, nolentem trahunt*)...

E kisha dashur racjonalist njera të fundi të ku racjonaliteti i bën këpucët racjonalitetit...

4 të Shën Mitrit 2006

Nga kartat e lal Mikucit.

Një kart që mban numerin 7. E njëjta e numeruar:

“Kam besë se Jani e Jisuj diskutuan si Pali (Eb. 4,14 e pas) mbi priftërin e re sipas Melkisedhekut e se ki prift i ri do të kish qënë Jisuj. Si rues i Ligjes Jani u ka skandalisuar pse drej si thot Pali Jisui i ka thënë se Ligja ng’ë e persosur e se ai do t’ë kish persosur e se ture ndërruar priftërin do t’u kish ndërruar edhe Ligja.

“Kam besë se një diskurs i tillë u ka bënë përposh një platan afër ujërat e Jordani tek Jani zënej fill e pakëznej jo për të përgatitnej udhin priftit të ri, njëmos ngë kapirmi pse pas zbulimit të pakzimit të Jisuit, akoma Jani ng’ë i bindur se Jisui është mesia, ose profiti i ri. Par se t’ë therjin akoma Jani i dirgon thënë se do të dier ndose Jisui është ai që ka të vinjë.

Sot eksistojn akoma dishipujt e Janit. Vjen me thën se jo gjithë klen të bindur se Jisui ish Krishti. Jisui ka klën i famasur ka fjalët e rrepta të Janit kundër gjithë të mëkateruamit, sidomos kundër gravet. E që skandall i math ka qënë për Janin fakti se Jisui bashkofej me gra e me fajtoje . E që ju ka dukur fjala e Jisuit që vejt ture thën se drej ata kundër të cilët vejt ture predhikuar Jani do të kishin pasur mëpars të rregjër të qiellvet?”

5 të shën Mitrit 2006.

“*Intelligo ut credam*” është alibi për mos të kesh bënë. Pse, çë do të kapirish? Fea është substancje të shurbisevet çë shpresomi. E çë shpresomi? Shurbise çë nëng shihen. E shurbiset çë nëng shihen nëng jan fakte, ose shurbise çë mund t’jet se ndëlgohen. Sesi mund të kapirmi shurbiset çë shpresomi: i shpresomi “*e basta*”, me fenë. E pra kur kapirmi, çë kapirmi? Atë çë kemi besë se kapirmi, e kush e mban kët besë? Njetër besë.

Drejt kështu; pse pra thomi: “*credo ut intelligam*”. Ng’është ndëlgës pa besë, besa e ndelgimi jan gjithë një. Nga ndëlgës hinë ket një rrëfyem ket i cili vet ka domethënie. “*Intelligam*” hinë ket besa si një rrikatë (një “shantaxh”, si thon sqiptarët), si një marrje me dhunë besën, ka ana e arsyes e cila vet do të ket rregjëri ket shpirti njerzorë – po është ngamon arsya e cila na thot se mund të ndelgomi vet mbrënda besës, se mund të ndelgomi gjë vet ture besuar ket mejtet e arsyes. Po besa ng’është arsya, me arsyen mund t’jemi vet nihilistra. Për shurbiset e fesë dufet vet “*l’intelletto d’amore*” (“*nous*”, jo “*diánoia*”, thon Etrat lindorë) i cili është shurbès sipërnaturalë: është dashuri, jo besim racjonal, si thot Simone Weil.

Përsëritinj: Besa zë vend ket shkretëria e arsyes. Kur arsya dimonstron nihilismin qellin ket shkretëria e hapet nata e zezë e besës ket ulet Teresa de Lissieux afër atyrve ateistra, çë jan ateistra drejt pse besuan ket mejtet e arsyes. Thot S. Weil se me mejtet e arsyes kan ligjë ateistrat. Po S. Weil mbafet akoma ka ana e njëj arsye çë ng’j’arru akoma ket nihilismi. E nihilismi është produkt’i fundit të iluminizmit, të arsyes positive.

“*Intelligo ut credam*” vjen me thën se vet kur ndelgonj (*intelligo*) se ng’eksiston ndryshe se besa, ahirna vet mund të kem bes pa rezervë. Sot postmodernizmi dimonstronj se ka besa nëng kemi shpëtim. Se besa nevon ndihmjen e arsyes ose të intelektit sa të

ket fundim o përsosuri, është kakodoksi ellenike ose të arsyes perëndore...

8 të shën Mitrit 2006.

Ture cituar S. Sontang: “një shkrimtar ka t’jet katër vetë:

Një i lënë, “obsédé”

Një çot (një babllabà)

Një stilist

Një kritik

Lënsia më pëlqen t’jet gjë si “theja mania” e Platonit. Çotia do t’jet kuraji të vëfesh ket nj’udhë e re. Po, pra ç’u vure mb’udhë, ke të kesh shijen e stilistit (“le bon goût”) të mos të kurrivaresh me shijen e të tjervet e, për këtë, ke t’jesh kritik i mir, ose ke të kesh shumë urtësi.

S.Sontag thot se:

Lënsia jep materjalin,

çotia e lë të dal jasht,

stilisti jep shijen,

kritiku urtësin.

Nani sa herë pam ndër shkrimet e arbëreshëvet vet çotì, pa lënsì, pa “bon goût”, e pa urtësi?

Çotì të vëna në urdhër drej si thot rregulla e gazetarvet, me pes W: *what, why, who, when, where*.

Si nga here, shkrimtarëvet arbëreshë i sosjin të ruajin rregullat; për kë i ruajin ng’i intereson mosnjeriu.

Shkrimet e arbëreshëvet jan shumë shpesh “*flatus vocis*”. E ngë jan asedhë ushtrime stili, pse, ndose ishin të tillë, do t’i jipjim kënaqësi, sa më pak, veshit.

11 të shën Mitrit 2006.

Nani që jan e arrëjin shkrimtarë ka Shqipëria që shkruajn litisht na vjen një zding i madh për gjithë Arbërinë e më e më për atë profesor ka Kosenxa që i hapjin derin ture dorkroqisur sikur se jan e j'arrëjin ndë mest neve mjeshtrit të cilëvet i kemi bëzonj.

Ng'i kemi zili për suksesin që do të ken.

Na ngë shkruami se të kemi sukses.

U, për shembull, shkruanjë për një lulëzim i mbrëndshëm, me të cilin ruanj sesi kleva i piksur e ka cila gluhë jam i folur. Bënj kundet me historin time tekun kle një mot ket i cili ngë dinj'e fjisnja litisht: gjeshinj me arbërishtjen mishin tim e vrenj me të cilat noerë gjykonj botën. Gjufa i përket "*Lebenswelt*"-it, e kemi kalosh si kemi lëkurën, sesi mund t'e shqepemi ka vetëhea jonë, po që me t'vremi botën dhe e krijomi...

Pra qindron ngamon problemi: "*Qui m'y (Firmozë) a mis? Par l'ordre et la conduit de ce lieu et ce temps a-t-il été destiné à moi?*" (Pascal: *Pensées*. Bunschvicg, 205)

U, Firmozë? E qetësia e madhe e përgjegjes më dredh trutë e zëmrin. Edhë ket një llok i tillë hapet "*l'infinie immensité des espaces que j'ignore et qui m'ignore, je m'effrai et m'étonne de me voir ici plutôt que là*" (ibidem) Firmozë më mirë se Port-Royal-des-Champs...mejtonj magjepsjen e ndonjëj "*mauvais démiurge*" që më qellin dhunë për kush'e di kë...: ...ka për të dalësh i lën...

15 të shën Mitrit 2006.

Sot Zefi më tha se mbllin rivisten. Ng'e di ndose jam kutjend o jo. Mund t'jet se Zefi u bë i bindur se kem' të sosmi "l'accanimento terapeutico" për këtë mëmë e pesqind vjeç e moçme, e cila ka ca mot që ka rahallin.

Mund t'jet se jam i gëzuar pse nanë mund t'i kushtonj motin, që bier ture i vat prapa kësaj çotije pa domethënie (ngamon ndose eksiston gjë ket gjell'e njeriut që ka domethënie) që është të shkruarit arbërisht, pindaksisë, që ka shumë mot që e le më një anë. Ka shumë mot që Elena, e bukura bil'e miqjve time, më lipi një ritrat. Mund t'jet se nanë mund t'e kutëndonj.

Vjen zdingu për ngagjë, po motin që na dha i ligu demjurg, te një menirë kem t'e shkomi.

I kam zili këtirve kuj i ngau entuzjazmi, për gjithë pordharet e tyrve. Po entuzjazmi është si kuraxhi: o e ke, ose mos njeri mund të t'e japë.

Për ngushëllim thom se entuzjazmi i ngau atyrve më volgare e sidomos putigelëvet, ose gjithë miqëvet e berluskonit. Xura se në Shqipëri shija e ligë e berluskonit ka shumë sukses; ka jetr'anë entuzjazmi me të cilin vijin në Itali shqiptarët është vërtetimi i këtij fati të mirë.

Kur entuzjazmi i të tjeret më mundin, o vet'e djovasinj një faqe të Sgalambro, ose të Rensi, ose të Leopardit, o ulem përpara televizionit e vrenj një kasë të ku Carmelo Bene i hjidet gjithëve qaqarunëvet (llafazanëvet, si thon shqiptarët), rrufjanëvet e shtypjes që ka përpara. Carmelo Bene më ndërse: sa llafazanë, sa rrufjane kemi në Arbëri mbi të cilëvet mund të vëllësh?

Entuzjazmi është mjeshtëri i ligë, i jep dorin demjurgut të ligë e bën e i bëhemi shërbëtor e kësaj botje, bën e harromi se mund t'jet gjë më mir për të cilin vlen dënimi të shkomi dhunin e gjelles.

Entuzjazmi bën e harron, turë vën më paqë ndërgegjëjen, dhëmbjen, irracjonalizmin, lënsin e vepravet tona. Entuzjazmi bën e mejton se gjithsej vete mir se ka arsye ket veprat tona e se mbatan na presjin "magnifiche sorti e progressive". "T'avanza, t'avanza/ divino straniero"... këndonej një prift skencjat entusjast. Entusjast sesi skencjati Odifreddi.

Pak dëmë, ndose ndodhet.

Pak dëmë, ndose të ndryshme skencjate thon se këtu e pak vjet, dyzet, ëh o jo, do të zdorrokopsmi (daft Ynë Zot) botin; do të qindroni pa ujë për me pirë, pa pishqë ndë detit, pa akull ndër malet, pa peme për me ngrën; e gjithë kët për entuzjazmin e skenzjetravet. Entuzjazmi na çikarin, na qëllon... sa jan entuzjamërat në Arbëri...

Një shkrimtar pak i gjegjur n'Itali – pse edhë këtu “la moneta cattiva scaccia la buona”, pse shkomi motin me shkrimtar katër soldesh – Ceronetti shkruajti se i njëjti mestjer njerëzor është dhëmbja. Një frazë e tillë ngë mund t’jet ngushullimi. Po u e marr për ngushullim, pse kapirta se i njëjti ngushullim është t’jesh pa ngushullim...

E pra “*noblesse obligë*” edhë këtù....

16 – 17- 18 – 19... të shën Mitrit 2006

(.....
.....)

25 të shën Mitrit 2006.

Sot Zefi më tha: vazhdò e shkruaj arbërisht pse ngë mbllinj Mondo Albanese. Thot se ja sugjeroj Bellushi ka S. Vasili... “e già”...

U pata mot, ndërsa harronja arbërishtjen, të pindiksnja Elenin. E cila erdh e pozarti me paçenxë e më duket se bëra një vizatim të dalur.

E putha Lenin, ture e haristisur pse më dha një ndodhje të mirrënja njetër her llapsin ndër duar. Për së drejti vizatonj nga dita. Po e bënj te një “Moleskine” për vizatime që qellinj ngamon me mua. Po një kund është të vizatosh te një flet e vogël, njetër te një 50 x 70, ose më të madhe.

Vizatim'i Lenis është një ishlë armonije te ku prënj disarmonin te ku gjellonj nga dita...

Po e të sosinj, për nanì...

Do të zdropem Perugia e Romë për disà dita. Do të vete t'jap shtitje te ku do të harrofem për orë e orë.... mejtimi yoga më i bukur....

25 – 26 – 27 – të shën Mitrit

Shumë shëtítja.

Ndër dherat e vjeshtës pramenda mekanike priarjin boten. Ndër argomat zdyphen korbëra, pëllumba, qithére e pulëbardha që vijin ka kush'e di cili det. Cimbisjin gjithë me pangosuri... është kjo gjella e sidomos “pronoia” e Tënë Zoti: të hashë e t'jesh i ngrën....

(.....
.....)

28 të shën Mitrit 2006

•

Sot plotsova tridhjet vjeç si Mjeshtë Yoda.

Sot kremtova ditëlindjen e Sw. Deva Ravidàs (ëmëri im si mjeshtë Yoda-s). Ngë di që mësova. Ngë di që xura. Kërkova të xënja të harronja shumë shurbise.

Ki duket se është, kundër vesin e përgjithëshëm, i njëjti mësim: të xësh të harrosh sa xure, të xëshë padijturin...

Mjeshtri imë Osho, ose bhagwan Shree Rajneesh (filosofrat të urt i qeshjin) më dha këtë mësim: “*Take it easy*”, *futtitinni*, mos u mbjak, mos u llavë; e kur do të përpjekësh sw. Deva Ravidàs-in vrite”.

Vjen me thën se Sw. Deva Ravidàs-in ng'e përpoqa akoma, njëmos pse gjelloj për tridhjet vjeç?

.....
.....
mund t’jet se le draprin e vajta për karkalece, mund t’jet se bora qet e vajta ture kërkuar britë, se bora dhin e i vajta prapa erës, se le pramendin e u prora prap, se le diskursin pjot sens e i vajta prapa pirdhuçkarivet, se le grurin e i vajta prapa modhullis, se le gëlpërin e u bora prapa prëralles. Doksë past Ynë Zotë. Qoft e bën vllundatëza e Tij..... e doksë past Osho, faregjëu.

“I xathur e i xheshur bashkofem me gjindjen stolit jan të shqerra e pjot pjëf e u jam pjot lumëri.

Nën perdoronjë magji për të ngjatin jetën Nani përpara mua arvuret të vdekur rëngjallen...”.

– nga: *Kakuan: Then Bulls.*)

29 të shën Mitrit 2006.

Një dhurat:

“cimbis me një gilpër nj’anë e formës tënde pjot mjalëth e hirë me hollësi ket cëmbisja” (nga: *Centering, from Zen Flesh, Zen Bones, by P. Reps*).

Thot Ravidàs-i: “Po mos duaj të cimbisesh. Kush është çë cimbin? E çë cimbin kur cimbin? Mos të duash. Vullneti është ngamon shurbesi më i lig, celebron egocentrisme. Lëju, lënëria është shurbesi më i mirë. Lëju: njize o vonë gjë do të sponjë e mjalët do të dal, ndose e ke përmbrenda. E do të haristisish cimbën”.

(.....
.....
.....
.....
.....
.....)

.....)

1 të shën Mirtirit 2006.

Perugia më pret si më priti dyzetedhjetë vjeç prap, kur isha djalosh e kisha ardhur këtù të këndonja me korin e Grottaferratas, me një tëtim i madhë sa asedhë “bora” e Triestes. Po kjò vorë që fryn më pastron qiellin ture e lën ket një kalthëri e kulluar që më kujton disà kalthëri e qiellëvet të Raffaello Perugino e, më e më, të Botticellit e të Di Credit. Ngrëfem njëhere menatet sa të shoh ngjyret e ndrìçullis e paesaxhin tekù kodhrat pjot ulla një nxijin e ngasjin qiellin me çukat e qiparisevet.

Ëh: jan paesaxhet e piktorevet që bekuan me pikpamjen e tyreve këtë botë shëjtrash.

Me korin e Grottaferrata këndova ket klisja e Shën Pjetrit, ç’është te kopshti botanik i Universitetit të Agraria.

Këndionja, ahirna, e ngë më dilë të ngrofsha.

Sot, i njëjti tëtim, që na shtie jasht ka kopshti tekù doj’ të ispecjonarjim barërat ç’ishin te mesjeta jatrit’ e këlllogjërvet benedektinëra që akoma sot mbajin klishin.

Pas dyzetedhjetë vjeç, njoh sa mënxitë lloket, sidomos brëndësin e klishtës: mëzi/mëzi korin, aqë sa dyshonj se kleva kurrë këtù. Mund t’jet se e ëndrra. Po pra i afirohem njëj kuadri të Sassoferato (G.B. Salvi), një Lajmërim, e thomë: “Ng’e ëndrra, njota prova”. Po kisha nj’etër kujtim që mund të më bënej martiri se ng’e kisha ëndrrur atë vizitë të dyzetedhjetë vjeç prapa: një kuadër i vogël i Raffaello te sakristia. Po sesi mund të hijim te ai llok që zakonisht është ngamon i ndaluar të huajvet, sidomos turistravet? Më ndifin rasti se është e shkon një kallogjër. I afërsohem e i lipin ndose kjò është klisja e shën Pjetrit. Më thot se ëh.

“Po këtë, te sakristia është një kuadrush i Raffellos?”

“Ëh” më përgjegjet.

Ahirna i thom se kur isha djolosh kisha kënduar grekisht me korin e Grottaferrata ket kjò klishë. Ture marrëdhën fjalë adunarem se këllogjëri është spanjole. Ngë bier rastin t’i thom se “La prometida de mi hijo es española de Murcia”. Kështu zëmi fill e fjasmi spanjole e zë rastin t’i lipinj ndose na burthom Raffaello. I gëzuar na kënaqin.

Raffaello është nanë martria më e sigurt se ngë ëndrra Perugia.

Për disa vepra ka klisha e Shën Pjetrit është një musé e historisë artistike e Italisë, ture vatë ka Perugino e ture shkuar ka Raffaello njera Reni e Guercino. Artista të mbdenjë. Ngë kan, jasht ka mëkatja e ka pak respekti, me nder, dosarit që shifen ket klishat e litinjëvet: atò shtatula xhesi (të allçi, si thon shqiptarët) të Santa Rita, ose Santa Teresa, e madhja e e vogëla, ose të Padre Pio që të vën më zëmër një angëth i math. Po ki është njetër diskut që do j bënur Shëmitriotëvet: po mund frymi miqë të lidhur “onorevole”-vet?

Dal ka klisha me lotë njomësije ndër syë e, ture dal, kujdhesem se ngë mejtonj një tropar i Shën Pjetrit e më vjen nzé vet “Oj ton Apostolon protothrone”, ç’është por tropari edhe i S.Palit. Vete ture murmurjasur këtë tropar me pakënaqësin e sime shoqe (litire). Kush e di që këndova dzytedhjetë vjeç prap...

Vet tëtimi më zgjon ka syndroma e Stendhalit.

*** **

Përpara “La Maestà” të Cimabue me atë ritrat të Shën Frangjiskut që duket i marr tëtimi, kështu i likësht, po me lumësin e shëjtravet ndër syë, me atë çikje buzqeshje që duket se do t’i lipinj ndlesë të tjervet t’i jap mërzi me paraqënëjen, me pranin, e tij (paraqënëje, pranë, të njëj çiltësije që skoncertain gjithë siguriment tanë); përpara “La Maestà” të Cimabue ng’jam

fare i sigurt se Giotto “*la fama di lui oscura*”. Mund t’jet se vjersh’i Dante “*ed ora ha Giotto il grido*” vjen me thën :”*la moda ora impone Giotto*”. Tek ki gjykim mund t’jet se më ndifin sensibiliteti im bixantin, po edhë ndjemja ime “moderne” ç’u edukoj me Van Gog, Gauguin, Modigliani, Chagal, Matisse që kirkuan të vejin mbatan mashtrimet e syut... (më vjen nzé një llokë të Cacciari: “*L’icona libera da ogni mimesi illusionistica: dall’illusione che reale sia soltanto l’immagine retinica elaborata dalla mente*” (*Della cosa ultima*. Fjeta 474).

Sigurisht Giotto ish’e piksnej njetër pikpamje, ish’e bënej se të hinej arta ket njetër moshë, po Cimabue është jasht motit. Këtù vë kufi se jam e mejtonj, mund t’jet, kundër pikpamjes sime, kunder asaj pikpamje që shpreha ket libri im jo i botuar, “L’Attonito, l’Angelo, la Terra”, teku fjas të nevojës të mos banomi ngamon një llok po t’i vemi prapa “shpirtit” që ngamon fryn e na qellin ku do aì. Giotto ish’e dilë ka shpi’e Cimabue, ish’e piksnej një djalekt të rì, ish’e dilë ka gramatika e stabilizuar ka piktura bixantine (bën shumë gabime, Giotto, te pikpamja e profesorvet), po sa më të ruanej larta, ruajti posht (edhë kjo është një pikpamje e sugjeruar ka “shpirti”): “*O curvae in terris animae et caelestium inanes*” (*Persius, Satira II*). Ture ruajtur Cimabue qindronj i babartur: mund t’jet se gjufa ime vate shumë e shpejtë. Po edhë ki është mashtrim shpirti, i cili ngë bën e rrimi fare të sigurtë te pozicjonat tona. Aì na ngatarren nga herë e bën të rreme gjithë të vërtetat tona. Ndose na ishim konsubstancjale me Shpirtin, ose me e Vërtetjen, nëngë do të kishim nevojë t’e kirkojim, do të banojim më paqë në njerën, ose ne të tjetrën. Po na kërkomi e për kët fat jeminga mon të babartur. Është kush thot se Historia është historia e gabimevet tanë. Mund t’jet se u gabova djè me Giotto, mund t’jet se gabofem sot me Cimabue.

Diskursi që më duket më i drejtë është se Cimabue e Giotto ngë mund të masen njeri me të tjetrin: përpiqen jeta të pamasme, i njëri qielli, i tjetri bota...

Vet një historicizëm naiv mund të mëjtonjë se Giotto vate më “përpara” se Cimabue. Vet një historicizëm naiv mund mëjtonjë se historia është një vijë që na qellin ngamon përpara drejt “le magnifiche sorti e progressive”. Po ka ki historicizëm mëjtimi u shpëtua. Ng’është filozofi serioze që mund të mbështetonjë se historia ka një drejtim të sigurtë. Na jemi ngamon të shkretëria. Ture ecur (ἄλη θεία). E kur thom se zografet tanë kan të daljin ka kopjat, ka riprodhimet e pindaksivet “bixantine”, dua të thom vet se kan të dalijin ka lloket që na bëjin të përtesur: gjella maset me mortjen (vrë: *Simmel*).

*** **

Assisi qindroj si ish aq vitra prap. Vrenj ka shesh’i basilikës shpëtë që bashkohen ket bregu, nga një me perspektiven e saj. Gurë që nguqëjin të butë si të bekuarë ka një agim, ose zbardhjin, si kur se një shi do t’i kish larë ka të hinjët e motit. Gurë të moçmë që kan parë prrallen e shën Frangjiskut, ose kan gjegjur me vesh të magjepsur të prasmin diskur e tij pa fjalë kur përpara zonjavet e Shën Damjanit, ç’e lutjin t’i fjitë (për të prasmin herë), i sëmur si ish, sa më të hapnej grykin, ture bën një rreth me prushin njëj zjarri që kishin dhezur furizët me degat e ullinjët, ç’ish e putojin, ture kapërcier te mesi, ture shtun hi sipër kryet, zu fill e luajti.

Ruanjë këto shpi që burthojin gurtë si shpia te ku u leva, ka një breg edhë u, ç’i gjet bregut të Assisi, e i thom tim kushiriri, Ndreut, që më suall me maknin e tij njera këtù: “Pse u lem Firmozë?”.

“Sa të harepshe me gjithë kët bukuri. Nd’u kishe ler këtù mëngu adunarshe se ishe ket barku e Tënë Zoti”.

Vrenj panoramin rreth rreth: “ Pse te kufiri ng’është deti si ka na?”

“ Njetër herë, thot Ndreu. Nëmos sesi mund të deshironje detin. E pra çë ke t’ë bëshë detin ne gjithë këta ullinjë? Vre sa ngjyre ndër këtë dhera”.

Një llak’e madhe hapet përposh Assisit, me dhera të gjelbër, të verdhë, të kuqë, botëgjinë. Këtù e këtjè rrotulla bari të thatë. Më tutjè argoma, vjen me thën se është’e ja arrën dimri e se dheu do të pres palacin e borës sa të mbrohet ka tëtimi.

*** **

Kan shumë këlllogjere të rinjë. Jan gjithë të rrethuar ka vasharele, fllokëverdhe rrushkullore, me kërtizin të zbuluar. Diskutojin e qeshjin. Gëzimi françeskan?

I qasem (ngamon me kundrastimin e sime shoqe e cila trëmbet se do t’jem i shajtur) njëj këtire çë më duket më (ën)gjeli. Ka një mjekër t’i pari leshi, të kuqë, dy syë aq të kaltër sa duket i verbër, i ultë shtati, e i likësht, me kokzat të gërnuame – një Frangjisk, te fundi. Po është i veshur i zì ndersa njetër frangjiskan e pret i veshur i hinjët ose te ngjyr’i botëgjinës. Thot se është konventual e se konventualet jan dreqë të biltë e S. Frangjiskut. “E të tjerët, atà çë dogjëtit ket kaminet, ng’ishin të mirë? atà ç’i vejin prapa Jakinit ka Fiore si ishin?”

Këlllogjëri më ruan e qeshin, ture vën një glisht ket kolleti i këmishës “jeans”, ç’i del ka stolia françeskane. Po i shtonjë: “Te mosha ime, ish mëkat të bashkofshe me gra, sidomos kështù të rea e të bukura çë duken ëngjëlit e Benozzo Gozzoli, aq jan rrushkullore”.

E i rrufienj si kur drejt në Assisi këlllogjëri, çë ish drejturi im, bën’e bora njurandin, paftesen time.

Kisha dal drejtë ka basilika më e ultë e i marr si isha ka pindaksit çë kisha par, kisha një fytyrë e lumtë si pak herë – po

çë jam e isha ngamon çeravrëjtur. Isha i harepsur se kisha par shurbise çë ngë do të kisha kurrë ëndrrur të shinja Firmozë.

M'u qas drejtori e më tha: "Tij të hiti djalli më zëmër".

Qindrova i ndaluar pse ngë pandefnaj çë kisha bën kështu të keqë sa të meritonja t'isha i shtun ket pisa.

Ajò fjalë më thartoj gjithë ditën e ka do përpiqnja drejtorin kish prirnja gjetkë sytë sa mos të pirpiqnja të tijt çë më ruajin të rreptë.

Pas darkës, ndërsa ish'e bridhjim me shokët e korit, dejtori m'u qas popà ture m'u kanosur: "Mos të kacikaresh nesermenat të vi' të bësh kungimin".

"Pse? çë bëra?"

M'u përgjegjë ture më dhën një shkupull te shiri: "Ti e di çë bëre. E mos ki arkancje, se djalli të hin angora më mbrënda. Më kapirte? Ke djallin më zëmër".

U vura ket një angonë e u vura e qajta, e për zëmërim i jipnja grushte murit. Një ndër shokët m'u qasë e më piejti pse qana. I rrufiejta akundin.

"Aì e bën me gjithë kështu. Ti sonde kur të vemi të fjëmi, ec e batir ket stanzja e tij e thuaji se do të skomollisesh. Po mos i rrufiej çotarit e të rremavet e të shkatavet ç'i bëre shokëvet. Thuaji se ruajte me deshër një grua".

"Po u ng'e ruajta një grua. E pra çë vjen me thën se ruahjta një grua me deshër?..."

"Mos ji çot. Ti ec e thuaji: Dua të skomollisem se ruajta një grua me deshër. E kapirte? Me deshër, një mos, mos ec fare".

"Çë vjen me thën me deshër?"

"Ma ka dolle ti? Ka je del?"

E shoku zu fill e më spiegoji këtën e këtën të tjetër.

Kur të tjerët te albergu van nga një te oda e tij, u vajt'e troqisa ket stanxja e drejtorit. Pra ç'i skomollisa mëkatën çë nëngë kisha bën, më puthi ndër ball: "U e dinja se ti do të marrësh udhët e shënjëtëris. Ti je nj'ëngjil".

Çë ahirna u rrita. Xura si rufen grat me deshir e zura e i desha. Xura edhë cili është mëkati që kënaqisin gjithë prifrat e i vë më paqë me Perëndin.

Këllogjëri leshkuq e me sytë të kalthër ka Assisi, më bën një buzqeshje të gjerë: “ *E si abbiamo ridotto il Signore a un guardone, ad uno che non ha di meglio da fare che guardare dal buco della serratura*”.

Jan të njëtat fjalë që më tha një herë papàs Matrangolo.

“*Comunque sono belle queste ragazzine che le vengono appresso*”

“*E il Signore vide che tutto era buono... omnia munda mundis*” më përgjegjet këllogjëri që zdrypet poshta ka shesh’i basilikës me korteun e vashazvet që duken shkundabishte me bithët të shtringuara ket xhinsërat, të ftuara ka Frangjisku për kush e di cilin bisedim.

E më lë të vetëm: I lumtë ti, që për tij Ynë Zot pa se gjithësej ish’i mir: “laudato si’ mi Signore për gjithë bukurit e gravet.

Ndryshe mote.

Për së dreqti, djallin më zëmër ngë m’e kish vën mos ndonjë grua, që edhë kam vrejtur i çudhitur e me ndonjë dridhme zëmërje ket basilika e shënjtit, po pa mallixje (djallëri); djallin më zëmër që ahirna me vu këllogjëri drejtor i cili me çëravrëjturin e tij më nxuar ka paqja e Tënë Zoti, ka lehtësia e xigojt të tij. Njoha pra obsesjonat e prifravet që bën e u lirova ka gjithë sinagogat. Haristonj Tënë Zot se sot jam i xathët e i xheshur ka gjithë obsesjonat e klishës, aqë lindore sa perëndore. Haristonj Tënë Zot se ng’jam as me *Azione Cattolica*, as me *Comunione e liberazione* e *Opus Dei* e tëtj...

Jam i xheshur e i xathur e kush më njeh e di.

*** **

Një cikë më përposh se ket shesh'i shën Frangjiskut, është një i ri ç'i bie njëj filliari, njëj titaroti, ose flauti, i bën me dy dega shtogu, njeri më i trash ka del muzika, e jetri më i hollë i ngjitur më një llac, ka fundi i të cilit fryhet ajri. Me tri vëra ket fund'i degës më e trashë, i riu ë i mir të bë' të daljin gjithë notat. I riu është një pollak e më thot se titarotin e bëjin delart e malevet e Shklavonës. Pe shum strumente, sidomos te museum'i "Suqué" i Cannes, po ngë kisha par kurrë një shurbes i tillë që duket një gjë për inxhinjier e të tringëllit.

I japë dy euro e më tringëllisin disa muzika e filmevet e Fellini. Të lumtë ti, për të cillin Ynë Zot pà se gjithëseja tringëllisin.

*** **

Par se t'ikmi Ndreu më qellin ket nj'udhë dherash ka vremi njetër herë gjithë llakën e Assisi: "Si thot ajò poesì e Lorca, që më citon nga herë që vemi ka rrah'i Farnitës Firmozë?"

I magjepsur vëfem e recitonj: "*Oye, hijo mio, el silencio./ Es un silencio andulado,/ un silencio,/ donde resbalan valles y ecos/ y que inclina las frentes/ hacia el suelo*".

Qikarinj kryet sikur se jam e bënj një metani, si kur se jam përpara njëj proskinitari sypër të cilit paesaxhi është konza e Frangjiskut (sot kem të jemi të kenaqur me Padre Pio e me "le agenzie di viaggio"...).

Ime shoqe i vë petrosinin: "*Non potevi perdere l'occasione di esibirti...*"

3 të shën Mirtirit 2006

Sot është ditëlindja ime e e tim kushëri.

“Pensée échapée, je lë voulais écrire; j’écis, au lieu, quell’elle m’est échapée... en écrivant ma pensée, elle m’échappe quelquefois (...) ma faiblesse (...) car je ne tends qu’à connaître mon néant ... ” (Pascal: “Pensées” - kush e di cili).

Kisha shum mejtime për rastin e ditëlindjes; kush e di ku van.

Jan shum atà që thon se ng’jemi na që mejtomi, po jemi të “mejtuar”, e se na jemi vet nj’antenë që kapton mejtimet që “Shpirti” shprishin këtë e këtë, si një që duall e mbuall grur, e disà ra ndë mest gjëmbavet, ducà mbi gurtë, ca ket nget varia, ndocà ket dheu i tokasur e bifet e gjelbëron më dimër e lunzon më paraverë e i verdhë më theristì i dhuronet i paqëm draprit.

U kam bes se është kështu: ng’jemi na që mejtomi.

Herë e herë konsideronj të ku rrin ekuacionat par se një matematëk t’i zbulonj. Rrin ket matematëka, e ku ndose jo? Ësht një rast se i zbulon një matematëk më i mirë se njetër. Thomi se i zbulon një matematëk që ka antenin më të mirë (ose dheun më të tokasur) se jetri dhe mund kaptonjë ato ekuaciona që jan të vluara ket matematika. Po kush e trasmiton matematikën?

Jam e marr udhën e Platonit... po ng’jam i mir ... *“ma faiblesse”... “mon néant”...*

Mund t’jet se ditëlindja ngë meriton më se një *“pensée échapée”*. Pra e t’e marrë ki qiellë i kalthër, i pastruar ka vorea e ngrirë që nxuar gjithë retë e mjergullin ka orizonti...

4 të shën Mirtirit 2006.

Ng’jam një upri, një vegël, i mir për nga dorë. Kan dy o tre që mund të me përdorojin...

5 të shën Mirtirit 2006.

I thën më drejtë. Është “e Vërtetja” që bën të rremë gjithë mejtimit tanë. Të cilët mos ng’ishin të rremë e parçjale (e për këtë të rremë) do të vendofshin një herë për ngamon. “E Vërtetja” ka funksjonin të zdorrokopsinjë nga pretendim tanshit. Si thot një teolog ortodoks Florenskij: “E vërtetja ime ngë mund t’jet e vërtetja e Krishtit, pse Krishti është konsustanxjall t’e Vërtetjes, un jo”.

Pse ki monsinjor që përpjek sot Romë ka gjithë këto siguri? Dakord. Jam irracjonalist. Por vet ka ana e gnoseologjisë ose të metodologjisë pse mejtontjë se arsya ngë ka mundësi, ose është e papërshtatshme të spiegonjë realitetin që është pluraliste, konkretisht e qosme. E sidomos arsya ngë ka zotëri sipër domethënien e prasme të tij . Ka ana e metafisikës ngë di ndose realiteti ka domethënie ose është i tërë absurd. Ki diskurs nëng mohon se kemi vet arsyen sa të thomi atë që thomi, edhe se gjithë realiteti është pa arsye, po arsya është limti, kufiri ynë, jo mundsia jonë. Sa shurbise gjënden jasht ka kufinjët e arsyes? Jasht ka kufinjët e gjuhës e cila është mjet’i arsyes; dhe, thën më pikerisht, arsya është arsya e gjuhës jo të “realitetit”; një sillogjizmë është vet shurbes gjuhsor.

Kush tha se ng’jan fakte po vet interpretime, ng’ish një çot, ishë një pjot tru, sidomos i lënë. Lënsia e tij na siguron se jemi ket një’ëndërr me të cilën kem’ të bëmi kundet nga dita.

Krishti la thën: “Vet e Vërtetja ju bën të lirë”. U e interpretonj: “Vetëm ndose difshit cila është natyra e “e Vërtetavet” tuaja (ose: se jan të rreme) mund t’jini të lirë. Të lirë ka obsesjonat e t’ “e Vërtetës”, e cila “*Che ci sia ciascuno lo dice, dove sia nessun lo sa*”; ndër numeret, mund t’jet, të cilët kan natyrë tautologjije.

Ndose Këllogjeri drejtor kishë bën kundet me obsesjonat e tij, me interpretimet e tij, e kish pasur dyshimim se pikpamja e tij

mbi djallin që më kish hitur mbrënda, ngë mund t'ish “e Vërtetja”, sot do t'isha edhe u një prift. I rrethuar, mund t'jet, ka vajza fllokëverdhe rrushkullore... (kush e di me të cilin kënaqësi time ose të Perëndisë)

6- 7- 8 të shën Mirtirit 2006

Dita të bjerra...

11. Dita e shën Mirtirit 2006.

Ngrin, sot.

12 të shën Mirtirit 2006

Përkthenj si mundin: “*Hereherë prirej e ruanej me respekt atò dosarè mirsije që kish sthun ktje si lëng pjënsi, sesi një gjeneral mund të kish par një masakrë i ordhëruar për t'i jip kënaqësi njëj impersonalë oreksi i math gjaku*” (Fitzgerald – “*Tender is the night*”).

Sesà më përket...

15 të shën Mirtirit 2006.

Ka milëra vjeç që vemi prapa arsyes. Ka milëra vjeç që njohmi ligjet e ekonomisë, e të shtetit, e të politikës. Shkruajtim miliona libresh mbi nga një argument. Njohmi gënjimet e retorikës, dimi që është “*modus ponens*” e edhe “*modus tollens*”, njohmi *Barbara*, *Disamis*, *Camestres*, *Baralipton*, *Celarent*, që ng’jan njerëz që përpjek ket bari... e jemi më maskallcunëra të ngamon.

Kemi ekonomistra të mbdenjë e megjithatë bën'e vdesmi uri gjimësin e botës. Kemi çmime Nobel të kimikës e megjithatë farmakostim qielle, dhera, ujëra. Kur thon si thot Oddifredi se sosin t'i marrësh vesh arsyes për të gjellosh më mirë, çë do të thon? Pse gjithë këtë t'urtë nëngë ditin të na shpëtojin ka humbja? Alcibiadi gjellonej afër Sokratit, përkundraz, mājde, vej e fjëj me të, e megjithatë kle maskarau më i math i Athenës: çë mëson arsya ndose shtu Francezët të prisjin krye, shtu Stalinin e Hoxha të krijonej gulag, e klshëtarit të dhezjin kamine, e të mbjojin Romin ne aromin e mishit të pjekur të Giordano Bruno?

“Aberrazioni”, thot Oddifredi. E sesì mund t'jet se njerëz çë frekuentarjin arsyes mund “aberraren”?

“Vet një Perëndi mund të na shpëtonjë” thot Heidegger. Po njera nanì Perëndit vepruan vet sa të na verbërojin: “*ouk emoranen ho theos ten sophian tou kosmou toutou*”?

Mbë natyren e arsyes përsëritinjtë të djovasinj librat e Horkheimer e Adorno.

*** **

Përkthenj, ture ndrequr, ka përkthimi litisht i “Ehi, prof !” të Frank Mc Court.

“Ndose dinja gjë mbi Sigmund Freud e mbi Psikoanalisin do të mundja të gjënja rrënjin e gjithë halavet të gjelles sime ket djalaria ime firmoçkanje çë më nxuar nga një autovlerësim e më bëri bisbetik e pa respjekët për të “mbëdhenjë” sesì profesorë, peshkope (“*fuge episcopos*”) e tëtj... e më pengoj sa të lartësofsha ket shoqeria civile e sa të bëfsha i qosmë... e më shtu llargu ka gjithë, veç ka disà miqë...”

Sigmund Freud e njoh, njoh edhe Adler (çë më bën të bindur më se të tjerët psikoanalistra) e Jung e Lacan e djovasa edhe Reich e Hillman, e Musatti (*Trattato di psicoanalisi*) e Borgna e

Carotenuto, po lëmsh'i gjelles sime nëng zgatarrefet. Te fundi ka ligjë Erakliti: "*Psychês peirata iòn ouk àn ekseúroio pãsan epiporeuómenos hodón: outo bathùn lógon échei – sa më do të veshë ture ngar gjithë udhët, kufiret e shpirti s'do t'i gjëshë, aqë i thellë është bisedimi ç'e përket*" (Diano, 51).

I kam, por, më bes Platonit i cili thot se te "*Fusha e E Vërtetjes*" zgjedhim një fat më par se të lefshim, pse vet kështu mund spjegofen disà marrje pozicionëve çë më pengojin të bënj këtë e atë. Është gjë e rrënjët çë më rrëjirin të vete ka ven të tjerët - nëngë dua të skondapsinj demonin e Sokratit...

Kush e di cilin fat jam e zbritinj, jam e paguanj. Joyce thot se ket Leopold Bloom i tij u rimishëruar Uliksi, i cili zgjedh njeriun më të zakonshëm. Ket u kush e di kush u ringjall. U me një cik mendjemadhësi mejtonj se u ka rimishëruar Sokrati i cili vërteta nani di çë vjen me thën mos të dish gjë e mos të kesh kifari me E Vërtetjen... e mund të bënj, te fundi, çotin...

*** **

Xura se një herë Editori ka Ungra, ai i madhi, i tha Frangjiskut të Pëllumbit: "Ma ti ngë do t'e shkruash një libër?" E ai ju pëergjegjë: "Ma ti çë më more, për piçuç?"

16 të shën Mirtirit 2006.

Sot moti është i sëmur. Ka dritësoria vrenj dhera të rrethuar ka një dushk pjotë ngjyret e vjeshtës. Edhe mështeknet (si thon shqiptarët / betulla) e pjoket e kopshtit çë rrethojin shpin time nguqtin fjetat. Sot te qiteti tek u banonj, eca ture stipur fjetat e thajtura. Ai rrëkim çë më bashkonej nga hap më vënej një malinkoni tëmadhe. Është e bie nani shi hollë hollë. Ditë mejtimi sot...

Mjeshtri Osho njëherë më dirgoj e tha: "Ec ka je vete, pse je vete drejt ka ke të vesh". E më thoj nga herë: "*Take it easy*".

Kështu sot përsëritin të njëjtin ves: djovasinj. Po par se të djovasinj ulem me bithët për trualli, dhezinj stereon e bën e tringëllisin muzika e *Cavalleria Rusticana*. Ngë ka muzik që më losin më shum, veçanërisht ndose kam kujdhës të pi një qelqëth të “*Passule*”, ç’është një “*passito*” ka Çirò.

17 të shën Mirtirit 2006

Ka ligjë Rensi, i cili është një filosof pak i njohur pse kultura italiane kle e kolonizuar ka Croce e bilët e tij ka një anë e ka Gentile ka tjetra. Rensi ish filosof i absurdit e ish kundër idealizmit të Croce e sidomos të Gentile; filozof i absurdi po që nëng mejtoj kurrë si Camus: “*Il n’y a qu’un problème philosophique vraiment sérieux: c’est le suicide. Juger que la vie vaut ou ne vaut pas la peine d’être vécue, s’est répondre à la question fondamentale de la philosophie...*” (*Le mythe de Sisyphe*). Rensi merr udhët e shpirtërimin për të cilin vlen të gjelloshë.

Rensi thotë se ndose do të ndifesh shpirtëror bë kund të shkosh anamesa gjithë shurbisevet që ke më afër sikur të shkoshë anamesa atyreve e njëj lloku të huaj. E thuaj nga herë: ma që zakona kan te Hora e Arbëreshëvet, ose Firmozës? Si më ngasjin mua zakonat të çudhitura të cilit e të akcilit? Ku i qellin lënsia e tyre? Që kam kifari u me këtë? Ahirna do të ndifesh i huaj ndë mes “*tou kosmou toutou*”. Ahirna mund t’jet se do të mejtosh se eksiston njetër jetë e se ket kjo je i huaj.

Ka ligjë Rensi: bë ket provë e pra thuum sesà shurbise ndan me ata që të rrethojin...

“*Lathe biosas/ ti që gjellon fshefu*” / ose *gjello i fshehur..*

Gjellonj një gjelle paralele, ose asintotike, që ngë do të ngas, të përpjek kurrë gjellen e të tjerëvet. Bënj ojsë më përket bota politike po prandanj marr mejtimet e Sgalambro te “*Dell’indifferenza in materia di società*”. E kjo huajnë ngë më

përket vet sot, po që kur u leva, mund t'jet. Pse shifem djalosh që venja ture u fëshefur e kërkonja të rrinja llargu ka të tjerët. Më tringëllisin akoma ndër vesh këndim'i monakes te asili kur vin' me të tjerët djalëra ture kënduar: "*La solitudine si deve fuggire/ si deve fuggire*". E u urritënja atë lozje të tjerëvet që ishin gjithë të lumtë të rrijin bashk.

Vet shëjtrat pra kish' të më sugjirojin: "*solitudo sola beatitudo*"/ ndë bithët monakes.

Ngë di ndose vërteta "*solitudo*" është një "*beatitudo*". Di vet se është karakteri im të rri i vetëm e t'jem i varesur ka gjithë shurbiset e të tjerëvet.

Mëmës mund t'i kisha thënë: "*Ti emoi kai soi gynai?*" - e mund t'e përsëritnja për gjithë këtë fjalë: "*Ti gar emoi kai hymin/ që kam kifari me ju?*"

Shkonj Firmozë i huaj, e gjithë të marrët e të dhënurit të firmozjotravet më duken lënsi, si domos të marrët e të dhënurit atyrve që kan të bëgaten, që do të kustonjë. Të dhënurit e të marrët e atyreve që kan të bëfen politikantra e ngë shohjin herën të jen të zgjedhur sindëk. T'atyrve ç'u pruartin ka Xhermania e nëng jan fare entusjaste si i përskruan C. Abate. Stistin, ture shtun likurin udhëvet, pëllese që nanì mos njeri banon: të biltë qindruan, entusjaste kundër të ndiemes së Abate, ku u len e të djersëvet të prindëvet ng'i mburton fare gjë. Te shpitë nanì është shkruajtur "Vendesì" e ngë gjëndet mosnjeri ç'i bjen.

Ndifsha i huaj edhé kur venja e kërkonja një cikë shoqeri ka papasi Matrangolo me të cilin, ndomos se fjisjim filosofije ose teologjije, ngë kishim fare gjë të ndajim. Pra aì ish shumë i marr ka veprat e kësaj jetë, i osesjonartur me kantieret që gjatë dyzetedhjetë vjeç nëngë blliti kurrë: e ndaloj vet mortja.

Ture shkruajtur këtë shenime vrenj për së llargu edhé fatin tim e më duket fati i njëj të tjetri: kush e di kush është ki i tillë që shkruan arbërisht për të fëshefet.

Më lefet ka kjò situatë vet ajo “*compation*” e buddhistravet, për vetëhenë time e të tjerëvet, po me kë mund t’ë ndanjë?

*** **

E se ndose i biri i tha s’jemës: “*Ti emoi kai soi gynai?*” /Çë kam kifari me tij grua?” sa më mund t’ë thomi na çë ng’i jemi fare te gjiria: “*Ti emoi kai soi gynai?*”. Po mos fjasmi kurrë të atyrve çë ngë paraqiten e çë ngë të përgjegjen kur i parkalesin edhe me lotët ndër sy.

*** **

Prëmë vajt’ë pe filmin “*Il regista di matrimonio*”. Mos ngë kish qën për atò dy gra çë recitojin, shum të bukura e çë të vën më paqë me gjellen, e për muzikën e Mascagni çë tringëllisin këtù e këtjè, e për paesaxhet e Cefalù, sa mot do të kisha bier. Të gjësh sot një film ç’ e vlen është vështir. Filmët e merikanëvet, varesjin. Filmët e italkanëvet jan pa undyrë.

Njetër rast për mos të dal ka shpia.

E gazetat? E thoj Leopardi e përsëritin Rensi: sesì mund të biermi mot me çotarit e motit. Vreni librat për me viell, pjetë përdhuçkari, e karari, e herdhari të Bruno Vespa... na rujnon Natalet nga vit...

Po këtu marr rastin e Bruno Vespa jo për të përsëritinj urtësit e Leopardi ose të Rensi. Përsëritinj atë çë thot teoria e informimit: Stypia nëng informon mbi faktet, po in/formon (vë më furmë) faktet. Është një pamundësi të informosh mbi faktet, të cilët, sa ninga i vren, hijin te pikëpamja jote, e pikëpamja jote i ndërron, i bën ndryshe ka atë çë jan.

Pikëpamja e Bruno Vespa e dimi cila ëshë: te librat e tij burthofet vet Bruno Vespa, nëng burthofen fakte.

*** **

Nëng shërofemi ka sëmundja e të shëromës e të shëndetjes. Sesi mund të shërohemi, e të kemi shëndet ndose vdesmi nga moment, nga çast. Shëroma e prasme është të shërohes ka nganjë pretëndim shëromje.

*** **

Nga menat përsëritinj kët visëndier: ruhem ket pasiqyri e nëng njifem. Ngjata mjekrën çë djë kisha shkurtuar; e gjatë, me leshët të gjatë, duket se më bën shumë barok; e shkurtur, me leshët të shkurtur, më bën keq klasik: i presë ndutu, aq leshët, sa mjekrën? E ajò fytyre pa mjekër, pa leshë, kështù pilikaçë, kështù lakuriqe (“ngë mund të paraqitesh kështu pilikaçë përpara Tënë Zoti, sidomos ndose je bixantin” – më tha një herë një ortodoksë kur isha pa mjekër e me leshët të shkurtur) kujit i gjet? Nandit? Helmit? të birit të Kaluqit? të birit e së bilës së Raçapës? Ose profesorit? ose piktorit? ose Ravidasit? ose të shoqit të Xhorxhës? ose të jatit të Nikolës e të Danielit? ose, ose, ose...

Sesà mashkare veshinj nga dita e cila është imja? Cila është e vërtetja ime? Një, mosnjeri, Njeqind milë...

Thot Hegël se persona është një sikursë juridike te ku mund dirgomi kartelen e taksëvet. E Russell thot se persona është një etiketë, një “griffe”, një griepshë, një patericë, tekù jan të varur stolitë më të ndrishme; një shkalandrun tekù jan të varur tiravole, kakavë, karroqe, fishele, halkoma, çë Firmozë ven përposhë ëmrit kolektivë “rrugënjë”.

“U” është një ëmër kolektivë – e për kët abstrakët: kur jem’e fjasmi për “unën” ngë dimi mbi kë jem’e fjasmi: “Un” është një shumicë çë ngë mund reduktofet ket “një” “U”.

Nani kush është “i njëjti” çë mban këtò fytyre si timet çë ngë njoh? E kush është ki çë gjykon se këto fytyre ng’jan të tijat?

Osho *Bhagwan Shree Rajneesh) thoj ngamon: mbaju si një qepë e jec ture nzier një sqepizë pas të tjetris, vrë çë të qindron. J'arrëmi te faregjëja, te një llok çë ngë kemi si të mejtoni, e për kë ngë kemi fjalë sa t'e thomi.

Mund t'jet se këtë jemi të gjashëm të Perëndisë, ikonëza e Tij. Jasht ka energjitë e Tija – si thot Palamas – Perëndia është “*epekeina tes ousias*”, është një “gjë” çë ngë ka thënë e domethënë, “*ahorestos*”, “*áfrastos*”, “*aperatos*” - e ture vazhduar me gjithë ato “a” privative....

Edhë na jasht ka “energjitë”, jasht ka kontinxhenzat, jasht ka mashkaret çë veshmi e xheshmi, nga çast e nga rast, jasht ka sikursë-t tanë ngë jemi fare gjë. Kështu fytyrat time çë më paraqiten nga menat ket pasiqyri, ngë më gjasjim, pse ngë kan si t'i gjasjin faregjësë sime.

Po ki është mejtim ikonoklastik, e pra çë “faregjëja” e Perëndis u mishërua e muar gjithë fytyrat çë kontinxhenxja i dhuroj, na ngë kemi si mos të mirpresmi gjithë fytyrat çë çasti e rasti na japjin. Me lodhje. Me gjithë të babarturin çë ki fat na lëshoj. Ture u bën i bindur se ngë kem' të marrmi mos njerin mashkare si jona për ngamon. Jemi një lojë të zakonës të kujtimit. E rrimi të zalistë përpara fytyrës sikursë t'jet jona.

“*Je est un autre*” (Rimbaud). Ngë dua të përsëritinj shurbise çë të tjerët than më mirë se u, rizikonj të masem me Rimbaud e ng'është surbes i lezë...

*** **

Ndose do t'ju ndodhet se do të gjëni ket shkrimet tim – jam'e i drejtohem atyre dy o tri lezues të cilëvet do t'i bien syt mbë atë çë vete ture shkruajtur për kotësiren time – gjë çë do t'ju duket i vështir, o i errët, mos bëni si papas Bellushi, këtë verë çë shkoj, Firmozë. Ndërsa doj të më llavderonej si shkrimtar i mirë e shum i urtë, tha se skrimet tim jan aq t'urtë se aì shpesh ng'i

kapirin e ka t'i djovasinj dy o tre herë sa t'i bier mb'udhë. Papas Bellushi la se të tjerët të kapirjin se u kam një marrdhënie, kush e di sa e thellë, me disà mistere të kulturës, sa herë e herë bëfem i errët.

Nani u ngë kam mos një marrëdhënie me misteret ose me thellësit e kulturës. Ng'jam si disà ka Ungra ç'e bëjin "apposta" t'jen të errët – kush e di që do t'i burthofen lesuezvet: për shembull, editori ka Ungra është ngamon i vështir, edhë kur dirgon një kartolin – po, e dimi, ai është stitik -.

Kur jam i errët vjen me thën se ngë dinja asedhë u që doj të thoja. Ahirna, parkalés' lezuezit të më lën të rri e të ven përpara...

Kotësira e ungërnjotëvet ngë ka të rrufier...

E mos njeri më pyeji që the këtë e që the këtë, që the djé o që the kockjë. Kam pak kujtim e pra që mburton që the djé? U kutëndofem se Shpirti më sugjeroj gjë, një intucjon me të cilin djé bëra kundet. Sot mund t'jet se ajo intucjon ngë vlen më, pse është një pikpamje parcjale – e si nga gjë ka të vdes (vré Anasimandrin). E pra Shpirti ngë do se të prëfemi mos gjikun – ngë do "eidola": *fori tribus, theatri...*

Djë mund t'jet se gjë që shkruajta e dijim vet u e Shpirti, që m'e sugjeroj, sot mund t'jet se ng'e kapirinj më atë që ai doj' të më sugjeronj. Vet Shpirti e di atë që doj' të thonja. E pra është një illuzjon, një gënjeme e madhë të mejtosh se fjalët mund të na paraqitjin gjellen kështu si është; është gënjeme e madhe të mejtoshë se, po që zoteromi dy o tri koncepte, mund të zoteromi realitetin...

Sidomos kur vëmi te qendri gjellen tënë: rrufihemi, e vëmi bashkë shurbise që u ndodhtin përsëdrejëti e surbise që ëndërtim e shurbise që deshirojim se të ndodhëshin. Jemi të rremë më vetëhenë tënë e ndërromi shpesh ëndrrat me realitetin (ngaherë se gjë si realiteti ndodhet, ose gjë si një realitet e njëjtë e ngave jasht ka milërat mashkare që veshmi). Na zoterom vet bindja se shurbiset van (jan) kështu e kështu, etëjt...

Atë çë thomi sot neser ka një tër domethënie e dislokaret (dis/vendohet?). Shpirti fryn kur do, ku do e ka do... e ng'është e vërtetë si thonej Descartes se Ynë Zot ngë mund të na gënjenj: “*Diatì en parabolis lalis aftis?...oti vlepontes u vlepusi ke akuontes uk akusin, udè sinius*”- “*Quare in parabolis loqueris eis?... quia videntes non vident et audientes non audiunt, neque intelligunt*” (Matt. 13,10).

21 të shën Mirtirit 2006.

“... *pantes hosoi perittoì gegonasin andres e katà philosophian e politikèn e poiesin e technas phainontai melagcholikoì ontes...* (...) *kai alloi de polloi ton eroon homoiopatheis phainonte toutois. Ton dè hysteron Empedokles kai Platon kai Sokrates kai heteroi sychnoi ton gnorimon, eti dè ton perì ten poiesin hoi pleistoì*” - “...*gjithë njerëzit të jashtzakonëm te aktiviteti filozofikë ose politikë, artistikë ose letrarë kan një natyrë melankolike... (...) shumë fatosa duket se patëtin syndroma si këtë. Ndër personaxhet të fundit Empediokli, Platoni, Sokrati, e shumë të tjetërt njerëz të famëshëm sesi edhe më të shumë midhis poetravet...* (Aristotele – Problemata 30).

Kam melankolin të madhe po s’iam as filozof, as politik (më ruajt Ynë Zot), as poet, as teknik, i mirë. Fati më dhà këtë keqësi të melankolisë po nëngë më dhà dhuratat e saj. Disà thon se je më par filozof, poet, e tjetj... e pra je malinkolikë. Mund t’jet: kur të ngasjin këtë talente syu të bëfët kështu i delirë sa ngë ke si mos të shihesh si i huaj ket kjò botë e ahirna lefet melankolia... (Po më lefet një pyetje: Pse ndose “*perì ten poiesin oi plestoì*” Zefi ng’është i ngar ka melankolia? Or qeshja e tij fëshefin një malinkoli pa kufir? – U kam besë se më i malinguari i njerëzvet është Zefi...)

U ngë pata mosnjë ndër këtë talente me të cilët mund të kisha fjandasur njetër botë, mund të kisha paraqitur një jatrë me të cilin mund të kisha lemuar humorin e zì...

Te familja ime thon se humorin e zì neve na e dha mbiëmëri, Helmi: “Jemi helmaraqëra” më thoj një cie, çë ish fort e sëmur me depresjonin.

“Na jemi Helmërat”, thoj, “e fat’i zì është yni”.

Njetër filozof më paraqirtin njetër fat çë mungon merin e tij.

Sinesi – të cilit nanë nëng më ndodhet libri grekisht – e ngë kam ngë të vete t’ë kirkonj ket përzim’i bibliotekës sime, ket librat jan të kumbisur në rast – Sinesi – çë nanë ngë kam si të citonj – Sinesi thot se atà çë buartin leshtë, sidomos ket çuk’e kreut, jan shumë të urtë, e jan prrëzë qiellit. Njetër i urtë i sotëm thot se qirka çë kishin një herë priftrat litinjë ishë shenj’i takimit tyre me qiellin.

Edhë për ket akund jam jasht ka domethënia e këtyrve t’urtrave: bora leshtë sidomos ket çuka e kryet po ngë jam fare i urtë e ngë ndifem në takim me qiellin.

Po më lefet njetër pyetje: pse t’urtit ka Ungra ngë buartin një fillë leshi? O jan t’urtë po ngë kan mosnjë takim me qiellin? E ndose ngë kan një takim me qiellin çë t’urtra jan e çë poetra jan?

*** **

Te varr’i Krishtit ëngjëli shkruajti pa shkruajtur: “Ouk esti odhe” – ng’ë këtë.

Ket varr’i S. Pjetrit është shkruajtur: “Petros éni” – Pjetri ë këtë.

Kush i vete prapa Krishtit ngë do të ket një gur..., kush i vete prapa Pjetrit e ka një gur... e më se një gur...

Më duket e njëjta situat e Krishtit kur shkruan mbi shurës, ndërsà Moiseu shkruan ket guri...

Fjalën e Krishtit Shpirti e tundin. Gur'i Moiseut nguret e ngurin e mos një shpirt mund t'ë tundinjë...

24 të shën Mirtirit 2006

Mbarova të djovasnja “*Non Essere Dio*”, një autobiografi të Gianni Vattimo. E gjeta për rast ket “*La Claudiana*”, e si gjithë librat, që më vu përposh syvet rasti, më ngau për mbrënda.

Një filozof thot se faregjë vjen për rast; sidomos për atë që përket librat, thot se është shpirti që t'i dërgon. Kam të thom se gjithë librat që djovasa i gjeta ket ndonjë librari te momenti i drejtë, kur drejt kisha nevojë se kish' t'i djovasnja. Thom edhe u se shpirti m'i vu përpara syvet.

Edhë këtë të Vattimo, këtë Autobiografi, që vjen e mbllin (ose hapin) një bisedim të gjatë që pata me këtë filozof.

Më vjen një mallngim i madhë ture e djovasur, pse vrenj se me Vattimo ndanjë jo vet mejtimet po edhe shumë fakte të gjelles, aq sa, ndose mund të marr këtë lëje, biografia e tij më duket imja.

Të dy kemi rrënjë në Kalabri, të dy iktim ka atëdheu (e ikja ka atëdheu më duket se të bën jo dogmatik, jo idhentitarë, po relativist). Të dy qindruam pa atë kur ishim të vegjil. Të dy jemi bijë të “mos njeriu”, “parvenu”. Për të dy Torino kle lloku i formacionës kulturore, ndomos se u kisha prapa krafëvet Grattaferratin, Romën e Palermin tek u kish zën sëmundja ime për librat.

U njoha librat e Vattimo kur kisha tash djovasur gjithë auktore, gjithë filosofrat që gjënj cituar ket kjo autobiografi: Ka Platoni, Aristoteli, Plotini njera Nietzsche, Heidegger, Lyotard, Wittgenstein, Kuhn (me Lakatos, e Feierabend), Rorty, e Dewey (këtë auktor e kisha njohur kur isha akoma te Liceu, më shpiti tim kushëriri Antonio Barletta, i cili ish'ë laurearej në pedagogji Salerno, drejt me një tesis mbë Dewey, e më djovasnej lloke e

këtij filozofi që ahirna vej si më i miri - e me të Papini, që pra kish' të shanja).

Kisha edhe tash djovasur Cacciari, që Vattimo thot se ng'ë kapirin: "*Massimo – gli dico – ti amo moltissimo, ma non capisco niente di quello che scrivi*"... "*Cacciari che razza di posizione ha? E chi lo sa?*" (fjeta 142/ 143).

Ketà konsideraciona më babarjin, pse ngë doj' t'i gjegjënja ka një filozof i "*mejtimit të dobët*". Pse Vattimo do të dier gjithëshorçit, gjithëqish? Pse do të zoteronjë situatën? Pse ngë ndalet një hapë më par se t'i lefet pyejtja, ose pse ngë vete një hapë më tutjë, ket pyetja mbaron?

Një filozof është një filozof ; e sesi i tillë ai lefet ket lefen pyejtat...

Ndose mund marr njetër herë lëje, u pretendonj t'e kapirinj Cacciarin.

Libra si "*Arcipelago*", si "*Icone della Legge*", si "*Dell'inizio*", "*Della cosa ultima*", ngë m'u duktin kaq të vështir. Kam të thom se edhe u pata vështirsi kur djovasa "*Krisis*", ose "*Dallo Steinhof*" e "*L'Angelo necessario*", po të tjerët përsëritinj t'i djovasinj me shumë kënaqësi. E më duket se filozofia e Cacciari-t është një këndim i e qënës, jo një konceptualizacion e saj - sa më pak një konceptualizacion klasike – "*Krisis*" deklaroi krisin e arsyes klasike, e arsyes dialektike (e hegelizmit e të marksizmit), e lirinë ka skemet totalitare të njohësisë e përgjithëshme – të historicizimit.

Më duket se Cacciari vëfet ket një situatë ket e cila gjegjen vet ehoat e e qënës, eho jo të determinuara. Kështu lefet një ëndërr, një poesi, një dëshir, mbrënda një "*epektasis*", një "*Sehnsucht*", tekun vet mund t'i vemi prapa aromës së e qënës pa ja arrurë kurrë. Mund t'jet një mejtimit më i dobët se ai i Cacciari-t? Te Cacciari filozofia bëfet muzikë, larmi stili e gjuhësije e shprehëje – një perkthim stilistik i "*einai pollakos legetai*".

Kan fjeta ket “*Della cosa ultima*” si atò të “*Insulae*”, si “*Parádeisos*”, “*Hesychía*”, te ku “*nous*”-i “intellekti i dashurisë” ruan me një bisht syu “*dianoja*”-n e të qelljin ndër lloke te ku mos një konceptualizacjon mban... nga mejtim mbarom me fjalë si “*In-finito*”, “*Baleno*”, “*Silenzio*”, “*Esichia*”, “*Angelo*”, “*Icona*” (te ku kush “nget” nëngë nget)...

Të shkruajturit të Cacciari-t i përket më “*theia mania*”-s e Platonit, se “*sofronsine*”..: “*Questo mi dice l’Angelo, “nel mio stesso linguaggio”. La “vis imaginativa”, il “mundus imaginalis” che egli mi dona dicono la libertà delle mie parole, il loro non essere semplicemente “al servizio” dell’informare-denotare, la loro natura “trasgressiva” o esodale” (*Della cosa Ultima*, fjeta 477 -nënvizimi është imi).*

Vëmi rë: “*trasgressiva o esodale*”. Esodh ka ku? Ka mbetja ket “një” llok e e Vërtës... Fthorà, asthéneia e filozofit të “*mejtimit të dobët*”... “*l’ente cela sempre la propria Arché, ma la cela nel suo immediato apparire, la cela mostrandosi, poiché proprio la sua singolarità, “ingiudicabile” scientificamente fa-segno immediatamente alla singolarità, irriducibile alla rete concettuale, della sua provenienza*). (...) (ib. 445)... “...si dà l’inesprimibile del “*pragma toúto*”... Proprio il suo “*infinito*” mi dona gioia...” (ib.507)

Cacciari i dedikoj shum fjeta Ikonës, e shumë herë citonë Etrat lindorë, për ket doj studhjuar ka na “*bixantinëra*”, ndose do të kenë “*bixantinëra*” ka anat tona...

Djovasa me lehtësi edhe librat e Umberto Eco, sidomos “*La struttura assente*”, pra i ribotuar si “*Trattato di Semiotica*”, që edhe Ndon Sassone gjënej të vështir. Ndon Sassone gjënej Eco të padhurueshëm, sidomos si shkrintar románesh (edhé u për këtë).

Mund t’jet se ngë gjeta mos një veshtirësi te “*Semjotika*” pse kisha frekuentuar Palerm mësimet e “*linguistica generale*” e “*filosofia del linguaggio*” që më haptin orixonte të papritur.

Edhè u si Vattimo mejtonj se Eco ng'ë filozof origjinal. Kam shtonjë se ng'është asedhè origjinale semjotika e tij pse përsëritin atë të Pierce...

Si do t'jet, kur zura e djovasa librat e Vattimo, çë rasti më vëjë përpara syvet, çast për çast, i shtova dritë dritës. Vattimo më bënej më të qartë Nietzsche e Heidegger. Me interpretimin e tij këtë të dy auktore birjin gjithë vështirësitë.

Me Vattimo, ç'është dy vjeç më i madhë se u, ndanj edhè "Azione Cattolica", ket desha të njëjtet shurbise çë deshë ai – kush e di ndose ndonjëherë u përpoqëtim ket kongreset, kur Vattimo ng'ish akoma Vattimo? Isha "di sinistra" edhë u; e pat' të bënja kundet me "*Democrazia Cristiana*" të peshkopit Stamati.

Vajta edhè u për vitra të gjegjënja meshën nga menat.

Edhè u u gjeta me djallin përbrënda pse seksualisht isha shum i paqët.

Po jo për meshqulit, ose për djaloshërat ("le marchette") si Vattimo; u qeva ngamon i marr ka grat e vet ka grat.

Jam "radicitus" eteroseksualë.

U bora (osè u gjeta?) prapa shum kopile e ngaherë përpara bukurisë femërore losem njomësije. Bukurin ngë di e e shoh ket kurmet mashkullorë.

Po ka ki libër kapirinj se si njomësia është e njëjta për grat e për burrat. Njomësia me të cilin Vattimo fjet për dasnorët e tij, është e njëjta me të cilin u mund fjinja të kopilevet time (si thot Koheleti im: *bëra një harem grash*: kotësi? Me dritën, për sa e rreme, të gravet shkonjë errësin e gjelles: llavdi Tënë Zoti).

E jam aq eteroseksual, sa kur udhëtonja me trenet e skompartimenti mbjofej burrash, ikënja sa të gjënja një llokë tekù mund t'ulëshja prezë njëjë gruaje.

Te ki libër xura se edhè Pareyson ("*Estetica*" e tij më mësoj shum shurbise), i rrepti filozof katolik, i osesonartur ka mëkatja, thoj: "*Ma sai che cosa vuoi, pensa a uno in viaggio, uno che è*

da solo, deve passare una serata, cosa fa? Se c'è questo servizio, piuttosto che rovinare una famiglia" (fjeta 96 / 97).

U ng'e konsiderova kurrë "un servizio", binja në dashuri me të gjitha... u i desha vet, grat: "*Non ho mai scopato, ho sempre fatto l'amore*" deklarova një herë.

I pata edhë u "terrazze" (faq. 112).

"Terrazza" të shpisë Firmozë ka Bregu tekù u leva; "terrazza" të shpisë teku banonjë nanì më se për tri muaj nga vit. "Terrazza" e shpisë të Enzo Mattanò, im kushrìr ka Ungra, me të cilin kemi shum bisedime filozofije ture folur të Heidegger, të Derrida, të Foucault, të Cacciari e të Vattimo... e të Gioacchino da Fiore të kujit vam e i bëm nderim shumë herë San Giovanni in Fiore...

Ka gjithë terracat time shihet deti Jon, sesì ka "terrazza" e Cetraro të shpisë së Vattimo shihet Tirreni. Ka terracat time deti shihet për së llargu: mund të jet se, ture par atë det, xura prerjen e kufirit, pafundimin e e Vërtetjes, llokun e naufragjëvet... lloku tekù, kur qielli është i pastruar ka vorea, shqilqen llargësia... ose "ardhëmja"...

Edhë u, kur e mbanj mendë, recitonjë, grekisht (vete pa thënë), *Apodhipnon*, Kompjetën (faq. 193): *Kyrje, isakuson tis prosevhjis mu...*

E kur e mbanj mend te dhesperi (sidomos përpara njëj perëndimi roman) këndonj: Fos ilaròn..., pse e shoh se ket errësia dhezen drita për rrengjalljen e neserit...

E si Vattimo, vete edhé ture dhënë limozna këtej e atej – më vjen keq se ngë kam shum tures sa të kenaqin gjithë marokinet o të farmakosurit – sidomos kur vete Torin – çë më ndëjin dorin – po ki fakt më bën të bindur se Vattimo, se si u, ng'i ka fare interes të hollavet...

Më mallingojë ki libër, sidomos kur fjet të dashnorvet të Vattimo, të dy të vdekur të rinjë, njeri me Aids, jetri me një kangaré.

Te ki rast burthofet gjithë njomësia, pothuaj amtare të Vattimo. Tragjik rrufiemi i mortjes të Gianpiero mbi një aeroplan...; e rrufiemi i mortjes të Sergio që më kujtoj fatin të lig të Ndonit Sassone, që edhe u ndjeka, hap pas hapi, njëra kur një ditë ngë m'u përgjegjë më te telefoni...

Një dashuri e hollë jona, imja e të Sasonit, që ndajtim edhe grat; sidomos grat, ket një kërkim spazmodik e të kush e di kë... Përpara njëj gruaje gjithë urtësia jonë, gjithë librat tënë vejin "afafuttiri"...

Tek e katërta të kopertinës, ture ndrequr faqen 195, djovasinj: "*Sconfitto in tutti i luoghi del mondo, non mi sono mai sentito così libero. Alla fine, senza che mai me lo sia detto così esplicitamente e con tanta forza, su tutto io ho cercato la libertà. Per me. Per gli altri. Più ancora dell'amore, forse, più della fama e del successo certamente, più del potere di sicuro, io ho cercato la libertà*". Sidomos – shtonj u – lirin ka arsya klasike që gjithsej zoteronej...

E ndanjë kët deklarcjon: që kur isha i vogël, që kur nëng i gjegjësha osesjonavet e prindëvet e priftravet e të mundësisë. Ngamon "Cane sciolto". Pa parti e pa klisë. Ngamon një hap më tutjë se të tjerët, e ngamon në polemik me profesorët e me dogmatizmet e tyrve – këtù mund shkruanja një libër, sidomos mbi luftin që pat' të duronja, kur kleva edhe u profesor, kundër dogmatizmet e kolegëvet e të drejtorvet që kishin qëndruar me kulturin ket atë që kishin xën te Universiteti ka ndryshe dogmatikra.

Kur përpoqa "*il pensiero debole*", "*mejtimin të dobët*", gjeta një hapësirë, tekù mund banonja mejtimet e sjelljet tim. Vattimo më paraqitnej një teori që ng'ish ket mundja ime të sintetixarnja.

Mbarojin (thom sa të thom, pse ngë mbaron faregjë) kerkimet e dyzetdhjetë vjeç studhimesh te ku hijin Wittgenstein, James, Horkeimer, Adorno, e, pse jo?, Giordano Bruno, Vico; e, pse jo?, lënsi'e Platonit (*Theja mania*), pak e studjuar kët perspektiv'e

irracjonalizmit që gjalpëron ket “*eksaifnes*” e Platonit e e Plotinit (vrë *Ŝestov*); e ai filozof Rensi që dij e vënej bashk irracjonalizmin e kërkimin shpirtëror, që u vete ngamon ture kultivuar me leximin e Bibljes, e të Etravet lindorë, e të buddhizmit Zen... e me atë të tjetërtin të lënë që kle Sergio Quinzio...

“*Lampi. Tracce. Frammenti*” (faq. 196) te një udhëtim, si Abrami, ket shkretëria, tekù herë e herë përpjek një oasis tekù mund të prëfesh e mund të rikriarësh me pemet e t’ëmbël e saj... Po. “*Se non morissi starei sempre attaccato all’ultima interpretazione che ho inventato. È solo morendo che noi che noi lasciamo posto ad altri eventi dell’Essere*” (faq.194). Je gjegjin Anasimandrin:... *fthoràn ... didonai... diken... katà ten tou chronou taksin...* ; e mund t’jet Simmel...?

26 të shën Mirtirit 2006.

“*Clangor anserum Capitolii*”, këtë na nget të gjegjëmi, nga dita, ka këtë gra “in adorazione” të berluskonit, si Carlucci, si Gardini, që njera dië i shitëtin kurm e urtësi çotivet e Televisjonës “spazzatura”. Sot predikojin – “*le liberali della casa delle libertà*” – dogmatisme “*neocon*”. E kan kundër gjithë hapësirat. E duan të rrëjiren. Ndërsa bien ket çotia e “*signora mia, dove andremo a finire*”. Duan edhe klisin, papën... pa klën shpirtërore... e ture klën të tëra “*tou kosmou toutou*”... për makijaxhet e stilit “alla moda (Kosmoi) më të cilët mashkararen

1 i shën Ndreut 2006.

Arsya mos nëngë dmostron vabëzënë e arsyes, është një arsy’e vapkëth. Ndose arsyja nëngë di e qellin ket irracjonalizmi është një arsye totalitariste, një mith që nëngë di e jecin ket udh’e arsyes. Irracjonalizm është mbarimi më racjonal i arsyes.

Kur arsya burthton muskulet, ahirna është e dejme e ngë di më ç'është e thot.

Na sot mund të përdoromi arsyen vet sa të deklaromi të rremë gjithë mbarimet dogmatikë e atyrve të cilët përdoruan arsyen sa të bëjin të trinceruar dogmat e tyre.

Kush sot është mbronjësi i arsyes? Papa, priftrat, klisat (ose synagogat), mbronjësit e të shtunës, ose ditaktoret, ose fashistat... të cilët jan të sigurt se atë çë mejtojin është “E Vërtetja”, pse atà jan gjithë një me t’ “E Vërtetjen”.

Kush ka një cik turpë të kryelartësisë të njeriut, ngë ka si mos t’jet një relativist, një skeptik çë do të shtier këtjè edhe ujët me të cilin lajti zorrët – klister’i Sekstit Empiriku.

Ndonjë prift, si djovastim te Arbitalia është i shqetësuar se me relativizmin, njeriu sa më t’jet një shqiponj, fjeturon ulët si një pulë.

Vet kryelarti çë bëfet i fort, e burthton muskulet e arsyes, fjeturon ulët pse arsya është mjet njersor shum njersor, me të cilin njeriu kërkon të mundinj mortjen e irracjonalitetin e natyrës. Kët e dij Pitagora i cili ishë racjonalist po i hapej *Theja mania-s* e cila është shurbes irracjonalist.

Ka t’ jetra anë këtë “dishipujë” të Krishtit do të kish’ të mejtojin se Krishti ng’i kërkoj një provë logjikje, po një metani, një të vatur mbatan trëmbjet çë armatosjin arsyen; Krishti ngë tha ëmëni një provë të njëj mejtimi të dreqtë, po një lënsi çë hapin zëmrin; i kërkoj “*l’intelletto d’amore*” ç’është i lënë e i verbër si dashuria.

Ka e tjetra anë Shën Pali thotë “*ek merous gignoskomen, ek merous prophiteuomen*”, e pra “*nunc vidimus per speculum in aenigmate, ose “Vlepomen gar di’ eksoptrou en enygmati”* e pra akoma: *Ouk emoranen o Theos tin sophian tou kosmou toutou?*” Nani një çë njeft për copaz (ek merous) e për copaz mund fjàs, sesi mund të pretëndonj të thot të dreqtin? E ndose një shef vet sikur ket një pasiqyrë e mbrënda enigmat sisi mund pretëndonjè

të thot t' e Vërtetjen e cila është jashtë ka gjithë enigmat. E ndose Ynë Zotë bëri të lënë gjithë shkencën e kësaj botje sesi mund të marrim për të mirë arsyen e cila është “shkencja e tou kosmou toutou”? Me arsyen e me sigurinë ç’i jipë arsya e qeshtin Shën Palin te Areopagu...

Cila arsye mund të rrëjirinjë Trinin, ose Virgjërin e Mërisë, ose ngjalljen e kurmit të Krishtit e tjetër...?

Ngë duami të bëmi kundet me lënsin e besës e për këtë i vemi prapa sigurimevet e arsyes... ngë duami se kan të na qeshjin...

Ndose ndonjë lezues do të dier cila është natyra e arsyes e të djovasinj Nietzsche, ose Horkheimer e edhe Adorno...

5 të shën Ndreut 2006

Jam mbi trenit që më qellin Romë te ku neser do të marr pullmanin që do të më qellinj Firmozë sa të vizatonj mëmin e sa të marr pjesë te festa e njëqind vjeçëvet që mbaroj cia ime, e motra e atit tim. Kam te gjaku mundësinë te rronjë edhe aq sa rruan të mbëdhenjëtim që vdiqëtin gjithë “të ndëdur ditësh”. Po dashuri’e gjelles ng’është ajo të deshirosh të rroshë një qind vjeç: një qind ose një ditë (sesa rrojin disa fjutura), ngë ka rëndësi. Gjella pakësufet ket i prasmi moment, ket rasti e çasti ket i cili është e të rrëmbën mortja. Po ki rast e ki çast jan nga herë nani. Nani je vdes. Pse gjella është këtë të vdekur nga rast e nga çast. Ng’është gjelle pa këtë të vdekur.

Të duash gjellen vjen me thën të duash vdeqjen.

“Amor fati” e “cupio dissolvi”: ket humbja jem’e vemi e na kem’ të deshiromi e të duami të vemi drek ku jem’e vemi...

E u ku jam e vete? Firmozë?...

6 të shën Ndreut 2006.

Fest'e Shën Nikollit. Sot Ungër hafen “panjokezit” ose bukezit e bekuar. Jan panjokezit e shën Kollit si thufet me një aferezë e rreme që diskutova moteshkuar te një artikull kundër gabimet e lingistikës e gjithësme e G. B. Rennis.

Gjegjinj kollponet e artëfixëvet e vete me kujitimi ket njetër mot kur zdripëshin ka Firmoza më këmbë Ungir për markatin tekù bjefëshin e shitëshin rrëpaset, ose dirqit të rinjë. E gjegjëshim britjet, thirrjet e tyre, sikur i therjin, për gjithë Ungrin. Më të mirët rrëpase ishin jorkërat. Ishin litinjët ka Altumunda që shisjin më të mirtë. E ditin pas shën Nëkollit, zënej më shpi ai ritë i rëndë, ç'ishë përgatitja e llamës, të ngrënit e dirqëvet.

Një kusì e madhe zënej llokun e vatrisë së tërë. E na që ngrëfshim ka shtrati me tëtim kish të vëfshim ket nj'angon te ku na e arrënej sa mënzit oft'e zjarrit.

I pari mejtim i mëmës ishë derku. I përgatitnej llamin me latirat pjot lëngun e valët e të lyerit e talurvet që kish lajtur ditën më parë. Tek latirat shtonej krunde, kúngulë, guli lakaresh, pataka të vegjëla të hedhura, koqe trikomeli. E pra derku kish si kontorn lënde, kështënja, mollë, e gjithë atà peme me krimba e të ngara, ç'e majin fort e i bëjin mishin t'ëmbël, ç'ish ushqimi më i dashur.

Kur piqënje pra një brinjizë derku më zjarrë ishë një gëzim i madhë për hundin. Aromit e atij mishi hipej për çiminert e zgjirofej për gjithë gjitonit. Kur mbjidëshim më dimër në katund ture ardhur ka kollegjet te ku studhjojim ndër qitetët, siguria se ja kishim arrur më shpi, ishë arom'i mishit që pjiqej ndër vatrë. Mëma më vë më zjarr, sonde, një brinjëz derku. Ngë kam si t'i thom se jam vegjetarjan. Është i ndaluar të kesh më shpit time këta “vese litinjësh”. Kam të ha, dua o ngë dua, mish derku. Edhë pse mëma m'e vëloj e sigurtë se kënaqësia ime është mish'i derkut. Po ka vatra ngë vjen mos një arom e atij mishi që

hanja kur isha djalë. Mëma, sa mos të gjegjin angimet tim, më siguron se këtë është mish çë bjejt Fermë tekun është një akcile i cili rritin derkun “dreq si një herë”. Po këtë mish, si do nevrosa moderne, ngë ka një fillë dhjamje, ket zjarri ngë pikon një pikë të lyeri, e mishtë piqet pa një aromë. Jam i sigurtë se është mish i akulluar. Akulli i jep çë do shurbesi të njëjtin shije. Kështu ngë di ndose je ha mish shtjerri, kaciqi, derku, pulastri, pipje, kunilli, delje, dhije, ose qeni, ose maçe...

Uniteti, njëjsia, aq e dashur ka gjithë filosofat është e sherbëtuar ka akulli e frigoriferit e ka “akulli” (vrë Weber) e “la razionalizzazione” e markatit intenacjonal: “*ut unum sint*” – si thon edhe Kosenx...

8 të shën Ndreut 2006

Sot është festa e Shin (si thomi na Firmozë e Ungir – Ungir e jo Ungër) Mëris së butes. Sot i vëfet piri butes e ngjepset vera e re. Po na sot i bëmi festë cje Menes. E motra e atit tim ç’ja arru një qind vjeç.

Cje Mena është, si thufet, një bibliotekë, një trizuar kujtimesh, e veçantë. Sidomos për historin e familës sime, po ture ardhur ka ajò mesjetë ket e cila fjitej vet arbërisht, e televizjona ngë kish akoma omologuar gjithësej në zbritje, “al ribasso”, mesjetë ka e cila vinj edhe u, kle ndër vitra, po edhe nani ç’u vura e shkruanj arbërisht, fjalori më i besueshëm. Më se ai i Giordanot ket i cili shumë fjalë të Firmozës nëngë çfaqen, nëng façofen.

Ka ajò pata vërtetim se thufet “mesimvri” e jo “jug” – çë Firmozë mosnjeri di çë vjen me thën – po për së dreqëti edhe “mesimvri” ng’e di njeri.

Cje Mena pat te menira e saj një gjelle pjotë aventurë pse i vate prapa Nikoll Aronit, lal’e saj, i cili do të na kish qellur gjithë në Afrikë. E kle për rastin e vdeqjes e tatëmadhit timë – i ati cje Menës - e për mos të lëjin vetëm mëmatacin, ç’u ng’u leva

Derna. Atjè lan eshtrat e lalë Mikucit, kur pa' të prirshin gjithë Firmozë, pra çë zu guerra e dytë boterore.

Në Afrik lalë Nikoll Aroni ja kishë arrur te një pozicjon e rëndëshme te diplomacia. E kishin nëmëruar më par konsoll e Libjes, pra podhestà i Derna. Atjè fitoj medalin e artë ka duart e regjèresesh Elena pse kish ndaluar shkloverin, akoma e praktikuar ka misilmanërat e Tripolitanies.

Gjella e Nikoll Aronit është njetër aventurë çë do rrëfiejtur; e njize o vonë kam të gjënj motin t'e bënëj.

Aq Nikoll Aroni, sa lalë Mikuci Elmo, i vëllaj i cje Menës e atit timë – njetër personaxhë i rëndëshëm, të cilit u buar Firmozë kujtimi, pse u buartin Derna gjithë veprat e tij piktori e shkrimtari, ture ndjekur guerra – Nikoll Aroni e Mikuci Elmo i shtuan nobilitet familës sime...

Te festa e cje Menës, tek e cila u ndodhëtin të bilët e e reja, e i dhëndri litirë, e të niprat e stranipra çë fjasjin gjithë litisht, mora fjalin e arbësisht kujtova motet kur ishim gjithë arbëreshë e mund të thojim a të çë diktonej zëmëra me fjalët më të mbrëndëshme. Ngë desha të dinja ndose fjalët time ishin të kapirtur ka këtë të rinjë çë buartin ndjenjet e jo vet glufin arbëreshe. Zëmra më qelli ka desh...

9 të shën Ndreut 2006.

Sonde erdhë e më bëri një vizitë sindëku Giovanni Manoccio. Do se kam t'i shkruanj një librush sa t'i bëmi nderim, kët verë çë vjen, Viçenxit Capparelli, jatroit e shkrimtarit e filozofit të math ka Firmoza.

Capparelli shkruajti disa libra të rëndë mbi filozofin e Pitàgoras. Pitàgora, ai çë diti e xu gjithë skencjen botore e moshës së tij, ture xën dijturin e Egjiptit, të Kaldevet, të Magjëvet e të Zarathustrës, e të Cinës e indjanëvet e të judhinjëvet etëtj... e pra

diti e i mësoj gjithë atyrve filosofra që banojin në Kalabri, që ahirna ishë “*E megale Hellas*”, ose Italia, par se ki ëmër t’ishë ëmëri i gjithë peninshulis. Pitagora, ati i gjithë dijturisë së Evropës...

Marr dëtirin me kënaqësi (ndomos se ngë ndifem i mir për ket ndërmarje) pse kan shum vitra që jam e lipinj t’i bëmi nderim këtij shkrintari i njohur, te mot’i tij, ket bota e tërë, anamesa filosofat ç’i interesofshin filozofisë antike. Ka jetr’anë jam sot, mund t’jet, i njëjti, ka anat tona, që djovasi gjithë veprin e tij e bënë të milëra fjetash.

Ndërsa fjasmi më vjen nzë ai llok i Jamblikut ket thot se Pitagora doj se nga një ket skolla e tij kish të fjitë ket djalekti i tij (phonë patriia): “*Legetai toiny n os phonei chresthai tei patroiai ekastois paengellon, osoi ton Ellenon proselthon pros ten koinonian tauten: to gar xenizein ouk edokimazon*” – “*Thon se atyrve të Greqëravet që ja arrëjin te komuniteti e tilla, kish të fjisjin nga një te gluha e të etravet: pse ng’ishë mirë të fjisjin me gjufin të huaj*”. E thojn pitgoristrat se djalekti dorik ish më i miri. Djalekti jonik e ài eolik e aktik kishin nje modhulacjon kromatike. Doriku ish enarmonik e tëtj...

Kush e di cili djalekt yni është më i miri. U thom se ài i Firmozës e ài i Ungri sigurisht jan enarmonik pse kan, si do Pitagora, më zanore. E se ket kjo kategori mund të hijin ài i Frasnitës e i Çivitës, të di këtë kan muzikin e Firmozës ose t’Ungri. Të tjerët më duken shum të tresh.

Kush di, e të na thot si ven shurbiset ket ki dhë. E të na thot si Dante ket De Vulgari eloquentia cili është “*non vulgare, sed potius tristiloquium, “albanorum” vulgarium omnium turpissimum*”. U e di cili (cilët) është (jan). Po ng’e thom, pse ngë dua të frynj mosnjeri: *ogni scarrafone è bell’a mamma soja*”

10 – 11 të shën Ndreut 2006

Në udhëtim për të priremi Rivarol. Prëfemi një parë orë Romë sa të pimi një kafë ka im vëllà Çezari. E pra nisemi popà për Perugia te ku j'arrëmi ç'është errët. Hëna ëmbëlson perfillet e kodravet çë biren te orixonti. E këtë ullinjë...

15 – 16 – 17 të shën Ndreut 2006

Zën fill ditat të bjerra e ardhëmjes e Krishtlindjes. Sa mejtime për dhuratat cilit e akcilit... një ffigë e madhe, lodhësi e varesi...

1823 të shën Ndreut

... .. (...) ... (...)...
mboqe (mallkime) mboqe...

24 të shën Ndreut 2006

Jam i mbituar ka Roberto Lureri ç'është një publicitar shumë i bëgat ka Milano, çë bjejt një palere Torre Canavese e e bëri, me një arkitekt i vlerëshëm, një vepër artje. Çë vjen me thën “la conservazione”. Ng'i ngau faregjë te muret e jashtëm. E këtë gurë të hinjët, të nxitur ka shirat, qindruan si ishin mot e mot prap. Këtë gurë të hinjët më vën një dashuri e malinguar mbrënda. Firmozë i shtien sipër ntonkat me ngjiret sintetikë për një joekapitur delirësi borgeze. Stistin dosari Firmozë. I trëmben motit...

Nga herë çë më fton Roberto kan t'i bën një konferenc, ose një recit poesish, i bashkuar ka dy musikantra: një ç'i bie titarotit e jetri kundrabasit. Improvisarmi. Një herë bëm një shfaqje te teatri i Torre e patëtim një sukses i madhë. E ç'ahirna për Roberto jam një aktor i vlerëm. E më siell shokët sa të më gjegjin...

Po, sonde, par se të recitonj i këndonj “I parthenos simeron”, që bashk me “Fos ilaron”, është këndimi më i bukur ndër troparet bixantine. Thon se Romani Melodi piksi kët këndim gjithë një herje, fjalë e muzikë, ndër natin e Natalle vet më klishë. I marr ka një ekstaz, u ngrë ka karriqja e zu fill të këndonej: “I parthenos...”

Roberto qindron i thamasur e më lipin të përsëritin këndimin. U këndonj njetër here e vë më paqë dëtirin me krishtëlindjen tënë...

25 të shën Ndreut 2006

Ditë e bjerrë ture ngrën e ture pir, anamesa gjindje që të krishtlindjes ng’i mburton fare gjë. Ënëna një cikë mesjetje, ose priremi te Greqja e mistervet e Eleusi... ënëna një orgjë me grat e Djonisit... Mosha te ku na ngau të jetomi është pa krip e pa vaj.

28 të shën Ndreut 2006

Këtë vajzë e bukur e bëm jatrua. Gjasht vitra gjasht studhimesh. E ngë buar një ditë. Veproj serjozisht, me kushenxje, si thomi Firmozë. U llaurear me 110 e llavdi e me puthjen akadhemike. Sot jem’e i bëmi fest. Ndrër të ndryshmet bisedime t’urt del ai: “E nanì ke të pënxoshë të martofesh”.

Ndrikulla litire putigare ka mbjatu kësillin t’urt t’i ofronjë: “Uno bello, bravo e ricco”.

“Certo – i sulem – un medico. Il solito stronzo”.

I lë gjithë pa fjalë.

“Il solito stronzo di medico non lo voglio. Basta coi medici, e con i soliti stronzi” paron gjithësej vajza. E puthin.

“E bella di mamma, che cosa vorresti? Tu ti devi scegliere uno ricco” – hin e jëma.

“ Vorrei solo uno intelligente. Di bravi, belli e ricchi, ho fatto esperienza: tutti stronzi, come dice zio Nando, e magari di

comunione e liberazione, o dell'opus dei; o forse un po' massoni, che non guasta mai per essere bravi... Stronzi con la Porche, o la Bugatti e il Rollex al polso.... Grazie, nè... non vorrei fare la moglie medico stronza di un medico stronzo. I medici sono stronzi per definizione soprattutto quando indossano il camice...”

Darsma e llaurejes vete përpara me shum kënaqësi, sidomos për deklarasjonat e vajzës që burthofet më e urtë se sa u burthua ket studhimet. Jam i sigutr se njetër jatrua “bello bravo e pieno di soldi”, po “stronzo”, ngë do të na hinjë më shpì.

I bekuar Zefi ynë që niprat i bëri priftra... “belli bravi”, po jo “stronzi”

30 të shën Ndreut 2006

Jam e nisem për Genova. Menat, dej e kocdej do duronj atjè. Më ngushillon se do të vet' shoh detin. E shtitjet ket “il lungo mare” të Genova jan sa më të mirat që mund t'jen...

Mirupafshim ditari im...

1 i Janarit 2007

Vit'i ri më pret me mejtime shum të gëzuar.

Jam e jap një shtitje gjat detit të Xhenovas. Përposh një qiell të vrëjtur që kërcënon të shtier gjithë shiun që kjo stinë e that e edhe e vdekur eti, nëng shtu akona. Ecinj për ndonjë disa kilometre ka Boccadasse njera te qaza De Ferrari. Kur mejtonj se është hera sa të mbjidhem, zë shiu. Kështu vete ana ngana murevet sa mos të lagem, ture kërkuar praket e balkunevet si mbrojtje. Ngë më trëmbin shiu. Sa shira mora kalosh. U ngë di që është lumbrela. Po shiu shtringon, e po që jam mënor të të kushirinjë e sime shoqe, ngë dua t'i mbjidhem më shpì i tërë i lagët, sa mos të vë mosnjeri ngushtë – sidomos time shoqe...

Mbaronjë përosh një portik tekua jan ndryshe gjindë që jan e presjin sa të sosinjë shiu.

Gjithsej mund të preshë të parzën e viti, jo se të qaset një sa të të jap një broshur të ku publicizofet kremaciona.

“E të lëmi botën të ngjallëvet”.

E njera këtu vemi n’akord.

Po prier fjetat e më proponojin një varrim “classico”, ose një “con grande rito” e tëtj...

I jam në detyrë për shijen e mirë: ngë më paraqiten ëngjël me çerën e helmuar e me sytë të prier më truall, ose flaka që një ëngjël do të shuanjë ture e shkelur te dheu, ose skelete me draprin ndë duar, ose klepsidra, ose gjithë armamentarin e mortjes që banon gjithë vërrezët, gjithë kambusandrat të krishterë. Ka një fjetë një vajzë, ç’i merë merën një trandafilje, më ruan e paqëme.

Ok.

Ngë më trëmbën mortja, ngë më bën neveri se kam të vdes. Më bën neveri varrimi, aq i ulët sa “di gran classe”. Më bën “schifo” gjithë atë që bashkon mortjen: lotët, lulet (që për ndryshe jan kështu të bukura), manifestet, fotografia ket varri e tëtj... Më bën “schifo” se njeri do të ndrronjë të një biznes kufomin tënd (si më bën “schifo” se jatronjë kan të bëgaten mbë dhëmbjen e të tjervet).

Doj të vdisnja te një llok i humbur, te një shkretërië, te fundi i errët i njëj dushku i ngrën ka milingonat, ka korbrat, ka qent, ka gjithë kafsha që ka u, i konsideruar si i prasmi shenj i “pronoias”, i kujdhesit të Tënëzoti. E doja eshtrat tim t’ishin të ngrën ka suvalat e detit e të ndërruar në pipëtimin e shurës. Si Fleba Feniqi: “*Those are pearls that where his eyes*”, si thot poeti...

Sidomos ngë dua vën ket atà varre mërmuri, si stisen Firmozë, ka të cilët atomet tëndë ngë kan si të priren ket shiu, ket ajri, ket dheu si bare, ose si lule, pse marmuri të ndallon të bëfesh koprë.

Varri. I sprasmi llok ket të tjetër kërkojin të dëshperuarin themelim të paqëmiës, të vakandit, të faregjësë të egoit të tyre. Kambusand’i Firmozës është shenj’i këtyrve mërgimëtare që duan t’jen, si do t’jet, të vendosur ket një dhë...

Mejtime të bukur për të parzën e vitit të rì. Haristonj atë që më dha broshurin e dal ka portiku e vete përposh shiut: “*Ma sì, ma sì, laudato si mi Signore per nostra corporal sorella morte...*”.

J’ arrënj më shpi që ndërsa shiu mbaroj. Po jam gjithë i lagët, picirrë. Ngë di ndose qiellit i dualtin lotët pse ish e qeshnej, o ndose ish e qanej. Për çotitë e mia. Për mua – vete pa thënë.

5 të Janarit 2007.

Jam i marr ka libri që jam e shkruanj mbi Capparelli, filozof’i Firmozës. Kam vështirsi pse ngë ndanj gjë me këtë “*Omojosis tòi thôi*”, që për mua është hybris-a më e madhe që i vendosi kultura ellenike kulturës evropjane. Edhë sot që jemi gjithë ateistra, te fundi i shpirtit tënë kemi ngamon ngasjen t’jemi: të ngjashëm të Perëndisë - si na prëmëtoj djalli. Na hami ngamon pemin e dijturisë e me teknikën bëmi mërekul që asedé Perëndia di e bën. Po ngjasja e Perëndisë që proponon Capparelli është e ndryshme ka ngasja e diellit. Ngjasja e Perëndisë që proponon Capparelli i gjet më Megalopsychés s’Aristotelit, tek e cila njeriu është i ftuar të shkrakonjë gjithë atë që grekisht thufen “*epithymiai*”. Ket të cilat janë dëshir’i suksesit; dëshiri i egoit t’imponofet mbë të tjetër; dëshir’i egoit t’jet gjë, ndërsa është një moné e t’egoit vet, një mashkare ndër më të ligat, me të cilin njeriu veshet si Perëndi. Ndërsa njeriu lirofet ka mjegulat që i rrin përsipër shpirtit, shkon ket atarasía, apátheia, ksenetéia, e ket gjithë virtytat që bëjin shpirtin të lirë, ose vakandjen ka gjithë dëshirët që na rëndësojin e na vën ket qendr’i gjelles, jo vet sonës po edhe të tjetret – me gjithë pasojet që njofti.

17 të Janarit 2007.

Shkova këto dita sipër librat e Jamblikut e të Prokolit ture kërkuar të thellonja problemet e teurgjisë e të ngjasjes së Perëndisë. Jan probleme që nëng i përgjegjen arsyes radikale. Po drej arsy radikale më vë përpara domethënjes së këtyrve probleme: “Sesi arsy radikale ka mundësi mbi këtyrve shurbiseve ndose arsy radikale do të problematizonjë nga rezultat të arsyes?”

Rrizikonj të përsëritinj shurbise që shkruajta të ndryshme herë, po nga herë që mund pëshstinj sipër arsyes e risultetevet (?) e saj, ngë lë të më pështonjë rasti.

Probleme si atà të teurgjisë i shkuan ndër duar të psyqatrisë e personaxhe si Teresa de Avila ose si Teresa de Lissieux, ose sesi Juan de la Cruz, u vapkësuan ndër libre pa domethënie. Mendëmadja e jatronjëvet, ose të positivistravet ngë ka mbarim. Kështu libr'i Ida Magli mbi Teresa de Lissieux është të një varfërije intelektuale që ngë ka të rrëfier.

19 të Janarit 2007.

Ka kartat e lalë Mikucit:

Derna, Maj 1937

“Vejim për buzën e Jordanit. Mjeshtri vej ture lagur këmbët mb’uj, që herë herë shkelnej ket kurriz’i i Maries ka Magdala, ç’i ecënej përpara. Ishin edhe të ndryshme gra ket grupi, ç’u kish madhësuar ndersa vejim pa ditur ku. Ishin shumë që kishin kureshtjen të njëjtin Mjeshtrin, e kush do ndodhej na vin prapa. Maria, e cila ish më e bukura e grupit, me të cilien kish’t’eksercitonja gjithë apatin, enkratin, ataraksin e pitagorikut, sa mos të binja në nëngasje, dukej se ishë miqja e tij më e ngushta. Vej ture ndaluar cilin e akcilin.

“Çë doni? – vej tute thën – Çë veni ture gjetur?”

E mjestri i përgjegjës: “Ng’ë akoma hera ime. Po leji të rrin. U ngë kam ndalime për mosnjeri. Kush do të më vinjë prapa të më gjegjinjë, e të vinjë”.

Ndërsa Maria e Mjeshtri, bridhjin akoma me ujët ture u lagur njeri me të tjetrën - e ki akund ngë dukej i denjë i gjelljes së njëj mjeshtri - dualtim ket një hapësir tekù u kish mbjedhur shumë gjindë. Gjegjës një vuxhë e trashë që vej ture premëtuar pisin gjithëve: “Pendoheni, një mos është e ja arrën korrësi që do të shtier ket zjarri pasosëm barët e ligë”.

Gjithë u ndalum. E më më grat, ç’u vun prapa grupit sikurse doj të gjëjin streh ka nëmat e atij njeriu që thërrit si i dalur krye. “Është Jani” tha mjeshtri e shpejtoj hapin, ture i thën gravet: “Mos trëmbeni, eni me mua”. E vej ture tundur kryet e ture hapur krafet pangushullim.

Kur na pan të tjerët se ish e qasëshim, na hapëtin udhën.

Galilea ish e pjotë mjeshtrish. Nga mjeshtër kish grupin e tij ç’i vej prapa. Si edhë në Greqi ka vinja u që, si Mjeshtri im Pitagora, kisha ardhur në Galilë sa të xënja sa më shumë mbi misteret e besimevet. Në Greqi do t’ishim gjithë filozofia e bëjim garë kush dinej më shumë. Nga mjeshtër i thonej çot të tjetrit. Kisha gjegjur se në Galilë banonej një mjeshtër i cili për së vogli i kishë mbajtur krye më t’urtravet, e kish dimostruar një urtësi që vet një perëndi mund t’i kish frymëzuar, ose kish xën ket njetër gjelle, si mjeshtri ynë Pytagora. Thufej pra se kish banuar ket shkretëria e këtjës, ture ndënjur pa ngrën, u kish ndesur me gjithë djelët që banojin njeriun, e i kish mundur gjithë. Ket shkretëria u kish bën i zot’i gjithë epythimivet, si thomi na. E ja kish arrur enkratisë, e cila në Greqi është më e madhja vyrtët.

I venja prapa ka ca mot e prisnja mesime të mbdenj. Po përsëritnej vet se ng’ishë akoma ora e tij, e isha një cik i zhgënjitur për gjindjen ç’e rrethonej. Mua par se të më mirprisjin te rreth’i pitagoristravet më shqyrtuan ka kryet njera ndër këmbë e i vun kujdhes edhe sjelljes sime.

E pra ki mjeshtër haj e pij. Dukej se ngë kish ndo një rregull igjenike për të ngrënit si na pitagoristra. E kisha par vet të llargofej të parkalesnej llargu ka të tjetër, e ki fakt më ngushullonej, pse ka na dhulia e hyinivet është themelor për edhukimin shpirtëror të njeriut të urtë. Heshtja e tij mbi mësimet më dukej se kish t'ishë një gjë si "ehemythia" jonë, e cila si thot Filostrati është njetër menirë të fjash. E më dukej se këtë të bashkuar me gjithë, do t'ish një strategji si ajo e atyrve gjymnosofistra të cilët i vëjin gjithë veshtirsitë dishipulvet, e sidomos deklarëjonin se ngë kishin fare gjë t'i mësojin, sa të masjin dashurin e tyrve për dijturin.

Pandefa se ai çë thërrit do t'ish njetër mjeshërt, e se ture përpjekur Mjeshttrin tim, do të kisha, te fundi, qën i pranishëm te një logomaqi, si thomi na, intersant.

Kisha oreks të shinja një logomaki për së dreqti, edhë pse m'u kish dukur se Mjeshtrit iu kish gjymëtuar rasti të burthonej gjithë dijturin e tij. Më kë kish t'u kish masur, me Marien ka Magdala? ose me atà dy o tri kriminel zelotra çë fëshefjin thikin ket qikat e stolivet, të gatishëm të vrisjin cilin e akcilin? Ket skollat tona kishin gra. Ng'ishë ki problemi, po ishin gra të zgjedhura ket të parat familia. Ishin grà fisnike, shoqe bularesh. Po sigurisht ng'ishin anamesa neve kriminel, ose gjindë vulgare, or, sesi thomi na, "banausoi".

Ndërsa iu qastim atij çë Mjeshtri thërrit Jani, ai u qet. Fëshiti buzin me kurrizin e dorës. Ruajti fitu Mjeshttrin e pra, ture ngjatur dorin kanosisht, zuffill të thërrit akoma më fort, me një zërë pjot thartësi. Pra ture qeshur me një ironi të madhe: "Vreni. Njota shtjerr'i Perëndis. Njota ai çë do t'ju nxjer gjithë mëkatët..."

Syt' e Janit ishin pjot gjak. Qindrova i çuditur ka fjalët e Janit pjot dhunë.

Thash më zëmër: “Çë mjeshtër do t’jet ki pa ataraksi. Çë mjeshtër do t’jet ki çë pret të tjetrën mjeshtër me një dhunë fjalësh të tilla?”

Prita se edhë Mjeshtri im do t’i prirej me njetëraq dhunë.

Kuse i bëri shënjë Maries e të tjeravet gra t’i vijin përpara e dora dora me ‘tò hiri nd’ujë. Zu fill e nxuar mbrolat e u qasë ket uji lumit ish më thell, dhjà prrëzë këmbëvet e Janit e ju vu për gjunaz: “Pakëzom, ndëlem gjithë mëkatët...”

Jani kur pa se edhë grat, ç’ishin me mjeshttrin, ishin e hijin nd’uj, i pruar krafët e me të njëjtën përqeshje: “U të pakzonj tij? U ngë mund të të lidhinj asedhë rripat e carithevet”.

“Bë atë çë do bën” iu përgjegjë Mjeshtri me rreptësi.

Ahirna Jani shtù llargu shkopin me të cilin i kanosej gjithëve, rrëmbej ujët me dy duart ture u rrëjirtur sa mënxit shtuaru. Shtu ujët sipër kryet e Mjeshtrit e dha një vajtim.

Ahirna u ngrejtin gjithë fjeturat e pëllumbat çë banojin degat e arvurvet.

Një skëlzim më verboj e m’u duk se gjegjënja një zanë çë thoj: “Ki është biri imë”.

Ka ca motë venja ture përsëritur historin e Pitagorit teku thufet se një lumë e përshëndeti: Haire Pythagora”. Më lypnja ndose këtë rrufieme jan të vërtet...”

*** **

Fjeta e lal Mikucit mbaron me një shenim i shkruajtur me ngjostër të kuqë: “Personaxhi pitagorik ç’i vete prapa Jisuit mund t’jet shum i gjasëm i e vërtetjes e ndonjë vijë mjeshtri gjymnosofistë të Jisui është i besuam. Gjithë rrëfiemi, kur dot’e zë fill t’e shkruanj, mund t’jet si ditar’i një pitagoriku ç’i vete prapa Krishtit sa të njohë mistere.

Tituli mund t’jet: Ditar’i Damis-it.

Si dihet Damis ishë famulli i Apollonit ka Tiana, mbi të cilin na la një ditar. Mund të imagjinoj se Damis përpoqi Jisuin gjatë një udhëtim të Apollonit. E mund të bënj një parakon midhis një pitagorist e një profit si Jisui i cili ngë proponoj kurrë mësimë të themelluar ket logjika... ”.

Fjeta është si gjithë të tjerat pjot korrigjime.

23 të Janarit 2007

Mora këto ditë çë shkuan librin e Giuseppe Gramis (ose Pin'i Nanis, ose Pin'i Trikitollës): “*Il Paese del cuore*”. Një librush tekù Pini vete ture rrufier disà episode e gjelles së tij. Shurbise simpatike, çë tash Pini na rrëfienej, tridjetë vjeç prapa, kur vejin Dhiamant për detin. Po ki librush mban ka e tija se është i *shkruajtur* arbërisht, pa “testo a fronte”. Vlerja e tij është drej kjo: është i pari shkrim në prozë çë del ka anat tona. Jo më shum. Po botues’i tij, “Marco” ka Ungra ngë lë t’i shkonj rasti pa të tregonj gjithë dijturin e tij, sidomos etikë e moralë, ture burthuar sa muskle ka sa të rrëjirinj një fjtur.

Do t’ish mir për nganjë libër të vej te markat’i kulturërs me këmbët e tij, pa ndihmen rrufjane të njëj parathënie.

Shkruajti një here një shkrimtare i vlefshem se parathëniet jan si kokodeu i pulës çë do t’i thot gjitonisë se bëri venë. E shton Borges se “Një parathënie është, ndër më të shumat, një rast i trishtuar te ku auktori vete e mbaron te retorika e pas tryesis o ket panegjirikat të varrimevet e shtifet ket iperbolat çë ngë kan responsabilitet”.

E Kostantin Marku ngë la t’i pështonej rasti sa të esibirej ket një panegjirik varrimi e te iperbolat ipokrite, te ku thërret në qacë, “purezza morale” “candore sentimentale” “vicende memorabili” “risvolti umani indelebili”... e të ndrysmë shurbise të tilla për me qeshur...

Nani na arbëreshë nevomi gjithsej ket dobësia jonë, veç këtë retorik pas tryesis ose këtë panegjirik varrimi. Për së drekti, kjo retorik na ndan ka nga një dobësi, e cila është, ose kish t'ish, ngamon një bekim. Fati i keq është se ng'jemi fare të dobët, po jemi të qosmë të gjithë vesevet borgez. Sidomos të vesit të kërkomi t'i jami faregjësë sonë një plotësi që na bën të verbër, aq sa i vemi prap “Hybris” më të madhe.

Im bir më thot: *“Ma voi arbëreshë rischiate di essere sommersi dal ridicolo da questi intellettuali che vi ritrovate. Non meritate tanto, per quel po' che vi conosco”*.

24 të Janarit 2007.

Këto ditë që shkuan, moti na dhuroj gjithsej: puhë me vapë, era të liga me tëtim. Na erdhë, më në fund, edhë shiu për dy ditë. E na duket një mërakull. Çukat e grurit që është bitet ishin të verdha për voesën. Sot na u pruar dielli e malet jan pjotë borë. Edhë gjelbri ka njetër gjallë pra që shiu e potisi. Edhë çukat e grurit duken se buartin dëmin e voesës.

Ngrëfen në fjeturin papani pëllumbat. Këtë ditë që shkuan ngrëfëshin vet korbrat, ture rahur pendat me varesi. Te qielli i hinjët dukëshin një shenjë të njëj shkrimi i huaj.

25 të Janarit. 2007

Diovasinj ket *“La tentation d'exister”* të shkrimtarit romen-francizë Cioran (përkthenj si mundin): *“Pa ligjë pandefmi të mërguarin si një që abdikarin, që tërhiqet e mbafet mënjane, i nënshtruar dobësivët të tija, te gjëndja e tij t'i lëni. (...) Kush buar gjithsej, vlon si e prasmja mundësi shpresën të doksës o të skandallit literar. Duron të bier gjithsej veç ëmrin e tij. Po sesi mund të imponojë ëmrin e tij ndose shkruan ket një gjufë që të civilizuarit ngë njofjin ose shajin? Do të maset me njetër*

shprehje? Ng'është shurbes i leht të heqinjë dorin ka fjalët te ku rrjedh gjithë e shkuamja e tij. (...)

“Një i tillë shkruan një roman ç’e bën mbjatu të famshëm. Rrufian gjithë psimet e tij. Bashkatëdhettartë, te vend’i huaj, i kan zili: edhë atà kan pasur psime, mund t’jet edhë më shum. (...) Një i tillë ndrofet ket drejturi i njëj rivistje; sa të duronjë, rizikon të vdes uri...(…) ...mergimëtarët baskofen në grupe, jo për të mbrojin intereset e tyre, po për të mbjedjin solde, e të shtien gjak sa të botojin keqardjet e tyre, psimet e tyre... (...) jan aq të mirë si poetra sa të ligjë si prozëtarë. Ekzaminoni prodhimin litrar e njëj populi të vogël, çë ngë ka njurandin të piksinj rrënjat: e madhja sasi e prodhimit poesije është karakteristikka çë më thamasin... (...) sa të sfordhet proza do rreptësi...(…) poesia mburon...”.

Kështu këta të pahme vija të Cioran mbi epërsit e mërgimit, i cili vë ket marramendja e poesisë - e na bën të gjithë poetra...

Ket fjalët e Cioran sa obseksiona tona pë, sa lënsi...

Po vazhdoni të djovasni tekstin e shkrimtarit romen, i cili di çë thot, pse shkoj të tërë gjellen e tij si mërgimtar.

*** **

Gjuha ime mërgimtare esht shum barbare, mullaqe, mistrice e shprehur me një gramatike jo e stabilizuar, si një sabir një kriolle. Po një gjuhë e stabilizuar është një gjuhë e vdekur – thon linguistat.

29 të Janarit 2007.

Vinj e xë sod, ka ime kushrë çë banon Firmozë, se Peshkopi ka Ungra (e kush njëmos?) “na dirgoj një prift romen i cili thot vet një meshë menatevet njëhere, litisht. Ma çë ka ndë kocët ki bonsinjur?”.

Më thot se foli me peshkopin ka Kasana ture i thën shtërgimin (?) te ku gjenden fimozjotët, e se ai për gjithë përgjegje u vu e qeshi. Më thot edhe se jetra ime kushërire, Rakelia e Aronit, ng'i përgjegjet litisht te mesha zotit rumen, po greqisht. Doj' t'e gjegjënja një meshë të tillë...

Ngë di si kam t'e ndreqinj një problem të tillë. Po më vjen të thom, me gjithë atà që na mësuat etrat tanë – se na ishim një pont midhis Lindorit e të Perëndimit -, se Shpirti u lodh me ne Arbëreshë, se nëng na frymëson më, e se do të na humbinj ture na losur anamesa litinjëvet.

Sa më t'jip e të mirr, peshkopi ka Ungra, sa të bëjin një licë klasik tekù mund të xëfej grekishtja , u vu te udha e këtij fati të lig, të shkeljes të romenvet. Të cilët ngë dimi që vijin e bëjin ka na: ka shumë priftra ket atëdheu tyre? Ngë nevojën të evagjelizojin populin e tyre?

Mund të kapirinj se vijin n'Itali puntorë për të përmirësojin situatën e tyre, po priftrat cilin situat kan të përmirësojin? Sot ngë kan më komunistrat që'i imponojn materjalizmin ateistë, pse nëng qëndrojin ket atëdheu i tyre sa të evagjelizojin gjithë atà që'u kthytëtin ket ateizmi?

Është vërteta një çudi kjo ardhëmje romenesh ket djokesa jonë, e është një çudi më e çuditur mirpresja e peshkopit ka Ungra.

Ka të humbet grekishtja? Ngë jemi gjindë serjozë na arbëreshë ndose lëmi t' ja arrënj një fat i tillë.

*** **

Grekishtja.

Sot kan shumë atà që ven e studjojin, kush e di pse, filosofi, pa dijtur grekishtjen: po ku mund ven pa grekishtje ndose philosophia u le në Greqi e perdoromi gluhen e saj?

Na patëtim kët fat të bukur, se prrëzës Firmozës kishim S. Vasilin teku këllogjërit e Grottaferratës na mësuat gjithë

grekishtjen që mundëtim e patim fatin të mir të djovasjimit fjalën e Tënë Zoti (jo vet, po gjithë Platonin që mundëtim) te gjufa ket e cila kle e shkruajtur.

Ng'është mosnjë misilman që ngë një gjufin e Profitit. Po na të krishterë jemi të sekularizuar e shomi gjithëparu “eidola”, kështu edhe grekishtja mund t'jet një “eidolon” - po te kjo menir jemi edhe ikonoklastra.

Si do t'jet, ngë kapirmi më pse jan e spëndojin gjithë atë solde sa të bëjin klisat bizantine: që nevoj ka?

Jo pa domethënie klisja e Ungri ngë ruan ka Lindori. Prifti kur thot meshin ruan ka Perëndimi, ruan jo ka ana e Jerushalemës, e të Kostantinopolit, po ka an'e Romës.

Prifttrat e Ungri i prierjin krafët edhe Konxës te ku është, si deshtin Etrat tanë, shën Mëria e Kostantinopolit.

E ture ruajtur ka perëndimi, par o von, klisja e Ungri ka të perëndonj.

Pa se mosnjeri të ket turpë.

Mirupafshim, Qisha e Ungri.

30 të Janarit. 2007

Mbrënda ket klisat ngë hin kurrë një lypës, një “ptokòs”.

Ngë m'u ndodh kurrë të pirpiqënja te S. Pietro, një të ktyre për të cilët është e bënë regjëria e qiellvet. Vjen me thën se klisat jan të bëna jo për rregjërën e qiellvet, po për borgeset, “për të sëmurt për të cilët erdhë i biri i njeriut”.

Një “ptokòs” ngë ka që të bënjë më klis, pse ai ja arru ku kish t'ja arrënej...

Po vjen me thën edhe se te klisat ngë hinë kurrë një Perëndi.

Te gjithë mitologjia klasike, hyjnit fëshefen ket një i nëmur i përzën ka gjithë të bëgetët – edhe Logosi ynë u bë i nëmur e i panjohur...

Një ka të ket një shikim shumë të ushtruar sa të kapirinjë se ket syt të njëj të nëmuri fëshefet buzqeshja e Perëndis.
Ket klishat ngë m'u ndodh të pirpiqnja kurrë një lypës, ose një ptokos, ndose do të hinej, do t'ish i pirzënur jasht.
Klishat jan lloke për borgezet.
Lloket e perëndivet do t'jen grazhdet, ose buzët e udhëvet, ose praget e dyrvet e sallëvet ket dreken të pangosurit...

31 të Janarit 2007.

Prirrem e djovasinj këtë frazë t'Aristotilit (Politika:1337 b, 11):
“*Diò tàs te toiaútas téchnas, hósai tò sôma paraskeuázousi cheïron diakeïsthai, banaúsous laloûmen, kai tàs mistharnikàs ergasías: áschlon gàr poioûsi tèn diánoian kai tapeinén*”.

“...*banaúsous laloûmen, kai tàs mistharnikàs ergasías ...*” - thomi të trasha (vulgare) edhë veprimtaritë për turren, për të holla. Veprimtaritë ng'jan të trasha për 'ta, po i bëjin të trasha të hollat – e sesà më të holla fiton sa më i trash jë. Mejtò sa të tresh jan jatronjë të fitojn sa fitojn sidomos mbë dhëmbjet e të njerëzvet...

Prandaj, çë do veprimtari do të bësh, edhë ajò çë të duket më njerëzore, ndose e bën sa të bëgatesh, bëhet më e trasha.

Sa të holë jemi na (të pakët) çë dhuromi çë do bëmi, pa dashur fare gjë prap?

Pse është megalopsyhji mos t'i kesh bëzonj mos njeriu, po t'i ndifish me shpejtësi (*megalopsýchou de kai tò médenòs deïsthai è mólis, hupérteïn de prothýmós* – Arist. Ethikôn Nikomacheiôn, 1124 b, 17). E është e megaloprepies e Tënë Zoti të bëshë ngagjë gratis.

Te vulgariteti i moshës sonë: “*Senza denari non si cantano messe*”. Kështu ket, dashuria... kështuethënura...

*** **

Na e arrù sot ki dëlud: e shoqja e berluskonit ju fry të shoqit pse aì i pat kujdhës ndonjë dy o tri asì shkundabythë e shkundasisë, pa artë as anë, çë nga dita na selljin më shpi faregjën e programevet e televizionës.

Na shquar zëmrën kjò grua, çë u ndie kështù e dhëspëruar sa i shkruajti njëj ndër më të mbëdhenj xhornel (gazeta) t'Italis sa të deklaronëj gjithë dhunin ç'i qelli i shoqi. Sesì mundi i shoqi t'i çanej gjithë jetën e përsosur, pjotë lila, tek u kish vën aì i shkret si regjërëshe ket regjëria e tij? Si kle se aì ngë kle një shoq i përsosur si princet ket prallat?

Ketà ture parë gjithë atò soap opera çë dërgojin ket televizionat e tyre mbaruan se i patëtin besë.

Po Veronika kish t'e pandefnej se i shoqi mund t'i bënej, par o vonë, skercin ç'ajò i bëri të shoqes e parë e tij?

Pse Veronika kishë t'ishë më dinje beje se e para shoqe e berluskonit? Ka i vin kjo mendemadhësi?

E thon se këtë jan mbronjësit e fëmijës.

Po ndërsa jam e shkruanj me arrën lajmi se berluskoni tash iu përgjegjë të shoqes. Sa t'i lypin ndëlesë. Publikisht. E duan se si perëndit: gjithë bota ka të ndanjë dëludhet e tyre.

Si personaxhet e televizionës këtë përmierjin përpara gjithëve. Pa turpë. Po me mikrorepì.

Po dhëmbja më e madhë është se ki dëludhë vjen e na tandon paqjen dhjà nani ç'ish'e përgatitshim për S. Remo...

“Zo s'past
pula pjast
gjeli rroftë
e na këndoftë”.

Thot një filastrokë e djaleris sime, te ku pula është Veronika, e gjeli berluskoni – vete pa thënë.

2 të Fjavarit 2007

Me arru këtò ditë që shkuan kjo kartë të Giuseppe Gramis, pra që haristisa për librushin arbërisht “*Il paese del cuore*”, mbë të cilin tash shkruajta.

Kopjonj kët kartë, jo për shurbiset e mira që thot për mua, por sa të dimostronj se kur e kè për mbrënda gluhin, bëfe alfabet i vetëm, pa skollë e pa gramatik puriste. Na shkrufemi, e u shkruajtëm ngamon arbërisht, pse botën që kish’ të shprehjim, doj shprehur arbërisht. Ki akund dimostron edhe se një kojne eksiston tash e se ngë nevoli të vem’ t’e xëmi mosgjikun, sidomòs ket “gli sportelli linguistici”, si domos te skollat e ministerit.

Giuseppe Gramis do njohur pse është një personaxh i veçant për mua.

Është i njofur Ungir si “Pin’i nanis”, ose Pin’i mëmëslartë, pse kle i rritur, kur qindroj i varfër, ka nana e madhe.

Pat një djalëri të vobtë e ish i destinuar të bënej kusturiarin, kur, tash i math për skollin, i erdhë ëndi i studimevet. Po këtò shurbise i rrufien ai i njëjti ket librush’i tij. Dua të mbanj mend se edhe Ndon Sasoni pat të njëjtën fat, edhe ai zu fill e studhjoj kur ishë tash dishipull ket i njëjti mjeshtëri kusturier.

Fati i kryevet të Ungris.

Dua nanë të kopjonj kartën që më dirgoj. Kush e di mos ndonjetër, që fshefet se ka turp, do t’e marrë kurajin të shkruanjë sesì ndien për mbrënda.

Shkruan Pin’i nanis:

“Ti ng’je një koc’e bjerrë, je Nandini pa difjete; je Nandini i mirë si buka e grinjë që del e ngroft ka një furrë pa rruhun; je i njomë si gjiza që pikset e bardhë ket kakav’e masarit; je i butë i butë e vrushkullon urtsi si shatëvana ka Piruka.

“E kam besë se dhon Fernandi t’erdhë nd’ëndrit. Mua aì ngë desh të më dinej më. Më pruar çerin ka shumë motë. Kush t’e

thot që muar vesh të shtrëmbur, ç’i fjandasi koca. Gjë që bëra, ç’i dha mbaç e e muar a mallu. Ng’i m’edhë më nd’ëndrit. Nani, mbase, do të bënë paqë. Thuaji, kur t’e shoç pupà, se u e dua mirë si më parë. E ndose i bëra gjë, i lip të falur.

“E mban mend atë sonet që dhon Fernandi shkruajti pir Xhilden Epifanio, që ti më dirgove, një herë, shumë e shumë motë prap?”

“U, ahirna, ja dhë të motris tije, zonjis Pipin. Kush t’e thot, mund jet se ai e muar a mallu e ç’atëherë ng’e ndiejta më afër.

“Beato Sasoni, ndjè zot, që qe shoku it më i miri, e u zvodh ture gudhirtur dashurin tënde. Murgu u, kursë, që të pë pak herë e më qindroj ngllikza jote ndë glacit.

“Mos më lip numerin e telefonit, eni rrimi si jemi sepsë dufemi më shumë. Qindromi si ajò nuse e ai dhëndir që kan turp të pirpiqen. Dashuria jonë ka të rrier shtuaru e tërë, ngë ka të shkoqet si argoma muajin e llonarit. Më tutjè... njetër herë. Mos e ndiej se thom kështù.

“Një perfaqim tije e gjithë familjes tënde.

“Pin’i nanis.”

Pini është personaxh që ngë buar fare gjë të mesjetës ka e cila vinjë edhë u. I ka besë ëndravit. Ai shef prrëzë gjithë të vdekurit, me të cilët pat kifari kur jetojin e ishin o dhon Fernandi, o nana, o gjithë gjitonët të cilët u bënë personaxhet e rrufiomet e librushit të tij.

E më e më kish kifari, ndër ëndrret, me dhon Fernandin, i cili klë personaxhi më i veçant ket gjella e tij, pse “më nxuar gëlpërin ka duart e më vu librat”.

Shpesh më thoj se e ndienej prrëzë, prapa krafëvet: “Ahirna mbëlinj sytë e ngë prirem prapë pse jam i sigurt se doj t’e shinja prrëzë mua dhon Fernandin. Të vdekurit ngë vdesjin. Të rrinë prëzë njera ç’i ng’i bën gjë”.

Sigurit’ e të sigurve mbi ç’është e vërtetja e ç’është nj’ëndërr...

Pini na lënej nga herë të çudhitur: u i jipnja dorë Pinit, e Pini rrufienej. Nga mon arbërisht.

8 të Fjavarit 2007.

Më pëlqen të përkthenj (ngamon si mundin – vete pa thënë) disa auktore që vete ture djovasur e që më thon gjë mbi situatës sime (sonë) mërgjimtari.

Këtë herë i nget Julia-s Kristeva, e cila është njetër ndër atà të huaj që lanë gjufin e tyre atëdhetare e shkruajtjin françizë.

Kristeva është bulgare, e është shkrimtare françizë e madhe, si Mircea Eliade, si Cioran.

Thot Kristeva ket një intervistë e botuar në një librush me titulin “*Au risque de la pensée*” (*Edition de l’aube*):

“E vërtetja jonë (imja e edhë, guxonj të mejtonj, e vërtetja e nganjëj) ngë qendron ket të përkaturit njëj rrënjëje – megjithëse kjò eksiston e dufet t’e njoftmi – po te zotësia të bëfemi mërgimëtarë, vjen me thënë të marrëshë një llargësi ka rrënja. Rrënja është një ëmë, një gluhë, një biologji. Megjithatë bëhemi na, me vetëhenë tënë, te çasti ket i cili na bëhemi të lirë ka atà. E është një liri pa sosome. Njota pse mërgimi është fjala më e dreqtë. Mërgimi është një proces vùajtje, ka njera anë, e, ka e tjetra, të zgjedhje, po është një udhëtim, një rrugë pa sosome...”

Mejtonjë “*ksetetejan*” e Etravet tanë aq të krishterë se paganë. Filosofrat të mbdhenj si Pitagora e Platoni predhikuan “*ksetetejan*”, t’i bëfesh i huaj “*kësaj jetje*”.

E t’i bëfesh i huaj edhë vetëhesë tënde...

16 të Fjavarit 2007

“Qui m’y a mis? Par l’ordre et la conduite de qui ce lieu et ce temps a-t-il été destiné à moi? Memoria hospitis unius diei praetereuntis” (Pascal, Pensées 205).

Jo ket ki lok tekù sod banonj, po Firmozë, kush më vu? E thom Firmozë pse ka do vete rrënja të rri kalosh, si të rri kalosh nostalgi’e prejardhjes, te ku banonje indiferent par se të vinja ket ki motë e ki llok, tekù nga dita ke të bësh ftigin e dhunin e vendimevet për të shpëtosh atë ndryshim atë “*eterotes*” që të lë t’jesh. Na ngë kemi kifari me e vërtetjen po me vendimet tanë. E këtë vendime jan dhuna që ngë kan të rrëfier.

Ruini thot se fjet për t’e vërtetjen.

Të tijat jan vet vendime të zgjedhura për këtë mot, e për këtë llok që ja thon Itali.

Pse na ngau ki motë e ki llok?

“Memoria hospitis unius diei praetereuntis...”

*** **

Sot jam pa fuqi e pa vullnet e libri që jam e shkruanj për nderim Kaparellit prëfët ka çotitë time... ai do fuqi e vullnet. Do radhë, gjithë radhën që kishë Kaparelli ket veprat e tija. Po ai ish i udhëhequr ka matematika, ka armonia e përpjestimevet...

Po djovasinj këta shenime ket Pascal: *“Je sais un peu ce que c’est, et combien peu de gens l’entendent. Nulle science humaine ne le peu garder. Saint Thomas ne l’a pas gardé. La mathématique le garde, mais elle est inutile en sa profondeur”* (Pensée 61).

E më shton tutjè: *“J’écrirai ici mes pensées sans ordre, et non pas peut être dans une confusion sans dessein: c’est le véritable ordre, et qui marquera toujours mon objet par le désordre même.*

Je ferais trop d'honneur à mon sujet, si je le traitais avec ordre, puisque je veux montrer qu'il en est incapable” (ibidem, 373).

Po u ngë kam t'i bënj “*trop d'honneur*” subjektit tim, po kam t'i bënj nder Kaparellit e për këtë kam t'jem pjot fuqi, pjot mirvlimë e i radhur... (ordinato)

19 të Fjavarit 2007.

Sot më vdiq maçja. Kish' të thonja: më spovisi. Pse na arbëreshë vëmi ndryshim anamesa vdeqjes së kafshës e të njeriut. Kafsha spovisin, njeriu vdes. Po ture gjelluar te qitetët moderne ndër apartamentet, kafshin shpije e antropomorfizua. Për kaqë maçja më vdiq. Më vdiqë Moira.

Kish njëzetë vjeç, si kur se thua njëqind vjeç për një njeri.

Ka dusà vitra që kish bjerrë të parët e ndomos se ish e verbër vej rreth rreth shpisë e sigurtë.

Hipej te shexha, pra këcenej te tavolini i kopjuterit, e ture skanzuar librat, e sidomos tastjeren pa ngar kurrë një tast, kapërcenej te praku i dritësorës, ulej e paqëme përballë diellit e bënej, atë ç'u thonja, një mejtin Zen. Rrofollimi, i lezë i lezë, i saj ish shenji se ish te paqja më e madhe.

Kur ulësja te divani të djovasnja, e kisha ngamon te prëfri, sidomos kur djovasnja Platonin, sikur se edhe ajo doj të ndanej me mua atë paqe që atà shkrime më vën ngaherë më zëmër.

Kur banonja Firmozë, te djaleria ime, ngë kishim këtë afërsi me kafshin shpije.

Qen, maçe, dilëjin e hijin ka shpia e mos njeri i vëj kufi.

Vet qeni gjahtar, i atit tim, ish i ruajtur me kujdhës, kish të ngrënit e tij, e kish një llok më shpi te ku fjëj.

Maçet vejin e vjin ture rrethuar gjithë gjitonin, mbjdhëshin më shpi vet natën, e muajet e dimrit rijin e ngrofëshin ket polica. Më verë mos ngj'ishin më hjë, vëfshin te praku dritësorës sa të ruajin diellin që perëndonej.

Hajin kur kishin u, e pijin kur kishin etë. Kjò ish gjella e tyre dreqë si ajò e t'urtravet Taoistra.

Kan shum të na mësojin maçet...

Mortja Moires i erdhë somenat me sytë të kaltër e jatreshes veterinare, një vajzë shum'e burkur, mike e tim biri, Nikollit, ai që bënë natyralistin Groset, i cili na porositi mos të lëjim maçen në vuajtje.

Ka disa muajë ç'u kish firasur e tërë. U kish bënë eshtra e likur. Ngë kapërcenej më te praku i finestrin.

Kishë tri ditë që as hanej as pinej. Ngë rrinej më te lloku i saj, sipër divanit. E ultë më truall, ngamon me kryet e veshët të drejt, pa një shertim, dukej se kish marr librazbyth ka gjithësej. Sigurisht ish'e prit mortjen.

Ime shoqe kërkonej t'i jip ndonjë pik klumështi me gjishtin, po refuzonej nga gjë.

Kur ja arru jatresha i vate përpara sikur se dij që dhurat ishe i sill ajò.

Kur jatresha e pa, tha: "Maçet nëng rrëkojin. Po mund t'jet se, këtë e një cik, do t'i vijin konvulsjonat. Ndose ngë doni se ka të vuajë, nani kem't'e qëllomi".

U ruajtëm ndër sy, u e ime shoqe, e me vuxhën që na dridhej i tham: "Bë atë që më mir për të".

Ime shoqe muar maçën më dore ture e karicuuar e jatresha i bëri një njicjun.

Ngë shkuan pes minute, e Moira, na la.

E varrostim përposh një pishë ket kopshti i dusà miqëve tanëshit, ndërsa maçj'e tyrve erdhë e u ulë te buz'e vërës që Elio na kishin përgatitur. Një parë korbra u ngrëjtin ka degat e pishit ture thërritur.

Jam e mejtonj mbë eutanasin që i dham Moires.

Është kundër natyrës? Një minut më shum që i kishë shtuar Moires? Mund t'jet konvulsjonat?

Nartyra ngë di çë bën. Jemi na këtù sa të dier natyra çë ka të bënjë.

Na jemi natyra, natyra me ndërgegjshme.

Ngë jemi gjë ç'është jasht ka natyra, edhë kur jem'e bëmi gjë, të kështù i thën, artificjall, jemi e bëmi ngamon gjë të natyrorë.

Kur këmilli mejtoj të bënej marrocin teku fshefet, bëri gjë artificjall or natyror?

Na jemi natyrë çë mejton, e ndose bëmi shurbise të shtrëmbura është natyra ç'ë e bën shurbise të shtrëmbura...

Vajt'e djovasa, si aì i mallkuari intelektual çë jam, librin e Kunderas "*Lehtësia e padhuruashem e qënies*". Edhë atjë personaxhet, Thomas e Teresa, i bëjin një eutanasi qenit të tyre ç'ish i ngrën ka një kangarè.

Kundera shkruan: "Mder njerëzvet, qeni ngë ka shumë privilegje, njeri ndër këtë është se eutanasia për të ng'është e ndaluar ka ligja; kafshës i nget një mortje mëshirpjote".

Mejtova sa njerëz ngë patën këtë drejtësi, këtë privilegj.

Kujtova mikun tim Sasonin i ngrën ka leuçemia, i pakësuar, i riduçitur, një grusht vuajtje...:kush e di ndose patë privilegjin e mortjes mëshirpjote.

Ngë hinj te ki diskutës ket i cili duket se kan drejtësi fjalje vet dhuna, cinismi, mizir'e klishës katolike... po sesì mund mos t'i jami mortjen mësipjote atyrve të cilëvet dhëmbja, vuajtja i nxuartin nga një personalitet?

Ndienj veshin, më duket se Moira është'e mjaullisin e se do të më hipet ndër gjunjë. Patëtim një marrëdhënie tekù nga një kle pronar'i tij...

Vë mir në kufi Kundera ket i njëjti roman: "Teresa mirpriti Karenin (ki është ëmëri i qenit) Kështù si është, ngë desh t'e ndëronej t'i gjis asaj, mirpriti mbjatu universin e tij qeni, ngë desh të ja nxirr, ng'i pat zili ngatarrimevet e tij të fshefët. E rriti jo sa t'e ndërronej (sesì një burr do të ndronjë gruajen e tij, e

gruaja burrin) po vet sa t'i mësonej një gluhë elementare sa të kapirshin e të gjellojin bashk”.

Sa do të na mësojin kafshat... “na i kemi zili kafshës, thot njetër shkrimtar, pse mot’i tyre është kthim’i përjetëshëm të njëjtit, ndersa moti ynë është ajò vijë e drejtë që ngë ka kufir e tek e cila ngë kemi pushim, moti ynë është mot’i skicofrenisë. Të bjerrë ket e shkuamja që nëng priret, e të ngjatur ket ardhëmja që është vet një’ëndërr, ngë dim’e qindrofemi ket nanishmja...”

Ndërkaq ka fotografia më ruan me sytë (misteri më i thellë, honi më i madhë, i natyrës) e saj të kaltër e ket qetësia e saj më mëson më shumë shurbise se Platoni që jam e djovasinj nani pa rrofollimin të hollë të hollë e saj ket prëfëri...

Të haristis’ Moira, për se sa herë më mësove qetësin, ataraksin, autarkin... e thavmasjen e shurbisevet të gjelles, tek të cilat sqilqen gjithë bukuri’e qënies; e sesi kam të ngjatinj këmbët e krafet par se të tundem, sesi gëzofet dielli e hjea sipër qaramidhevet, si bënje kur të qellënja Firmozë llargu ka gjithë lënesi e njerëzëvet, që jan ndërgegjegjeshma e natyrës po ngë kan armonin tënde me gjithësejin... për tij këndonj: *Aom Mani Padme Um/ përunjem përpara tij berllok i i ngjatur ket zëmëra e qënës.*

27 të Fjavarit 2007.

“Lipoi hymās ploūtos, éphé, Ephésioi, hin’exelégkoisthe ponéreuómenoī” (Erakliti).

“Qofshit ngamon të bëget, ju Fimozjotra, ju Ungërnjotra, ju ka Hora e Arbëreshëvet, etëjt... sa të burthoni sa jini murgjë të vapkëk”.

Mbani mend se Firmozë “murg” vjen me thën “derelitto, infelice”. Për kaq, një “murg i vapëk” është një i vapëk sa më i vapëk mund t’jet.

Djovasnja këtë frazë të Eraklitit somenat, e qindrova i çuditur: “E tha Erakliti këtë frazë, këtë urtësi?”.

Sa herë e djovasa Eraklitin? E sa herë shkruajta këtë frazë për berluskonin ture thënë: “Sa i vapëk ka të ndifet ki njeri sa të deshironjë t’jet ngamon më i qosëm?”. Sa herë ngë mbajta mend se e kisha djovasur ket Erakliti?

Jam harram. E sa më shkojin vitrat sa më harram bëfem. Po kam ka e imja se harronj edhe të ligat që durova..., (e për së dreqëti Plotini thot se shpirti më i mir është ai që harron) e i qeshin gjithëve. Me çerin e piçuçit (kam besë).

Si do t’jet, sa na intereson kjo frazë: sa kem të ndifemi të bjerrë ndose vemi ngamon ture kërkuar sukses, ture kërkuar njeri të na nderonjë, të na ponisinjë. Sesa, për shembull, ka të ndifet i bjerr Abate, ndose vete ture kërkuar gjindë t’e adhurojin?

Ajò urtësi e Etravet tanë që thot: “*Lathe biosas*”, ose “*gjellò i fshehur*” ngë bën për në arbëreshë që ndifemi shumë të bjerrë e ngamon vemi ture gjetur kush ka të na gjegjinjë.

*** **

Jam i vështir. Shkrimet tim jan të vështir. Kam besë për dy o tre motive, ose katër. I pari: Ju qellinjtë te udhë që ng’jini të mësuar të frekuentoni. I dyti: traktonj argumente të vështir e ng’ë ftesa ime ndose ng’i ndelgoni. I treti: përdoronj një gjufë që ng’është e juaja. I katërti: gjuha ka dy nivele: një semjotik e një semantik. Te niveli semjotik edhe mund të kapiremi, te niveli semantik - te ku marr llok – mund t’jet se ngë ka mundësi të kuptohemi. Si do t’jet, bënë edhe u, te ki rast, si poeti grek Solomos: vete ture, marr hua, ose ture bjejtur fjalë që ng’jan timet po i gjasjin timevet. Bënë një sforxim të math – po ndienj se kam t’e bënë. Pse ng’ë beni edhe ju, kush e di mos hereherë ...

Te banda musikale t’Ungris, ish Çiriaku ç’i binei triangollit (trekëndëshit). Dhon Xhesufatit, të cilit i hanej bitha vej ture e

tanduar:” Çiri’, shi se je i bie kundër mot”. E Çiriaku i pergjegjej: Jam konvinto zot ma kam t’i bie”. Kështu mund t’i përgjegjem u atyrve profesorve që thon se gjufa ime ng’ë e pastër: Jam konvinto zotra po kam t’e shkruanj sesi e ndienj – m’e urdheron “dajmoni”, jam i zën ka një “*duende*” / *el dueño de casa/ zot’i shpisë*.

28 të Fjavarit 2007.

E vjen ket e thëna kjò frazë e Vangjelit që jam e djovasinj si nga menat (u Vangjelin e djovas’ grekisht. Noblesse oblige): “... *prosehjete heaftis apò tis zýmis, itis estin hypokrisis ton Fariseon. Udhen dhe synqekalymmenon estin ho uk apokalyfthisete, qe kryptòn ho u gnosthisete* (Luca, XII, 1,2)”. Mos fshefni fare gjë. Çë do fshefni e kini shkruajtur ndë çertë. Kështu atë dashuri doxje, që kemi gjithë shkruajtur ndër ballë. Dashuri doxje që ket bios-i pitagorikë ish i pari ves që vin i ruajtur e, ndose e tradhëtonje, të ndalonej posibilitetin të hinje te skolla, e vinje i përzën jasht.

Dashuria e doxis, ose dashuri’e suksesit është i pari gurë rrethë të cilit vjen i stisur egocentrizmi, psykofilia, deshiri të vendosesh si kërthiza e botës, që kultivon atë frymëmadhësi me të cilin do të bëmi gjë ke faregjëja që jemi.

12 të Marsit 2007

Par se të më vdisë maçja, ngë kisha si të lënja libre mbi tavulinit pse kish’ t’i lënja kalimthin asaj sa të shkonej pa pengime për të vej te praku dritësore. Si the jetrën herë, ajò murga ishë e verbër, po dij si kish të tundej në shpi: sosnej vet se nga gjë kish t’ish ket lloku i saj, ket lloku që Mojra kish ordheruar ket gjella e zakona e saj. Sot që Mojra ng’është më mund të lë libret si do ndodhen. Paudheria e djeshme është úrdhëria e sotme. E kush

thot se gjë është jasht ket lloku i tij – si thot ime shoqe kur më kanoset se vete ture lën shurbiset këtë e këtë – ? Cili është lloku i shurbisevet? Eksiston gjë si lloku i shurbisevet? Është një vendim yni se ai shurbes ka këtë llok e jo atë të tjetrin e ahirna vëfemi n'akord se shurbiset kanë të jen kështu e ashtu... po kur ime shoqe thot se oda ime është pjot paudhëri çë do të thot?

Ëh, ka ligjë Jan Bellushi se urdhëri i gluhës ka të jetë kështu e ashtu, po kush mund të më urdheronj se gluha ime ka të jetë kështu e ashtu? Bellushi mbaron te gluha si sistem semjotik jo semantik. Nga një gluhë, juaja, imja, e tyrja, ka gjithë urdherin e saj, nga njera ka gramatiken e saj. Kështu kur isha më skollë e bënja profesorin adunarsha se gabimet e nxënsvet ishin gabime vet për gramatiken time. Kisha vet të xënja urdherin çë gluha kish ket koca e të nxënstit – çë doj respektuar. Po skolla është vend'i censurës i gjithë shurbisvet çë klen deklaruar si të jashtzakonshëm. Sa pat' të harronja sa të gjënja vetëhenë time e sa të caktonja, se si artisti çë jam, se urdërin e shurbisevet, çë varën ka u, e caktonj u – semiologjikisht / jomundësia të kuptohemi e se të komunikomi për se drejti. Ki diskurs më qëllin drejt drejt ket ai i poesisë. Zefi Skiro Di Maxho thot se gjuha është muzikë – e thoj edhe Platoni /*ἀὐτὴ ἢ Μοῦσα / Musa e njëjta*. E ka ligjë Zefi, ai është poet e di atë çë thot. E poesia nëng mund të përkthefet.

22 të Marsit 2007

Shkova gjithë këto ditë çë kaluan, ture i vatë prapa librit çë jam e shkruanj mbë filosofinë e Kaparellit. Diskursi është e bëfët nga dita më i komplikuar. Hapin një derë e ke mbjatu të hapish njetër. Diskurset i mbështjelen rreth vetveta e njëjët e tyre. E këtë vlen ajò e thën litiret e Senekas i cili edhe për Perëndinë thoj: “Semel jubet, semper paret”. Vjen me thën se njëherë çë zgjodhe diskursin pra të qëllin ai ku do.

Si ndodhet kur je pindaksin. Vlen e para pinielatë, epara e dhën furçi, pra ngjiret ka të ven ku do ajò. Këtò ditë ngë shkruajta vet po edhè pindaksa. Dy orë skruajta e dy orë pindaksa.

Pindaksa te një kuadër të math nj'ulli ç'është ka ca mot temi imë i parapilqier.

Kam te kryet ullinjët e Firmozës anamesa të cilëvet u rrita. E mejtonjë edhè ullinjët e Zefit që rrethojin shpin e tij ket dheu ç'i la i jati në fushat e Horës së Arbreshëvet.

Kuadret e mi jan të pambarur, ndomos se i nënshkruajta. Po ven si fjeta të ditarit tim. I cili për kët muaj mbaron këtù.

I botova te kompjuteri. Vete pa thën se ngjiret e kompjuterit ng'jan ngjiret e kuadrevet... e se mëkati më i madhë është të burthosh kuadre te kopjuteri ose që shkojin ket syu mekanik...

S'ka ligjë Benjamin, ket *“qeroj i riprodhimit teknik i vepris së artës”*: ngë biret vet *“Hjea”* e vepris po vepra e vetme..., riprodhimi teknik është varr'i artjes...

24 të Marsit 2007.

Kisha taksur se për këtë muaj ngë do të kisha shkruajtur më. Po si bënj mos të shtonj këtë varge për një faktë që m'u ndodh sot? Isha te markati i Rivarolo e më ndaloj një vajzë fort e bukur, po me një buzqeshje të karit si kan gjithë ato që kan një mikrofön ndër duar e prapa krafëvet një llofar me një telekamer sipër mushkut.

“Posso intervistarla? Posso farle due domande?”

“Sì, perché no, visto che sono di buon umore? Qual è il problema?”

“Vorrei sapere come si vive a Rivarolo. Non è vero che è una città attiva, vivace?”

“Che cosa vuole sapere, quello che penso io o quello che si attende di sentir dire indirizzandomi la risposta?”

“No, quello che pensa lei. Non le sembra che Rivarolo sia negli ultimi tempi diventata una cittadina molto vivace?”

Kam t̄ armatosem me “santa pazienza”.

“Allora, facciamo così, visto che lei ha un bel musetto, invece di mandarla a quel paese, le rispondo non quello che vuol sentir dire ma quello che mi pare. Rivarolo negli ultimi tempi è davvero cambiata. Da città operaia, a città bottegaia. Ma la sua tristezza è rimasta la stessa. Prima sfiancavate gli operai in fabbrica e gli facevate passare la voglia di un sorriso, oggi l’avete riempita di bottegai che sono per definizione la gente più triste di questo mondo, i querulomani per eccellenza, pronti solo a lamentarsi e fare gli usurai quando gli capita – e non c’è gente più triste e più trista degli usurai. Capisce cosa voglio dire? Che cosa fa il bottegaio? Come le puttane attende i clienti. E intanto che attende i clienti che fa? È affacciato alla porta con le mani legate dietro la schiena, incapace di fare alcunché, di pensare alcunché. È la gente meno umana di questo mondo. Se per umano intendiamo l’animale capace di pensiero. Pensare significa fare. Che fa un bottegaio? S’annoia. Facessero almeno all’uncinetto.

Rivarolo ha la noia dei bottegai. Non c’è più un artigiano, non c’è più un contadino. Li ha mai visti gli artigiani al lavoro? Un ebanista, per esempio. Un sarto, un calzolaio, un doratore, un rilegatore di libri? Quanta intelligenza ci voleva? Qual è l’intelligenza del bottegaio? La Partita Iva? Ci pensa il commercialista, altro gigione senza pensiero.

Che cosa vuole che sia Rivarolo? Un grande supermercato all’aperto, come Torino d’altronde. Ci fosse almeno quella vucciria che c’è in ogni strada di Palermo. Ci fosse almeno uno stigghiolaro, una focacceria che mentre ti servono un panino con la meusa o ti arrostitiscono le stigghiole ti raccontano di tutti gli sticchi e di tutti i sacramenti...”

Ajò që më intervistarin bier buzqeshjen piçuçe. Ngë kapirin që jan stiggjollat e që është panini me “la meusa” eli sticchi.

E u vazhdonj e fjas.

“La tristezza del bottegaio. Ha mai osservato un contadino che prepara la terra per i provini? Non sa che cos’è un provino? Non ha mai visto una donna che fila la lana? Che cosa c’è di esaltante in una città di bottegai? In una città dove si vende solo ciò che è prodotto altrove, che è creato altrove magari in Cina? Abbiamo affidato l’inventiva ai Cinesi. Di che cosa possiamo esaltarci?...”. Ngë vë më rë se jam’e i fjas njëj marcjane e se edhë u i njëjti jam një marcian.

Këputinj diskursin e më vjen një buzqeshje piçuçi edhë mua.

Një trim më paraqitin një fjetë e më parkalesin t’ja nënshkruanj: “È per l’uso della sua immagine”.

“Perché ho un’immagine? Ci pisci sopra se vuole. Non sono mica un piccolo borghese con l’ossessione dell’apparire o della proprietà privata. Son povero, come faccio ad avere una immagine? Alla mia immagine, se lei la trova, ci pisci sopra....”

1-8 të Prillit 2007

Shkova Paskët Firmozë te ku pirpoqa me shum kënaqësi atà të dy o tri vajza e trima që kisha tash përpjekur gjatë verës e vitit që shkoj e me të cilët kisha lidhur një miqësi të hollë me diskurse që hijin ket problemet e gjelles së tyre, sidomos për studimet që jan e bëjin ture gjegjur vet vuxhin e markatit të punës.

Pisërofej Ana Maria: “Jam e bënj studimet pa entuzjasmë. Do të kisha një vokaxjun të më mundënej e tërë e t’i jipë domethënie jetës sime. Ndienj se jam vet e qellur ka të tjerët e se ng’e zoteronj u gjellen time”.

Kur e përpjek nanì ka të njëjtën problem. E kur i rrufienj gjellen e Kaparellit, i cili sa të zoteronej gjellen e tij te modjeli pitagorik,

dreq sesi e ndienej ket shpirti i tij, teku ndienej një vuxhë e madhe ç’e thërrit, refjutoj karrjeren universitare sa mos t’ish i helqur gjetskë ka vokacjona e tij. Njohu fatën e tij e këtjè u shtu me atë “*amor fati*”, të cilit thufet.

Ana më ruan e çuditur e shertron: “Avere un destino”.

Kjò është jav’e bindjes e të fatit të qellur njera te fundi, edhè ndose te fundi është një kryqe.

Të deshirosh një fat vjen me thën se deshiron nj’unitet për të mbjedhësh në një shumizin çë jemi. Ana Maria mund t’jet se deshiron kët unitet... Sigurisht deshiron t’jet e vënë e vetëm pa ndërmjetarë përpara gjelles sa t’i përgjegjet me vetëhenë e saj vuxhës ç’e thërret...

Nga një ndër nesh është i thërritur ka një vuxhë çë do të na bënë të njëjtë, po kjò vuxhë çë na thërret sa t’jet e gjegjur do qetësi. Do se ngë kem t’i gjegjëmi mosnjë të tjetri. Sidomos do se ngë kem’ t’i marrësh vesh parastoqevet çë bota e njerëzvet piksin për merit e ekonomisë ç’është sot perëndia më e gjegjur.

Mund t’jet se Ana do të gjegjin vuxhin çë do t’e qellinj ket ai rrëzikë ç’është një gjelle autentik.

10-11-12 të Prillit 2007.

I shkonjë Romë këtò ditë. Vizitonj për të enesmin herë një ekspositë të Chagal. Qindronj si nga herë i magjepsur ka ki artist ç’u bë ket ndiemja e vogël e mundi gjithë të mbdhenjët.

Qellinj rreth Romës time rë spanjole. Hipemi e zdrypemi ka Gianicolo. Vemi e hami ket një ristorand të judinjëvet te Portico d’Ottavia. Shkararmi gjithë Trastevere. Ecmi për orë e orë. U Romë ngë hipem kurrë ket një pullman ose te metropolitana, tundem vet më këmbë. Qiteti sesi dushqet nëng më lodin.

I lë gjithë të çuditur: “Mund t’ecish gjithë këtë mot? Si e mundin”.

I përgjegjem se kam dy këmbë e se mosha më bëri më qendrak.

13 të Prillit 2007.

“ *April is the cruellest month*”. Më vjen nxë ki vjersh i Eliot ndërsa ng’e mundinj të dal ka slliba. Edhë mëma te telefoni më thot se është pjetë gjumë e se ng’ja arrën të bënj fare gjë. Thot se është paravera, ndërrim’i stinës.

Thom: u lodha Romë ndër këto dita. Jam e i paguanjë dëtinin kurmit.

Ngë m’e k’ënda të bënj fare gjë.

Kërkonj të djovasinj, po më bien kryet. Kërkonj të fjë, po më zgardhallisen sytë. Më zë nevroza. Ahirna i lipinj ndifmje muzikës.

Ulem me bithët më truall, si meriton mejtimi yoga. Ke t’jesh i qendruar më dhë sa të marrshë ndo një fuqi.

Hipet muzika e njëj llahuti indjanë, një “sitar” i bashkuar ka tambure. Pra hin një titarot çë me shkallat e tij duket se do të më hëlqë ndër qiell. Këputinj gjithë kujtimitet, gjithë mendimet...

14 të Prillit 2007.

“*Nun ç’è nenti ki shtudjari*”. Si thot Zefi. Është njëtër ditë me kryetë të vargrisor.

Sot është dita e Mozart.

15 të Prillit 2007.

Sot më ndifi Beethoven. Pra i lipa lipisi Vivaldit, e pra akoma Rimsky-Korsakov-it me “Sherazad”, me atë vjollin çë ka gjithë

lotët e njomësisë që do të bëjmë mir të qajim. E pra i thërrita “Paraverës” së Stravinskij me muzikën e saj që ngë ka te bota gjë më Djonisiak ...

16 të Prillit 2007.

Mosha më rrigallarti allergjin. Somenat kam syt që më digëlisjin. Hunda më pikon. Më ha gjithë kurmi. Kam kocën të rëndë si një thesë gurësh. Më vjen gjum. Dherat rreth shpisë janë pjotë arvore me lule e bare të ligjë për mua. Graminacat. Te kopshti janë e presjin bartë, kam ket goja gjithë pjëfut që ngrën makna që është e e tndon.

Dua vet të fjë. Vë te lektor'i CD muzikat e Shostakoviç-it. Më vijin mejtime që kanë kifari me muzikën e sferëvet qiellore të Kaparelit e të Pitagorit...

17 të Prillit 2007

Im bir më sheh se shkruan arbërisht e më shanë: “Ma chi te lo fa fare? Chi vuoi che ti legga? Perdi il tuo tempo come un nevrotico compulsivo che ripete sempre gli stessi gesti senza senso...”.

I përgjegjem se fakti se u leva arbëresh ka t'e ket ndonjë domethënie. E mos ng'e ka, dua t'ja jap u. Na jemi këtù sa t'i japmi domethënie shurbisevet. Sesi thot Descartes: “*Shurbiset ng'jan pse i përpyjek ose pse i ngas, ose pse i shof, po pse i piksinj me mejtimin*”. Citonjë ka “*Meditationes de prima philosophia*” ture kujtuar. Ndose u piksinj një jetë arbëreshe me mejtimin mund t'jet se ajo jetë eksiston. Po diskursi ng'është kështù i lezë, pse u jetën arbëreshe e mejtonj, jam edhe i mirë t'e shprehin po pra ndose Bellushi ngë më konfirmon (*consensus doctorum*) se ajo jetë eksiston, ajo jetë ng'eksiston – e sesi mund

t'eksistoj një jetë e shprehur me një gjuhë jo e delirë si imja?
Kan të na qeshjin shqiptarët?

Vet Bellushi, si Papa, ka mundësinë t'i jap patentën e eksitencjes kësaj jetjë o kësaj të tjetris.

Si Limbi. Çë kur Papa, si Bellushi, tha se ng'eksiston, Limbi ng'eksiston. Me një fat i ligë për mua. Donja të mohonja lidhjen e pakëzimit sa të venja te Limbi, tek do t'u kisha përpyetur me shpirtra të mëdhenj si Sokrati, Platoni, mund t'jet Diotima e tëtj... e me gjithë djaloshërat, çë ngë klen të pakzuar. Nani më nget pisa. O parrajsi me peshkopin ka Ungra, me Bellushin (ku mund të verë Bellushi jo mos se ndë Parrajsit?)... e pandefni çë gëzim?

Si Papa mohoj Limbin kështu Bellushi më mohoj Arbërinë.
Time.

“Ke ligjë, i thom tim biri, kush bën e bënj të mejtonj një jetë arbëreshe si imja ndose Bellushi i nigon eksistenzjen?”

21 të Prillit 2007

Mosnjeri thoftë se ng'jam malësor. Sot vam në Valle d'Aosta e u hiptim sipër Champoluc ket një katundjelë me katër shpië e një kambanar ç'ja thon Mandrou. Atjë lam maknën e pra më këmbë u hiptim njera pothuaj 2000 m.

Kle një ngjtje e vështir për mua. Sa u mbjaka? Ndomos se qellnja hapin e alpinit, dalë e dalë, m'u hipë zëmra më gojë. Pa' të qindronja dusa herë sa të mirrnja frymë. Ng'e mundënja të fjisnja me të shoqen e tim kushëriri çë kish qindruar prap me mua ndersa ime shoqe e im kushrir hipshin të lezë si kacamate.

U mbjaka. Një herë edhë për këto udhë venja i lezë. Sa herë u hipa ndër këto mbersa. E mendonj se një herë u hipa me judhçin Mele njera te këmbët e akullit e Monte Rosa, 3300 m.

Ture ecur dalë e dalë, si do t'jet, u hipa ku ishin të tjerët, sipër njëj shkëmbi. Atjë si arbëreshë të mirë haptim tryesin. Bëm

pashkunin ture ngrën kulaçin e Pashkëvet me, sesi do tradhita, saucicë e supërsata. Kush hipet ndër malet kështu lart, ngë ka të mbjonjë pjënsin, as kur hipet as kur zdripet. Po mund t'jet se një arbëresh nëng ha e ngë pi sesa mundin?

Dielli ish i fort aqë sa pa' të nxirnja suveren. Kam akoma se tëtimin e duronjë pa probleme. E kur mundinj, sidomos më malë, më pëlqen të xheshem e të lë të më perqafonjë ajri.

Ajëri ng'ish i fofhtë, si një mund të presë te Alpet. Fati do se simbjët çukat e malevet, edhë ket lartësia ket gjëndemi, jan pa borë. Vrenj sesi u pakësua akull'i Monte Rosa. Çukat jan të zbuluara e akulli është vet ket vendet më të fshefur, ket ngjatet më hjea.

Një herë pata një diskutim me një sicilian që më vandonej detin ture thën se malet sielljin mallingim.

I the se mos një civilitet mejtojë kurrë detin si shpi'e perëndivët. Gjithë mejtuan detin si shpi'e monstrevët. Çuk'e malevet është ngamon shpi'e hyjnivët. Minerva banon malet, kështu Pulini e të tjerët hyjni diellor. Neptuni i cili është hyjni'e pasionëvet të zeza, është rregj'i ujëravët të krypëm të shterpë (kështu thojn të lashtët, po deti ka gjelle drejt si bota),.

Ture ruajtur ka çuk'e shkëmbit ku ish'e mirrjim zëmrin, m'erdhë nxé judhç Mele i cili kur j'arrum ket këmb'e akullit të Kastorit mbi Monte Rosa më tha: "She' sa lart të solla. Përsipër tij nani është vet Perëndia".

28 të Prillit 2007.

Jam i marr sot ka dëmbj'e kryet. Kam si një rreth që më shtringon ballët. Nd'ish akona e gjallë Rozin'e Rakajelles do të më thoj: "Ti bir je i marrë syish".

Kur do të më djovasinjë Bellushi, jam i sigurt se do të thot: "Kjo ng'është shprehje firmoçëkanje". Pse mos njeri Firmozë sot,

ndose ja thua oralisht, do të dier që vjen me thën “ i marrë syish”. Disà mejtojin se fjala do ndar “si ish”. E shum jan atà që dhanaren sa të din që vjem me thën pse je i marr “come era”. Dhon Fernandi Manes bridh me këtë sharada. E “ket m’iku thoj” e djovesnej “ket Miku thoj” e dirgonej ket Farmacia e Ungris një djalosh me këtë mbashat: “Di’ al farmacista che ti dia una pomata per dove Domenico diceva”.

Kështu bëfet një sharadë me shprehjen “ndle Zot” që Firmozë e Ungër thufet: “ndjè Zot” e ndelgofet si “nd’jè Zot” me domethënien: “Se Signore ci sei (sottinteso: ricordati) del tal dei tali”. Kështu m’e spjegonej me shumë akribi një i urt ka Ungra.

Përvò, i miri Bellush, sa të kesh besë.

Anxi kish të shkruanja "të luglio". Po drej se kam kifari me mortje kam të jem autentik. E për t'jem autentik ngë mund të shkruanj një gjufë si do ndodhet. E asedhë një gjufë passepartout si mund t'jet "gjufa" (shqipe). Gjufa është lloku ku burthofet shpirti (ndose e ke). E të kesh një shpirt vjen me thën të kesh një botë (un mondo). Vet njeriu ka një botë, e cila është bota e tijë te ku burthofet eksperienca çë patë të qënies. Si thot Heidegger te pirkthimi i Vattimo: (...) "*è la distruzione del nostro rapporto all'essere come tale la vera ragione del nostro falso rapporto complessivo con il linguaggio. Le iniziative per la purezza della lingua e per la sua difesa contro le crescenti deformazioni meritano certo considerazione. Ma attraverso tali iniziative risulta solo, alla fine, ancor più chiaramente provato che, per ciò che concerne il linguaggio, non si sa più di che cosa si tratti*".

Nani bota ime është Firmoza ndë mest shurbiset e së cilës kan domethënie gjithë fjalët time. Për shembul për mua fjala "diathë" vjen me thën gjithë djathët çë hëngra Firmozë me cilët e me akcilët. Për këtë ndose raporti im me qënien e djathit do

t'jet autentik ngë mund thom “udhos” si thon te Hora e Arbëreshëvet. Edhë të thuash “Hora e Arbëreshëvet” ka të ndrishme domethënie se të thuash “Piana degli albanesi”. “Piana degli Albanesi” është një katund të kartës gjeografike së Italis. “Hora e Arbëreshëvet” është një llokë shpirtëror që ngë ka kifari me gjeografin. U ngë di si thufet shqipisht “Hora e Arbëreshëvet”, po si do të thufet, edhë si “Hora e Arbëreshëvet” ngë do t’ish për mua jo më se një tringëll pa domethënie. Non so se mi spego. Ndose jo, ecni e studhioni, pse ju nevojnin shum studhime...

Përkundrazi, mos studhioni fare. Gjegjëni vet Shpirtin, fort i harruar ture i vat prapa urtësis së skollëvet. Shpirti ngë ka kifari me skollët.

*** **

E bëri të prasmën Papa. Vet ket klishe katolike rronë e Vërtetja. Vet papa e Ruini (rruina – nomina sunt numina) jan të zgjedhur ka e Vërtetja.

Të zgjedhurit...

Një herë gjegja këtë frazë Bose (më mire gjermanisht: Böse), i cili është një vend te ku gjëndet një monaster tekun jan të mbjedhur gjithë të “zgjedhurit” (e po që jan “di moda”, jan më të zgjedhur se, vëmi, frangjiskanët). Këllogjeri i math zu fill një predhëk ture i thën të tjervet këllogjere: “Na të zgjedhurit...”.

U që ng’u ndiejta kurrë i zgjedhur u ngrajta ka karriqja ket isha i ulur e dolla ka qisha...

13 të Llonarit 2007. Te Hora (Hora e Arbëreshëvet).

Si nga vit erdha te Hora të gjënja Zefin. Kjo visitë më ngrakon nga herë. E mos ngë vinj sa më pak një herë ndë viti te Hora,

ndifem i bierr. Diskursi vete mbjatu mbi librin e Mandallaut “*Mundus vult decipi*”. Djovasinj si do ndodhem kapitolin “Oj e bukura Morè”.

Si do t’jet: pse “oj e bukura Morè” e jo “oj e bukura Çameri”? Pse pipmi “Koronin” e jo Argjirokastrin?

Është e vërtet se ahirna, kur prindët tanë erdëtin ka jetra buzë e detit, ng’eksistonej Shqiperia e se ishë Greqì ka do kan ardhur, po pse pikerisht njeri qajti Morenë? Pse pra prindët tan erdhëtin n’Itali me priftra çë parkalesjin grekisht? E pse u thom “parkalesinj” e jo “lutem”, e cila është fjalë çë Ungir Firmozë e, kam besë, edhé S. Vasilë, pak njoftin?... diskursi bie si gjithë diskurset çë ngë kan themellim ndër dokumendet. Po do t’ishë interesant një kërkim i tillë...

Zefi më thot se kem’ të shkruami shqip sa t’jemi të djovasur ka shum vetë. E më burthon librin antologji ç’i botuan në Shqiperi “Ishuj”. Po sa veta në Shqiperi do t’e djovasjin? E pse ndalon ata çë mund t’e djovasjin në Arbëri po ng’e mundjin pse ngë njoftin shqipin? Dakord, mirë, do t’e djovasinj Bellushi. E u? pse jo u? Pse më ndalon? Ng’jam u një lektor më te kundi?

Po ndose problemi është ki, “politikë”, jo shpirtëror, pse Zefi ngë shkruan si bën Abate “e chi s’è visto s’è visto”? Shkruami litisht e problemi risolviret vetim. Jemi të sigurt se ture hitur ket fjala litire jem’e himi ket njetër fjalë shpirtërore. Pse litiria ka, ka ana e saj, se,si arbrishtja, është fjalë ëmëtare: e xumë kur ishëm të vëgjil.

Me litishtjen kemi pra se ajò është gjufë më e qosme, e e folur ka shum më vetë. Me litishjen mund t’jemi të botuar ka ndonjë revistë litrare e rënd e jo vet ka fjetat “parroqane” tona.

Thomi të dreqëten: ndose Mandallau do të kishë shkruajtur librin e tij “*Mundus vult decipi*” arbërisht ose shqip do t’e kishë djovasur De Leo e do t’e kishë pasur me të polemiken e madhe çë patë? E Vaccaro do t’e kishë tratur me suponenxjen me të

cilin e tratoj? E Mandallau mund të kishë paraqitur librin e tij si dokument për karrieren e tij të kërkuesi?

E ndose e kish shkruajtur shqipisht, si kish mbaruar gjithë kustjuna, gjithë çështja?

16 të Llonarit 2007. Cinisi, Palermo.

Mund t'jet se Bellushi më rri kalosh pse do konsideracionin time, do t'jet i marr parasysh. E u ngë kam fare vështirsi t'ja jap. E bën mbjatu këtë diklaracionë: “Bellushi është më i urti e më i miri ndër arbëreshët. Është më i shkilqieri riçerkator i Universitetit të Kosenxës”.

Po sa mund të vlenjë konsideraciona ime? U(?) ka shumë mot – thomi që kur jam (?) një “swami”, një mjeshtër i yoga-s – praktikonj faregjën. Jam edhe një “Anam” – ose “pa ëmër”. Jam (?) edhe u (?), si mjeshtri im Osho, një “osho” një zero; një, pupani, faregjë; një rreth që rrethon faregjën.

Jam (?), se si thon siçiljanët “*nenti miscatu cu nuddru*”. E ki është fati im (?) i shkilqier (?), fati (?) im (?) i bekuar (?).

Fat që mos ndonjë siçiljanë do të ket. E kam besë se asedhë Bellushi do t'e ket. Jemi, te një menir o njetër, gjithë siçiljanëra. Siçiljani do të jet gjë, si dot'jet. Faregjëja siçiljanit i bën turpë. E sa t'jet gjë i lipën ndihje gjëjavet: petëkavet e të miravet që jan gjë, pozitivisht. Pa petkë siçiljani është fare gjë. E për gjëjat është i gatshëm të vras. Edhë Empedokli, kur j'arru te konklujona se njeriu është ngamon “*nenti miscatu ku nuddru*”, e se ata që rrethojin ishin gjithë “*nenti mishkatu ku nuddru*”, Ai që ndifej një Perëndi, si gjithë siciljanet, u vra.

Po u s'do t'e kem fatin e Empedoklit, pse sa të vritesh gjë ke t'jesh. E u (?) s'do të vritem, pse ndose doja, ngë do të dinja që kish të vrisënja.

Kështu më dispilqen për Bellushin pse, konsiderata që mund të kem për të, është e njëj “*nenti miscatu cu nuddru*”.

Më dispëlqen se pa' të përdorja fjalë si “u”, “jam”, të cilat do të shtien Bellushin të thërres: “Njota si kontradiret, mënjëhere thot se ng'eksiston e pra usarin këtë folje, këtë verbëra (“verbi”, litisht) që konfirmarjin eksistenxjen e tij. *Contradicitur*”. E kam besë: foljet, ose “i verbi”, jan të verbër e verbërojin gjithë atë ç'i kan besë – ose kan besë se prapa fjalëvet është gjë. Realizmi socialist pat këtë verbësi, mejtonej se prapa teksit kish gjë si “jeta këtë jashtë”.

Ndose Bellushi eksiston (ma eksiston Bellushi? Ng'është për rast një fandasë ime me të cilin kërkonj, edhe u (?) të eksistonj ture recituar, ket ai teatër ket i cili projektarinj ëndrret e kujt e dikujt?), ndose Bellushi është i sigurt se eksiston, e do të përpjek atë shurbes ç'është e e ëndrrin, e të m'e thot.

E megjithatë, t'jesh “*nenti miscatu cu nuddru*” ng'është fat i keq, si do dot'e pënxojin siçiljanërat. Vet Perëndia është “*nenti miscatu cu nuddru*”. Perëndia si dihet ng'është “gjë”. Këtë e di teologjia apofatike. Perëndia është eksaktikisht: “*nenti miscatu cu nuddru*” - pse ng'ë “gjë” e ng'ë “njeri”.

Ndose siçiljanërat do t'i vëjin rë fjalëvet që uzarjin, e rëndësis së tyre ontologjike, do të sosjin të ndifshin padreternëra nga herë që ndifen “*qualichiduno miscatu cu qualichicosa*”.

Fati i lig është për siçiljanërat se kur “*qualichiduno*” është “*miscatu cu qualichicosa*” vjen me thën che “u qualichiduno”, *në të e për të (avto kaθ'avto)*, ng'është fare gjë; e se, ndose do t'jet gjë, ka të gjënj gjën e tij jashtë, ndër shurbise që, *në të e për të*, ng'jan fare gjë. Në fund, sidomos edhe kur siçiljani është “*qualichiduno miscatu cu qualichicosa*”, dhja ahirna është fare gjë.

Po tham se Perëndia është faregjëja e gjëjavet. E për të rrier ket fargjëja e saj, e cila është gjithëseja, ngë ka të ket ëmër. Perëndia ng'është padreterni. Padreterni është ëmir ç'i përket siçiljanëravet ose Bellushit i cili do t'jetë gjë.

Sa t'jeshë Perëndi, ke t'jeshë “*nenti miscatu cu nuddru*”, drej si u (?).

Përsëritinjtë: si mund t'i xhuvarinjtë konsideracionja ime Bellushit? E të mos të më rri me fryminjtë përsipër xerkut. Me mua(?) “*c'è nenti chi sturiani*”.

17 të Llonarit 2007. Cinisi.

“Ngë dua të kem epigona”, thotë ai që bën kund se është Nandini – e lozin këtë lozje e lënë.

18 të Llonarit 2007. Cinisi.

Sot pindaksa gjithë ditin, pse është kjo vajizë e bukur që do të xërë të vizatonjtë. Ajò vete më skollë te një profesor, që është e i mashtron ndutu kryet ture i mësuar “*il disegno dal vero*”. E Rita, ki është ëmri i saj, bired prapa shurbesit që ka përpara pse ka t'ë kopjarinjtë i-tillë-e- i-cili. Vë rë ajò se logjika e kuadrit ng'ë logjika e shurbesit që ka përpara. E ki fakt e babarinjtë. Është e mirë Rita të kopjarinjtë shurbesinjtë që ka përpara po sakërdhired se vizatimi që bëri është pa gjelle.

U i thom: ec shpejt. Dy vija sosjinjtë e supirqojinjtë. Ke të bësh një hjë? Sosinjtë një vijë.

Rita do bën ritratinjtë e vëfet “*in posa*”. I japë një shikim, e pra ng'ë ruanjtë më. Me një vijë të njëjtë i disenjarinjtë çerinjtë. Ndër syë i japë një mallkoninjtë që kan gjithë ritretatjtë që pindaksinjtë u. E jëma kish dashur një ritrat me buzqeshje. Po buzqeshja ngë më përket. Rita qindron e çuditur si vet një vijë mban gjithë hjetë pa vizatuar një hjë. Ngë jeton çera e Ritës po jeton vizatimi i çerës së saj e kështu jeton edhe Rita...

Kështu malinkonia e vizatimit ng'është malinkonia e Ritës e cila është e mbajtur ka ajò që Schelling thërret “*Schwermut*”, ose

“*unzerstorliche Melancholie*”. Nje melankoni rrenjësore, që zë rrenjë ket fund’i gjelles. Një melankoni që mbanë nga një gëzim. Ngë ka gëzim pa malinkoni. Malinkonia ngë sosin kurrë. Sosin gëzimi, ngë sosin kurrë malinkonia.

Gëzimi pa malinkoni është një shurbesë padomethënë...

Malinkonia është bukuria e Ritës. E u ngë di t’e vizatonjë këtë bukurì... mund t’jet se vizatova vet malinkonin time ture ruajtur malinkonin e Ritës. Përkundraz malinkonia e Ritës është ktjë jasht pse u këtë brënda kam këtë malinkoni...

I bëra një ritratë Ritës kur ish e vogël, katër pes vjetësh. Çë ahirna kish hjenë e malinkonisë sikur se ndër sy kish atë piejtje pa përgjegjëje: çë jam e bënj këtë?

19 të Llonarit 2007. Cinisi.

Sonde jemi të ftuar ket darka e njëj miku çë ftoj gjithë miqët çë kan shpì te deti Cinisi-t.

Atà çë ngë më njohjin më ruajin me kureshtje. Duan të din ndose jam “*qualichidunu miscatu ku qualichicosa*”. Kam impresjonin se gjithë jan e më masjin me “*ku è kishtu, i unni veni?*”, po çë jam një çë nëng lozin me kartazit, çë ngë jep fare impresjonin se e di të gjatë mbë gjithë diskutet e kësaj jetë. “*Che c’è problema?*” ose: “*che problema c’è?*”, ose: “*Fisa sì? Pirkì nun telefonasti a mmia*”, ose: “*Telefona a mmia ke te lo risolvo io il problema*”. Gjithë risolvirjin problemet e gjithëve. Ti çë ngë ke bëzonjë të risolvirish probleme as tëndët as të tjervet, ti çë ngë ke bëzonjë e miqëvet të miqëvet je një piçuçë i tërë.

20 të Llonarit 2007. Cinisi.

Sot ture dalë ka deti re mbi shkëmbet. U cënova mirë. Poqa kurrizin e kocin e kofshë. Preva gjithë shollin e këmbës së majtë,

e gjithë gjithët. Bora ekuilibrin pse më mangoj forza ndër muskulet e këmbës. Jam e mbjakem. U mbjaka. E mund t'jet se jam si jam nanì pse bora ekuilibrin e mendjes...

Po. Po. Po do t'ish hera të shkruanja një *“De vulgari eloquentia”* sa të gjustifikonja këtë munges ekuilibri ture uzartur kët arbëresh të ri (?). Po ngjepsen jam e e shkruanj ndërsa shkruanj si shkruanj. Çë bëzonj është të vete për udhët e teorisë.

Nanì e të sosinj kjo konsideracion e përgjithshme: gjufa është lloku tekù burthofet Shpirti (trashendental), i cili i burthofet njeriut shumë herë e në menirat më të ndrishmet. Shpirti është historik. Ngë mund t'jet i lidhur ket një menirë e vetme e cila do t'ish absolutixaciona e njëj dukje të vetme.

Na çë ng'jemi idolatra kem'të ruami me një bisht syu çë do na prisintare si e njëjta dukje e Shpirtit. Do të vëfemi ket historia e do t'i lëshohemi te krafet e saj sa të na qellinj ku do: s'mund himi dy herë ket i njëjti lumë. Me etiketën e gjufës së pastër vjen i absolutixartur një aspekt i vetëm, e për gjithmonë, i ndërgjegjes njersore.

E përsëritinj: ng'jam idolatrë.

25 të Llonarit 2007. Cinisi.

“Më mir i pari këtù se i dyti Romë”.

Kam besë se më të shumit ndër shkrimtarët arbëreshë çë shkruajin shqip, bëjin kët raxhonament. Më mirë të parët në Shqipëri se të dytët në Itali. Pse ki është problemi: në Itali ke të masesh me shkrimtarë të njohur ka gjithë bota, ndersa në Shqipëri ke kifari... me kë?

N'Itali sa fuqi ke të kesh sa të masesh me Eco, Tamaro, Tondelli, Ammaniti, Consolo, Camilleri, Calvino (sa të citonj të partë çë më vijin nxè)? Edhë me Abate, thon se ke të masesh n'Itali. Ndersa në Shqipëri, me kë mase? Ngë më vijin nxè ëmre?...

“Më mir i pari këtù se i dyti Romë”.

Mund të bënja një listë ëmresh “di gigioni”... që janë e presjin çmimim Nobel...

Është i qartë se kur shkruan arbërisht bëjnë kundet vet me vetëhenë tënde. E me Shpirtin që frynë ku do, kur do e si do... ket shkretetritë...

26 të Llonarit 2007. Cinisi.

Ditë e mirë sot. Më than se ndose dua se të më shkojin lakosat e këmbës kam t’ë banj ket ujët e detit. Krypa shëronë gjithësej. Si mundinjtë ndë mest shkëmbevet j’arrënjë ujitë e detit e nuotarinjtë (Bellù, pse do të kisha shkruajtur “notonjtë?”), për orë e orë ture u shallartur nd’ujë. Ture vat nën ujë me mashkaren e tubin e pa penda ket herë. Kan ligjë, me ujët e detit këmba e lakosur ngë më dhëmbet.

Ime soqe më ruan për së llargu e është më e qenatur ajò se u se jam e rri gjithë këtë motë nd’ujë.

Kur dalë ka deti, ndër skëmbet – na s’vemi kurrë ket shura, urremi shurat – më jep një ndihmje, ture më ndëjtur dorin, Rita. Është një vrundull, e më burthofet malinkonia e saj. Më dhëmbet zëmra. U dua malinkoninjtë time. Pa malinkoninjtë, pa dhëmbjen e malinkonisë, jeta është banal – vjen m’ë thën se “këtò” shurbise, “kjò” situatë, të kutëndojin: οὐκ ἔσμεν τοῦ κόσμου τούτου.

Dua malinkoninjtë time pse më vë penda lehtësije. Më dhëmbet, e ng’ë duronjtë, malinkoninjtë e të tjervet.

*** **

Sonde i bëra njetër ritratë malinkonisë së Ritës.

28 të Llonarit 2007.

Përshkonj ngushtin e Messina
- Më kur vete në Siqili
Se kur prirem në Kalbri
Botë e ngushët -
I hapët për dheun që njofti shumë gjymëshyjni
Fjalë të ndryshme
Të ndryshme fytyre
Prralla që na losjin
T'*orcinus orca*
Sy të mbdhenj
Are
Ket muzika e idhjomavet
Të ngushët o që zgjirofen
Pa rregull
Si i shtie shpirti
Që interpreton
Botin gjirin zëmrën që mbrazet
Të veshurat e zeza të magut
Të madhit tiap
Që vin ka variu
Si Pan-i i Mazara
Që luan i zënur ka kush e di cili zeks hyjnor

E venë n'xhenxhulla orat
Ket aromat

E të luan mbrënda
Një lënsi
Që të gozhdjasin
Me "*il sorriso dell'ignoto marinaio*"
E turpjen e gruas së Laurana

Lucio Piccolo me të vdekurit mban bisedime

Lehtësi

Çë këputin varesitë, barret e gjelles

Dua të spëtonj me aurigën e Mozia-s

Ture vrejtur kupolat e kuqe

Gurtë mjalthi

Vuxhët e Capo

E Vucciria

Idhjomat që losen

Ket ajret

E kalthërisë

Si loset gjithë

Lodja e botës

30 të Llonarit 2007.

Sanënga j'arrura Firmozë më liptin një "Xaxen". E bëm ket kopshti i Bjazit mozaicisti, i cili u ngarkua të më fotografarnej për arkivin e tij. Njeri do të thot se jam narcisist.

E t'e thet.

Menira më e mir sa të shpëtosh ka gjithë veset është t'i hishë mbrënda. Ketë "fatispecie", t'jeshë narcisist ndër më të thellat.

7 të Gushtit 2007.

E prandaj ngë kemi si t'i thomi kundër papës as Ruinit. Ë e vërtetja se atà kan të mbroitjin besin ka e rremja. Po cila është e

vërtetia? “*Pistevo is ena Theon, Patera pantokratora... ke is ena Kirion, Iisun Christon, ton ion tu Theu... sarkothenta ek Pnevmatos Aghiu*” e tëj..., ose te përkthimi i Zefit S. d.M: “U kam besë te një Perëndi, At i gjithpusteshëm... E te një Zot, Jisui Krishti, i Biri i Perëndisë... e mori mish nga Shpirti i Shëjt...” me atë që vjen prapa... Kjo është e Vërtetja, e njëjta që profeson Klisha. Jashta ka klisha që profeson këtë besë ng’është shpëtim. Gjithë klisat që kanë këtë besë bëjnë Klishin e cila ng’është një klishë e vetëm. E cila ng’është vet klisha kështu e thënë katolike e Romës. Klisha katolike e Romës është vetëm një ndër klisat, të cilat janë dukje historike të Klishës të Krishtit.

Na që jemi të thieshtë ngë duami t’jemi të skandallizuar ka deklaraciona tekun thufet se vet katolikrat e klishës së Romës janë të shpëtuar pse i marrëjin vesh papës. Më vjen shumë vështirë të mejtonte se ng’jan të shpëtuar atë Valdesëra ka Guardia Piemontese që klen të humbur në ditat e 11 e 28 të theristiu 1561. Katolikrat i therrëtin gjithë përpara klishës e s. Frangjiskut ka Paola. Dy milë vetë, që kishin vet ftesin se ng’ishin papistra.

Na që jemi të thieshtë ngë mund të mejtomi se mund t’jetë se do të shpëtofen edhe ordtodoksrat, po gjithë të tjerët do t’i gjëmi gjithë ndë pisët...

Na i kemi besë vet klishës së Krishtit, e duami “*ποικιλία*” e Shpirtit Shënjtë i cili është liri, pse frynë kur do, ku do e si do. Na pilqen një klishë me shumë ngjyre e me shumë arome me shumë drita drejë si atë që u mbështetëtin te kryet e apostujvet...ὅτι ὁκουν εἷς ἕκαστος τῆ ἰδίᾳ διαλέκτω λαλούντων αὐτῶν “*e nga një kapirnej ket djalekti i tij*”.

Nje gjuhë (ose djalekti), është një kulturë, një menirë e ndryshme të kapirishë jetën...

Gramatika e gluha zyrtare e stabilizuar një herë për ngamon është mejt mundësie e përjashtimi.

Vëmi rë se dhja sa u pikës klisha u bënë ndarjet, përjashtimet Pjetri kundër Jakobit, Pali kundër Pjetrit e Jakobit ...

Sa të thomi: djovasimi shumë teologra ortodoksra: Berdjaev, Bulgakov, Lossky, Evdokimov, Sestov ... se sa liri mendje gjëmi ket këta. Sesi ndifet se Shpirti frynë.

Na i kemi zili besës sonë të krishtere e cila do t'jet "*sine glossa*" e për këtë ngë mund të lëmi se mosnjeri do të marrë për benë e tij historike si e njëjta besë. Si gjithë të tjerët jem'e ecmi ket shtegu që na kle i treguar, e i cili, si gjithë tregimet, do t'jet i ndërprer ket dushku ket nga fjalë do të bired, ket nga bë do të humbet. Ki fat na kle i dhën. Me këtë kem' të bëmi kundet. E ket "*gnothi se auton*" na vremi një thirrje, një ftesë, të njofmi fatin që na kle i dhën. E ki fat është fati i krishter, i cili thot se me pakzimin jemi rregjëra priftra e profitra. Nani talentin e profitisë kem' t'e eksercitomi, mos t'ardët pronari e të na thoft: që bëre me atë talent që të lè? E vure nën dhé sa të gjellonje i paqëm, pa shqetësime, pa tandime, pa disturbe? Ti deshe paqen e njerëzvet, jo paqen që vjen ka fati i qellur te fundi".

Nani mund t'jet se ai talent që patëtim ka fati ngë vlen fare gjë, e më se fare gjë mund t'jet se jemi: "*nenti miscatu cu nuddru*". Qoft. Po ndose ka ai fare gjë që pate do të bifet gjë, cili do t'jet çmimi it?

8 të Gushtit 2007

Pra thua: pse fjet kundër peshkopit ka Ungra?

M'e thoni që vijin m'e thën këtë fjalë të marra ka "Contributo del Vescovo di Lungro per il Sinodo della Chiesa Ucraina Greco-Cattolica" (Lajme –anno xviii – n. 3 – sett. Dic. 2006). "*Certo, gli influssi occidentali, in mezzo ai quali vive (scil. l'Arberia), hanno modificato alcuni suoi atteggiamenti...*".

Cilët jan: "gli influssi occidentali"? "Occidente", vien me thën: "Kapitalizmi", "Sekolarizmi", "Globalizmi", "Uniatizmi",

“Katolicizmi” etëjtj... Kapitalizmi, uniatizmi, globalizmi, jan gjithë të siella të “sekolarizmit”, i cili është biri i par i katolicizmit...

Cilët jan “gli influssi occidentali” të cilët “hanno modificato alcuni suoi atteggiamenti” , ndose pra thufet se “*la spiritualità è rimasta fedele alla concezione orientale: spiritualità soda, fortemente aderente e radicata alla vita di ogni giorno, ma anche protesa alla contemplazione della vita trascendente*”?

Vëmi mënjane të njëjtin retorik te ku vlen vet “*il birignao similturiale*”, sesi e thërrita të ndryshme herë, ketò jan fjalë padomethënie, të thieshtë “*nonsense*”. Sesi këtë fjalë që vaxhdojin: “*Fin dal XV secolo, infatti, la presenza in Italia della Chiesa Italo- albanese di rito bizantino ha dato occasione alla Chiesa che è in Italia di esercitare il dialogo ecumenico, dovendo condividere, nello stesso territorio, cristiani di rito diverso e quindi di cultura, spiritualità e leggi differenti*”.

Çë vjen me thën: “*La Chiesa che è in Italia*”? ka kjo shprehie një vlerje që kufizon? E që vjen me thën një Klishë e kufizuar n’Itali? Vjen me thën se ng’është e ngë mund t’jet “*Klisha*” “*tout court*”?

E “*cristiani di rito diverso*”, të cilët megjithatë bëjin “*il Corpus Domini*”, ose novenat e shën Frangjiskut, ose që këndojin “*Sono stati i miei peccati*” me një teologji e mëkatjes që të shtrëmbon veshët e sytë etëjtj...? E “*quindi di cultura, spiritualità e leggi differenti*”? ma jem’e skercarmi?

Fjalë të viella pa një dogmatizmë kritikë (si e thërret me një osimor Bulgakov), i cili kish të vënej ket mendimi se fare gjë do marr leteralisht ndër shurbiset që thufen, e sidomos ngë ven të përsëritura.

“Fjalëvet bajate”, si thonë shqiptarët, kem’ t’i ruami për mbrënda par se t’i përsëritmi. Ng’është rrëzik më i madhë për shëndetjen e mendjes sa të përsëritish: “fjalë bajate”.

Ki është dëmi i shkrimevet e “Lajme”, të cilët po që jan të mbushur me stereotipa, ng’jan lajme, “notizie”, “novelle”, pse ng’jam të rea. Kështu shpirti i “Buona Novella” (të mirit “shurbes i ri”) vete te përroj i mbeturinavet, të rifjutravet.

*** **

Eni t’i japmi, ndose vlen hala, domethënie fjalavet.

Bizantinë, te situata jonë, ngë vjen me thën fare gjë. Priftrat tanë u rritëtin me jesuitrat. U çivostin me tomizmin. Ndose ja pien, ngë din që tha Krisostomi, ose S. Vasili i math, ose Grigori ka Nisa, ose Damaskeni, ose Origeni...

Papas Matrangolo thoj se tomizmi e kish aqë farmakosur me arsyen, me logjizmet, sa kish dal ka Universiteti i Vatikanit, praktikisht, ateist. Pat të prirej ka liturgjia sa të gjënej njetër herë besën. Si do t’jet ngë kish djovasur, për pregjykimin katolik, teologat ortodokse të Ruisë, si Florenskij, Bulgakov, Berdjaev etëtj... që jan llargu ka katolicizmi, që do do të thet ekumenizmi ipokritë i Vatikanit.

Si do t’jet: sesì mund t’jemi bixantinra ndose xum katekizmin e Pio X?

E t’e thet Bulgakov, i cili e thot më mir e me më urtësi se na që jemi gjymëskrze (e gjëmi te përkëthimi litisht: *La luce senza tramonto* – Lipa 2002, pag. 108): “*I dogmi religiosi cercano sempre nuove incarnazioni nella creatività filosofica. Perciò la tendenza della teologia romana, orientata a fare del tomismo una sorta di norma dell’attività filosofica, impone ai filosofi cattolici il peso di un dogmatismo inutile e dannoso, che conduce inevitabilmente all’ipocrisia*”.

“*Dogmatismo inutile e dannoso*”. I cili ndrron lehtësinë e zigojit të Tënëzoti ket një barrë i padhuruashëm.

Te kjò situatë, Bixantinë vjen me thën gjë vet ket minuetet e Eminenxavet që mbjidhen te Vatikani e bëjin garën kushë ka t’i

lërë jetrit karriqen më të lartë me një ipokrisi pa fund: *“No, si accomodi lei che è bizantino, noi latini siamo di casa qui in Vaticano. Si accomodi, si accomodi lei Eccellenza, le spetta il posto d’onore come primogenito”*.

E dhën kjò situatë, mund të thomi nga herë vet atë çë duan të gjegjin le loro Eccelenze? Ng’është yni një mëkat kundër Shpirtit shënjtë i cili kërkon ngamon *“sempre nuove incarnazioni nella creatività filosofica”*?

9 të Gushtit 2007.

Fakti (i keq) është se Eparkia e Ungrës është sot (ndose ng’e kle mosdonjëhere kurrë) një furmë pa përmbajtje. Është një mbështjelle, një veshje, pa një kulturë ç’i jep domethënie. Është një folklor i mir për turistat (sesà i pilqejin turistat, gjithëve), ndose i japmi ngarkimin njëj laiku ateist të na pindaksin ikonat. Ndose pindaksmi ikonat pa esull e pa mundur sytë, pa gjegjur Shpirtin, ture i vat prapa vet zoterisë teknike... pa u dhezur ndër tru si ai S. Lukë i njëj ikonz’e lashtë , sesì mund të thufemi bixantinëra? Kultura jonë është perëndore, umaniste, papiste, katolike, demokristjane. E fashiste. E nënshtruar gjithëve konfomizmevet borgese tipik të irenizmit ipokrit të kujit ka të mbanjë mundësin. I japjin ligjë gjithëve, ng’i dispilqejin mosnjeriu, aqë berluskonit sa Berinottit.

Jemi litinjë ndër më të thellat. E na dhëmbet zëmra të djovasmi se jemi lindorë, bixantinëra e gjithë atò të tjera shurbise të cilat ket situata e sosme ngë kan domethënie.

Protosyngjellin (nunc nuda nomina tenemus) pra bën “il giogione” e vemi gjithë të paqëm ket vapkësia e shpirtit. Pikatu se vet Nandini është i dal trushë.

10 të Gushtit 2007.

Na ngë duami të in/formomi gjuhën, po duami të informomi (duami të jami lajme) mbë gjuhës, ndërsa bëhet ndër shkrimet tanë, sesi ndodhet, si një qënië e gjallë, në formën, që merr formë ndërsa bëhet.

Djovasni, ju parkales, “Estetica” e Pareyson.

11 të Gushtit 2007.

Kur tham se Empedokli u trëmb kur kapirti se njeriu është “*nenti miscatu cu nuddru*” u vra, vete pa thënë se ishim e ironizojim. Empedokli u vra pse do të prirej ket ai “faregjë” që është qenia ket rrënja e saj te ku shqirren kufinjet te ku principium-i individuationis lidhin njerëzit. Empedokli bëri atë që bën nga mjeshtër i yogas: hapin te një ek/stas ndërgegjen e tij e ja arrën atij “*nenti miscatu ku nuddru*” që është Gjithësja-Një. Ec ja rrufiej siçilianëvet.

Prandaj kur siçiljanët uzarjin këtë frazë sa të të fyejin, ose të të turpërojin, jan e të bëjin komplimentin më të madhë. E të jen siçilianët “*qualichiduno miscatu cu qualichicosa*”. Ja lëmi sherbëtorëvet, skllavëvet tanë këtë nderim të math t’jen “*qualichiduno miscatu cu qualichicosa*”.

“*Unni u piggjaru kishtu*” shkoj ket darka Cinisi-t ki mejtim ndërsa darsmorët na vrejnin se rijim mënjane pa marrpjes ket entusjasm’i tyre per berluskonin e për fashistrat që kumandojn Siçilien...

Rita më qaset e më lipin ndose jam e harepsem. Një bukuri ngë meriton të rritet ndë mest barrin e “algoritmavet e mbetjes gjallë”. Barri i pasionavet. Kapirinj nanë pse disa ninfa ngë dojin ngar ka mosnjeri, sidomos ka perënditë. Dhafna...

Vej ture thën: “Gjellen? Ja lë shkllavëvet tim...”

Atà llarisjin, qeshjin ngamon, pse jan e ironizojin mbë një i cili është “*nenti miscatu cu nuddru*”, të cili ngë ke si t’j’arrëshë pse ng’është mosgjikun si do mos ket një personalitet që fyjet. Herë e herë e xë trëmbja e faregjës. Sikur ecën e bën atë ushtrim të pienj: “kush është e ecin?”. Humbet herë e herë – e kish t’ishin këtò eksasit e Plotinit – te medhitacionat kur këputin mejtimet që lidhjin ket “algoritmet e mbetjes gjallë”.

Thon se mund të këputish frymin, jo mejtimet. Kan ligjë. Po atà të mbetur vet me ndërgjegjen e vartur, e thjeshtë, pa qënur i lidhur me fare gjë, është kputja e mejtimit. Ndërgjegje e vartur. Ngj’emi mos gjikun. Ngj’emi më atë shumiz që na zoteron nga dita. Njëjta e thjeshtë: u jam (faregjë: “*nenti miscatu cu nuddru*”). Sesi mund t’e thomi? Vet kur je shumizë je. Ket e njëjta e thjeshtë ng’je fare gjë.

Rita më vren me sytë të butë. Papas Manoli na pret, Alfredit e mua, me njomësi. Ket e parja ngë na njeh. Pra që i thomi: “Jam Nando Elmo”, me një buzqeshje ironike thot: “Të njoh, të njoh. Djovasinj shkrimet tëndë”. Thot se bën mir të bën polemikat që bën. E fjasmi arbërisht. I prësëntarinj teoritë gjufësore time e thot se jan të mira.

“Ma quello non sa quello che dice”. Jam e gjegjinj thirrmat e profesorvet.

Edhë ki mjeshtëri i lashtë është nga mon përposh provimet e atyrve që din.

I bjemi të dytën botim e fjalorit e Vangjelin i përkthier arbërisht. Më thot: “Shomi si djovasin”.

Sqaronj vuxhin e zë fill: “Libër i gjenealogjis se Jisu Krishtit, të birit Davidhit...” e atë që vjen pra. E ndersa djovasinj ture keier këtù e këtjè si ndodhet, Manolit i zlargofet buza ket një buzqeshje që ngë ka të rrëfier. “ahirna, thot Manoli i kënaqisur; mund të t-e shes Vangjelin, di e djovasin”.

Jam i gozdjasur ka kjo televizionë që vijon gjithë ditën ture kokorrisur. Nanì më siell muzikat e njëj filmi (i bardhë e i zi,

kam besë) me motive ç'ishin të rrëfieme romane. E vemi me kujtimin në Trastevere ku edhë sot kur shkomi Romë, tri katër herë vitin, vemi ture gjetur atë qitet ç'ish katundare e sot u spavë. Ulemi jasht ket një pankin ose mbë skalunet e krojit përpara S. Maria in Trastevere e vijon të ha atà supli çë kan zëmrin akullore pse jan të vluar të ngrijtur. Si thot Manoli kur na mangon gjë kem' t'e marrmi ka litishtja. I thom se është kjò gjëndja jonë ka shumë mot. Shtomi: "U lem e banomi përposh qiellit t' Italisë. Ki ë qielli ynë". Muzika romane na jep ndifjen sa të kapirinjë pse muzika e filmit "Don Juan" me ca këndime spanjol, më njomin shpirtin. Rita. bën tëtum sot, tëtumi i nga gushti të Firmozës. E pra thon vapët. Simbjet patim dy netë vapë Cinisi. Palerm ish ngamon nj'ajr i hollë çë na harepsenej kurmin. Ecjim përposh diellit. Thon vapët. Kem' të vemi të vëmi kalosh gjë më të rëndë. Kem të mbulofemi se tëtum'i Firmozës na kërrusin, jo vet kurmin po edhë trutë. Ësht nj'ajir variu çë fshiti qiellin e ka terraci im duket gjithë fusha e Sibarit me ngjiret e saj: gjelbëri i sheshevet, botëgjina e kodhravet, i verdhi të kallamevet të korravet. E pra i ziu të zjarrevet çë simbjet ditë pas ditje dogjëtun sa më mundëtun (e vera ngë shkoj akoma). Kamnoj na zu frymin. Ndukëtum më kamnuu ndër këto dita sa ngë nduket më dimër përpara vatrës. E pra ngjiri i kalthër i detit, çë sa më se të mblynjë orixntin e hapin... te deti Rita noton si një trilë ndë mest shkëmbevet ket ram e prem gjshtë. Po çë ngë kemi si të notarmi edhë na, rimi sipër shkëmbevet e ruami me zili hollësin e kurmit të saj. Pra do të firaset, pra do të spavet bukuria e pra bukurin e saj do të vem' t'e gjëmi gjetëk. Për ket pikstim bukurin absolute, idhen e bukuris, çë ngë firaset, çë ngë musharet, nëng thafet. Pra djë mbrëma ndersa ishim e mirrjim darken me zotin Trupo e më Dhimitrin tonë na zu shiu. Pra thon vapat. I ka zën vapa disà çivitjotrave ç'erdhtin e na bën komplimentet për sa shkruami ket K. Y.. Dhimitri na shuan disà entusjasme. Pra Rita më tha se ngë do të disenjarin më. I thomi

se ka pjanofortin: tringlis pjanofortin. Çë vete ture gjetur. Ke ndër duar nj'artë hjynore. E më vijin ndër vesh ato sunata e Ravel-it çë na drovolisnej ket shpia e s'jëmës kur ish akoma e vogël e burthonej një mjeshtri veç. Atà të zi ket pajsaxhi çë më hapet përpara jan lakosa ç'i dhëmbet jo vet dheut po edhë zëmris sonë. Jan litinj ata çë ven ture vën zjarrë. Ngë duami të bëmi diskurse raciste, po populi ynë është i butë. Ngë do të mejtonej kurrë të vej t'i vënej zjarrë kështënjavet, fagjevet, farnitavet. Jan litinjët mafjuzëra çë vijin e i vën zjarrë dheravet tanë. Djersëvet tanë. Gjakut e prindëvet tanë. Kem' të thomi edhë se mos njeri ndër tanët sot shurben ndër dherat e se u lenë spilithra gjithaparur. Vreshtat o i shkultin o jan të ngrëna ka baret të ligjë. “Ka të të vër më barrës Shpirti. Ngë mund të duash fare gjë me vëllimin tënd”. Ndërsa vemi ture diskutuar mbë artjen. “Ke të lëshë shpirtin të të qellinj dorin. Ke t'i qëllofesh sipër të bënurit tëndë. Është njetër çë ka të të qellinjë. Sa më rri me sytë të hapur sa më ng'j'arrën merës”. E pra jan atà çë ngë vepruan kurrë. Çë ngë lanë një shkrim. Ngë lanë një pindaksi e ven ture mësuar ka e djatha e ka e ménxhira. Kan edhë atà çë shkruajin edhë kundërstime e ng'i nënshkruajin. Ngë kan kuraxhë? Duan kështù t'jen të ndar ka të tjerët. E kan edhë atà çë ndërsejin të tjerët. Ë kjò Arbëria, thon aqë zoti Trupo sa Dhimitri ndërsa vijin pika shiu të na nxierjin jasht ka perivoli i ristoranteit çë është ket një pllas i moçëm. I cili ka në pamje gurët çë me ngjiret e tyre të ngrohjin zëmrin, ndersa çimenti e ngjiret kimik të rrëmbejin e të ngatarrejin zorrët.

Trokisin ket dera Barbula. Na siell rushë ka nj'udhri çë bën pargolë ket kopsh'i saj. Ka farnita pargolea kle e mbytur ka ferrat, ka spilithrat, ka gjithë baret të ligjë. Simbjet, me gjithë thatësirën ç'është'e vijon ka çë këtë dimër, ngë hëngëtim as një kullumbir as një gërshì, për së dreqti ng'i hëngëtim asedhë ka Zefi çë vjet na paraqiti kullumbër të mbdenjë si koca jonë. Kush'e di ka van shirat. Po na mbami mendë vera me vapë e

thartësi të forta kur ndafej dheu ndër farnitat. Çë vete ture thën nani. Po moti është si është. Kushë është më pacë se moti. Jam e kërkonj Ritën ket disà disinje. Ki ng'është akund i mir. Vëlimi është shurbesi më i ligë. “Këputëni vëllimin, na thoj mjeshtri ynë Osho. *Take it easy*”. E gjegja njëherë edhe ka Karmelo Bene i cili i thërrit një vashanele ç'i thonej: u dua të mos eksistoj, si ti. E ai: Ti ngë ke të duash fare gjë. Mbarò të duash. Vëlimi e vëlimi të vëlimi është deshiri t'eksistoshë. Sa mos t'eksistoshë ngë ke të duash t'eksistoshë”. Ku u bora? Ç'ish'e thonja? Ku, si thoj një çë fjitë pjotë hjë e hollësië, ishnja? Kjo medhitacion ngë ka mbarim.

16 të Gushtit 2007.

E mos ngë kemi si t'i fjasmi kundër papës e kundër pepshut ka Ungra e kundër berluskonit e kundër Prodit e kundër njeriut “in genere” e kundër vetëhesë sonë “in partikolare”, për kë kem të fjasmi? Kem të thomi sa e bukur është vetëhea jonë, sa i bukur është njeriu, sa i bukur është Prodi, sa i bukur është berlusconi, sa e bukur është buzqeshja e tij, sa të bukur jan shqiptarët ç'i troqisjin duart e ng'i duket vërteta se mund t'i gjasjin ture deshruar dreq atà të mira ç'i burthton televisjona e tij? U ng'e di çë vlen hala të shkruash, cilat jan shurbiset e njeriut çë kan cilësi kështu të lart çë mund të helqin vëmendjen tonë. Thon disà se vet Shën Mëria e zoti Krisht kan cilësi e tilla mund të helq vëmendjen tonë. Po sesi kem të fjasmi mbi këta argumente? Sesi fjetë papa, ose sesi fjetë peshkopi ka Ungra? Kem t'i vëmi sentimentalismën ipokrit e retorik pa domethënie ç'i vën disà priftra çë njohmi? Është akcili çë di e fjetë litisht sa mëngu disà shkrimtar t'Italisë i cili ja bredhë me gjithë “i luoghi comuni” çë bëjin retotiken eklesjastike më të kurrivartur e pra vete i gëzuar të vetëhesë së tij ture mejtuar se bëri kush e di kë. Na jemi shumë të kundrastuar ndose vlen hala t'i vesh prapa “i luoghi comuni”

pa kërkuar të ruash mbrënda vetëhesë tënde tekù fshefen gjithë shurbiset që ngë qenë kurrë të thëna. Na kemi besë se kur i vete prapa shurbisevet që qenë tashi të thëna je bënë një mëkatë të madhë kundër Shpirtit; kur ngë lodhe të kërkosh; kur ngë shtie djersë për mos të shkosh ka karrerat ket shkuan të tjerët; mos ngë vëfe te rrëziku të biresh, e të biersh vetëhenë tënde; mos ngë lodhe të kërkosh e vërtetjen e cila ng'i jipet mos njeriu përgjithmonë; që je jeton e bënë? Thot Eraklit: *ψυχῆς πείρατα ἰὼν οὐκ ἂν ἐξεύροιο πᾶσαν ἐπιπορευόμενος ὁδόν· οὕτω βαθὺν λόγον ἔχει/ për sesa mund të vesh ture përshkuar gjithë udhët, kufinjet e shpirti së do t'i gjëje, aqë është i thell logos-i i tij*". Shpirti ka logjismoin e tij te një hon, te një abis, te një humbje, sesi mund mejtomi se ki abis, mund t'jet i thën me një shpreqje e njëjtë si jan "i luoghi comuni" " vendet e gjitve"? E Democriti thot: "*Ἐτεῖ δὲ οὐδὲν ἴδμεν ἐν βυθῶ γὰρ ἡ ἀλήθεια.*" / "Ngë dimi faregjë: shurbiset si na duken (aletheia) jan të shtruara sipër një honë, një humbje, një abisë". Thuana ju si mund të biremi prapa një "luogo comune", "nje vend të gjitve", një stereotip. Po edhe shpirti frynë. Na dirgon disà ikona të vetëhesë së tij. Ikona me të cilat ndërsa burthtofet fshehet, pse atij i pëlqen të fëshefet, e pse i pëlqen t'jet i kërkuar. Me këtë kërkim na dëfton udhën bujare që mund përshkonj njeriu i mir. Alpinist ng'është ai që përshkon udhët të hapura ka të tjerët alpinistra, ose ai që hipet ket çuka e Cervino-t me teleferiken ose me ashensorin. Alpinist është vet ai që hipet ket çuk'e malit për udhë të rea, ka ngë shkoj mos njeri. Nani këta predikatore të dieles që përsëritjin të njëjten fjalë sesi mund t'i thërresmi. Mund t'jet se shpirti ng'i sugjeron një fjalë e re? Or ai ja sugjeron, po atà ng'e gjegjin pse jan të zën vet ka vetëhea e tyre, ose jan e ruajin vet kërthizin e tyre?

E mos thoni se jan të lënë atà që de/lirarjin, atà që daljin ka karrera e të tjervet. Shpirti që frynë bën të "lënë". "Theja mania" e thërrit Platonin vizitin e shpirtit. E thoj se vet të "lënë", të marrët ka "theia mania" i dhan shurbise të mira Greqisë; të tjetër,

atà t'urtë, më shumë gjykim, me shumë arsye, s'i dhan Greqisë kurrë gjë.

Mjeshtër lindorë buddhista lan thën: “Kur përpjek Buddha-n, vrite”. E Etrat e shkretërisë: “Kur do të duket se je sheh Krishtin, vë rë: është djalli ç’është e të mashtron”.

Nani këta tanët ka i marrjin sigurit e tyre? Ka “consensus doctorum”? e kush i siguron “docti”? shpirti? Jemi të sigurët?

Po duami t’ju shtimi te një përrua me këtë diskuturë? Mund t’jet, të lidhur si jini vetëhesë tuaj. Sigurisht, duami t’ju mbami të zgjuar.

Sesà fjëmi në Arbëri, e ja arrën dhëndrri e gjëndeni jasht ka darsmja.

17 të Gushtit.

Dy ditë të dedikuar Ungir kultures e kultures Arbëreshe. Ket e para u paraqit një libër të shkrintarit litì Di Giacomo “L’affondatore di gommoni” tekù fjitet të njëj i riu Shqiptar i sosëm çë pra ndodje të ngurta, më par në Shqipëri e pra n’Itali, priret sa të bënj delarin në Shqipëri. Libri është i botuar ka Mondadori. Ndër atà ç’e djovastin disà më than se libri është interesant, të tjerët më than se disà akunde ngë rrëjiren. Si do t’jet këtë ngë na intereson libri. Na intereson temi i mërgimit. Si pandefjim diskursi vate ket mërgimi si fat i keq e dualtin ket diskutjona gjithë “i luoghi comuni” të komedis e të këndimevet napoletanë. E zun gjithë, sidomos atà çë ngë dualtin kurrë ka shpia, të vaitojin, mbi atyrve çë lën atëdheun... “*quant’è amara sta Merica per nui napulitane*”... më kendojin ndër tru kujtimet e mërgimit tim. Po ngë le të më qeljin ket lloku i tyre lotët e atyrve çë qindruan Ungir e jasht katundit van vet për vakanxat. Kur erdhë hera ime të fjishnja ket mbjedhja e intelektualvet ju hjidha me gjithë ironin e mundëshme. Mbahta se mërgimi është situat ontologjike e njeriut. I cili ng’ “është”, po “ek/siston”, ose

ngamon është “jasht” (*ek*) ka ku “gjëndet”(sistere), anamesa kujtimevet e shprënzat. Njeriu ngamon mërgon ka e shkuanja e vete, edhe vet me sprënxin ket e ardhmja. Është pra një urdhërim, aq i Perëndis Abramit kur i thot “le tët ëmë e tët atë e shpin tënde e ec ket një dhë çë do të të burthonj...”; se i urtësisë, i filosofisë. Pitagora, si thot Jambliku, kapirti se ngë mund të filosofarnej mos ngë kish lën t’jatin e t’jemin e shpin e mos ng’u kish këputur ka gjithë zakonat. Kur Krishti thot: “lë tët ëmë e tët atë e ea prapa mua”, është e thot të njëjtin shurbes. Aì si e Vërtetja ngë ka si mos të thet të njëjtin shurbes. E Vërtetja ngë do se ke t’jesh i lidur mosndonjë zakonie, mosndonjë prindi mosndonjë farje. Kur i thot s’jëmës: ç’është anamesa mua e tij, grua? Është e vë anamesa tij e s’jëmës lirin ka ndonjë lidje.

Për ke na përket neve, mos ng’u kishim bënë mërgimtare Torin mund t’jet se ngë do të na u kishin ndodhur gjithë atò përvoje çë na bënë të lirë ka nganjë lidhje. Na duket se kemi një sy më të pastër sa të shomi shurbiset tona e një llargësi çë na lë të vremi gjithë ngushtjet e atyrve çë qindruan të lidhur fëmilës e zakonavet.

Po vremi ka jetr’anë vet sesa u bëgatëtin me mërgimin e sa qëndruan të vapkë pse qindruan më katund.

Mbrëmanet, ture u prier ka Ungra gjegja një koncert te ku tringëllisjin një grup musikal ka Firmoza, njetër ka Ungra e njetër i bën ka tri të rinjë çë vijin ka Xhermania. Vete pa thën se këtë të tri ishin më të mirtë.

18 të Gushtit 2007.

Edhë sonde Ungër një mbjedhje të urtëshë të katundit sa të fjisjin mbë kulturen e Ungris. Fjalë fort t’urta çë ngan gjithë problemet, ka surbiset e Klishës, të urbanistikës, të kulturë musikale, njera të “lo sportello linguistico”. Vete pa thën se mosnjeri foli arbërisht, asedhë “la sportellista linguistica”. Kur

erdhë turni im shpreha arbërisht një lipje vetëm: “Sesi mund të pritëndoni se t’u bilë mund të fjasjin arbërisht ndose ju, sidomos ndër këtë përpjekje kulturore, ngë fjitni kurrë arbërisht? E kur do t’jet se një vet, vet një do të ngrëfet për të fjas arbërisht? Si doni se gjufa ka të gjellonj ndose ng’i jini një shembul, një, tu bilëve se mund të shprehmi arbërisht çë do duami, e ndose ng’i buthtomi sesi mund të vërtetofet ki mërakull?”

24 të Gushtit 2007.

E kështu i zbuluam gjithë misteret e Bellushit. Te municipi i Firmozës më thon se kurset për të xëjin arbërishtjen ng’i bën mir mosnjeriu, se analfabetra ishin e analfabetra qindruan. Thon se mësimet ja bëjin litisht e se zun, me një urtësi pedagogjike jashtzakonshme, ka gramatika. E jo ka gjufa çë din, po ka pastërsia shqipe.

“U, na thot një ndër skollelet, ngë kapirnja fare gjë. Vet sa varesësha. Venja ket le lezioni vet se isha i obligatur...”

Ndose llecjonat, kështuthëna arbëreshe, ng’i xhuvartin skollelëvedt ka Firmoza, njeriu i kam bën mir ture i mbjuar kushallin me tures, e ki s’è visto s’è visto...

Kapiret pse Ungër ngë na rrëshirin t’i helqëmi “alla sportellista linguistica” një fjalë arbëreshe një...

*** **

Njera sot vendi Internet të Zefit vate në vakand, në pushim. Vemi edhë na një herë e për gjithmonë...

